

BIBLIOTECA

654

Mitresh Kuteh.



vepra letrare 1

Përgatiti

NASHO JORGAQI

Redaktore

ROZETA UÇI


Recensues

Naum Prifti

Teodor Laço



MITRUSH KUTELI (1907-1967)





Po i paraqesim lexuesit serinë e veprës letrare të Mitrush Kutelit në pesë vëllime, ku përmbledhet pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij letrare e shkruar dhe botuar që nga vitet 30 deri në vitet e fundit të jetës së shkrimtarit.

Vëllimi i parë dhe i dytë përmbajnë tregime dhe rrëfenja që autori i ka botuar në librat «**Net shqiptare**» (1938 dhe 1944), «**Ago Jakupi e të tjera rrëfime**» (1943), «**Kapllan Aga i Shaban Shpatës**» (1944), «**Dashuria e barbarit Artan**» (1946) si dhe në disa periodikë të kohës. Disa nga këto tregime u ripunuan nga autori dhe u botuan në librin «**Tregime të zgjedhura**» në vitin 1972. Në botimin tonë është marrë varianti i përpunuar i këtyre tregimeve.

Vëllimi i tretë përmban novelat, tri nga të cilat autori i shkroi si projekte të romaneve të ardhshme, që s'mundi t'i përfundojë. Ato u botuan të përmbledhura në vitin 1983, në librin «**Në një cep të Ilirisë së Poshtme**».

Në vëllimin e katërt kemi përfshirë «**Tregimet e moçme shqiptare**» dhe përrallat, me të cilat autori u drejtohet kryesisht moshave të reja.

Vëllimi i pestë përmban poezi, kritikë le-

trare dhe publicistikë. Krijimet poetike janë marrë kryesisht nga libri «**Baltë nga kjo tokë**» (1973) ndërsa shkrimet kritike dhe studimet janë marrë nga shtypi periodik para – dhe Pasçlirimit, si dhe nga libri «**Shënime letrare**» (1944). Disa nga shkrimet kritike dhe studimet janë parathënie veprash të përkthyer nga autori.

Parathënie

Mitrush Kuteli është cilësuar me të drejtë si një nga mjeshtrit e fjalës shqipe. Me fjalën shqipe ai ngriti një vepër të tërë artistike, që i ka dhënë emër dhe vend të nderuar në historinë e letërsisë shqiptare. Kuteli përfaqëson një nga individualitetet e shquara krijuese të traditës sonë letrare. Një personalitet, ku qëndrojnë së bashku prozatori me poetin, përkthyesi me kritikun letrar, përralltari me folkloristin, publicisti me studiuesin e shkencave ekonomike e mbi të gjitha mjeshtri i tregimit.

Trashëgimia letrare e Kutelit është e gjerë dhe e pasur, origjinale dhe përherë e freskët. Ajo është e gatuar me historinë dhe jetën e gjallë të popullit, sidomos me dertet e gazet e fshatarësisë, me frymën e një psikologjie e mendësie thjesht shqiptare, me indin dhe nervin e fjalës autentike shqipe. Veçanërisht proza i ngjan një rrëfimi të përmallshëm për vendlindjen dhe njerëzit e saj, për karakterin dhe virtytet e bashkatdhetarëve, për visaret kombëtare. Një brendi e këtillë i ka dhënë veprës së Kutelit një fizionomi të theksuar kombëtare dhe frymëmarrje të gjerë popullore. Prej këndej janë përftuar dhe konceptet e tij letrare, që flasin për një ideal estetik të përparuar.

Edhe pse është autor i dy epokave, sepse jetoi dhe krijoi para dhe pas Çlirimit, ai, siç do të shpjegojmë më tej, mbetet një shkrimtar demokrat dhe vepra e tij, duke pasur një thelb të shëndoshë ideoestetik i takon traditës përparimtare të letërsisë sonë. Në rrjedhat e kësaj tradite letrare, Kuteli përfaqëson jo vetëm një këndvështrim dhe vokacion të ri, po dhe një dukuri ideoartistike që ka arsyet e saj. Studimet letrare për të gjitha këto ende nuk e kanë thënë fjalën e tyre të plotë e të gjithëmbarshme, me gjithë vlerat e spikatura të veprës. Një rrethanë e këtyrë, natyrisht, e vështirëson dhe detyrën tonë për të paraqitur, analizuar dhe interpretuar jetën dhe individualitetin krijues të Mitrush Kutelit.

1

Mitrush Kuteli, që është pseudonimi letrar i Dhimitër Paskos (të cilin ai e krijoi nga trajta e shkurtër e përkëdhelëse e emrit dhe mbiemrit të vjetër të familjes), u lind më 13 shtator 1907 në Pogradec. Në këtë qytet të vogël piktoresk në mes pyjeve të gështenjave dhe ujërave të liqenit ai do të kalonte fëmijërinë. Vendlindja i derdhi në shpirt që për së vogli bukurinë e natyrës së saj të mrekullueshme, i foli në gjuhën e butë të trevës së vet, e mëkoi me këngë e zakone shqiptare, i rrëfeu histori të moçme. Pleqtë dhe plakat e mëhallës, gjyshja dhe nëna, e mbi të gjitha i ati, Pandi Pasko Kuteli, u bënë mësuesit e parë të shkrimtarit të ardhshëm. Babai, rrobaqepës shajaku e murator, bojaxhi e zograf, që jeta e detyroi të mërgonte për sa e sa vjet në Rumani, mbeti për Mitrushin shëmbëlltyra e njeriut të ndershëm të punës dhe e shqiptarit atdhetar. Prej tij mësoi së pari të lexonte e të shkruante shqip, dëgjoi të flitet për lëvizjen patriotike e për N. Naçon. Në dyqanin e vogël që i ati e hapi

sapo u kthye në atdhe, duke u bërë ndërlidhës i patriotëve dhe përhapës i librave e gazetave shqip, djali i vogël i Kutelëve jetoi atmosferën e Lëvizjes Kombëtare. Në këtë kohë do të shikonte të bastisej dyqani e shtëpia nga turqit e të burgosej i ati. Vitet e fëmijërisë kaluan nëpër Pogradecin dhe Mokrën e ndezur nga lufta për çlirimin dhe mbrojtjen e atdheut.

Në 1913 Mitrushi nisi mësimet në shkollën fillore shqipe të vendlindjes, të cilën e mbaron në vjeshtën e trazuar të vitit 1919. Po në këtë vit nxënësi Dhimitraq P. Pasko botoi dy vjershat e tij të para «Mëmës Shqipëri dhe «Skënderbeu» në kalendarin «Poradeci», që e nxirnin patriotët e qytetit.

«Bazën e vërtetë letrare, – kujton ai, – ma dhanë përrallat e nënës dhe të fqinjëve, folklori ynë i pasur që nisa të njoh nga vogëlia, librat e librarisë së vogël të babait: «Valët e detit të Spiro Dines, librat e Naimit, «Baba Tomori» i Çajupit, Hriostomatia e Qiriazit etj. etj. I pari Naimi më fali dashurinë e gjuhës, të tokës, të malit shqiptar, mallëngjimin për Abaz Alinë. I falem Naimit!»*

Ishte ky një fillim i mbarë që do t'i jepte zemër autorit tepër të ri dhe do ta lidhte përgjithmonë me letërsinë. Në këto hapa të parë atë do ta ndihmonte dhe një rrethanë fatlume, njohja me poetin Lasgush Poradeci. Ai do të shoqërohej me të dhe do të mësonte prej tij.

I ati, arsimdashës i flaktë, deshi që djali i tij i vetëm të ndiqte më tej mësimet, por mundësitë ekonomike nuk i kish. Prandaj i biri u detyrua të priste dy vjet, derisa siguroi një bursë për në shkollën tregtare rumune të Selanikut. Në këtë qytet të njohur të Ballkanit, Mitrushi mësoi disa vjet dhe, ndonëse kish prirje të tjera dhe ndoqi një degë që s'e kishte për zemër, u dallua si nxënës inteligjent, serioz e plot interesa. Përveç mësimëve, ai u

*) Letër V. Balës, 15 qershor 1963.

dha pas leximeve, u thellua më tej në gjuhën amtare dhe përvetësoi rumanishten dhe greqishten. Ndërkohë merret dhe me veprimtari të gjallë shoqërore patriotike, bëhet një nga themeluesit e drejtuesit e shoqërisë kulturore «Kostandin Kristoforidhi», të krijuar nga nxënësit shqiptarë që mësonin në shkollat e Selanikut. Pikërisht nga kjo kohë fillon interesimi dhe shqetësimi i sinqertë i këtij të riu për ngjarjet politike që ndodhnin në Shqipëri gjatë viteve 20. Kështu, ai do t'i përjetonte si fitoren ashtu edhe disfatën e Revolucionit Demokratik-borgjez, e pastaj do të ndiqte me ankth dramën e lojën tragjike që luhej në kurriz të popullit nga bejlerët me Zogun në krye. I prekur dhe i nxitur nga këto ngjarje tronditëse, Mitushi i ri nisi të shkruajë vjersha e artikuj, të cilat i botoi në gazetën antizogiste «Shqipëria e re», që dilte në Kostancë të Rumanisë.

Më 1928 Mitushi, pasi mbaron shkëlqyeshëm maturën e shkollës tregtare rùmune të Selanikut, shkon në Bukuresht ku hyn në Akademinë e Shkencave Ekonomike. Në Rumani djaloshi poradecar nuk do të ndihej dhe aq i huaj, jo vetëm se këtu ra në një vend mikpritës e me zakone e psikologji të përafërt, por u gjend dhe në një nga kolonitë më të mëdha të mërgimit shqiptar, vatër e njohur për traditat patriotike, trevë e rrahur dhe nga kurbetçinjtë e Pogradecit e të Korçës. Shqiptarët këtu rixirrin gazeta e revista shqipe, botonin libra, kishin hapur shkolla dhe kurse në gjuhën amtare. Prej këndej kishin nisur rrugën e tyre një plejadë letrarësh me emër si M. Grameno, M.S. Gurra, I.M. Qafëzezi etj.

Por prapë ai ishte i huaj në dhé të huaj. Studimet universitare i ndoqi në kushte të vështira ekonomike, duke bërë, siç thotë vetë, «jetë mansarde» e duke punuar ndërkohë edhe si llogaritar. Megjithatë, këto rrethana nuk e penguan këtë të ri, gjithnjë të zellshëm e të etur për dije, të arrinte rezultate shumë të mira në studime dhe të

aktivizohej në radhët e studentëve shqiptarë të Rumanisë. Për disa vjet, ai do të ishte sekretar dhe pastaj kryetar i shoqërisë së tyre. Ndërkaq, letërsia do të mbetej pasioni i tij kryesor, jo vetëm se do të vijonte të shkruante e të bashkëpunonte me shtypin shqiptar, por dhe do të studionte për t'u formuar e për të marrë kulturë letrare. Ai tani lexonte në disa gjuhë.

Studimet e larta ekonomike të cilat i kryen më 1931, Mitrushi i vazhdon më tej dhe më 1934 merr titullin «Doktor i Shkencave Ekonomike» në fushën e çështjeve bankaro-monetare. Tema që mbrojt i kushtohej sistemeve bankare te vendeve të Ballkanit.

Ç'do të bënte tani ky intelektual 27-vjeçar që kish fituar një shkallë të lartë kualifikimi dhe e kish nisur mbarë rrugën e studimeve të mirëfillta ekonomike?

Kthimi në Shqipëri nuk ishte dhe aq i lehtë, nga një anë se s'kishte punë të siguruar dhe fushë veprimi të specialitetit të vet shkencor, dhe nga ana tjetër ai ishte armiqësuar me qeveritarët e Tiranës. Shkrimet e tij letrare e publicistike kishin rënë në sy për frymën antizogiste e antifeudale, kurse studimet ekonomike dalloheshin për qëndrime të hapura kundër ndërhyrjeve të kapitaleve të huaja e sidomos atij italian.

Nisi të punojë në një nga bankat e shumta të Bukureshtit. Më vonë nevojat e jetës e detyruan ta lerë kryeqytetin dhe të shërbejë si nëpunës i kreditit nëpër minierat e Bukovinës, Çernovicës e gjetkë. Ishte ky një rast për të njohur nga afër realitetin e rëndë të kohës.

Puna e ekonomistit, si specialist krediti dhe autor i veprave të kësaj fushe ishin njëra anë e veprimtarisë të gjerë e të frytshme të Mitrushit në vitet 30. Ai botoi një varg librash e broshurash mbi probleme bankare. Ana tjetër ishte letërsia. Në qoftë se me të parën përballonte jetën, me të dytën u përgjigjej prirjeve të brendshme shpirtërore dhe përpiqej të kontribuonte në mbarëvajtjen

e letërsisë kombëtare. Do të vijonte të shkruante me përkushtim vepra të reja, rrëfime dhe vjersha, artikuj letrarë e kulturorë, studime. Proza do të bëhej fusha kryesore, ku do të shfaqej në mënyrë të plotë individualiteti dhe origjinaliteti i tij krijues. Më 1938 botoi në Konstancë përmbledhjen e parë me rrëfime «Net shqiptare». Ishte kjo përmbledhja e parë me rrëfime që autori ia kushtoi «Nënës, për mallet dhe brengat e mërgimit». Libri u botua më 1938 në shtypshkronjën «Albania të Konstancës dhe me gjithë pengesat që dolën, u përhap shpejt në koloninë e shqiptarëve të Rumanisë dhe në Shqipëri. Në letërsinë shqiptare të kohës kjo vepër shënonte një ngjarje. Fill mbas këtij libri autori boton vepra ekonomike, e njuh opinionin vendas me proverba shqiptare (boton librin «Proverbe albanese»), mbledh folklor rumun në Moldavi, boton artikuj për letërsinë shqiptare, polemizon nga pozita shkencore në të mirë të kulturës sonë kombëtare, boton librin «Disa vërejtje kritike rreth librit «Albanica» të zotit Anton Balota» 1937 etj. Në këto punë ai tregon para opinionit të huaj njohje e përgatitje të gjithanshme, seriozitet e kompetencë.

Në kapërcyell të viteve 30-40 Kuteli, si shumë intelektualë të kohës, përjetoi ngjarjet dramatike që ndodhën në jetën e popujve të Ballkanit, pasojat e rënda të agresionit fashist. Shkrimtari u detyrua të kalonte nëpër peripetitë e luftës e të rreziqeve, t'i vuante thellë këto e të pësonte prej tyre derisa kthehet në vjeshtën e vitit 1942 në Shqipëri.

«Si u ktheva në atdhe, — shkruan Kuteli, — ku atë që e pata Nënë e gjeta varr, fillova të shoh «lumturinë» që i kish sjellë këtij vendi zhurmëmadhja perandori: njerëz të varur në tregje, burgje, brenda dhe jashtë Shqipërisë plot me njerëzit tanë, fusha për qëndrimi dhe vdekje...»*)

*) «Sulm e lotë» Parathënia, Tiranë, 1944.

Pas afro një çerek shekulli mërgimi, ai qëndron përfundimisht në atdhe. Kuteli i sapokthyer nga ndarja e gjatë, nuk e ka të lehtë të orientohet në situatën e krijuar në Shqipëri. Jo vetëm se i ka këputur prej vitesh në një masë të madhe lidhjet me jetën dhe me problemet e shoqërisë shqiptare, por duke ushqyer iluzione të paqarta politike, i goditur dhe nga fatkeqësi familjare, ai tërhiqet pas interesave dhe preokupacioneve të veta intelektuale e letrare. Qëndron në vendlindje, çmallet me njerëzit dhe viset e fëmijërisë. Dëgjon me etje të pashuar, mban shënime e regjistron gjithë ç'i thonë e i rrëfejnë bashkëvendësit e tij. Me këto që dëgjon, nis e shkruan rrëfime të reja dhe përgatit përmbledhjen folklorike «Këngë e britma nga qyteti i djegur».

Pas disa muajsh Kuteli fillon nga puna si ekonomist në shoqërinë private «SASTEB», me mendimin se do të merrej lirisht me veprimtari letrare. Ishte kjo një zgjidhje pak a shumë romantike për shkrimtarin në një kohë kur vendosej fati i atdheut. Tërhiqet përsëri nga e kaluara plot ngjyra të forta, kridhet në botën e rrëfimeve. Një valë e fuqishme patriotizmi e përfshin gjatë një udhëtimi që bën në Kosovë, prej të cilit lind «Poemi kosovar».

Një ngjarje e rëndë tronditi jetën e shkrimtarit në shtator të vitit 1943; fashistët i vranë të atin dhe i dogjën shtëpinë në Pogradec. Me flakët e zjarrit u zhdukën mjaft dorëshkrime dhe biblioteka. Dhimbjen e thellë dhe urrejtjen kundrejt perandorisë fashiste, këtij «Xhehenemi të zi...» që i ndezi kjo gjëmë familjare, ai do t'i derdhte ato ditë në vargjet e «Poemit të Shëndaumit».

Me kapitullimin e Italisë fashiste dhe me pushtimin e ri gjerman të vendit, gjendja u rëndua e u ndërlikua. Por hovi i Luftës Nacionalçlirimtare nën drejtimin e PKSH u ngrit më lart. Radhët e Frontit Antifashist u shtuan e u forcuan. Mitrush Kuteli, ndonëse objektivisht kish shumë arsye të lidhej aktivisht me të, qëndroi i mbyllur në rrethin

e interesave të tij krijuese, në pozitën e një qëndrimi «as-njanës. Ai së toku me disa intelektualë të tjerë ushqyen iluzionin e gabuar se mund të distancoheshin nga pushtuesit, duke krijuar një jetë letrare e mendore neutrale e gjoja të pavarur, në emër të mbrojtjes të gjuhës e të kulturës kombëtare.*

Me këto mendime e iluzione Kuteli do të punonte nga vjeshta e vitit 1943 e deri në tetor 1944, duke zhvilluar një veprimtari të gjerë letrare, publicistike, edituese e studimore. Boton disa vëllime me rrëfime, me vjersha e poema, me pamflete, me studime letrare, me folklor, bën përkthime dhe drejton «Revistën letrare» etj.

Krijimtaria e M. Kutelit në vitet 1943-1944 përfshin vepra pothuaj nga të gjitha fushat e letërsisë: tregime e skica, poema e poezi, pamflete e studime letrare, folklor e përkthime. Ai boton radhazi librat «Ago Jakupi e të tjera rrëfime» (1943), «Kapllan Aga i Shaban Shpatës.» Rrëfime-rrëfenja» (1944), «Dashuria e barbarit Artan», riboton «Netë shqiptare» (1944), vëllimin me poema e vjersha «Sulm e lot» (1944), librin «Shënime letrare» (1944), vëllimthin me pamflete «Havadan më havadan» (1944), përmbledhjen folklorike «Këngë e britma nga qyteti i djegur» (1944), vjershat e F. Nolit «Mall e brengë» (1944), tregime të përkthyera «Kapedan Gardani me shokë» etj. etj.

Jeta në kushtet e rënda të pushtimit nazist do ta vënë shpejt Kutelin para provash e situatash të vështira, që do t'i hedhin poshtë iluzionet e «neutralitetit». Duke punuar në Bankën Kombëtare, ai do të shihte nga afër makinacionet financiare të pushtuesit në kurriz të popullit. Në këtë situatë Kuteli mund të tregonte atdhedashurinë e tij përmes një angazhimi e veprimi konkret, larg çdo qëndrimi sositës. Dhe vërtet, ai merr pjesë në aksionin, që zhvillohet në labirintet e Bankës, për sabo-

*) Jorgo Bulo: Tradita e risi letrare, Tiranë, 1981, f. 164.

timin e nxjerrjes së emisionit të monedhës së re dhe e bën të pamundur shtypjen e saj. Pas këtij veprimi, konsulenti teknik shqiptar u diktua dhe urdhërohet të arrestohet, po tamam në këtë kohë, duke qenë i lidhur me forcat e Frontit Nacionalçlirimtar, ai hidhet menjëherë në zonën e lirë partizane.

Ishte tetori i vitit 1944, kulmi i luftës, kur Ushtria Nacionalçlirimtare i qe afruar kryeqytetit dhe kish nisur sulmin vendimtar për çlirimin e atdheut. Në këtë kohë, me thirrjen e Partisë kishin dalë nga Tirana dhe qenë bashkuar me luftëtarët e lirisë dhe shkrimtarë dhe artistë të tjerë patriotë. M. Kuteli do të shkojë në mes partizanëve të Brigadës së Parë të batalionit «Dajti», në Surel e në Shkallën e Priskës. Këtu, ai do të takohet dhe me shkrimtarët S. Spasse e N. Bulka, me artistët T. Tashko e K. Koço etj. Duke kujtuar më vonë këtë ngjarje jo të zakonshme në jetën e tij, M. Kuteli do të shkruajë sinqerisht «e kuptova gabimin tim të madh: pse nuk isha hedhur me kohë në luftën partizane? Mua nuk më ndante asgjë nga kjo lëvizje. Kisha qenë gjithnjë njeri që rron me punën e tij. Veç kësaj, italianët më kishin vrarë babanë.»*) Por më mirë vonë se kurrë. Vonesa e stepja e tij e kishin burimin te drama e artistit të shkëputur nga jeta e gjallë e popullit, nga ato ngjarje të mëdha e procese të reja që po ndodhnin në jetën e kombit. Tani shkrimtari demokrat ishte i vetdijshtëm se kish bërë zgjidhjen më të drejtë. Ishte në nderin e tij e të letërsisë sonë që ai të radhitej me forcat e Shqipërisë së re që po lindte.

Pikërisht në mes luftëtarëve të lirisë, në zonën e lirë partizane, ai do të frymëzohet e do të shkruajë poemën «Letra e fundit e një djaloshi partizan». Ky do të ishte epilogu i krijimtarisë së tij në etapën e dytë. Fill pas

*) M. Kuteli: Kujtime – Arkivi i familjes, Dorëshkrim.

Çlirimit, veç vjershave të tjera, do të shkruajë dhe romanin «Njerëz dhe ujë» kushtuar vuajtjeve dhe qëndrës antifashiste të të internuarve në kampin e Prishtinës, si dhe dramën «Ura» me subjekt nga rindërtimi i vendit, vepra të cilat fatkeqësisht nuk na kanë arritur.

Ditët që u formua Qeveria Demokratike në Berat, M. Kuteli u gjend atje. Ai ishte caktuar një nga tre nëpunësit e parë të Ministrisë së Financave, këshilltar për çështjet monetare. Koha që kaloi në Beratin e çliruar do ti linte mbresa të thella dhe këto shihen qartë në shënimet lakonike të ditarit të tij. Ngjarjet historike do të përtërijnë shpirtërisht shkrimtarin dhe ekonomistin demokrat.

Me gjithë punën e madhe e me përgjegjësi që përballonte si ekonomist, duke dhënë ndihmesën e vet si specialist me përvojë për përgatitjen e ligjeve të para financiare të pushtetit të ri, ai nuk do të linte pas dore punën fisnike të shkrimtarit. Jo vetëm vijon të krijojë vepra të reja, po merr pjesë gjallërisht në jetën letrare të vendit. Është ndër të parët që përshëndet dhe nënshkruan thirrjen për themelimin e Lidhjes së Shkrimtarëve, zgjidhet në këshillin e saj dhe në redaksinë e revistës «Bota e re», bashkëpunon me shtypin («Bashkimi», «Jehona e Tiranës», «Hosteni» etj.).

Nga fundi i viteve 40, Mitrush Kuteli, pas një veprimtarie intensive në Bankën Kombëtare, i kushtohet kryesisht punës letrare. Kalon si përkthyes, në fillim pranë gazetës «Zëri i popullit» e pastaj përfundimisht në shtëpinë botuese «Naim Frashëri». Për afro 15 vjet ai do të dërdhë në lëmin e përkthimeve tërë aftësitë dhe energjitë e veta, përvojën krijuese dhe kulturën e pasur letrare e gjuhësore.

I dhënë në radhë të parë pas përkthimeve, Kuteli gjatë këtyre viteve, sidomos dhjetë vjetët e fundit, do të vazhdojë të merret dhe me krijimtari letrare. Do të me-

rret me rrëfimet, duke i përpunuar e pasuruar, po më shumë do të jepet pas prozës së gjatë, dhe fryt i kësaj është botimi i disa kapitujve të romanit «Në një cep të Ilirisë së Poshtme», i pjesës së parë të një romani tjetër «Mërgim e kthim». Në të njëjtën kohë, duke u qëndruar besnik prirjeve të brendshme, po dhe njohjes së gjithanshme të folklorit, ai i vihet punës për t'i ritreguar brezit të ri legjendat e baladat e popullit dhe i boton këto në vëllimet «Tregime të moçme shqiptare» dhe «Xinxifiloja». Me këtë frymë deri diku autori shkruan dhe novelën «Net me përralla në Fshatin e Qepëve». Ndjeshmërinë poetike dhe përtëritjen e përhershme të artistit, Kuteli do ta tregojë dhe në vjershat që do të botojë kohë pas kohe e sidomos me poemën «Pylli i gështenjave».

Me vepra gjithnjë nëpër duar, me plane të afërta e të largëta, me një angazhim të vazhdueshëm krijues, do t'i kalojnë shkrimtarit vitet. Me gjithë lodhjen dhe sëmundjet e herëpashershme, Kuteli nuk dinte të pushonte. Përkundrazi, mendonte që pasi të kryente romanin ilir, të shkruante triologjinë «Njerëz nëpër jetë», me temë nga vendlindja dhe të hartonte një histori të Bankës Kombëtare Shqiptare, por nuk arriti, se duke gdhirë 4 maji i vitit 1967, disa muaj para se të mbushte të 60-at, zemra e shkrimtarit pushoi përgjithnjë.

Në njoftimin që jepte Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë me këtë rast, thuhej në mes të tjerash se ai «me talentin dhe aftësitë e tij si shkrimtar e përkthyes kontribuoi në prozën shqipe dhe në përkthimin e disa vepra të rëndësishme botërore e vepra të realizmit socialist. Shumë shkrime të Paraçlirimit dhe ato që krijoi pas Çlirimit përshkohen nga fryma popullore, nga dashuria për fjalën shqipe dhe për vendin. Me përkthime, ai ndihmoi për lëvrimin e gjuhës letrare dhe në pasurimin e kulturës sonë.»*)

*) Gazeta «Drita», 7 maj 1967.

Në studimin e trashëgimisë të Mitrush Kutelit duhet mbajtur parasysh se veprimtaria e tij paraqitet jo vetëm poliedrike dhe me nivel të lartë artistik, por dhe si një fenomen letrar me dimension të dyfishtë historik. Duke pohuar këtë, duam të themi se Kuteli është shkrimtar i dy epokave, një dukuri kjo e njohur në letërsinë shqiptare. Por në qoftë se në letërsinë tonë të traditës shtrija e krijimtarisë së një autori në epoka të ndryshme nxjerr para studiuesve disa probleme, ndonëse jo thelbësore, në letërsinë e re ky kalim nga një epokë në tjetrën përbën një proces të ndërlikuar e të vështirë, që lidhet me botëkuptimin dhe metodën krijuese të shkrimtarit. Është fjala për pasqyrimin dhe interpretimin e një realiteti të ri, për përvetësimin artistik dhe zbatimin krijues të parimeve të reja ideoartistike. Kuptohet se dhe procesi i integritit të këtyre autorëve që vijnë në letërsinë e re nga letërsia e traditës, nuk është i lehtë dhe i njëjtë për të gjithë. Një gjë e tillë varet e përcaktohet nga origjina e përkatësia klasore, nga formimi botëkuptimor, nga faktorë të ndryshëm jetësorë etj.

Kuteli mbeti një shkrimtar demokrat, një artist realist, një krijues i lidhur gjithnjë me gurrat shpirtërore të popullit. Vështruar kështu, trashëgimia e tij kryesore i takon letërsisë sonë përparimtare të traditës, ndërsa pjesa tjetër, pa dyshim, bart kontribute të çmueshme që e pasurojnë dhe e rritin figurën e Kutelit si shkrimtar.

Harku i veprimtarisë letraro-kulturore të Mitrush Kutelit ngrihet përmbi dyzet vjet të jetës dhe historisë shqiptare. E ndarë në dy etapa, ajo është pothuajse e barabartë nga pikëpamja kohore, po të kemi parasysh se etapa e parë nis nga mesi i viteve 20 dhe mbyllet në vitin 1944, ndërsa etapa e dytë fillon nga kjo kohë dhe përfundon në gjysmën e dytë të viteve 60. Por pavarë-



Prindërit e shkrimtarit

1911
1912
1913
1914
1915
1916
1917
1918
1919
1920
1921
1922
1923
1924
1925
1926
1927
1928
1929
1930
1931
1932
1933
1934
1935
1936
1937
1938
1939
1940
1941
1942
1943
1944
1945
1946
1947
1948
1949
1950
1951
1952
1953
1954
1955
1956
1957
1958
1959
1960
1961
1962
1963
1964
1965
1966
1967
1968
1969
1970
1971
1972
1973
1974
1975
1976
1977
1978
1979
1980
1981
1982
1983
1984
1985
1986
1987
1988
1989
1990
1991
1992
1993
1994
1995
1996
1997
1998
1999
2000
2001
2002
2003
2004
2005
2006
2007
2008
2009
2010
2011
2012
2013
2014
2015
2016
2017
2018
2019
2020
2021
2022
2023
2024
2025
2026
2027
2028
2029
2030
2031
2032
2033
2034
2035
2036
2037
2038
2039
2040
2041
2042
2043
2044
2045
2046
2047
2048
2049
2050
2051
2052
2053
2054
2055
2056
2057
2058
2059
2060
2061
2062
2063
2064
2065
2066
2067
2068
2069
2070
2071
2072
2073
2074
2075
2076
2077
2078
2079
2080
2081
2082
2083
2084
2085
2086
2087
2088
2089
2090
2091
2092
2093
2094
2095
2096
2097
2098
2099
2100

sisht nga kjo ndarje, veprimtaria e tij duhet parë e analizuar në tërësinë e vet, si shprehje e pjellë e një personaliteti të fuqishëm artistik. S'ka dyshim që Kuteli është në radhë të parë një tregimtar i shquar, me merita të veçanta në letërsinë tonë, por kjo nuk e ka penguar shkrimtarin që gjatë një etape në tjetrën të manifestojë dhe aftësi të tjera dhe të na zbulojë vlera të ndryshme. Kështu, në etapën e parë, ai do të njihet më shumë si tregimtar e poet, kritik letrar e publicist, folklorist dhe editor, (pa lënë anash faktin se u njoh dhe si një ekonomist me emër), në etapën e dytë paraqitet si autor i prozës së gjatë që synon drejt romanit, krijues i novelës-përrallë, ritreguesi dhe përpunuesi i legjendave e baladave popullore, përkthyes-artist i dorës së parë.



S'ka dyshim se forcat kryesore krijuese Mitrush Kuteli i derdhi në lëmin e prozës tregimtare, prandaj dhe dimensionin e tij zotërues është ai i prozatorit. Në këtë gjini Kuteli dha një ndihmesë të veçantë.

Dihet se prozës shqiptare i është dashur të ndjekë një rrugë të vështirë, me zigzage e ritme të ngadalshme. E lindur në një terren letrar poetik, me një traditë jo të pasur të llojit të vet, ajo edhe gjatë Rilindjes nuk e kapërcen nivelin e një proze didaskalike-moralizuese. Vetëm pas Pavarësisë, në kushtet e reja shoqërore historike, në marginat e prozës sonë do të zhvillohen procese të brendshme e do të shprehen dukuri që do ta ndryshojnë fizionominë e saj të përgjithshme. Në këto procese progresive duhet të veçojmë dy momente më të rëndësishme: lindjen e romanit shqiptar në fillim të shekullit dhe ngritjen cilësore që shënoi tregimi në vitet 20-30. Me

MOUSTE
R-46341

këtë të fundit lidhet emri i Kutelit në historinë e letërsisë sonë të traditës.

Në kapërcyell të viteve 20-30 proza jonë, duke ndjekur traditën e shëndoshë tematike të letërsisë së Rilindjes, do të bënte që brenda hapësirave të saj të hynte fryma dhe problemet e mprehta shoqërore të kohës. Poezia, me gjithë nivelin e lartë dhe aftësitë pasqyruese e përgjithësuese, nuk arrinte, për vetë specifikën e saj, ta jepte realitetin shqiptar në gjerësinë e thellësinë që lypte koha. Kjo detyrë i takonte prozës, si gjini letrare e përmasave e përgjithësimeve të mëdha. Po a ishte ajo në gjendje me nivelin e asaj kohe ta bënte këtë? E vërteta është se që të arrihej kjo, proza duhet të fitonte pjekuri, në radhë të parë pjekuri tematike, rrokje të gjerë të jetës shqiptare, trajtim bashkëkohor të problemeve të ditës, si dhe nivel artistik, të cilin e kishte në shkallë të pamjaftueshme. Kualifikimi artistik i prozës, nuk do të ishte diçka në vetvete, një proces i mbyllur, po kjo do të arrihej në radhë të parë në lidhje të gjithëmbarshme me realitetin e gjallë, me problemet, me njeriun shqiptar dhe mjedisin e tij.

Natyrisht, pjekuria e prozës nuk mund të sigurohej menjëherë jo vetëm se lypte kohë, po varej dhe nga faktorë objektivë e subjektivë, letrarë e jashtëletrarë, se tekefundit kish të bënte me rrugën e secilit individualitet në këtë fushë të letërsisë. Prandaj dhe frytet e prozës sonë do t'i shohim nga fundi i dekadës së dytë dhe mes i së tretës. Atëherë do të dalin dhe prozatorët e vërtetë, mjeshtrit e epikës tregimtare si Migjeni, M. Kuteli, N. Bulka etj. Secili do të ketë profilin e tij, që do të varej nga përvoja jetësore dhe natyra artistike, nga konceptet dhe formimi ideo-estetik, nga mjedisi dhe pozita shoqërore.

Krijimi i fizionomisë së prozës sonë, lëvrimi i formave të saj, konsolidimi i mjeteve shprehëse ndoqi rrugë

të ndryshme dhe nuk ishte i barabartë për të gjithë individualitetet krijuese. Në rast se proza e Migjenit karakterizohet nga një frymë e theksuar novatore, si në konceptimin e jetës dhe këndvështrimet e reja, ashtu dhe me shkallën e lartë të origjinalitetit, këtë nuk mund ta themi për të tjerë. Proza e E. Koliqit jo vetëm ishte antipodi filozofiko-shoqëror i asaj të Migjenit, por që ndërtuar sipas modeleve të prozës së huaj, duke pasur parasysh praktikat kozmopolite, me frymë e prirje dekadente të letërsisë italiane. Mitrush Kuteli nuk u tregua novator në shkallën e Migjenit dhe as u mbështet në modele të huaja si Koliqi, ai e ngriti prozën e vet mbi bazën kombëtare, iu drejtua frymës dhe modeleve të rrëfimit popullor. Nga kjo pikëpamje, ajo, në kohën e saj, i kundërvihej atmosferës dhe tendencave kozmopolite të inteligjencies borgjeze e klerikale.

Mitrush Kuteli krijoi rreth tridhjetë tregime, të cilat ai i quan zakonisht rrëfime, ndërsa një pjesë e cilësonte rrëfenja. Me rrëfimet e rrëfenjat ai e pasuroi prozën e shkurtër shqiptare me një tip të veçantë tregimi, që jo vetëm ishte një lloj i ri letrar, por me arritjet më të mira, solli që Kuteli të bëhet pionier i një shkolle të tregimit tonë. Tregimi kutelian, siç do të analizojmë më tej, është ngritur ose shartuar kryesisht mbi trungun e rrëfimit popullor shqiptar.

Ndarja e tyre në rrëfime e rrëfenja është përcaktuar sa nga tematika, aq edhe nga fryma që ngërthejnë. Në qoftë se në të përat zotërojnë tema patriotike-sociale, në të dytat trajtohen motive folklorike e mitologjike.

Siç është thënë me të drejtë*, amfiteatri ku zhvillohen ngjarjet dhe vepronë heronjtë e rrëfimeve të Kutelit

*) Mirash Markaj: Vende dhe njerëz në veprën e Mitrush Kutelit. Kumbesë mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 80-vjetorit të M. Kutelit në Pogradec, tetor, 1987.

janë zakonet, trevat e vendlindjes, që shtrihen nga Guri i Kuq e deri te Guri i Prerë, janë hapësirat plot dritë e ngjyra të Pogradecit dhe viset e ashpra të malësive të Mokrës. Që në rrëfimet e para autori e çon lexuesin në Katjellë, nën brigjet e Mokrës dhe në Peshkëpi, nën Malin e Thatë për ta vazhduar më tej si një rregull të paprekur në Tushemisht e në Grykën e Rrëmenjit, në Pyllin e Gështenjave e në mjediset e qytetit të Pogradecit, pa u larguar asnjëherë nga ujërat e liqenit. Në këtë sfond piktoresk, epik e lirik, të vizatuar me hijeshi dhe saktësi, ndizet e lëviz jeta shqiptare nga penda e Kutelit. Është e njëjta trevë që gjejmë dhe në poezinë e Lasgushit, por në qoftë se poeti i këndoi, prozatori e përshkroi në përmasa të gjera.

Vështruar në rrafsh kohor, rrëfimet e Kutelit kanë për brendi kryesisht të kaluarën, epoka të largëta, kohëra që kanë kaluar në histori. Është zakonisht historia e gdhendur në kujtesën e popullit, të cilin autori e gjurmon, e qartëson, e interpreton dhe e përshkruan. Ajo vjen nga mitologjia, përmes qeniesh e bëmash të jashtëzakonshme, si pjesë e megjulluar e historisë dhe shpalolet në ngjarje e figura të qarta, flet për kohën e Skënderbeut dhe të Bendo Shapërdanit, përshkruan epokën e madhe të Rilindjes, evokon ndodhi të luftërave ballkanike e asaj botërore dhe ndalet në kufijtë midis dy kohërave, kur mbyllen përpjekjet për një Shqipëri të lirë dhe nis zhgënjimi i popullit nga pushteti i bejlerëve. Edhe kur shtjellon ngjarje që e kapërcejnë këtë kufi, ato tregohen më shumë si ndodhi të së kaluarës.

Distancimi kohor te Kuteli merr funksione të caktuara ideoartistike: ai projektton të kaluarën me synime bashkëkohore dhe kjo bën që objektivist të shquhen diferencat në mes epokave, e disa herë të nënvizohen dhe ide të rëndësishme aktuale.

Po të parafrazonim një mendim të Ismail Kadaresë se

në rrëfimet e Kutelit është pikturuar e përshkruar «Shqipëria e përjetshme» që «s'kish asgjë të përbashkët me Shqipërinë zyrtare, me mbretërinë e përkohshme të Zogut*), do të thoshim se Kuteli duke bërë këtë, arrin të krijojë vizionin e botës shqiptare, të jetës së popullit. Edhe pse kjo botë shqiptare duket disi e largët dhe për pasojë, siç thotë Kadareja «mospërfillëse dhe e mënjanuar nga tallazet politike», objektivisht brenda saj vlon jeta e popullit e veçanërisht jeta e fshatarësisë, veprojnë konflikte të ashpra e karaktere të fuqishme, ndizen pasione tronditëse, shtrohen probleme e nxirren mësimet nga historia. Duke arritur të bëjë këtë në rrëfimet madhore, Kuteli i flet kohës së tij në mënyrën e vet dhe hyn në dialog me të. Në këtë pikëpamje, kjo nuk ishte vetëm një ballafaqim tërësor në mes së kaluarës e të tashmes, por dhe një rrezonim idesh, konceptesh e mendimesh midis epokash të ndryshme. ^

Por te rrëfimet e Kutelit, megjithëse e kaluara dhe e sotmja konceptohen si kategori historike dhe e para nuk shkëputet nga e dyta, prapë ndeshemi herë-herë me një frymë ekzaltimi pas së kaluarës, me një lloj magjepsje ndaj njerëzve dhe bëmave të tyre për të cilat flet historia e gojëdhanat. Ai është aq i pakënaqur nga aktualiteti bashkëkohor, sa shëmbëllyrat e vërteta të patriotizmit e vlerave shpirtërore, të burrërisë e urtësisë, të pastërtisë morale i gjen kryesisht në kohë të kaluara.

Në qendër të prozës rrëfimtare të Kutelit është fshatarësia shqiptare, qëndresa e saj për ekzistencë, lufta për liri dhe për tokë. Kjo ka bërë që autori ta vështrtojë e përshkruajë fshatin shqiptar, si arenë luftërash liridashëse e ndeshjesh klasore. Në këtë konceptim historik nuk e ka çuar shkrimtarin një botëkuptim shkençor i ndërgjegjshëm, por vetë jeta, njohja intuitive dhe

*) Ismail Kadare: Parathënia – Vepra e Migjenit, Tiranë, 1989.

përjetimi i saj i thellë, ballafaqimi me situata tronditëse të kohës, të mëkuarit që në fëmijëri me realitetin e gjithëmbarshëm fshatar. Nga ana tjetër, kultura dhe aftësitë e shquara prej ekonomisti e mprehën dhe e bënë më analitik vështrimin e tij. Jeta shqiptare e veçanërisht ajo e fshatit do të kalonte nëpër spektrin e diferencimit klasor. Kuteli në këtë vështrim vihet në rolin e një dëshmitari e përshkruesi që ka marrë anën e fshatarësisë e të vegjëlisë në përgjithësi, që nuk pajtohet me shtypjen e padrejtësitë e kohës.

Problemet që kanë shqetësuar Mitrush Kutelein dhe i ka bërë objekt në rrëfimet e veta, janë ato që lidhen me gjendjen shoqërore dhe ekonomike të fshatarësisë shqiptare. Është fjala për disa nga plagët e rënda të jetës së saj, si kurbeti e hakmarrja, mercenarizmi dhe përçarja, arbitrariteti klasor.

① Kurbeti në rrëfimet e Kuteleit jepet jo vetëm si një e keqe e madhe shoqërore që shkreteton fshatin shqiptar, por dhe si një dramë në jetën e vështirë të fshatarit. Mbi këtë dramë është ngritur rrëfimi «Xha Brahua i Shkumbanores». Pasojat e kësaj drame hedhin hijen e tyre të rëndë dhe në lodrat e ëndrrat e pastra të fëmijëve, si ndodh në rrëfimin «Vendosa të shkoj në mërgim». Në një dimension tjetër është dhënë kurbeti te rrëfimi «Natë qershori», ku tregohet për jetën e vështirë të punëtorëve mërgimtarë dhe lidhjet shpirtërore që mbajnë me atdheun. Vizioni i atdheut sillet i gjallë në tregim sa nëpërmjet kujtimeve të vendlindjes, aq dhe të rrëfimeve të moçme për trimërinë fshatare kundër bejlerëve.

Më gjerë dhe me forcë më përgjithësuese ka dalë në rrëfimet e Kuteleit zakoni i egër i hakmarrjes, zakoni që paraqitet si pjellë e normave patriarkale dhe e politikës përçarëse të pushtuesve e të bejlerëve. Lufta vëllavrasëse në mes dy fiseve, Gjonomadheve e Gjatollinjve («Gjonomadhë e Gjatollinj») është përshkruar aq e egër

dhe e pamëshirshme, sa tingëllon si një legjendë tron-ditëse. Guximi i çartur i fshatarëve, karakteri dhe pasionet e tyre të fuqishme bëhen pre të një zakoni atavik siç është hakmarrja. Duke ecur në vazhden e Rilindjes, autori në rrëfimet me këtë temë, situatave të rënda e dramatike u ka dhënë zgjidhje të drejta dhe realiste.

Zakoni i hakmarrjes dhe i mercenarizmit janë parë nga Kuteli si shfaqje të të njëjtit fenomen dhe të kushteve të përbashkëta shoqërore. Ishin varfëria dhe nevojat ekonomike, padituria dhe ndasitë, ato që ushqenin dhe nxisnin mercenarizmin në jetën e fshatarësisë sonë. Fati tragjik i Gurit dhe i Xhezarit, të cilët duke luftuar për interesa të huaj kuptojnë më në fund absurditetin e veprimeve të tyre, përbëjnë dramën e rrëfimit «Më kot». Evoluimi i mendimeve dhe i qëndrimit të heronjve, kthesa që ata bëjnë realizohet nëpërmjet situatash të përligjura dhe motivesh bindëse nga ana psikologjike. I përafërt me këtë rrëfim për nga idetë dhe koha kur zhvillohen ngjarjet paraqitet dhe rrëfimi «Natë prilli». Ai është ndërtuar mbi një varg ndodhish trimërore që rrëfohen nga Deštani, një malësor nga Mokra i porsakthyer nga lufta. Tregimi tingëllon si një mallkim për gjakderdhjen e pakuptimtë të luftërave të padrejta dhe pasojave tragjike në jetën e fshatarëve të thjeshtë, po dhe si një baladë për trimërinë e shqiptarit, të trashëguar brez pas brezi. Kuvendet dhe rrëfimet e burrave, aktet dhe psikologjia e tyre jepen me nota epike. Për të fshatari e në përgjithësi burri nuk mund të merret me mend pa trimëri, pa akte guximtare. Janë këto që i japin kuptim ekzistencës dhe pozitës së tij në shoqërinë e kohës.

Vend të rëndësishëm zë në rrëfimet e Kutelit tema antifeudale. Kuteli ka, meritën që ta ketë përshkruar ballazi klasën feudale, si një forcë regresive e të zvetënuar shpirtërisht, që shtyp popullin, si klasë që ka tradhtuar interesat e atdheut dhe është bërë vegël e pushtuesve.

Edhe në konceptimin e trajtimit e kësaj teme, ai është nisur nga burimet popullore, nga kronikat e pashkruara të kujtesës së fshatarësisë, nga njerëz dhe ngjarje që i ka njohur e përjetuar në vendlindje, në Pogradec e në Mokër. Mbi bazën e këtyre burimeve të gjalla kanë lindur rrëfimet tronditëse për bejlerët dhe zullumet e tyre.

Duke dhënë në retrospektivë padrejtësitë dhe shtypjen feudale si fenomene që zhvillohen në të kaluarën, kufijtë e së kaluarës me të sotmen bëhen të përbashkët, po të mbajmë parasysh se, sado ndryshime të kenë ndodhur, thelbi shoqëror dhe ekonomik i klasës feudale dhe pasojat e saj në jetën e fshatarit nuk kishin ndryshuar. Mjaf-ton të themi se argumentin më bindës dhe shembujt më të gjallë ia jepte autorit realiteti i fshatit shqiptar të kohës, siç qenë dëbimi me forcë i fshatarëve të Goricës nga tokat e tyre apo konflikti i ashpër i fshatarëve të Peshkëpisë me Istref beun.

Mitrush Kuteli në rrëfimet me temë antifeudale nuk bën histori e as jep kronika ndodhish të ngjara; ai synon të përgjithësojë e të arrijë në tipizimin e fenomenit nëpërmjet karaktereve dhe situatave sa më domethënëse. Feudalët, bejlerët e agallarët janë dhënë si figura përgjithësuese të armiqve të popullit, si shtypës dhe dhunues të fshatarësisë, shpërdorues të pushtetit. Ata dalin uzurpatorë, tiranë e dinakë, të zhveshur nga virtytet e bartës veshesh të ulëta. Kjo është një vijë konstante që ndjek autori në paraqitjen e tyre, nga kohët më të hershme të anarkisë feudale («Natë kollozheku») e deri në kohët më të afërta («Vjeshta e Xheladin beut»).

Ndoshta asnjë figurë tjetër nuk e ka mishëruar aq mirë dhe në një kontekst shoqëror-psikologjik tipin e beut shqiptar të kohës së sundimit të plotë të klasës feudale sa ajo e Olloman beut të «Natë kollozheku». Nëpërmjet një rrëfimi të moçëm që tregon malsori plak xha Martini, zbulohet i shkallëzuar psikologjikisht dhe i nuancuar artis-

tikisht, duke kaluar nga një situatë në tjetrën, tirania e një beu tipik, natyra e tij prej shtypsi e shfrytëzuesi, cinizmi e dinakëria, tradhtia, ndaj atdheut. Po ky realitet do të ishte i njëanshëm, në rast se autori nuk do t'i kishte kundërvënë figurës së beut, figurën antagonistë të fshatarit trim e të paepur siç është ajo e Malush Kautundishtit. Qëndresa e tij dhe e fshatarëve përshkruhen si kundërveprim i fuqishëm ndaj padrejtësisë e tiranisë dhe në qoftë se ata marrin një goditje të rëndë me vrasjen e Malushit, autori nënvizon idenë, se fara e luftës dhe e urrejtjes ndaj bejlerëve rron në shpirtin e popullit.

Jo rastësisht, rrëfimin për zullumet e Kahreman beut në tregimin «Natë muaji shëmbitër» e bën Argjir Vlonjati, një luftëtar i epopesë së Vlorës. Gjithë historia që shpaloset para lexuesit është një zinxhir ndodhish për të këqijat sociale dhe kombëtare të bejlerëve, si shkaktarë të kurbetit të fshatarëve e të mjerimit të tyre, si dhunues dhe shkelës të ndjenjave të të rinjve. Prandaj dhe hakmarrja kundra tij, vjen në rrëfim si rezultat logjik i mbrojtjes së dinjitetit njerëzor dhe i nderit shqiptar. «Ku ka bej... ik një sahat e më parë...» – ky është lajtmotivi i tregimit.

Përgjithësimi shoqëror dhe mishërimi ideoartistik i temës antif feudale në prozën e Kutelit arrin kulmin në rrëfimin «Vjeshta e Xheladin beut». Megjithëse në të zotëron plani etiko-intim dhe figura e beut është lokalizuar në rrethin familjar, kjo nuk pengon që të ndihet sfondi shoqëror e historik. Pozicioni i prerë klasor i autorit dhe vizatimi realist i marrëdhënieve shoqërore në rrëfim janë harmonizuar me thurjen e goditur të subjektit, me rjedhën e natyrshme të situatave, me këndvështrimin origjinal të dhënies së ngjarjeve. Rrëfimi arrin të përftojë një sintezë të vërtetë artistike mbi një fenomen regresiv të jetës shqiptare, siç është ai i degjenerimit të plotë të klasës feudale. Duke pasur një adresë të qartë

historike dhe sociale, Xheladin beu është beu tipik shqiptar me thelbin e vet klasor, me biografinë politike të një mohuesi të atdheut dhe tradhtari të kombit, po dhe të një shfrytëzuesi të paskrupull të popullit.

I vendosur në çifligun e vet, në marrëdhënie brenda dhe jashtë mjedisit, fokusi i shkrimtarit realist, arrin të nxjerrë në dritën e së vërtetës karakterin dhe tipin e tij shoqëror. I pashpirt dhe egoist, njeri me koncepte të ngushta orientale e anakronike, me botën e ngushtë e të varfër prej turçeliu, parazit e vulgar, rob i epsheve dhe i pangopësisë, Xheladin beu është mishërim i klasës së tij. Veçanërisht, ai del mjaft i qartë në marrëdhënie me Marën, që përbën dhe nyjën e gjithë tregimit. Momenti i zbulimit që e bija e Marës është bija e tij, me të cilin ai do të përsëritë lidhjet që ka pasur me t'ëmën, krijon një tension dramatik aq të fortë, sa e çon Xheladin beun në çmenduri. Një akt i tillë duket befasues për klasën e tij që ka humbur shumë nga natyra njerëzore, por në rastin konkret – falë aftësisë së autorit, ai përliqet dhe tingëllon bindës. Ndoshta, një zgjidhje tjetër do ta nxirrte Xheladin beun më tepër një tip patologjik, që do ta kufizonte së tepërmi kuptimin shoqëror të figurës. Rëndësi të veçantë në tregim merr Mara, me peshën e saj të madhe ideo-emocionale. Është kjo grua e thjeshtë, që me karakterin e vlerat e saj shpirtërore, me kurajë dhe këmbëngulje të paepur, e mbërthen Xheladin beun në gozhdat e turpit dhe i jep dënimin e merituar.

* Realiteti historik dhe shoqëror i fshatit shqiptar të rrëfimet e Kutelit nuk mund të merret me mend pa figurën e kaçakut. Kjo kish të bënte me një fenomen të njohur social e politik, të përhapur në vendin tonë gjatë pushtimit osman dhe më pas dhe përfshinte në radhë të parë fshatarësinë, por dhe elementë të vegjëlisë qytetare, që ngrinin krye kundër robërisë së huaj dhe padrejtësive e terrorit feudal. Me këto lidhen sa e sa ngjarje

e akte trimërie, trima e luftëtarë të paepur, për të cilët populli nuk rreshtte së treguari. Pas këtyre figurave legjendare, Kuteli do të magjepsetj dhe do t'i rikrijonte në rrëfimet e tij. Një pasqyrim realist e zbërthim psikologjik mjaft të goditur ka gjetur kjo temë në rrëfimin «Si u takua Ndoni me Zallorët». Është fjala për kaçakët trima të Mokrës e të Gorës që u dalin në mbrojtje fshatarëve, ngaqë nuk i paguajnë xhelepe shtetit dhe u kundërvihen zullumeve të bejlerëve të Velçanit e të Kaprosheve. Autori për ta dhënë këtë ka gjetur një mënyrë origjinale. Nuk merret me luftën e trimëritë e Zallorëve, po i përshkruan ata në një situatë jo të zakonshme në jetën e tyre plot peripecira: tregon se si u takuan kaçakët me Ndonin, këngëtarin me nam të krahinës! E gjithë ideja është kjo: pas natyrës së ashpër të kaçakëve fshihet një zemër e ndjeshme, një shpirt i madh fisnik! Kuteli, ky vërejtës i hollë, gjen rast të japë botën e brendshme të kaçakëve, humanizmin e tyre, ndjenjat e mendimet që u zgjon kënga. Procedura që ndjek autori për zbulimin dhe individualizimin e personazheve është dialogu, një dialog që përtohet nga situatat, në përshtatje me nivelin dhe pozitën e tyre shoqërore, me karakterin e secilit. Në rrëfim janë gërshetuar paraqitja realiste me frymën romantike, notat epike me ato lirike. Mbi bazën e antitezave dhe dritëhijeve, të dhëna përmes detajeve psikologjike dhe rrethana shoqërore, rrëfimi tingëllon bindës, i vërtetë e tepër njerëzor. -

↓ Me fatin e njerëzve të paligjshëm a të hapsanikëve (të burgosurve), shokë të kaçakëve është thurur rrëfimi «Natë vjeshte të tretë». Në qendër të tij është gjyshi, një furrëxhi që punon për Lëvizjen Kombëtare në një nga qytetet e Jugut. Patriot e punëtor, trim e zemërbardhë, ai përfaqëson vegjëlinë e qytetit, të lidhur me luftën për lirinë e atdheut. Para lexuesit kalojnë njerëz e zhvillohen fshati tonë», «Natë muaji maj» etj. janë shkruar mbi mo-

ngjarje nga më të ndryshmet, të cilat përshkruhen nga pozita e psikologjia e një fëmije. Të perceptuara e të rrëfyera prej tij, të mbushura plot nostalgji për kohën e bukur të fëmijërisë, ato janë dhënë me ngjyra idilike e të pleksura me një varg bestytnish. Por këto nuk arrijnë të cënojnë atmosferën plot kolorit të kohës, frymën e sinqeritetit, psikologjinë fëmijërore mbi të cilën ngrihet rrëfimi.

Të tërheq vëmendjen rrëfimi «Qetësi përpara fërtyme», i cili është kuptimplotë për sa i takon evoluimit të botëkuptimit të shkrimtarit. I njëjti rrëfim na paraqitet në dy variante: njëri i shkruar para Çlirimit, me një gamë ideore dhe pasqyruese të ngushtë, dhe tjetri në natyrën dhe përmasat e një vepre të plotë realiste. Merita kryesore e rrëfimit të përpunuar qëndron në faktin se autori ka mundur të pasqyrojë me vërtetësi qëndjen shpirtërore të fshatarësisë sonë në kohën e Pavarësisë, zhgënjimin e saj të thellë dhe konfliktin e përhershëm me bejlerët. Sa asnjëherë, ai e jep masën e fshatarësisë si një masë që shtypet, po dhe zien përbrenda nga urrejtja klasore. Burim i kësaj gjendjeje të rëndë mbetet gjithnjë problemi i pazgjidhur agrar.

Të gjitha këto ide e konstatime kanë gjetur në rrëfim një pasqyrim ideoartistik interesant. Fshati është paraqitur përmes dy forcave kundërshtare: nga një anë janë fshatarët si Dani, Asllani, Xha Dalipi etj. dhe nga ana tjetër bejlerët e kulakët si Myrto beu, Aqo Zylali etj. Tregimi ka një shtrirje të gjerë dhe në të veprojnë shumë personazhe, por idetë e tij i bartin Dani e Aqo Zylali, si figurat më përfaqësuese. Në qoftë se i pari është fshatari i shtypur që e ndien së brendshmi pakënaqësinë e klasës së vet dhe flet për nevojën e luftës për drejtësi, i dyti, është kulaku, përfaqësuesi i parësisë fshatare që shtyp njerëzit e tokës. Natyra e këtij të fundit si shfrytëzues, cinizmi dhe imoraliteti, dalin në raport me Danin, i cili jepet si njeri punëtor e i ndershëm, trim e bujar.

Ai mishëron aspiratat e ndjenjat e klasës së tij, bëhet zëdhënës i saj. Kjo paraqitet në një periudhë qetësie në dukje, po që në fakt është pragu i furtunës së ardhshme, të cilën autori ka ditur ta vizatojë me realizëm dhe emociione të besueshme.

«Qetësi përpara fërtyme», si tregimi më i gjatë i Kutelit ka një frymëmarrje të gjerë jetësore, jo vetëm nga linjat dhe moria e personazheve vepruese, po dhe nga bepatia e fakteve e detajeve, situatave. Ai vlon nga nota të fuqishme të pakënaqësisë shoqërore, nga problemet e mprehta, nga ankesat dhe revolta e fshatarëve ndaj taksave e tagar-mbledhësve, dhjetarëve e taksidarëve. Dendësia e madhe e fakteve dhe linjat e ngritura i japin veprës disa veti të romanit, por mungesa e një fabule qendrore, mozaiku i ngjarjeve, ritmi i ngadaltë kanë çuar në një kompozicion pak a shumë të shpërndarë, në një lloj fragmentarizmi dhe prolisiteti. Megjithatë, rrëfimi është dëshmi se autori po shkonte me sukses drejt një vështrimi e trajtimi më të thellë të temës së fshatit nga pozitë e një shkrintari realist.

Në mes rrëfimeve për fshatin e Kutelit, gjejmë dhe syresh që tregojnë për njerëz dhe ngjarje të cilat nuk trajtojnë drejtpërdrejt problematikën e mprehtë shoqërore dhe gjenden e rëndë të fshatit tonë të Paraçlirimit. Të tilla janë rrëfimet «Ago Jakupi» «Fije nga jeta e Theofil Kostarit» dhe «Fshati im e pi rakinë». Ato kanë të përbashkët botën rustike shqiptare me koloritin e saj të fortë, figura e mentalitete tradicionale, aspekte të jetës zakonore dhe të etikës fshatare, peizazhin piktoresk. Veç kësaj, këto rrëfime, afrohen me njëri-tjetrin nga notat e ekzaltimit e idilizimit të së kaluarës. Pakënaqësia ndaj jetës bashkëkohore e bën autorin t'i kundërvënë të kaluarën dhe këtë ta paraqesë në dritën plot ngjyra të kujtimeve. Zakonisht, këto rrëfime që janë më shumë si ekskursione nëpër kujtime, nuk kanë subjekt, por mba-

hen falë aftësive narrative të autorit dhe lidhjeve asociative.

Rrëfimi për Ago Jakupin është një tregim psikologjik. Ago Jakupi është tipi i fshatarit, i dhënë me mish e me shpirt pas punës. Kuteli te ky njeri synon të mishërojë idealin e burrit shqiptar, njeriun me karakter të fortë e me dinjitet, trim e punëtor, të besës e bujar. Del qartë karakteri i tij, por dhe tipi shoqëror që përfaqëson, individualizmi i pronarit dhe dashuria e njeriut të tokës për punën, pa lënë anash bestytnitë dhe një varg konceptesh fataliste.

Rrëfimi është ngritur mbi bazën e disa situatave psikologjike. Ago Jakupi na jepet në moshën e pleqërisë, në gjendje meditimi dhe evokimesh, të cilat kthehen në qortime të ndërgjegjes, në pendesa për egoizmin e tij. Tregohet se si pleqëria e ka bërë Ago Jakupin më human dhe se frika para vdekjes i ka zbutur zemrën. Në këtë rast nxjerr krye koncepti fetar, se duhej të bëjë mirë që të gjejë mirë te zoti. Meditimet e arsyetimet e plakut zbulohen nëpërmjet monologut të brendshëm, një monologu që zhvillohet në sfondin e peizazhit të fshatit dhe të punëve bujqësore të një familjeje fshatare. Adhurimi që ka autori për këtë figurë e bëjnë atë të mos distancohet dhe tonet e kritikës të jenë tepër të buta.

Edhe «Fshati im e pi rakinë» është një nga rrëfimet piktoreske të Kutelit, me ngjyra të forta e me tone gazmore, kushtuar jetës e zakoneve fshatare. Është fjala për një fshat të krahinës së vendlindjes, për të cilin autori merr përsipër të tregojë për zakonin e të pirit. Tregimi tij është i shtruar, i këndshëm, me humor. Flitet për fshatin që s'di tjetër veçse të pijë, një fshat dionisian, thua se prej andej të ketë dalë perëndia e verës. Vepron në të hiperbola, trazuar me një humor plot kripë, ironia e qesëndia fshatare dhe situatat komike e plot gaz. Problemet dhe hallët e ditës lihen anash dhe vendin e tyre


e zënë situata gazmore e skena gastronomike, rite zakonore dhe përshkrimi i portreteve të burrave, Kudo zotëron nostalgjia për jetën fshatare, që në fakt është malli i pushuar i autorit të sapokthyer nga mërgimi i gjatë. Megjithatë, rrëfimi është plot optimizëm, me një humor realist dhe tepër i këndshëm.

Me nota të thella nostalgjie e malli, është gatuar dhe rrëfimi «Fije nga jeta e Theofil Kostarit», Kemi të bëjmë me një evokim letrar autobiografik, thurur me fije kujtimesh nga fëmijëria e autorit. Zbulohet bota e vogël dhe e madhe e kohës së vegjëlisë, përmes një vargu rrëfenjesh, të lidhura nga rrëfimi aq tërheqës i tregimtarit. Shkrimtari është ndalur në një moment psikologjik tepër të goditur, në kohën kur fëmija kalon nga jeta-ëndërr në jetën e vërtetë. Ky kalim del bukur nga mënyra se si i kujtohen ndodhi të hershme që kanë të bëjnë me këngën e Çeços e me kapedan Kajo Babjenin, me nënën e tërmetin, me lodrat e me besimet e kota. Të gjitha këto rrjedhin nëpër rrëfenjëza e biseda sa të natyrshme aq edhe tërheqëse. Fshatin shqiptar e ndiejmë nga mënyra se si jepen mentalitetet e kohës, sidomos kur flitet për etikën dhe statusin patriarkal, për paragjykimet dhe besytënitë e njerëzve, që kanë përfshirë dhe botën e fëmijëve. Por të gjitha këto, të paraqitura pa sens kritik, marrë në një plan evokues, si një çmallje e autorit me vendlindjen. Vetëm nga fundi shkrimtari gjen rast të shprehë urrejtjen ndaj pushtuesve fashistë që dogjën fshatin dhe vranë njerëzit. Natyrisht, kjo i jep rrëfimit një notë të fortë vërtetësie, po të marrim parasysh kohën kur u shkrua e u botua.


Në prozën e shkurtër të Kutelit hyjnë, përveç rrëfimeve, dhe rrëfenjat, të cilat dallohen nga të parat, qoftë nga brendia dhe fryma popullore, qoftë dhe nga trajta e ndërtimit të tyre. Rrëfenjat si «Natë marsi», «Natë gushti» apo akoma më shumë «Hanet e karvanet», «Lugetërit e

·tive folklorike e subjekte mitologjike. Ato përshkohen nga fryma e baladave dhe nga mënyra e thurjes dhe e të treguarit janë tipike për narracionin popullor. Disa prej tyre trajtojnë motive patriotike, duke evokuar kohëra legjendarë heroike dhe figura të forta trimash, me theksa epikë, që qëndrojnë në mes gojëdhënës e historisë. Të tilla personazhe të skalitura janë plaka Bubullimë dhe Kostandini («Natë marsi»), apo ajo e Nikollë Brandës nga Mokra malore («Natë gushti»). Por me gjithë vlerat që kanë këto tregime, në disa prej tyre autori tërhiqet aq tepër pas ngjarjeve e figurave legjendare, lëshohet aq shumë pas dëshirës për të rrëfyer për gjithë sa ka dëgjuar nga goja e popullit sa harron idetë domethënëse, bie në njëfarë natyralizmi tërhequr nga ndonjë besytyni, koncept fetar, paragjykim a mentalitet anakronik. Natyrisht, kufizimet botëkuptimore të Kutelit dhe ndonjë koncept romantizant i tij nuk e lejuan autorin t'u shpëtojë të gjitha këtyre dobësive, siç nuk do t'i shmanget disa herë trajtimit të së Mirës e të Keqes, apo të ndonjë fenomeni tjetër si kategori abstrakte, të shkëputura nga themeli historiko-social.

Rrëfimet më të mira të Kutelit u takojnë atyre krijimeve të shquara të letërsisë sonë, që lexuesi mund t'u kthehet e rikthehet me dëshirë e dobi. Kjo vjen ngaqë nëpër to rrjedhin burime të jetës së gjallë të popullit, ndihen zërat dhe flakërojnë ngjyrat e saj. Kuteli, duke krijuar një tip të ri tregimi në prozën tonë, dëshmoi e provoi dhe një herë forcën dhe bukurinë e fjalës shqipe, mundësitë e saj të mëdha shprehëse, aftësitë ndërtuese e krijuese. Të gjitha këto e bëjnë Mitrush Kutelin një nga mjeshtrit e tregimit shqiptar.



Shkrimtari me gruan dhe katër fëmijët duke shëtitur me varkë në liqenin e qytetit të tij.



Në dhjetëvjeçarin e fundit të jetës lidhjet e M. Kutelit me folklorin bëhen më të ngushta e më të frytshme. Folklori do të jetë për të jo vetëm burim dhe lëndë për rrëfimet, po dhe një fushë ku ai do të punojë për të thurur vepra të një lloji të veçantë. Në këtë rast raportet që vendos me folklorin janë të drejtpërdrejta dhe detyra që i vë vetes është të kthehet në një ndërmjetës në mes folklorit dhe lexuesit. Ai vihet në rolin e përpunuesit dhe ritreguesit të krijimtarisë popullore. Njohja e thellë dhe zotërimi i gjithëmbarshtëm i kësaj pasurie nga shkrimtari, përvoja e fituar si autor i rrëfimeve në shembullin e modeleve popullore, serioziteti dhe kriteret, sa artistike aq dhe shkencore që ndoqi e zbatoi, solli që kjo ndërmarrje të ketë sukses të plotë. Fryt i kësaj pune është libri «Tregime të moçme shqiptare», me balada e rapsodi popullore, të ritreguara nga autori për fëmijë. Ai nuk ka marrë përsipër t'i rikrijojë e plazmojë motivet, heronjtë, ngjarjet e folklorit, qëllimi i tij është më modest, synon vetëm t'i ritregojë, por bukur dhe saktë. Duke shfrytëzuar epikën legjendare dhe atë historike, ciklin e kreshnikëve të malësorëve të Veriut dhe rrëfimet e moçme të arbëreshëve për Skënderbeun, ai përfton prej tyre, një varg tregimesh në prozë. Puna e tij është puna e një mjeshtri që duke u kapur pas thelbësore, pas ideve të rëndësishme dhe vlerave artistike di ç'të marrë e di ç'të lërë. Me synime e kritere të tilla, ai u është shmangur elementeve fetare e mistike, si dhe anakronizmave gjuhësore. Merita e tij kryesore është se ngjarjet dhe personazhet legjendare, mjediset dhe etikën, motivet dhe elemente mitologjike ka arritur t'i japë si pjellë të jetës dhe historisë së moçme shqiptare, në një dritë të vërtetë, jashtë çdo mjegulle e fantazie boshe.

Bota e ritreguar nga Kuteli është një botë tipike shqip-

tare, me heronj të virtytshëm, me akte të larta njerëzore, me atmosferën epike e ڤllade lirike, me nota tragjike e komike. Në mendjen e lexuesit mbeten të gjalla në radhë të parë figura trimash, burrash e grash, njerëz të paepur, po edhe qenie të mbinatyrshme, tek të cilët janë mishëruar atdhedashuria dhe shpirti lirishtashës, krenaria dhe besa, bujaria dhe guximi.

Puna e Kutelit në këtë vepër nuk është ajo e një ritreguesi të thjeshtë e formal. Duke i kthyer baladat e rapsoditë nga poezia në prozë, ai ka qenë i ndërgjegjshëm se edhe pse e «kanë humbur thelbin e tyre poetik», u ka mbetur skeleti, zhvillimi i ngjarjeve, tharmi ideoartistik; janë këto me të cilat ai operon dhe e ndërton veprën. Për shkrimtarin kjo është një nga format letrare për ta futur lexuesin, sidomos brezin e ri, në botën e madhe të legjendave e rapsodive, në mbretërinë magjepsëse të krijimtarisë së popullit. Ndryshe nga disa rrëfenja të shkruara para Çlirimit, Kuteli lëndën folklorike kësaj here nuk e absolutizon e nuk idealizon, ai trajton drejt shfaqjet e moralit e të normave patriarkale, rendin fisnor. Prej epokave të largëta ai nxjerr mësimë dhe ide të rëndësishme, vlera etike dhe estetike e mbi të gjitha patriotike.

Te «Tregimet të moçme shqiptare» lexuesi vëren dhe ndjen prozatorin e shquar, rrëfimtarin e hollë, artistin që e kupton dhe e interpreton me mjeshtri e mençuri krijimtarinë e madhe të popullit. Me synime të qarta ideoartistike e sens mase, me kritere të sakta dhe shije estetike, ai arrin të përfshijë në ritregimet e veta ngjarjet dhe njerëzit, situatat dhe moralin, epikën dhe lirikën, humorin e folklorit. Të gjitha këto i ka marrë të lidhura ngushtë me elemente të formës, si me dialogun, kompozicionin, detajet, poetikën e rrëfimit popullor. Kështu mund të shpjegohet tërë ai variacion i tregimeve, gjallëria dhe lëvizja që ndihet në to, zotërimi i aksionit dhe vërtetësia e konflikteve. Çelësi i gjithë bukurisë së tyre qëndron pa-

dyshim te gjuha e përdorur aq mjeshtërisht, te stili aq i natyrshëm i ndërtuar me indin dhe ritmin e rrëfimit të popullit.

«Tregimet e moçme shqiptare» janë një mozaik kallëzimesh me të cilat Kuteli çeli dhe një brazdë të re në letërsinë tonë. Kjo është vepra e parë e llojit të vet, kur shkrimtari e ritregon poezinë me gjuhën e prozës, duke iu përmbajtur kritereve të letërsisë artistike.

Nga ritregimet e baladave e rapsodive, të cilat qëndrojnë brenda kufijve të prozës së shkurtër, Kuteli kalon në novelat-përrallë. Nga ky lloj letrar do të botojë dy libra «Xinxifilua» (1962) dhe «Net me përralla në Fshatin e Qepëve» (1964). Ato dallojnë nga njëra-tjetra si nga lënda ashtu dhe nga shkalla e origjinalitetit dhe përpunimit ortistik. Në qoftë se «Xinxifilua» ndjek tragën e «Tregimeve të moçme shqiptare», «Net me përralla në Fshatin e Qepëve» vërtet është shkruar në frymën e gjallë të folklorit, por është një vepër e mirëfilltë origjinale.

Te «Xinxifilua», me përjashtim të disa përrallave të shkurtra, vendin kryesor e zënë novelat-përrallë «Xinxifilua», «E Bukura e Detit» dhe «Hapu malore, mbyllu malore». Në këto kemi Kutelin-përralltar, shkrimtarin aë, ashtu si Anderseni, Peroja, vllëzërit Grim apo Haufi, arrin ta kthejë përrallën popullore në përrallë letrare. Përralla në pendën e tij të sprovuar, jo vetëm i zgjeroi dimensionet e veta, por dhe fitoi cilësi të reja ideoartistike. Kësaj here, ai nuk u nis nga poezia, por nga proza dhe kjo kishte vështirësi serioze që mund t'i kapërcente një prozator me përvojë si Kuteli. Në këtë qëllim, ai nuk ndoqi rrugën e redaktimit të lehtë, apo thjeshtëzimit të përrallës, siç kishin bërë disa autorë para tij. Përralla u konceptua nga ai si një lloj i vecantë i prozës dhe kjo bëri që lënda të kalojë nëpër filtrin e shkrimtarit. Duke e mbryjtur brumin e përrallës popullore, i mbështetur në motivet dhe subjektet, në personazhet dhe situatat tipike,

në mjetet dhe poetikën e rrëfimit oral, ai mundi ta rijapë përrallën si përrallë letrare. Kështu, bashkoi disa përralla, bëri ndryshime, gërshetoi ose zgjeroi linja, skaliti e qartësoi karaktere, u dha ngjarjeve domethënie më të thellë shoqërore, nënvizoi momente të ndryshme psikologjike dhe të gjitha këto me mjetet e rrëfimit popullor dhe një gjuhë të pasur, plot kolorit e të rrjedhshme.

Konflikti në përrallat e Kutelit përftohet nga ndeshja ndërmjet dy forcave antagoniste, kategori të njohura në përrallën tonë, në mes së Mirës dhe së Keqes, së Bukurës e së Shëmtuarës, të Voglit e të Madhit, ku përherë fiton i pari mbi të dytin. Ato mishërohen në personazhe si Xinxifilua, Trëndelinua, Ariu i Madh, e Bukura e Detit, Tatëloshi etj. Ata veprojnë në një atmosferë të vërtetë përrallore, që dëshmojnë për një fantazi të begatë, po dhe në mjedise reale, ku zbulohet bota e kafshëve e shpendëve, e drurëve dhe e bimëve, flora dhe fauna shqiptare, për të cilat autori ka dituri të gjëra e të sakta.

«Net me përralla në Fshatin e Qepëve» zë një vend të veçantë në krijimtarinë e Kutelit, si një vepër që qëndron në kapërcyell të përrallës me prozën realiste. Pikërisht në gërshetimin e harmonishëm të elementeve të përrallës me jetën reale qëndron dhe origjinaliteti i saj. Origjinale jo vetëm për sa tregohet në të, po dhe në mënyrën dhe trajtat që merr rrëfimi, për strukturën mbi të cilën ngrihet. Nëpërmjet përrallave të teta Ngjelës e të së bijës, Fijes, si dhe të bisedave e debateve në kuvendin e burrave, para lexuesit hapet tabloja e shoqërisë shqiptare të viteve 30, problemet e mprehta dhe plagët e saj. Flitet për krizën ekonomike, për mërgimin tragjik, për shfrytëzimin e pakënaqësinë e popullit, siç flitet e lidhur ngushtë me këto dhe për mbretin dhe mbretërinë që e kanë marrë Shqipërinë nëpër këmbë. Nga ana tjetër, novela evokon kohën e Rilindjes, duke nxjerrë mjaft qartë

zhgënjimin e njerëzve të thjeshtë prej pushtetit të feudo-borgjezisë. Të gjitha këto përshkruhen nga pozita demokratike, me një këndvështrim e sens klasor dhe mjete kryesor individualizues që përdor autori janë humori e satira. Nëpërmjet tete Ngjelinës e Fijes, Xexos dhe Lolit tallen e goditen mbreti dhe bejlerët si Mahir beu e Shasho beu, fajdexhinjtë dhe tagrambledhësit. Mendimet e gjykimet e këtyre njerëzve të thjeshtë, qëndrimet dhe karakterizimet e tyre janë realiste e plot jetë. Ato rrëfejnë bukur e shtruar, me objektivitet dhe në rrethana psikologjike të motivuara. Kjo e bën veprën të tingëllojë si një satirë e fortë politike për kohën. Problemi i qepëve të pashitura, si një problem ekonomik i ditës, i jep dorë autorit të ndërtojë një vepër realiste që, jo vetëm hedh dritë në situatat politike e shoqërore të kohës, por, ç'është më e rëndësishme, brenda kësaj kornize pasqyron gjendjen shpirtërore të popullit, i cili, sado që shtypet, nuk e lëshon veten, përkundrazi, është plot dinjitet e krenar, gjykon drejt e di se ç'bën.

Edhe pse novela vuan vende-vende nga zgjatjet dhe proliksiteti, ajo është një vepër e pjekur letrare, qoftë për trajtimin origjinal të temës së vegjëlisë dhe personazhet e tipizuara, qoftë për impulset e forta satirike dhe mençurinë popullore, qoftë dhe për rrëfimin e mrekullueshëm që rrjedh përmes një gjuhe e stili mjeshtëror.

Mitrush Kuteli nuk do të qëndronte në prozën e shkurtyr e as do të kufizohet me novelën përrallë. Pas, kësaj së fundit, ai do të kalonte në prozën e gjatë dhe do të shkruante novelën realiste «Mërgimi», me synimin për ta zgjeruar e për ta kthyer në roman. Por këtë nuk e arriti ta bëjë dhe ajo mbeti novelë.

Te «Mërgimi» Kuteli i kthehet rishtaz temës së kurbetit oq e trajtuar dhe e parapëlqyer në rrëfimet e tij. Ai e njihnte mjat mirë jetën e mërgimtarëve shqiptarë, të cilët shkonin në vende të huaja për t'i shpëtuar dhunës

feudale dhe binin në kthetrat e shfrytëzimit kapitalist. Mbi bazën e kësaj njohjeje, të një lënde të pasur jetësore dhe me koncepte të shëndosha materialiste është ndërtuar novela. Kjo e bën të dallohet nga rrëfimet e tij të Paraçlirimit për kurbetin. Duke iu përmbajtur një trajtimi realist, pa iu shmangur notave romantike, për novelën janë të huaja shfaqjet romantizante dhe idealizuese. Vendin kryesor e zënë tabloja e gjallë e shfrytëzimit kapitalist të mërgimtarëve, procesi i zgjimit të ndërgjegjes së tyre klasore, përhapja e ideve revolucionare dhe organizimi i tyre politik. Kulmin ajo e arrin me organizimin e grevës, ku punëtorët shqiptarë marrin pjesë aktive. Por në mes mërgimtarëve shqiptarë autori bën diferencime, kur nga një anë paraqet punëtorët si Xoxi, Mihali etj., që ngrihen kundër pronarit kapitalist siç është Hocu, dhe nga ana tjetër parinë, si Postoli me shokë. Del qartë fryma e solidaritetit proletar, vendosmëria e bindja në të drejtat e tyre. Megjithëse vepra nuk i ka shpëtuar skematizmit dhe materiali jetësor nuk ka arritur tërësisht shprehjen e vet emocionale, dhe ndonjëherë tregimi qëndron ndërmjet përshkrimit letrar dhe kujtimeve, prapë vërehen përpjekjet e sinqerta të autorit për ta ridhënë realitetin nga pozita ideoartistike të përparuara.

Krijimtaria e Kutelit në dhjetëvjeçarin e fundit dëshmon se ai synonte gjithnjë e më shumë drejt formave të gjera të prozës epike. Duke mos u mjaftuar me novelën, ai bën përpjekje për të shkruar drejt romanit. Përçapjet e para romaneske ndihen që të bërthama disiplanesh e tregimit të gjatë «Qetësi përpara fërtyme» ose tek ideja që tregimet «Vendosa të shkoj në mërgim» dhe «Unë, Çuli dhe Marina» të ndërroheshin, siç pohon vetë, «në një roman të jetës fëmijërore».

Por punës së vërtetë për hartimin e një romani, Kuteli i hyri kur nisi të mendojë seriozisht dhe të merret praktikisht me veprën «Në një cep të Ilirisë së Poshtme». Ish-

te kjo një dëshirë e hershme, që i lindi qysh në vitet 40, dëshira për të trajtuar sa më gjerë temën e qëndresës të të parëve tanë përballë rrebesheve të historisë. Për këtë, siç thotë shkrimtari, zbriti «në rrënjët ilirike, i joshur pas krenarisë shqiptare, prej ritmit teutan e krutan» të popullit të tij, pas gjithë atij vargu të paprerë luftërash heroike për të mbijetuar në trojet e veta. Ai i vë për detyrë vetes që «të bëjë... të flasin varret e lashta ilire, gurët e kështjellave tona të moçme, të tregojë qëndresën e fortë të një populli të fortë dhe kjo qëndresë të bëhet shëmbëlltë për brezat e rinj...*)»

Një detyrë kjo sa e ndërlikuar dhe e vështirë, por që Kuteli iu vu tërë seriozitet e përkushtim, duke u përgatitur për vite me radhë shpirtërisht dhe intelektualisht. Për këtë e ndihmuan kultura e themeltë klasike, njohja e thellë e historisë, sidomos e asaj të lashtësisë, interesat e gjalla arkeologjike.

Frytet e kësaj pune u dukën që në kapitujt e parë, të cilët i botoi dhe në revistën «Nëntori» (1965), me shpresë për ta vazhduar veprën më tej. Mirëpo autori nuk arriti ta bëjë këtë dhe romani mbeti i pakryer. Ai u botua më vonë, ashtu siç kishte mbetur në formën e dy novelave postume në librin «Në një cep të Ilirisë së Poshtme» (1983). Por edhe pse ato janë pjesë të një vepre dhe kanë aspekte problemore e tematike të përbashkëta, prapë secila ka vlera dhe tipare të veçanta dhe si të tilla plotësojnë njëra-tjetrën në paraqitjen e botës ilire. Kështu, novela e parë «Në një cep të Ilirisë së Poshtme» i kushtohet luftës së ilirëve për mbrojtjen e trojeve të tyre nga armiqtë, kurse e dyta «Nga Dyrakiona në Bardhonë» merret më shumë me jetën e shoqërisë ilire, me aspekte social-klasore të saj. Njëpërmjet një imagjinate të gjallë, autori ka ditur të depërtojë në hapësirat e historisë so-

*) M. Kuteli, Kujtime – f. 16, Dorëshkrim.

në të lashtë, ta evokojë dhe konkretizojë këtë realitet të largët në personazhe e ngjarje, në veprime e situata me vlera artistike e njohëse.

M. Kuteli e çon lexuesin në shekullin IV-II para erës sonë, në periudhën helenistike të mbretërimit të ilirëve, kur të parët tanë luftonin kundër pushtuesve maqedonas e romakë. Ngjarjet zhvillohen në Ilirinë e Poshtme, në trojet e Shqipërisë së sotme. Në të dy novelat del tabloja e jetës ilire, bota shpirtërore, konceptet e mentalitetet e tyre, niveli i kulturës materiale, organizimi shtetëror dhe struktura shoqërore.

Të dy novelat kanë për emërues të përbashkët tematiko-jetësor botën ilire, të cilën autori e përfton nga një pasuri e madhe historike, mitologjike, folklorike, etnografike etj. Duke synuar që ta japë sa më gjerë e imët jetën e të parëve tanë, ai i përshkruan ata si njerëz që kanë një nivel të lartë qytetërimi për kohën. Ilirët janë luftëtarë të shquar, por njëkohësisht bujq e blegtorë të aftë e me tradita. Autori flet për zejet e tyre, për armët e për veshjen, për jetën materiale, tregon për toponimet e antroponimet ilire. Aq thellë ka hyrë ai në këtë univers të antikitetit, sa deri dhe florën e faunën e Ilirisë së Poshtme e përshkruan me hollësi, saktësi e laryshi të habitshme.

Novelat janë një shembull i prozës historike, ku e vërteta shkencore shkrihet me të vërtetën artistike, ku kultura e gjerë, erudicioni i pasur gërshetohet natyrshëm me fantazinë dhe imagjinatën krijuese. Vlera e tyre rritet, po të kemi parasysh se e gjithë lënda është konceptuar e përpunuar në mënyrë poetike. Historia dhe jeta kanë kaluar nëpër filtrin e një artisti të hollë dhe rolin kryesor në këtë proces e zë gjuha. Në përdorimin e plazmimin e saj dhe në këtë temë komplekse Kuteli tregohet mjeshtër. Në qoftë se nuk ka arritur ta bëjë këtë në ecurinë e zbulimin e plotë të karaktereve, e ka reali-

zuar plotësisht në përshkrimet, në përshkrimin e natyrës, të veprimeve, të portreteve. Këto kanë një plasticitet të riallë dhe nuancat e ngjyrimet e ligjërit të tyre ndërrojnë natyrshëm në varësi me situatat psikologjike, me funksionin emocional që merr peizazhi e mjedisi, vepri apo atmosfera në vepër. Nga kjo pikëpamje, novelat janë të mbushura plot me faqe antologjike ku gjuha shqipe këndon dhe zgjon kënaqësi të vërteta estetike. Por në tërësi vepra edhe pse nuk u krye, duhet çmuar jo vetëm për vlerat e shquara njohëse dhe edukative, por si shembull, se ç'fryte mund të japin devotshmëria dhe talenti i artistit, qoftë dhe në trajtimin e një teme historike nga lashtësia.

4

Poezia

Poezia është një rrjedhë tjetër në shtratin e gjerë krijes të Mitrush Kutelit. Ai do ta lëvrojë këtë pothuajse gjatë gjithë jetës, duke iu kthyer herë pas here, sidomos në momente të veçanta. Në këto raste Kuteli, në vend të tregojë me anë të rrëfimeve, shprehet me gjuhën eliptike të poezisë. Prandaj dhe vjershat e tij vështruar në tërësi i ngjajnë një ditari poetik.

Nga Kuteli kemi disa vëllime me poema e poezi; «Sulm e lot» (1944), «Pylli i gështenjave» (1958) dhe përmbledhja postume «Baltë nga kjo tokë» (1973).

Është krejt e kuptueshme që edhe Kuteli ta niste rrugën e gjatë të letërsisë nga poezia. Pas provave të para, vjershat të cilat paraqesin interes letrar janë ato që botoi në gazetën «Shqipëria e re» nga viti 1925 e këndeji. Dy të parat, «Pranë Shëndaumit» dhe «Të bardhat» lindën si nevojë për t'u çmallur me vendlindjen në dhe të huaj. Por vjershëtori i ri nuk do të mbetet me kaq. Malli i vendlindjes do ta çonte në shqetësimet për fatin e

atdheut. Zemërimin dhe urrejtjen ndaj tradhtarëve të kombit dhe uzurpatorëve të pushtetit në Shqipëri, ai do ta shprehte dhe nëpërmjet vargjeve. Në këtë temë, poeti i ri krijoi vjershën «Kënaqë», me anën e së cilës satirizon klikën feudale, vajton B. Currin e L. Gurakuqin dhe paralajmëron rrezikun italian. Duke shkruar në frymën e folklorit, poezia e Kutelit në këtë kohë, dëshmon jo vetëm për talentin e tij, por dhe për mendimet e përparuar. Ajo paralajmëron prozatorin e temave antif feudale.

Poezia e Kutelit do të rizgjohet më me forcë në vitet 40, në rrethanat e ngjarjeve dramatike të luftës dhe masakrave të fashizmit, të cilat poeti do t'i stigmatizojë nga pozita atdhetare në vëllimin «Sulm e lot». Do ta bëjë këtë në poemën «Kartë nga Shëndaumi», përmes monologut të një gruaje kundër perandorisë që i ka djegur shtëpinë dhe njerëzit e dashur, por dhe kundër zotit dhe gënjeshtreve të fesë. Dhimbja është dhënë me ngjyra tepër të forta, dhe ndonëse urrejtja e tragjizmi nuk arrijnë frymën heroike, ato përskohen nga nota të thella proteste. Këtë do ta bëjë dhe në vjershën «Balta shqiptare» që tingëllon si një klithmë dashurie për tokën amtare, që vuan nën çizmen e huaj.

Një tingëllim tjetër do të marrë poezia e Kutelit, kur ai do të frymëzohet nga heroizmi partizan dhe kjo do të ndihet qartë në poemën «Letra e fundit e një djaloshi partizan». Është vjersha që hap vargun e vjershave që Kuteli do të shkruajë herë pas here pas Çlirimit. Është një formë kjo jo vetëm për të pikëzuar gjendje të ndryshme shpirtërore, por dhe për të trajtuar disa motive të parapëlqyera prej tij.

Motivet e parapëlqyera të poezisë së Kutelit do të jenë ato të lashtësisë ilire dhe të jetës së re, të dashurisë për tokën amtare dhe gjuhën shqipe, evokimi i historisë shqiptare dhe përjetimi i sinqertë i realitetit socialist. Gjejmë në to të përvijuar njeriun shqiptar dhe peiza-

a të bibliografia letrare e veprave të huaja që solli në gjukretr shqipe M. Kuteli nuk do të ishte e plotë, po të mos përmendim përkthimin e poezisë së P. Nerudës («Zgjohu druvar!...»), të P. Eluarit («Vjersha të zgjedhura»), prozën e Lu Sinit («Tregime të zgjedhura») apo të tregimeve turke, persiane, arabe, mongole, polake etj. si dhe një bibliotekë me përralla të popujve të ndryshëm. Vargun e përkthimeve të veta, ai i mbylli me «Reportazhin me litar në grykë» të J. Fuçikut.

Bilanci i pasur i veprave dhe niveli i lartë i shqipërimeve e bëjnë M. Kutelin një nga figurat qendrore të shkollës shqiptare të përkthimit. Ai dha në këtë punë sa të mundimshme aq edhe fisnike, gjithë ç'i duhen një artisti të vërtetë. Në metodën dhe praktikën e përkthimit, shkrimtari-përkthyes u udhëhoq nga parime që i qëndronin besnik veprës, brendisë e frymës së saj, individualitetit të autorit, veçorive stilistiko-gjuhësore. Përkthimet e Kutelit në këtë kuptim kanë kaluar nëpër një proces pune rrikrijuese për të përcjellë te lexuesi shqiptar sa më saktë e më bukur thelbin ideoemocional të veprës, thellësinë e mendimit e të ndjenjës, nuancat e ngjyrimet, hijeshinë e origjinalit. Veçanërisht, mjeshtëria e ridhënies me art të Kutelit shkëlqen në lëmin e prozës, ku bagazhi i pasur gjuhësor dhe vlerat e holla estetike të autorëve të huaj gjetën shpesh një ekuivalencë të përsosur në gjuhën shqipe. Kjo i bën dhe shqipërimet e tij pjesë të pandarë të kulturës sonë dhe shkollë për brezat e rinj të përkthyesve.

Vepra e gjerë letrare e Mitrush Kutelit përbën, pa dyshim, një nga përvojat artistike më të vyera dhe më interesante të prozës sonë; Një përvojë origjinale, që mban

vulën e një personaliteti të spikatur krijues dhe qv_o-riton të njihet e të studiohet seriozisht.

① Në radhë të parë duhet thënë se Kuteli është nga ata shkrimtarë që tërheq vëmendjen për identitetin e theksuar kombëtar, për një imazh të gjallë shqiptar. E kur themi kështu, kemi parasysh tiparet e qenësishme të shqiptarit, të jetës e të historisë së tij, të mendësisë dhe të filozofisë popullore, të botës shpirtërore e të konstitucionit psikik. E vështruar më gjerë, vepra e Kutelit në sfondin e përgjithshëm të jetës dhe të halleve njerëzore i ngjan një afresku me të vërtetë shqiptar.

Autenticiteti kombëtar në krijimtarinë e shkrimtarit tonë është i gjithëmbarshtëm, pasi rrok disa nga sferat më të rëndësishme të botës shqiptare e në radhë të parë të fshatarësisë, si bartësja kryesore e tipareve e vlerave të etnosit tonë në të kaluarën. Ato nuk kanë të bëjnë me shfaqje të jashtme, nuk janë ngjyime piktoreske, po me koncepte themelore për jetën dhe marrëdhëniet ndër-njerëzore, për kategoritë filozofike dhe juridike, etike dhe estetike. Të gjitha këtyre Kuteli është përpjekur t'u japë vend në veprën e tij dhe ta bëjë këtë nga një pozitë e përparuar, nga pozita e fshatarësisë dhe e vegjëlisë përgjithësisht.

② Vepra e Kutelit është e mbrujtur me një frymëmarrje të gjerë popullore. Vërtet autori pohon se ushqimi i tij i përhershëm ka qenë «piksëpari folklori dhe përsëri folklori», se ai është gatuar që për së vogli me gojëdhënat, me rrëfimet e këngët e popullit dhe kanë qenë këto përcaktuese në formimin e tij si shkrimtar.

Tipike për karakterin dhe frymën e theksuar popullore të krijimtarisë së Kutelit janë rrëfimet e tij. Autori nuk ngurron të tregojë se ç'rrugë dhe procedim ideoartistik ka ndjekur për krijimin e tyre. Ai është nisur kurdoherë nga realiteti i drejtpërdrejtë, nga ngjarje të përjetuara

a të dëgjuaara prej popullit, nga njerëz dhe mjedise konkrete e të vërteta.

Puna e autorit me rrëfimet, e hetuar nga afër, tregon se sa i vështirë dhe i mundimshëm ka qenë procesi i krijimit të tyre. Shkrimtar me ndërgjegje të lartë artistike, përherë i pakënaqur nga vetja, Kuteli ka përballuar me sukses të gjitha detyrat komplekse që nxjerr ky lloj i veçantë i prozës tregimtare. Ishte në natyrën e tij përpunimi, përsosja, e vazhdueshme e çdo vepre, si një ligj i detyruar, të cilit ai nuk iu shmang asnjëherë. Duke pasur «mbi kokë mallkimin e madh të paqetësisë», shqetësimin dhe përgjegjësinë e përhershme të artistit të vërtetë, Kuteli do t'i ripunonte shkrimet 5-6-7 herë, i nisur nga bindja se «në art rruga ndaj së thjeshtës shkon shpesh nëpër të ndërlikuarën, të cilën punonjësi i artit duhet ta hedhë poshtë, ashtu siç hedh bujku kashtën dhe ruan dritin. Dhe kjo kërkon shumë punë, durim, autokritikë të heshtur, dialektikë me vetveten, kështu që më e mira të zëvendësojë të mirën.»*)

Në studimin e figurës së Mitrush Kutelit si shkrimtar një rëndësi të veçantë ka dhe njohja dhe përcaktimi i metodës artistike prej së cilës u udhëhoq dhe zbatoi në krijimtarinë e tij. S'ka dyshim, se Kuteli është nga ata shkrimtarë të periudhës së Pavarësisë që kontribuoi për t'i hapur rrugë të gjerë e për ta konsoliduar realizmin në letërsinë tonë. Dihet se proza do të kalonte nëpër një rrugë të mundimshme nga romantizmi në realizëm dhe kjo, jo vetëm për shkak të traditës së fortë romantike, por dhe të rrethanave historike dhe gjendjes së atëherëshme të shoqërisë shqiptare. Në këto kushte, letërsia e sidomos proza detyrohej të anonte e flirtonte me letërsinë sentimentaliste. Do të ishin fryma dhe format e kësaj së fundit që do të ndiheshin më shumë në

*) M. Kuteli – Kujtime, f. 16.

prozë. Dhe që të kapërcehej kjo gjendje, duhej jo vetëm ngritja e nivelit të përgjithshëm të letërsisë, por dhe talente të fuqishme. Për këtë do të kontribuonte me sukses Migjeni, por kontribut do të jepte dhe Kuteli me rrëfimet më të mira. Disa nga problemet shoqërore që ngriti, fryma antifeudale, pakënaqësia e fshatarësisë, stigmatizmi i pushtetit dhe normave morale të bejlerëve, krijimi i karaktereve të fuqishme dhe i mjediseve të besueshme e bëjnë prozën e tij më të shëndoshë t'i takojë letërsisë realiste. Aq më tepër, këtë mund ta themi për rrëfimet e viteve të fundit, që u ripunuan nga pozita të avancuara dhe me koncepte të reja ideoestetike.

Por në tërësi proza e Kutelit, e parë në vështrim retrospektiv, në vijat e saj të përgjithshme paraqitet siç është pohuar me të drejtë «një prozë realiste, me theks të dukshëm romantik*»). Kjo e dyta do të ndihet kryesisht në evokimin e së kaluarës, në trajtimin e figurave legjendare dhe bëmave heroike, në poetizimin e jetës zakonore dhe të natyrës shqiptare. Notat romantike u përfatuan, jo vetëm se një pjesë prozës së tij u shkrua me mallin e nostalgjinë e mërgimitarit, por nga që autori duke u mbështetur në prozën popullore, mori prej saj dhe frymën romantike.

Individualiteti i Kutelit si krijues i shquar, mjeshtëria e lartë artistike, mund të vërehet në disa nga aspektet e punës së tij prej prozatori. Proza e tij ka karakter përgjithësisht liriko-epik dhe cilësia e saj përcaktuese është natyra rrëfimtare. Kjo do të thotë se shkrimtari e përjeton realitetin kryesisht nëpërmjet rrëfimit. Krijimi kutelian qëndron në mes frymës lirike dhe trajtave epike, ku shpesh zotëron e para, sepse siç thotë dhe autori «për të rrëfyer duhet një fluid lirik**»). Në këtë pikpamje na duket

*) Historia e letërsisë shqiptare — f. 54.

***) Shënime letrare. Idem, f. 141.

i drejtë përcaktimi se rrëfimet e këtij shkrimtari janë «krijime me një nënshtrat të fuqishëm lirik, i cili aty-këtu del në sipërfaqe për t'u përthithur me elementët zotruar epikë e dramatikë».

Rrëfimet e Kutelit kanë një varg tiparesh që përcaktohen nga brendia e larushia tematike, por dhe nga veçansia e mjeteve shprehëse, nga poetika që ai ka shfrytëzuar në raste të ndryshme. Poetika e rrëfimeve të tij është poetika e rrëfimit popullor, veçse e përpunuar artistikisht nga mjeshtri. Një shqyrtim nga afër nxjerr në pah natyrën dhe veçoritë e poetikës kuteliane. Së pari, në të, ashtu siç ndodh dhe në rrëfimin popullor, një rol të rëndësishëm luan figura e rrëfimtarit. Ai krijon raporte të caktuara me dëgjuesin, me kohën dhe hapësirën dhe kthehet në personazh unik i gjithë prozës së tij tregimtare. Ai dhe autori shpesh shkrihen në një ose zëvendësojnë njëri-tjetrin.

Elementet e poetikës në rrëfimet e Kutelit duhen parë dhe në veçoritë e subjektit e të fabulës, në pasurinë e detajit, në variacionet e ligjërit, në origjinalitetin e kompozicionit. Fabulat kuteliane paraqiten në dukje të thjeshta, pa ndërlikime e me një zhvillim të natyrshëm, por rrokin shumë anë të realitetit, duke depërtuar në thellësi e duke u shtrirë në hapsirë e në kohë. Në qendër merren ngjarje të rëndësishme, çaste kulmore të jetës, dhe ndërthuren konflikte të ashpra me tension dramatik. Përveç kësaj, Kuteli në prozën e tij rrëfimtare e historike udhëhiqet nga parimi retrospektiv i evokimit të kohës së fabulës dhe kohës së veprimit. Kjo do të thotë se largësia kohore është veçori e poetikës së tij.*

Në rrëfimin kutelian detaji është një nga mjetet më efikase të procedeut artistik dhe si i tillë paraqitet i shu-

*) Sali Bashota «Modele të veçantë të një shkrimi. «Rilindja», 14.1.1989.

mëllojshëm. Me vetitë e tij artistike, detaji i shërben drejtpërdrejt procesit të individualizimit e të tipizimit, konkretizon natyrën e fenomenit në përputhje me logjikën psikologjike e artistike.

Ashtu si te tregimtarët e tjerë, dhe te rrëfimet e Kutelit gjejmë edhe gjykimin e rrëfyesit mbi atë që tregon, siç gjejmë dhe përshkrimin, dialogun e monologun, por merita e autorit tonë në këtë rast është se këto forma e mjete të njohura i ka përdorur e shfrytëzuar me origjinalitet e me mjeshtëri të lartë artistike. Kështu, vërejmë se të treguarit e Kutelit është sa analitik aq edhe sintetik, i shprehur zakonisht me ritmin e kadencën e bisedës, me një dinamikë të brendshme. Mënyra si tregon e rrëfen jo vetëm pasqyron e vizaton, por bën të përftohen veprime e lëvizje.

Shprehja më e plotë e mënyrës së rrëfimit të Kutelit janë përshkrimet. Përshkrimi tek ai është i fuqishëm, karakterizues dhe i harmonishëm. Autori e përdor si për të dhënë situata e mjedise, ngjarje dhe ndeshje, por ai merr vlera të veçanta kur është fjala për peizazhin e portretin. Prandaj, me të drejtë mund ta quanim poet i shpirtit shqiptar dhe këngëtar i natyrës shqiptare. Në përshkrimin e natyrës, proza tek ai kthehet në poezi dhe faqe të tilla, që hasen me dhjetëra në rrëfimet e tij, tingëllojnë si proza poetike, të denja për çdo antologji.

Pjesë e pandarë e prozës së Kutelit janë dhe dialogu me monologun, të cilët së bashku me përshkrimin ndërtojnë veprën. Ato shfaqen në situata të caktuara, si një nga burimet e informacionit, por akoma më shumë, me funksionin tipizues e individualizues. Mënyra e thurjes së tyre, veçoritë gjuhësore, leksiku dhe ndërtimi sintaktik i bëjnë ato që objektivist të bartin psikologjinë e personazheve, botëkuptimin dhe mentalitetin, shkallën e kulturës dhe temperamentin. Në qoftë se dialogu qëndron brenda kufijve të gjuhës së bisedës, është i gjallë a i

shtruar në varësi nga rrethanat, ruan ritmin e saj, monologu ka nëntekst të qartë, rrjedh pa artifice dhe në harmoni me komponentët e tjerë. Në të dy rastet ndihet qëndrimi ideoemocional i autorit dhe është i pranishëm tendencioziteti i tij.

Poetika e prozës së Kutelit nuk mund të kuptohet pa poetikën e kompozicionit të rrëfimeve. Ndërtimi që u bën ai atyre janë origjinale dhe me veti artistike të qarta. Zakonisht ato janë në vartësi nga rrëfimtari dhe rrëfimtari luan rol organizues në kompozicionin e tregimit. Ai paraqet hyrjen, subjektin, kap fillin e intrigës, bën zgjidhjen. Ekzistojnë marrëdhënie të brendshme të vazhdueshme në mes rrëfimitarit, heroit dhe lexuesit dhe janë këto që përcaktojnë karakterin e ndërtimit të tregimeve. Brenda subjektit ai integron organikisht si komponent të rrëfimit të përgjithshëm dhe digresione të ndryshme, të gërshetuara këto me përshkrimin dhe dialogun. Në këtë pikëpamje gjejmë struktura origjinale, si shprehje të poetikës së autorit.

Ndoshta thesari më i çmuar që na ka lënë Kuteli si shkrimtar është gjuha. Me të drejtë, ai cilësohet një nga mjeshtrit e saj, një nga stilistët e mbarë letërsisë shqiptare. Adhurues dhe ndjekës besnik i gjuhës së rilindësve të mëdhenj, i ushqyer në gurrën e pasur të të folurit së vendlindjes, Kuteli do të formohet si shkrimtar sa në shkollën e gjuhës shqipe, aq edhe në atë të jetës shqiptare. Konceptet e tij për gjuhën amtare janë jo vetëm ato të një atdhetari të flaktë, që e sheh atë si një nga tiparet kryesore të kombit dhe pasuri të madhe shpirtërore të popullit, po dhe të një artisti të shquar, që i përkushtohet asaj shpirtërisht, intelektualisht e fizikisht.

Duke e studiuar nga afër gjuhën e Kutelit, do të vëmë re se ajo përbën një nga kapitujt më të pasur e më interesantë të prozës sonë të traditës dhe jo vetëm të asaj. Ajo dallohet si një gjuhë e mbrujtur me jetë të

gjallë, me forcë të brendshme, me begati dhe bukuri të madhe. Veç kësaj, gjuha e Kutelit karakterizohet nga cilësi të larta të ligjërimit artistik, jo vetëm për nga leksiku i pasur dhe i pastër, por dhe nga fryma ngjizëse, nga aftësitë analitike e sintetike, nga vetitë ndërtuese të një sintaksi thjesht shqip. Vitaliteti i saj duket dhe nga pasuria figurative e muzikore, nga nuancat e holla stilistike. Kuteli është një nga stilistët që i ka të paktë shokët në letërsinë tonë, një stilist me individualitet, me tipare krejtësisht të vetat.

Pesha e Kutelit në letërsinë tonë të traditës, e veçanërisht në prozën e saj nuk është vetëm ajo e një talenti të shquar, por dhe e një fenomeni që rezatoi dhe jashtë vetes. Me individualitetin e tij artistik, si krijues i një tipi të veçantë të tregimit, me stilin dhe gjuhën që përdori, ai hapi një brazdë të re në prozën tonë tregimtare, krijoi, në qoftë se mund të shprehemi kështu, një shkollë të tregimit shqiptar. Nëpër të do të kalonin disa nga tregimtarët e brezave të mëvonshëm si J. Xoxa, S. Andoni, N. Prifti, A. Kondo etj.

Mitrush Kuteli punoi në të mirë të letërsisë e kulturës shqiptare për afro gjysmë shekulli. Vepra e tij u shtri në dy epoka historike dhe, ndonëse bëri një rrugë të vështirë, ndoqi një vijë progresive.

Duke i hedhur një vështrim përgjithësues rrugës së veprimtarisë letrare e kulturore të Mitrush Kutelit, kuptohet qartë se ai u takon atyre shkrimtarëve të letërsisë sonë që u bënë mjeshtër të fjalës shqipe dhe përmes saj, krijuan vepra me frymë patriotike, dhanë shpirtin e popullit, dashurinë e tij për lirinë dhe tokën, treguan krenarinë për njeriun shqiptar dhe historinë kombëtare.

Diku, në shënimet e veta Kuteli do ta përmbledhë me këto fjalë tërë thelbin e jetës së tij: «Unë kam dashuruar shumë, kam urreyer shumë, kam punuar shumë dhe fatkeqësisht, kam gabuar shumë...» Kur artisti e pohon këtë

me sinqeritet të plotë dhe pas tij qëndron vepra, kjo tregon se këto fjalë s'janë shprehje retorike. Është vepra ajo që mbetet dhe e bën të nderohet emrin e Mitrush Kutelit, si punëtor të palodhur të letrave shqipe dhe mjeshtër të hollë të gjuhës amtare.

Trashëgimia letrare e Kutelit ka meritën dhe privilegjin të ketë konservuar artistikisht jetën autentike shqiptare, realitetin e rëndë të së kaluarës që tanimë ka mbetur në histori. Falë talentit të fuqishëm të shkrimtarit, ajo ruan për lexuesin e sotëm vlera të larta ideoartistike. Kjo dëshmon, veç të tjerash, se autori i ka përballuar me sukses kohën dhe nivelet e reja të letërsisë sonë.

NASHO JORGAQI

1989

0
REMOVED

Vjeshta e Xheladin beut

I

As vetë Xheladin beu nuk dinte përse ndiente një zbrazëtitirë aq të madhe në zemër atij mëngjesi vjeshte të dytë. Një zbrazëtitirë sa një zgërbojë gështenje që e ka brejtur krimbi përbrenda, një shembëtitirë, një turbullirë e një neveritje pa fund e pa anë...

Edhe çudi: mëngjesi s'ishte i keq. E rrallë dhe e verdhë, vërtet, fleta e plepit përtej dritareve me hekura e kafazë, po qielli i kulluar, i ëmbël. Shpesëria që, siç na duket neve, njerëzisë, s'ditka kurrë se ç'qenka dhe-mbja e pikëllesa, cicërinte e ngazëllohej me bujë të madhe aty pranë konakëve të beut e tej e tutje – arave, pemëve, qiellit – kurse ai, Xheladin beu i Shemshedin beut të Xheladin pashait, apo «beu i madh», siç i thosh tërë bota, zot i patundur mbi çifligje e mbi njerëz, ndiente një zbrazëtitirë të madhe në zemër. Gojën e kish të hidhur, sikur të paskej ngrënë shafran, qiellëzën të thatë, gjuhën të trashë si shuall bualli. Dhe herë-herë, një të theurur në tepelekun e kokës.

As nga shëndeti, as nga malli e gjëja s'ish qarë shumë gjer ahëre beu i madh. Shëndetin e kish pasur grurë:

burrë i ngjeshur, dërdëng, ta çaje bëje katër; kamjen të rëndë, shumë brezash, sa as vetë s'ia merrte dot radhën me të numëruar e me kalem; bujqit, raja e harbutë, të gjithë me dorën në zemër, si nuse kauri: s'guxonin as t'i thoshin me emër, as ta shikonin në dritën e syrit. Edhe sikur t'u bënte urdhër që të shtriheshin përdhe që t'i shkelte me këmbë, siç shkelet balta për të bërë plitharë, shumë prej tyre do të shtriheshin t'i shkelte. Se jo më kot, Xheladin beu kish në dorë bukën e kopaçen, tamam ç'i duhet fusharakut që të bëhet i butë si dele, jo aq fort për jetën e tij sa për atë të fëmijëve të njomë e shumë brenga të tjera të kësaj dore. Thua të qaheshin? Po kujt t'i qaheshin? Kush i dëgjonte? Të ngriheshin e të iknin? Mirë, të iknin, po ku? Kudo që të shkonin, i priste qaförja, sepse gjithë bejlerët e pashallarët kishin kërbaç e qahjanj. Tërë dheu që jepë bukë ishte i tyrja. Mirë thoshin ata që thoshin: gjithë derrat një turi kanë... Ca që ishin ngritur e kishin ikur natën, në errësirë, me fëmijët në kosha e pleqtë në tezga, kishin humbur si uji nëpër ujë, nuk u qe ndier nami e nishani. Prandaj ata që kishin mbetur rrinin aty ku ishin, bënin grurë e hanin misër. Kur s'kish misër të mirë, hanin misër gjarpri, këlkëzë, të shkuar nëpër tri ujëra, zienin brenda për brenda siç ziejnë e roniten në lyrën e vet ato kokat e këmbët e bagëtisë të futura në një poçe të madhe balte, me këltyrën të zënë me brumë, brenda në furrë. Nuk u ndihej as regëtima, as cicërma. Herë-herë binte ndonjë sëmundje e u vinte kosën të vegjëlve e të mëdhenjve; shtëpi e fshatra të tëra mbeteshin të shkreta. Po, çudi, çudi, pas sëmundjes shtoheshin përsëri si fara e sinapit.

Ta pret mendja, se ndër raja e ndër harbutë kish edhe kokëndezur, që nuk duronin më tej e mateshin t'ia shkrepnin, po Xheladin beu, që ishte brezi i tretë, zot në atë mëngë të mbretërisë së madhe të Baba Sulltanit, e kish vënë punën në vijë të mos bënte rrëk njeri, kështu

që kokëndezurit mbeteshin pa kokë përpara se të ndiznin koka të tjera. Këtë punë e bënëin qajhallarët, «trimat», siç u thosh bëu, apo «lanxhot», «larot», «zybat», siç u thoshin me gjysmë goje ata të tjerët, vegjelia.

Ja, kështu!

Puna e bejllëkut dhe e çiflikllëkut do marifet. Dhe marifetet mblidhen e shtohen brez pas brezi, nga babai, nga gjyshi e më tej. Këto marifete Xheladin beu i kish në xhep dhe i nxirrte një nga një a të gjitha bashkë, si t'ia donte puna. Veç kësaj, duhej ta dini se ai kishte zënë të gjitha shtigjet, shpatullat i kishte të ngrohta dhe i kthente gjithnjë andej nga ngrohte dielli, duvaxhi me mish e me shpirt i «llambës së dynjasë», Baba Sulltanit, të cilit i dërgonte kur e kur peshqeshe: mahmudije të verdha e çupa të bardha, nga çifligjet e tij. Nuk e harronte Kapu aganë, as sadrazemin, as sulltane-validenë, as adëmin e madh, të parin e haremllekut të sulltanit, që të mbyllnin sytë kur Xheladin beu zgjeronte çifligjet lart e poshtë, në skërkat e bujqërisë, në zabelet ahe tokat e buta pa zot. Nuk përzihej fort në gërnjat e të mëdhenjve të mbretërisë, po kur i vinte ndonjë bumbashir e i thosh se Baba Sulltani kish luftë s'di se ku, në Qyrdistan, në Rabistan apo në Tinglimajmunistan, beu i dërgonte karvanë me imdate e njerëz me dyfeqe, që do të linin kokën andej. Po mbi të gjithë, beu mbështetej tek i vjehri, që ish bir veziri, mbështetej tek të kunetërit, që ishin të gjithë në bukë të madhe.

Me gjithë këto të mira që zumë në gojë e ato që nuk i zumë fare — kazanët e qypat dinga me mahmudije të verdha nga ato të merhum sulltan Mahmutit dhe mexhidije të verdha e të bardha nga ato të merhum sulltan Mexhitit, me dupje, lira, ingjiliska e verdhashka të ndryshme të kauristanit (s'prish punë se i kish prerë kauristani, alltën ishin edhe këto, nuk i hante ndryshku) dhe që i shtoheshin mot e për mot, kukumale — me gji-

thë ata trimat mustaqepresh e mustaqerruar, që kish nënë urdhër e që s'linin të fluturonte as zogu pa lënë poshtë ndonjë pendë, se nuk i ushqente më kot me mish të majmë e somune të bardha, Xheladin beu ndiente një zbrazësi të madhe në zemër (po, brenda në zemër) atij mëngjesi të ëmbël vjeshte.

Dhe kjo oda e madhe e konakut të madh me mure kalaje, me ca dritare me nga dy palë hekura të përdredhur si brirë dashi e me kafazë, nëpër të cilat drita e diellit hynte e çjerrë si nëpër ca kula drizash, i qerthullohej beut ashtu siç qerthullohen kuajt në lëmë. Jo, nuk qerthullohej oda, po qerthulloheshin trutë e Xheladin beut. Dhe nuk dinte ç'ishte kjo punë. I sëmure nuk ishte, sepse ishte i ngjallur, dhe të ngjallurit, thonë, nuk sëmuren kurrë. Kish pasur, vërtet në të ri, një si frëngjyzë a si i thonë asaj sëmundjes së frëngut, që ia kish dhënë peshqesh një çingi e trashë, brenda në Manastir, ku kish vajtur me ftesën e valiut dhe kish «këmbyer gjellën», po kjo s'ish gjë: punë e vjetër, e harruar. Fshikën ia kish mbyllur një xherah plak me melhem zhive e hudhër të shtypur në havan e s'di çfarë tjetër. Ca më vonë i qe mbushur trupi me pushkuriza prush të kuqe, po edhe këto i kish mbyllur me melhem dhe trupi i qe zbardhur përsëri. Pastaj i kish rënë leshi i kokës, po rroftë festja me xhufkë, që ia mbulonte tullupanen. S'di se kush i kish thënë se po të kesh ndonjë sëmundje të kësaj dore, duhet ta hedhësh, t'ia japësh dikujt, ta përndash mbarë e prapë: peshqesh e more, peshqesh e dhe! Kjo ishte punë që dihej. Filan bej, hanedan i madh, e kish hedhur oftikën duke pështyrë fshehur në gjellët e mira që u shtronte mysafirëve dhe, thoshin, ish bërë mirë, kish rrojtur edhe mjaft vjet. Ç'është e drejta, me kohë e mot, shumë nga mysafirët e të afërmit ishin sëmurur, po kësaj s'ke ç'i bën: sikush si ta ketë shkruar nga dora e zotit. Fundi i fundit, përse ata

që mbeteshin faqekuq si molla, kurse ai, beu hanedan, të zverdhej e të thahej dita ditës? Ata të rronin, ai të vdiste – ë? Kështu bëri edhe Xheladin beu: i sollën një çupë të mitur (sa më e mitur, thoshin, aq më e mirë është për bejnë, se të miturat e kanë gjakun e hollë, të valë, dhe gjaku i hollë dhe i valë e hollon, e ngroh dhe e spastron gjakun e trashë, të ftohtë...) dhe beu e prishi. E prishi e dha urdhër ta shpinin tutje që të mos shihej e të mos dëgjohej. Pastaj e përndau frëngjyzën anembanë, në gra e në dylberë, dhe u shërua fare...

Dhe ja tani, oda e madhe e konakut të madh i qerthullohej si kuajt në lëmë. I therte tepeleku i kokës. Ndezi një cigare, esëll, që t'ia priste vrundullin e rrotullimit e të mbante mendjen në vend dhe zuri ta pijë shqeto, pa çibuk, po cigarja, aq e shijshme herët e tjera, tani iu duk e hidhur, e pështirë. E kafshoi dhe e hodhi tutje, në vatër.

Ç'ishte kjo punë? A mos beu s'ishte mirë? Jo, jo, Gjer dje kish qenë fare mirë.

Asaj nate kish bërë, vërtet, një aheng të vogël, me raki të fortë e meze nga të gjitha llojet – mish gjahu, pa dhjamë, të shuar me uthull, me hudhra, pra me shije shumë; mish të butë e të majmë, që e kish ushqyer me dorë, e kish ngrënë dhe kish hedhur tutje kokat dhe kish lëpirë të pesë gishtrërinjtë e më the të thashë (ca jevga me dajre e ca të tjera me këngë në gojë, me çitjane të fryra si bajrakë dovleti, kur i nget era, me nga një flori të verdhë të ngjitur në ballë me sherbet të trashë, që thyenin belin e tundnin vithet aman-aman, që ta ndiznin bejnë...), them, kish bërë një aheng të vogël, po kjo s'ishte pune e re. Se Xheladin beu kish qenë gjithnjë, që në të ri, njeriu i qejfit, hashari, dhe jo një herë e dy e zinte mëngjesi ku s'ta pret mendja, në konakët e afërm a të largët, në perdhosat e tebabisë, që mbanin erë myku e memish-haneje e shumë erëra të

tjera. Bile, edhe aty brenda, në selamllëk, kur priste mi-qësinë, meshkujt, beu kish në njërin krah odat e tij për punët e tij, me fjalë të tjera për gjerdheq-mbi gjerdheq. Pastaj, kur velej së tepërmi nga mishi i bardhë i haremllekut (kësaj here hanëmi as që ishte aty: kish shkuar teferiç në sarajet e babait, të pashait), ngrihej vinte atje ku desh vetë apo sillte në jatak ato që desh vetë, dhe defi binte pa pushuar ne dera, gjersa beu i madh mbaronte «punë». Kësaj «pune» ai i thosh «puna e perëndisë», po bota i thosh «puna e djallit». Dhe si e mbaronte këtë punë, po të ishte i kënaqur, i hidhte groshin me grusht, që ta dinte vegjëlja sa të madhe e kish zemrën beu i madh...

Këto teke ia dinin të gjithë, e më fort ia dinin e ia druanin ata që kishin çupa të mitura në shtëpi, prandaj përpiqeshin t'u gjenin shpejt e shpejt ndonjë burrë sidokudo e t'i martonin, për të hequr ferrën nga dera e për të shpëtuar faqebardhë. Po edhe në bri të buallit sikur t'u futkeshin këto, të bukurat, prapë Xheladin beu i gjente pas erës, sepse era e çupës së bukur qenka si ajo e mollës së mirë, u përhapka anembanë. Dhe, si ia gjente gjurmën, Xheladin beu akrosej si ai kali i zhdepur me elb e nuk i zinte vendi vend gjersa e bënte vollen e tij, ja me të mirë, ja me të keq. Po po: edhe me të mirë, sepse kur ia donte puna, beu bëhej, si i thonë, qumësht e mjaltë. Dhe ju e dini sa shumë hije i kanë një beu të madh kur qesh; i zbardhin dhëmbët, i xixëllojnë sytë, i shkëlqen lëkura e lyrshme e faqeve, i tundet xhufka e festes. Kjo të bënte t'i harroje të gjitha e të thoshte: «Oh, ç'burrë babaxhan është beu ynë, e paçim sa malet! Tamam si dielli i muajit maj!» Kështu thoshin syleshët, po ata që nuk ishin syleshë e dinin se Xheladin bej «babaxhani» ishte si ata qentë e ligj që të hanë nga prapa: të fshinte nga faqja e dheut! Ai kish edhe një fjalë të tijën, që e kish trashëguar nga i gjy-

shi: «Ç'do gjë e gjallë që pillet, rritet e kullot në dhenë tënd, është jotja. Merre e bëj ç'të duash.»

Kur ia donte puna të bënte tembillëk», u jepte urdhër trimave që të fillonin spastrimin. Atëherë njeriu zhdukej pa gjurmë, siç nuk lë gjurmë zogu në erë. Kish qenë e s'ishte më... Ai nuk harronte amanetin e vjetër të gjysh pashait: «Mbaje e shtoje atë që ke; preja kokën atij që mundohet ta ngrerë lart; mos lër të dalin në kasabanë tënde e në çifligjet e tua njerëz më të mençur se ti; mos e prish më të madhin; ki mendjen të shikosh nga fryn era e nga ngroh dielli. Për punët e tjera bëj ç'të duash, si zot malli.» Dilte nganjëherë një i krisur ndër raja e ndër hajdutë (nga një i veçuar), që vinte shpirtin në majë të dyfekut e ia shkreppte, po vendi s'e mbante dot me bukë shumë kohë dhe shpejt mbulonte balta baltën, rritej bari mbi varre dhe Xheladin beu bënte siç kish bërë...

Dhe ja sot, pas një ahengu të vogël, Xheladin beu ndiente një zbrazëti të madhe në zemër. Oda i vinte rrotull, zverkun e kish të rëndë, cigarja i dukej shafra.

U shtri në divan, vuri pëllëmbët prapa kokës, në jashtëk, hodhi këmbë mbi këmbë e u mundua të platitej.

Krisën dërrasat e thata të çardhakut, tringëlliu rezja e derës së parë në hyrje, dhe më tej rezja e derës së odës, kërcitën menteshat dhe hynë brenda katër a pesë kopile, kush me legen a ibrik, kush me sapun e peshqir në dorë. Këto të gjitha i printe një ballabane zeshkane me një shami aliskë në kokë, tërë tule mbarë e prapë, po gojëmjaltë. Kjo i tha tërë dhele: «Mirëmëngjes, bej. Si m'u gdhive, bej? Si më je zotrote, bej? Ta marrtë të kegen Sheqerja, bej. Ditët tona në të tuat, bej» e sa e sa të tjera të tilla. Kopilet përsëritën fjalët e ballabanes, por me zë të ulët, të drojtur, si me gjysmë goje. Xheladin beu u përgjunj e u la me zhurmë e me grahmë, duke hapur rreth e qark shumë stërkala, siç e

kish zakon; fërkoj zverkun bojë vishnje, u fshi me peshqir gjersa i krisi mishi, duke bërë «ohoho» e «ahaha», se e ndiente veten më mirë. Vetëm gojën e kish të hidhur, megjithëqë e lau dhe e shpëlau me ujë. Kur dolën të gjitha, bashkë me ballabanen, hyri kopilja më e vogël e shtëpisë, një miturake me ca faqe si pjeshkë që sapo e ke këputur nga dega, me vetulla të holla si tirtir Serezi. Sytë nuk i dukeshin, se i mbante përdhe e ia mbulonin qepallat e gjata. Kish një fustan me lule, as të gjatë, as të shkurtër, dhe një palë papuçe Stambolli, të qëndisura, që i kish futur në këmbët e zbathura. Kjo ishte, si të thuash, kopilja e fundit që kish hyrë në konak të beut, një jetime, që ia kish gjetur s'di se ku një myftar fshati e ia kish sjellë peshqesh, për të forcuar veten. Beut i kish pëlqyer shumë dhe e kish marrë që atë natë në dyshek, e kish bërë grua: ai me të gulçuar si buall kënete, ajo me të blegërirë, si shqerrë në thertore. Kështu edhe më tej, shumë net me radhë. Shoqet, kopilet e tjera, e kishin zili, po më kot: ajo priste me ankth e dhembje netët e dyshekut. Po të kish mundur do të kish ikur zbathur, zhveshur, uritur nga kjo shtëpi e urryer, nga ky njeri i urryer. Të ikte, po nuk mundte: dritaret kishin hekura, oborret kishin mure, qehallarë. Kështu, vajza ish shtruar, kish hyrë në sërën e grave të tjera dhe vinte në jatakun e beut sa herë që i jepte urdhër Sheqerja.

Tani ajo mbante në duar një tabaka të artë me një xhezve të verdhë e një filxhan sa një lagjin, pa vegël, të stolisur me yj e hënë. Beu e shikoi me epsh dhe i qeshi buza – për herë të parë atë ditë – pastaj u ngryspërsëri: kopilja ishte gjithnjë e bukur, me qafën të gjatë e të bardhë, me gjinjtë as të mëdhenj as të vegjël, të shtrënguar me jelekun e qëndisur, po bejnë nuk e gënjente syri. Kopilja ishte ndryshuar s'di se si, nuk ishte më ajo e para. Fytyrën e kish pak si të zbehtë, të mundur; belin më të mbushur. A mos vallë?...

I tha:

– Gurije (kështu i thoshin aty, po emrin e vërtetë nuk ia dinte njeri), hap atë penxhere.

Kopilja bëri siç i tha i zoti: Ia tabakanë me xhezeve dhe filxhan, u përkul sa hyri pothuaj e tëra në pezuli i murit të trashë, u zgjat, ngriti xhamin, e mbështeti në të dy zemberekët djathtas e majtas. Brenda në odë hyri më shumë dritë dhe, bashkë me dritën hyri edhe era e freskët e vjeshtës.

– Edhe atë tjetrën, – tha beu, që ia kish mbërthyer sytë shtatit të Gurijes.

Kopilja u përkul shumë e më shumë, fundi i fustanit iu ngrit lart e më lart dhe, për një çast, përpara syve të beut llamburitën pulpët e zëmbakta. Hyri brenda edhe më shumë dritë e më shumë ajër, që e gjallëruan Xheladin bejnë. Ndjeu një fërgëllim të këndshëm në rrëmbat dhe kërceu më këmbë.

– Edhe atë, Gurije!

Ajo u përkul në dritarja tjetër, përsëri i zbardhën pulpët gjer në kyçet me damarë të hollë, të kaltër, prapa kupës së gjurit. Kur u kthye të marrë tabakanë, kopilja u gjend në krahët e shëndoshë të Xheladin beut, që e hoqi vrulltaz dhe i ngjeshi kokën në kraharonin e tij leshtor. Beu i madh kundërmonte raki, gromësinte shpesh «gup-gup» duke përhapur një erë të rëndë. Gurija u drodh, bëri të prapsej, uli kryet, po ai e hoqi më fort dhe i puthi gropën e qafës. Buzët i kish të vala, të thata; mustaqet të ashpra si kreshta derri. E shtyu ngadalë drejt divanit, duke ia shtypur vrazhdë gjinjtë – si zot malli – ndonëse ajo klithi nga dhembja. Gurija priste me tmerr e krupë se ç’do të ndodhte më tej. Ah, sikur të kish një pus aty pranë, një greminë, që të hidhej, të vdiste... Vetëm të ndodhej sa më larg këtij divani të butë, larg Xheladin beut të ndezur, të lemerishëm, që e shtrëngonte, gufonte, kafshonte. Mirëpo ndër-

kaq beut i qe shuar zjarri i ndezur një çast më parë në damarët e fryrë. Iu prenë këmbët, u zverdh, u ngrys dhe e largoi vetë, duke e këqyrur me ca sy të skuqur, të kërcyer.

– Efëndëm... Ti je «ashtu»? – e pyeti Xheladin beu sa për të thënë një fjalë.

– «Ashtu»... bej... më tha...

– Efëndëm, kush të tha?

– Dado Sheqerja.

Sheqerja ishte ajo ballabanja zeshkane, e para mbi të gjitha kopilet dhe këto i thoshin «dado», ndonëse beu s'kish fëmijë, sepse hanëmi ishte shterpë.

Njëherë e njëkohë, Sheqerja kish qenë zjarrshojtësja e epsheve të parakohshme të Xheladin beut dhe kjo punë kish zgjatur shumë vjet, bile edhe pasi atij i qenë zgjuar epshe të tjera: për çupa miturake e për dylberë bardhoshë, e më tej, pasi ish martuar me hanëmin. Më vonë, kur Sheqeres i qenë flashkur e varur së tepërmi tulet dhe kur as të bardhët e zhivës nuk ia fshihte dot rrudhat e dërrudhat e shumta (doemos, ajo ishte disa vjet më e madhe nga beu), ky e kish pajosur mirë dhe e kish martuar me nallbanin e konakëve, shumë më të ri se veten, sepse, hej-hej! dadua dinte shumë ledhe dashurie, që i kish nxënë nga koha e Shemshedin beut, babait të Xheladin beut, kishte mbetur gjithnjë «folë e qesh», mbante kyçet e qilarëve dhe shkopin me të cilin rrihte kopilet. Nallbani ishte i kënaqur, se qe bërë «baxhanak» me bejnë e madh e puna i vinte mbarë, tamam «brishim në qilim», siç thosh kënga.

Po meqë zumë në gojë «baxhanakët», duhet të themi se Xheladin beu kish mjaft të tillë, të cilëve u falte kopilet e konakut, pasi velej me to e sillte të tjera, të njoma. Në këtë punë beu ndiqte gjurmë për gjurmë tragat e Baba Sulltanit, «diellit të dynjasë», i cili u falte sadrazemëve, pashallarëve, nedimëve, javerëve dhe gjithë të

mëdhenjve të mbretërisë, të afërm dhe të largmë, odalis-
kat e bukura që kishin shkuar nëpër jatakun e tij, pasi
i pajoste me pajëra të mëdha. Dhe këta burra të më-
dhenj të mbretërisë së madhe – sadrazemët, pashallarët,
nedimët, javerët e bejlerët e të gjithë kallëpeve – e ki-
shin për nder të madh të quheshin «baxhanakë» të «die-
llit të dynjasë» dhe të bënin fëmijë me bukuroshet që ki-
shin lënë vajzërinë në dyshekun e sulltanit e të forco-
nin themelet e mbretërive të tyre të vogla nën hijen e së
madhes. Sa për punë «vajzërie» atyre nuk u bëhej vonë,
sepse, kur u tekej, kishin çifligjet e tyre: «Zgjat dorën e
merr».

Tani dado Sheqerja ishte ajo që gjuante e shtinte
në dorë vajzat e njoma – zakonisht miturake, jetime,
pa krahë, po ndodhte edhe ndryshe... – që duhej të
shuanin epshet e Xheladin beut. Ajo vetë bëhej bullë
e i stoliste para gjerdekut, i mësonte se ç'të bënin e
si të bënin që ta kënaqnin të zonë. Asaj vetë, Sheqe-
res, i mjaftonte nallbani i shëndoshë, që mund të thyente
potkuan me dorë, e që punonte gjithë ditën me sandraç
e çekan dhe mbante erë të fortë djerse burri.

...Beu iu afrua Gurijes, e hoqi lehtë pas gjerdhanit të
inxhinjve dhe e pyeti duke i fryrë në turinj kundërmimin
që i dilte nga plënci:

– Efnm, hanëmi di gjësend?

– S'di...

Nuk u muar vesh mirë: s'dinte ajo, Gurija, apo s'dinte
hanëmi dhe se si i kuptoi beu këto fjalë. Tha:

– Sot do ta pi kahven (kështu i thosh beu kafesë:
«kahve», siç e kish dëgjuar nga i vjehri e nga e shoqja)
në ballkon.

Kopilja nxori tabakanë në ballkon, mbushi filxhanin
me «kahve» pak si të ftohur, pa ajkë, dhe u kthye në odë.

– Mirë, Shko, – tha beu.

Gurija doli kryeunjur, me sytë të përlotur, duke u

përkundur, sepse papuçet e qëndisura i futeshin thellë në qilimin e butë. Ajo dinte ç'dinte, nga të dëgjuarat, se kopilet që mbeteshin me barrë në konakët e beut... dhe prandaj kishte përse të lotonte. Kujt t'i ruhej më parë: hanëmit, shemrave, apo beut? Në çast harroi pusët dhe greminat, që kish menduar një çast më parë, thosh të kthehej, t'i binte në gjunjë e t'i thosh: «Aman, bej, mos më vraj... Mos... Mos... Lëshomë të shkoj gjëkund». Por nuk u kthye.

Xheladin beu mbeti vetëm. Tha të dilte në ballkon, të pinte «kahven», po e ktheu mendjen e i ra rrotull odës, qëndroi një çast përpara pasqyrës sa një derë, u shikua e nuk e njohu veten: nga pasqyra e vështronte një burrë tjetër me ca sy të skuqur, të kërcyer, me një grykë të shfryrë e të varur si ato laprat e misërokut, me ballin brazda-brazda. Aty-këtu, nëpër mustaqet e kreshpëruara, i dukeshin fije argjendi. Vetëm nën hundë, ku ndaheshin më dysh shtëllunga, i kish pak si të zverdura nga tymi i duhanit, tamam si ca qime përçi plak.

A mos e kish fajin pasqyra?

Jo, pasqyra e ndritur, me yll e hënë të bardhë, në cep, s'kish asnjë faj. Fajin e kishin vjetët e shumta që i kish rrojtur e gëzuar si shumë të paktë janë ata që i rrojnë dhe i gëzojnë, e kishin ahengjet e gjerdeqet e shpeshta, të cilat Sheqerja ia nxiste me pije xhenxhefili e karafili. Sidoqoftë tani, për herë të parë, Xheladin beu vuri re se sikur i kish shkuar një damaluk nëpër fytyrë. Megjithatë, vajti e u ngul përpara një pasqyre tjetër. Po edhe kjo ishte si e para dhe i tregonte një burrë me lapra, brezda e sy të skuqur. I ra lehtë festes, me gisht, dhe e shtyu në majë të kokës tullupane. E ktheu në vend, e vuri mbi sy, si ngaherë. Hej, sa zët i kish atë çast ata derra çifçinj që rronin me bukë misri e dhallë, po leshrat i kishin si penda e korbit...

— Efm, u mplake, Xheladin bej...

Kush foli kështu? U kthye e shikoi përçark. S'kish njeri. Kish folur vetë beu. Këtë zakon kish kohë që e kish filluar dhe po e shtonte dita-ditës: fliste e përgjigjej vetë. Njerëzit e tij të afërm e dinin, po bënë sikur s'dëgjonin, sikur s'vinin re kur çuquriste kot më kot nëpër mustaqet, që i ngriheshin dhe uleshin. Domosdo, ata e dinin fjalën e moçme: «Beu edhe gomar të bëhet, mos i hip.»

Dhe përsëri:

– U mplake, u mplake... I ke...

Dhe i vozitën mornica të ftohta nëpër trup jo për kohën që kish shkuar, po për atë që do të vinte pasandaj. Ja, nëpër qytet e nëpër fshatra zunë të rriten çupa të reja. Aty më parë i shihje pragjeve e udhës, nëpër pluhur, të dregosura, të qurrosura, të palara, kurse tani s'i sheh fare: janë «mbyllur». Domosdo, duhet të jenë zbukuruar. Kujt do t'i mbeten këto? Kujt do t'i mbetet mjalti i zgjonjve, rrushi i ëmbël, tërë pemët e çifligjeve? Xheladin beu po mplakej, Xheladin beu ish mplakur...

Mendja zuri t'i qerthullohej, sa ment ra poshtë, në sixhade. Bëri ca çape e ndenji në cep të divanit.

— Po pas pleqërie? — pyeti.

Dhe u përgjigj vetë:

– Pas pleqërie, efnm? Ti e di: varri...

I hipën djersë të ftohta, që ia njomën rrethin e festes. Atëherë, po të shihej në pasqyrë, do të dukej si një kufomë e pakallur në varr. Kish parë shumë të vdekur, kish dëgjuar e dëgjonte ditë për ditë se vdisnin njerëz, po ata, thosh ai, ishin budallenj. Budallenjtë vdisnin. Ata që s'kanë ç'të hanë, ata që tërë jetën s'dinë të bëjnë gjë tjetër veçse të ngasin qetë e t'i rëndojnë dorakut të parmendës. Ai ishte bej, ishte Xheladin beu i Shemshedin beut të Xheladin pashait, që e kishin pritur në shparga mëndafshi dhe e kishin tundur në djep

floriri. Ai nuk ishte si të tjerët, rajatë e harbutët, që i pjellin gratë në arat, i mbështjellin me lecka dhe i tundin në govatë, në vend të djepit. Një ishte Xheladin beu në atë mëngë të mbretërisë, një e me vulë!

Po pas pak e ktheu:

– Mirë, mirë, – tha, duke përtypur nëpër gojë «efëndëmin», që e kish, siç thosh bota, «araret» – po edhe babai vdiq, edhe gjyshi vdiq... budallenj, ishin ata?

Dhe u përgjigj vetë me një fjalë që e kishin marrë nga Xhixhi-hanëmi:

– Afedersën! Afedersën!

Dhe më tej, padashur: a s'ka edhe ai, Xheladin beu dy duar e dy këmbë, si gjithë bota? A s'duhet të punojë si gjithë bota për të nxjerrë bukën?

Këtu nuk e mbajti dot të qeshurin, me të madhe: «Ha-ha-ha! Ku është parë bej, nip pashai, të ngasë qetë? Ptu!»

Dhe u çudit se si mund t'i kish bërë vetes një pyetje kaq të shëmtuar. Si mund të vihej ai, beu i madh, burrë «temis» – siç i thosh pastërtisë, ndonëse kundërmonte nga kalbësitë e brendshme si ato saraxhatë e kuajve – në radhën e çifçinjve të thatë, nofullmëdhenj, të palarë, barkbosh, që zoti, me të madh të tij, i kish jaratisur t'i bënin grurë e berra? Doemos, edhe çupa për gjerdeqe...

– Jok, jok! – tha siç thosh Xhixhe hanëmi..

Kështu thirri beu sa kumboi tërë oda, si shpellë, dhe doli në ballkon, ndenji këmbëkryq në shaneshin, ndezi një cigare nga ato që ia dridhte Sheqerja e ia ngjitte me pështymën e saj. Aty, në ballkonin si kafaz me hekura të dendur e të përdredhur si ca rrathë buti, të teptisur jashtë e të lidhur lart me murin e gurtë – që ku shihte dhe nuk e shihnin – cigarja iu duk pak më e shijshme. Zgjati dorën, mori filxhanin dhe e shpuri në buzë, po e la prapë menjëherë: kafeja ish ftohur fare. Ngrysi ballin, përpoqi duart fap-fap, një herë, dy... Hyri një kopile e vogël si zog pule, e zbathur, që beu

nuk e thërriste më në dyshek dhe që, së shpejti, do ta vinte të ruante patat, sepse i kish shkuar koha, i kish kapërcyer të tetëmbëdhjetat. Kopilja u mat t'i kërkonte urdhrin, po nuk guxoi, ngriu me duart të mpleksura mbi gjinjtë e mëdhenj, shumë të mëdhenj për shtatin e saj të vogël. Vajza ish trembur: fytyra e tërë trupi i përkulur i Xheladin beut ishin tërë vija drite e hije. Drita vinte nga rrezet e diellit, hija nga hekurat e ballkonit. Për një çast asaj iu duk i llahtarshëm, si qoftëlargu, dhe prandaj u mëk.

– Moj, ti, si të thonë... – tha beu. – Kahvja m'u ftoh. Të më sjellë një tjetër. Ajo...

«Ajo» ishte Gurija...

Kopilja heshtur hyri, heshtur doli: Nuk iu ndie as hapi, as zëri.

Beu ktheu kokën nga ana tjetër. Në oborr shkonin e vinin njerëz pa zhurmë. Ata e dinin se beu ishte në ballkon. Nuk e shihnin, po e dinin: nga tymi i cigares që dilte nëpër hekurat, nga të murmuriturat me vetveten.

Konakët e Xheladin beut ishin ndërtuar në një vend të lartë, pothuaj në krye të qytetit. Që aty qyteti, apo «kasabaja ime», siç i thosh ai vetë, dukej si në pëllëmbë të dorës, me pak shtëpi të larta e shumë shtëpi të ulëta, me minare të bardha e kambanore të hirta, të gjitha të mbëshjtjella në kithin e përndritur të vjeshtës së thatë. Një pjesë e madhe e dyqaneve dhe gjithë hanet në vrom të tregut, një pjesë e shtëpive, kopshteve dhe vendeve virane, plot troskë, hithra e gjemb gomari dhe gjithë mullinjtë ishin të beut. Qiratë i mblidhte dhe ia sillte Zylfua, muaj për muaj. Aty, në «kasabanë e beut» nuk bëhej gjë pa i marrë dorën atij. Mëngjes për mëngjes vinte bylyk-bylyk parësia e vendit, që t'i falej beut, ose, siç i thoshin, «t'i pinte kafënë». Sillnin lajme se ç'kish ndodhur nga një ditë tek tjetra – kush ish vrarë e kush kish vdekur, kush kish ardhur e kush kish shkuar, kush

gjykohej e përse gjykohej, kush shiste e kush blinte, ku ish zhveshur ndonjë karvan, kush ish martuar e kush do të martohej e sa të tjera të kësaj dore – merrnin urdhra e pastaj shkonin me nxitim sikush në punë të tij. Rrallë e tek, kur ish fjala për ndonjë punë të madhe, a kur vinte ndonjë njeri i madh – kajmekam, kadi, yzbash ose duvaxhi i parë – dilte e priste vetë beu; më të shumtat e herës e prisnin veqilët, Zykuva a Zylfua. Beu bënte sehir nga ballkoni ose ngjitej lart, në kullë, një odë e vogël me katër dritare, që ku mund të shihej në të katër anët, ose rrinte në shilte prapa perdes, si sulltani i Stambollit, dhe njerëzit ia dëgjonin vetëm kollën ose pëllëmbët që i përpiqte fap-fap, dhe atëherë u ngrinte gjaku në zemër: përpoqi duart beu!

Domosdo, në konakët e beut vinin edhe agallarë dhe myftarë fshatrash, vinin fshatarë për të qarë ndonjë hall. Ta pret mendja: asnjë nuk vinte me duar bosh.

Mirëpo kësaj here Xheladin beu s'kish nge të merrej me vogëlsira të këtilla; ai ndiente një zbrazëtirë të madhe në zemër.

Hoqi sytë nga qyteti dhe i hodhi tutje, në fushë: këtu të verdhë, më tej të murme dhe vende-vende të gjelbër, me selvi. Atje ku dukeshin selvi kish varreza, të vdekur, shumë të vdekur; sepse fshatarët e «kishin zakon» të vdisnin me shumicë, më fort fëmijët. Andej, në fushë, kish shumë shtëpi. «të shuara», shumë të tjera të braktisura. Nejse, t'i lëmë fshatarët e të zëmë një gjë tjetër, më të mirë: dhenë. Pothuaj tërë ky dhe, gjer larg, ku piqej me qiellin, ishte i tij. Me gjithë varreza. Edhe kodrat në të djathtë e në të mengjër. Të tijat, po ç'i do? Beu s'ishte mirë atij mëngjesi vjeshte. Pse e qysh? Po mpla-kej... Ja, mbrëmë, i kishin sjellë një «ftujë të njomë», si Gurijen. Jo, më të njomë: Gurija ishte pesëmbëdhjetë vjeç, ajo tjetra, që s'ia dinte as emrin, trembëdhjetë. Kishin kënduar me gojë e i kishin rënë deficit: «Jarnana,

jarnani», dhe prapë: «Jarnana, jarnani;/ Ato cica sherbetli,/ M'i bëj meze t'i pi raki...» Dhe ai, Xheladin beu, zot mbi dhera e mbi njerëz, s'ish bërë burrë, ish lidhur. Kësaj here s'kish bërë ferk as xhenxhefili, as karafili e as rakia me meze. Xheladin beu po mplakej. Vogëlushja çupë hyri, çupë doli... Dhe ish e bukur me vetullat të bëra me mazi, me thonjtë të lyer me këna, me sytë të bukur, me faqet me vrima.

Dhe beut i vinte keq, i vinte inat, i vinte turp. Ai goxha bej...

Aty për aty i shkrepri një mendje tjetër: kutj do t'i mbetey tërë kjo pasuri që kish mbledhur e ajo që po mblidhte? Tërë kjo kasaba, tërë këto çifligje? Vërtet, e shoqja, Xhixhe-hanëmi, ishte nga derë e madhe, bijë pashai e mbesë veziri, po shterpë, barkthatë. Veziri kish qenë «baxhanak» i sulltanit; edhe vetë pashai. Pra Xheladin beu kish hyrë në radhën e të parëve të mbretërisë dhe priste ta ngrinte oxhakun lart e më lart, të bëhej pasha. Peqe, po kujt do t'ia linte këtë oxhak? Mund të bënte një gjë: të shtinte kurorë të dytë e të tretë me gra pjellëtoze. Këtë të drejtë ia jepnin të gjitha kanunet e dheut e të qiellit, po Xheladin beu – i madhi Xheladin bej, i forti Xheladin bej – druhej ta prishte punën me të vjehrrin, me të kunetërit, me tërë farefisnin e së shoqes, gjer lart ne Porta e Lartë. Ai ia kish frikën sidomos Xhixhi hanëmit, një gamile tërë koska e kokalla, sikur të paskej qenë ushqyer jo me qumësht e mjaltë, po me karkalecë të pjekur. Kur endej nëpër çardhak e kur sillej nëpër odë, tërë këto kocka e kokalla bënëin trak-trak, sikur të paskej vozitur vetë shapatani apo ai kadiu i vjetër i Libohovës, që thoshin se ish ngjallur lugat, sepse kish qenë i shtrembër e ryshfetçi, i madh. Po ashtu, trak-trak, edhe kur ulej në shilte, kur binte në jatak; vetëm kocka e kokalla. Mirëpo këto ishin kocka e kokalla bije pashai e mbese veziri, dhe prandaj i mbulonte me mëndafsh e

pembe e belluz jeshil, të qëndisura me fije ari e të stolisura me xixa xhevahiri. Xixa të tjera të këtilla i ndritnin e i përndritnin në kapuç, në leshrat, në qafë, në kyçet e duarve, në gishtërinjtë me thonj të skuqur.

Ajo dhe të vëllezërit prisnin që Xheladin beu të hidhte topin – kështu apo ashtu... – dhe t'i përlanin pasurinë. Doemos, dinin se beu bridhte si maçok kobash poshtë e lart, brenda në qytet e jashtë nëpër fshatra, po kjo ishte punë mashkulli, le të bënte ç'të donte. Vetëm dy gjëra s'donin ata: kurorë të dytë, me shemër, dhe niqa...

Tani Xheladin beu vështronte e nuk shihte gjë, sikur t'i qenë përdelitur sytë. Mendja e tij bluante po atë punë: kujt do t'ia linte emrin, oxhakun, mallin? Niqa – jo, kurorë të dytë – jo, po atëherë si? Këtë kokël duhej ta kishte zgjidhur qekuri, dhe nuk e kish zgjidhur. Tani ish vjeshtë, tani beu...

Dha e mori me vete, murmuriti, u përgjigj vetë e së fundi tha me zë:

— Efnm, në djall të venë e bija e pashait, të bijtë e pashait dhe vetë pashai, i biri i vezirit! Do të bëj siç bëri im gjysh! Ja, po të pjellë kjo një djalë («kjo» ishte Gurija) do t'i shtie kurorë e do ta marr grua të dytë! Pastaj le të bëhet ç'të bëhet!

Po ç'kish bërë i gjyshi?

— Edhe gjyshit, Xheladin pashait, i kish qëlluar shterpë gruaja e parë. E mirë ishte, e bukur ishte, po shterpë... Dhe pashai e donte me gjithë shpirt e nuk desh t'ia thyente zemrën, t'i hidhte kurorë të dytë. Po si mund të rronte pa fëmijë? Dhe ja, një ditë vere, tek po rrinte në dritare, prapa hekurave, hyri në oborr një fshatar me një çupë të vogël, që e ndiqte si oqiçe. Fshatari ishte me opinga, çupa ishte zbathur. Ai iu afrua çezmës së pashait, piu ujë, lau sytë, u hoq mënjanë e i bëri vend çupës, zgjidhi shaminë e kuqe nga brezi e zuri të fshinte fytyrën, qafën. Çupa bëri siç kish bërë fshatari: piu

ujë, lau sytë, po nuk i fshiu se s'kish shami. I la të thaheshin votiu. Faqet e kuqe iu skuqën edhe më fort. Aty afër s'kish njeri. Megjithatë, çupa shikoi rrotull, pastaj ngriti pak fustanin dhe vuri njërën këmbë nën lyfyt, për të hequr pluhurin e udhës. Vuri edhe tjetrën, u përkul, i fërkoi. Këmbët i kishte, poshtë, të nxira, po lart, të bardha si nishesteja në diell. Piu edhe një herë, u hodhi edhe dy tre grushte ujë syve. Pashai e pa që prapa dritares me hekura dhe e pëlqeu. Ai ish njeri i dhënë pas këllëçit e pas luftrave e jo pas grave, po kjo çupë i pëlqeu. Dërgoi qehajanë, që tha: «Hyni brenda, se ju kërkon pashai.» Fshatari u tremb, po s'kish ç'të bënte: pasha, ky! Hyri brenda. Çupën e la në dera. «Sille edhe atë.» Çupa hyri, me të drojtur, duke njomur qilimin me këmbët e lagura. Pashai i hodhi një sy edhe ajo i pëlqeu e më shumë. «Mirë, tani nxirre këtë çupë, i tha, ai qehajait. Të presë jashtë.» Qehajai dhe çupa dolën. Pashai u kthye e e pyeti fshatarë cili ishte e nga ishte, ç'e kish atë çupë, ku vinte. Fshatari i tha emrin, fshatin. Fshati ishte pronë e pashait; çupa ishte mbesa e fshatarit, e bija e të vëllait, jetime. Sa vjeç? Dymbëdhjetë. Fshatari shkante në pazar. Çupën do ta martonte me një që i jepte njëqind groshë, tre krerë dhen, një palë rroba, një shami e s'di çfarë. Ai që e merrte – filani i biri i filanit nga filan fshat – ishte i pasur. Kish edhe tri gra të tjera, shumë djem e vajza, me të tria. Disa djem e disa vajza i kish martuar e me fëmijë më të mëdhenj se sa nusja e re, që i qe tekur të merrte, për pleqëri. Pashai e dëgjoi dhe, fundi, i tha: «Mirë, e mora vesh. Ti shko, çupën lëre këtu, se është malli im, nga çifligu im. Do ta martoj vetë me kë të dua.» «Aman, pasha! Derman, pasha! Vër dorë në zemër! Çupa është jetime, kam marrë kapar që t'ia jap filanit...» të gjitha shkuan kot; pashai nuk u tund nga fjala e parë. «Është malli im, do ta martoj vetë.» Nxori qesen, i nu-

mëroi pesëqind groshë, hodhi përsipër xhing-xhing edhe nja tri mexhite të bardha, i dha fjalën se do t'i jepte një pendë qe, pesë krerë dhen e s'di çfarë, pastaj përpoqi duart. Hyri qehajai, e zuri lehtë për krahu e nxori jashtë me të butë. Fshatari ishte edhe i gëzuar – pesëqind e kusur grosh, një pendë qe, pesë krerë dhen! – po edhe i trembur. «Aman, – i tha qehajait, mos më merrni më qafë! Kam në shtëpi fëmijët e mi e fëmijët e tjerë të vëllait. Druhem mos bie në gjak me atë mikun që më ka dhënë kaparë.» «Vër kësulën mbi sy, e qetësoi qehajai, – e i thuaj se çupën e mbajti pashai dora vetë. Në do gjak, le të vijë këtu»...

Që atë natë pashai e mori çupën në jatak. Edhe netët e tjera... Kur mbeti me barrë, e dërgoi në një fshat të largët, që të lindte. Bëri djalë. Atëherë pashai ishte dyzet e kusur vjeç. Këtë punë e mbajti të fshehtë. Të fshehtë-të fshehtë, po fjala i vajti në vesh së shoqes, pashalleshës. Në vend të pikëllohej, kjo u gëzua e i tha pashait: O im zot, pse ma fsheh mua gazin tënd? Gazyt është edhe imi. Unë ndodha të jem kështu siç jam, barkthatë. Ti, pasha, s'më ke faj... Kështu desh zoti. Hidi kurorë çupës, sille këtu me gjithë djalë. Do të ta dua si birin e gjirit e të pëqirit. Do të ta tund në djep floriri, do të ta lidh me shparga mëndafshi, që të rritet, të shtohet e të mos na shuhet oxhaku.» Pashai e shikoi i çuditur, po, e kuptoi se e shoqja i fliste nga zemra. Dërgoi e solli fshataren e vogël, me gjithë djalë. I hodhi kurorë. E shoqja e parë, pashalleshja, e mbajti fjalën: e lidhi djalin me shparga mëndafshi, e tundi në djep floriri. Nuk i mbajti kurrë mëri shemrës së re, të bukur si hënë. Kjo s'bëri fëmijë tjetër. Djali u rrit dhe u bë Shemshedin bej. Pashai vdiq pas disa vjet, po e la me fjalë që i biri të martohej i ri e të bënte shumë fëmijë. Shemshedin beu nuk ia shkeli porosinë. Bëri shumë djem, nga të cilët mbeti gjallë vetëm Xheladin beu; të tjerët

vdiqën apo u vranë nëpër luftëra, për të fituar ofiqe e çifligje. Ama pasurinë e shtoi shumë e më shumë, mbushi kazanë e qypa me verdhashka, se ish lakmonjës i madh pas parasë, dorështrënguar, i rripte të gjallë të gjithë ata që kish nën urdhër. Mbyllte grurin e misrin në hambarë të mëdhenj, që i hapte në mars a në prill, kur binte zia e bënte kërدينë. Mbante njerëz apostafat për të zhveshur karvanët, pastaj bënte sikur i dërgonte për të ndjekur hajdutët, ndërsa kuajt e mushkat e karvanëve, me gjithë barrë, i kishte në ahur. Ua kthente të zotërve me pagesë, dhe, më vonë, ua grabiste përsëri. Shkonte për gosti nëpër fshatrat e nëpër stanet, hante e pinte dhe, më në fund, në të ikur, kërkonte «dhëmbparasi» — pagesë për dhëmbët që ishin munduar për të ngrënë mishin e pjekur. Shpesh trimat e tij grabisnin tufë të tëra bagëtish. Qanin çobenët e çobankat, që kishin mbetur lugëthatë, po Shemshedin beut nuk i bëhej vonë. Njëherë, s'di se kur, thonë se një çoban i krisur, që beu i kish rrëmbyer kopenë, i ra me dyfek të gjatë e krisi e iku. Nuk e vrau, po e plagosi: i futi një plumb në mollaqet. Që atëherë Shemshedin beu s'mundi as t'i hipte kalit, as të ecte me dy këmbë. Plaga iu bë xhidavi, e madhe, që ia punonin me fitil. Lëngoi shumë vjet, përmbys, gjersa vdiq, apo gjersa ngordhi, siç thosh harbutëria e rajallëku. Gjithë pasurinë që kish trashëguar nga i ati, nga pashai, e atë që kish mbledhur vetë, ia la të birit, Xheladin beut. Ky ra pas qejfeve e ahengjeve, pas grave, pas zullumeve. Më tej, për të forcuar oxhakun, u martua me një bijë pashai, mbesë veziri, baxhanakë e stërbaxhanakë sulltani, me atë gamilen kockëmadhe e hundësamare, që i thoshin Xhixhi hanëm apo Xhixhiko hanëm. Beu s'e kish parë fare, se mblesëria e martesë ishin bërë, siç e donte puna, me lajmëtarë, që ia kishin ngritur në qiellin e shtatë të mbesën e vezirit, duke thënë se kjo ishte e bukur si hëna e gushtit, si dudia e butë

e sa të tjera të kësaj dore. Krushqit ia sollën nusen në shtëpi, me suvarinj, me salltanet të madh, me allajka e stërallajka prapa, po pa çupëri... Çupërinë ia kish falur s'di se kujt, që në kohën kur i thoshin Xhixhi hanëmkëz (këtë punë e dinte ajo vetë dhe ai mashkulli festekuq, që kish hyrë i pari në jatakun e saj), po Xheladin beu s'guxoi të bënte as gëk as mëk, se binte në luftë me pashallarë e vezirë, me baxhanakun e tyre, sulltanin.

Ja kështu! Xhixhiko-hanëmi doli, siç thamë, shterpë. Jo tamam shterpë se, siç thoshin gojët e këqija, dikur kish hedhur në diell fëmijën e parë dhe më tej kish shterrur. Këtë punë ajo e dinte qëkuri dhe prandaj ia kish bërë fora, andej, në pashallëkun e babait, duke ndërruar jaranët si fustanët.

Tani sikush bënte jetën e vet në konak të vet: hanëmi: në haremllek, me të pritur e me të përcjellë zonjat e parësisë (helbete, shpesh s'dihet ç'fshihet nën ferexhe: ti pandeh se është femër e të del një bandill mustaqedredhur...); beu, në selamllëk, me ato që dimë e ato që s'dimë.

Dhe prisnin. Çfarë prisnin? Kushedi... Rrallë e tek shtroheshin në sofër bashkë: beu, me Sheqeren pranë, gjithnjë sytë katër; hanëmi, me allajkën më këmbë, prapa kurrizit.

Xheladin beu nuk shkelte kurrë në pashallëkun e vjehrrit, plak, se kish frikë mos kthehej meit, në tabut... Ama «selamet» dhe «aleqym selamet» bashkë me peshqeshet, shkonin e vinin pa kursim. Dhe ndërkaq, beu e nxirrte dufin duke bredhur poshtë e lart, si ata maçokët e shkurgut, kurse hanëmi shkonte e rrinte muaj të tërë në pashallëkun e babait apo në atë të vëllait të madh, dhe atje, tym të dalë: sonte një festë, nesër një tjetër, pasnesër një sarëk – shterpë që shterpë ish!

Pashai plak i kish dërguar fjalë disa herë të dhëndrit

që t'i jepte për grua të dytë një mbesë, çupën e çupës a nuk e di çfarë (që të mos i shuhej oxhaku e të mos i dilte pasuria nga dora), po Xheladin beu, që ish dje-gur nga çorba, tani i frynte edhe kosit e s'desh të bën-te më krushqi me pashallarë.

– Evet, efnm! – thirri Xheladin beu, si e pleqëroi punën në mendje, – do të bëj ashtu siç bëri gjyshi!

Kur ngriti kokën, pa se përpara tij qëndronte Sheqer-ja me tabaka në dorë, me xhezeve e filxhan.

– Ti? Po pse, pse... ajo? Hëm... Hëm... Efnm – dhe u ngrit më këmbë.

Sheqerja buzëqeshi me atë gojën e madhe, u për-kul e mbushi filxhanin, sa një lagjin, me kafe avulloshe.

Xheladin beu ishte burrë i pashëm, i mbushur, i gjatë, po Sheqerja vinte një pëllëmbë më e gjatë. Domosdo, edhe shumë më e mbushur, prapa e përpara. Ajo e din-te se po të qëndronte më këmbë, ne pragu i ballkonit, do të duhej ta shikonte bejnë nga lart poshtë, kurse ky duhej të ngrinte kokën. Punë pa lezet... Prandaj u ul e ndenji burrisht ne pragu i ballkonit, duke hapur djath-tas e majtas palat e shumta të dimiteve dyzetkutëshe, dhe ngriti kryet të shikonte bejnë, që ndërkaq ish ulur përsëri dhe kish ndjellë me zhurmë, sikur të thithte pal-cën e ndonjë kocke, gllënqet e para të «kahves» së valë, zinxhirli, plot kajmak. Sheqerja tha:

– Ajo, bej, t'u bëftë Sheqerja, e ka marrë punën me frikë. S'di ç'i kanë thënë ato ziliqaret, kopilet. Të këtej-shmet e të andejshmet – dhe tregoi me dorë konakët e Xhixhi hanëmit.

– E kanë marrë vesh se është «ashtu»?

Sheqerja bëri me kokë:

– E kanë marrë... E kanë trembur çupën. I kanë thë-në se, gjoja, zotrote do ta vrasësh me gjithë foshnjë. Ka lojtur pak... Kështu e ka barra e parë, ta marrë She-qerja, po kjo bën veç botës. Flet përçart: «Bubu, beu!

Bubu, hanëmi! Do të më hedhin në pus. Do të më mbërthejnë në mur, të gjallël Të ik, të ik, në mal, me ujqit! Bubu, beu! Bubu, beu!» Kështu bën. — Dhe Sheqerja qeshi.

Xheladin beu ndezi një cigare, lëshoi një shtëllungë tymi mbi filxhanin, që ia mbushi Sheqerja së dyti, e tha:

— Jo, moj, jo! Këtë nuk e vras, nuk e mbyt. Unë... unë... efnm, them...

— Ka frikë edhe nga allajkat, nga të gjithë.

— Jo, jo! Të mos ketë frikë.

Për ca çaste biseda u kthye në çuçurimë. Beu e hoqi për jeleku, i tha në vesh ç'kish për të thënë. Dhe kur e kur: «Hëm, more vesh, Sheqe? Kështu... Unë,.. atë... po të bëjë djalë... efnm... si gjyshi!» Ajo dëgjonte e bënte me kokë në të djathtë e në të mengjër: «Peqe, be. Sa mirë të paska rënë në mend. Si të urdhërosh zotrote, bej, ta marrtë Sheqja, t'u bëftë Sheqja. Këtë punë ma ler mua, që t'i gjej vendin. Djalin do të ta rrit unë. Ti i bukur, ajo e mirë, djali si pëllumb! Të pëlcasin nga inqati ata që s'na duan.» Herë pas here bënte me kokë lart e poshtë, duke nxjerrë ca tinguj shumë të thatë a shumë të lëngët nga qiellza, nga gjuha e dhëmbët, që veshi i shquan dhe i kupton mirë, po kalemi nuk i merr dot: «ncuk», «ncuq», «ntxk», «ntck» e kështu më tej. Kur mbaroi, beu i vuri pëllëmbën mbi supin e tultë, të dhjamur, rëndoi, shtrëngoi, sa Sheqes i dhembti, zgurdulloi sytë.

— More vesh, Sheqe? Ashtu të bësh. Po të më sjellësh myzhdenë se bëri djalë, do të të jap një mulli!

— Më rrofsh, bej.

— Tani shko.

Sheqerja u ngrit më këmbë, pothuaj e gëzuar — sepse pëllëmba e rëndë e beut ia kish bërë supin zdrame — dhe, për një çast, me ato kindat e dimiteve të hapura djathtas e majtas, prapa e përpara, u duk si një mullar me bar që e kishin çarfalitur me gojë e me brirë

ca buaj shumë të uritur. Ndreqi palat, u mat të dalë. Beu po e shikonte tërë epsh. Aty për aty iu ndez një dëshirë e re për Sheqen e tij të vjetër. La filxhanë e tha:

– Jo, Sheqe, mos shko. Futi llozin derës dhe eja.

Sheqeres i qeshi fytyra:

– T'u bëftë Sheqja, bej... Ti me mua e ke shpirtin.

Shkoi i vuri llozin derës dhe u kthye me dhele, si dikur. I ndritnin tengllat e mëdha, të arta. Shkopsiti me naze jelekun...

Edhe kështu, atij mëngjesi vjeshte, Xheladin beu i Shemshedin beut të Xheladin pashait u bë përsëri burrë dhe «ortak» me «baxhanakun» e tij, nallbanin, të shoqin e Sheqeres.

Nga jashtë vinte trokëllima e çekanit të nallbanit që mbathte kuajt. Dimitet dyzetkutëshe kishin mbetur jetime, në mes të odës.

– Me Sheqen tënde e ke shpirtin, bej...

– Me ty, Sheqe, me ty..., – thosh beu duke gulçuar si kalë teknefes.

...Sheqerja u vesh përsëri, kopsiti sumbullat e jelekut dhe u mat të dilte, po diç iu kujtua:

– Jashtë presin ca njerëz.

– Ç'janë?

– S'janë gjë, hallexhinj: kasaballinj, fshatarakë. Ndofta, kanë ardhur të qahen.

– Të qahem, efm? U thuaj të flasin me Zykon. Sot jam zaif.

Zykua ishte veqili i parë i beut, një shkurtabiq i çalë e dredhak, që të shkante në hell, të digjte e nuk të piqte.

– Beu shtoi:

– Jam zaif. I thuaj Rizait të nxjerrë kuajt, të më shalojë Allçanë. Do të dal teferiç, andej – dhe tregoi

vagët fushën. – Për gjah. Me shtatë veta. Sillmë rrobat, Sheqe.

– Peqe, bej. A je mirë? – e pyeti ajo me buzë në gaz.

– Shumë mirë, Sheqe.

– Me mua e ke shpirtin, bej, me mua.

Veshi më nge rrobat e kadifesë së gjelbër me vija e sumbulla argjendi, që i kish apostafat për udhë e gjah. Sheqerja u ul në bisht e i mbërtheu kopsat poshtë, nën gjunjë; i lidhi lidhëzat e gjata të çizmeve të verdha, duke i shkuar kanxhë më kanxhë. Kur u mat të ngjesh-te kollanin me fishekë, u dëgjua një trokëllimë në derë. Sheqerja e hapi. Hyri një zhgan kopilesh që sillnin mëngjesin. Xheladin beu u shtrua në sofër, i ra festes dhe e largoi nga balli. Hëngri llap-llup, me zhurmë, si nga hera. E nisi me çorbë pule të majme, tërë sythe lyre, po të athët, të prerë me limua (dinte Sheqerja se ç't'i gatuate që t'i hiqte gromësiat e rakisë), e vazhdoi me mish të bardhë pule e miske, me qengj të pjekur, e mbylli me sheqerpare të mbytur në sherbet të trashë, të mbuluar me pluhur xhenxhefil, kanelle e karafilke. Çliroi kopsat, përpoqi buzët e gjuhën me «oh! oh!...», lëpiu të pesë gishtërinjtë, lakmoi shumë e u ngjesh paq, pastaj, kur s'mundi të hante më, u largua nga sofa, lau duart, u mbështet në jastëk dhe shikoi togun me kocka, poshtë, dhe sofrën plot mishra e ëmbëlsira.

– Eh, efnm! Mirë i ka jaratisur të gjitha i madhi zot, ama një gjë s'e ka bërë mirë: i ka dhënë njeriut vetëm një bark, si kamësit, ashtu edhe skamësit, që s'ka ç'të hajë... Punë i thonë kësaj? Ja, unë hëngra e u ngopa, po teproi. Kush do t'i hajë këto që lashë? Hë? Jo, këtë s'e ka bërë mirë!

Kjo ishte fjala që thosh dendur beu, kur ish me miq, kur hante shumë, velej e tepronte. Tani s'kish miq, po

prapë e tha fjalën dhe vështroi me pikëllim sofrën plot: kish ngrënë shumë, po edhe kish tepruar.

Për një çast harroi gjahun, Rizanë dhe pelën e kullme, që priste në oborr duke çukitur kalldrëmin me potkonjtë e nallbanit të Sheqeres, harroi langonjtë dhe qehallarët, dhe po e ndillte gjumi. Por, më në fund, e mundi veten, u ngrit, ngjeshi lehtë-lehtë kollanë mbi plëncin plot, mori çiftin e zbriti. Trimat e pritën me dorë në zemër e u hodhën ta ndihnin t'i hipte pelës: kush i ndreqi yzengjitë e kush i mbajti këmbën me të dy pëllëmbët dhe e ngriti lart. Puna shkoi zor, se beu që rënduar shumë, po i dha hov trupit e u gjend majë pelës, doli nga porta me qemer guri e u nis për në fushë: ai përpara, trimat prapa, langonjtë kur përpara e kur prapa.

Qielli ishte i kulluar, fusha e kodrat të veshura me dritë, udha e butë, me pluhur, vende-vende, në hije, e lagur nga vesa e natës. Zogj udhëtarë, të rënditur si perusti, fluturonin lart, shumë lart, duke fërfëllirë krahët. Langonjtë çafkëllonin nëpër stërnishtat mbi udhë e nën udhë. Nga një bërryl udhe dolën një tufë fshatarësh me qerre, kuaj, mushka e gomarë të ngarkuar me drithë, aepë, presh, kunguj, pemë, dru: i shpinin në konakët e beut. Kur e panë, mbajtën kafshët e qëndruan buzë hendekut, si të ngrirë, me dorë në zemër. Beu as që u hodhi sylë. Tani e kish marrë pak veten dhe kulloste rreth e qark sytë e skuqur. Nata e ahengut kish mbetur prapa, larg, në mjegull, me gjithë jarnanitë e jarnanatë e saj, që dukeshin të paqena, si një ëndërr e keqe e një nate dimri, kur të bëhet sikur të ndjek një llavë ulqsh, të afrohet të të çajë e ti bën të vraposh, të shpëtosh, po nuk ik dot, je mbërthyer në vend, thërret me të madhe e as veshi yt s'ta dëgjon zërin. Edhe Xhixhi hanëmi ishte zhdukur bashkë me natën e dimrit, me ujquit. Xheladin beu ishte në dell të mirë, bënte, i gëzuar, «ohoho!» e

«ahaha», jepte e merрте me vete. Ata që vinin prapa dëgjonin, po nuk ia shkoqitnin dot fjalët.

Papritur, era solli një kundërmim kërmë. Beu e trimat kaluan të ngrysur pranë një gomari të ngordhur me këmbët përpjetë, me kokalla të kuqe, dhe trembën një tufë galash të shtruara në gosti. Këto u ngritën e shqitën sipër kalorësve si ca hije të zeza, krokërinë me zemërim, ranë në një ugar, u ngritën përsëri e u kthyen në gostinë e tyre.

Beu nxori cigare, e ndezi, që të shpëtonte nga kundërmimi i kërmës. Nëpër arat me misër të paprerë, zbardhën, skuqën, zverdhën për një çast ca shami, pastaj s'u panë më. Domosdo, Xheladin Beu e kish hijen të rëndë, prandaj gratë e vajzat u tultitën nëpër misrat.

Më tej era u bë përsëri e pastër, e këndshme, si në vjeshtë. Një çast iu kujtua Gurija e trembur, me barrë.

– Në djall të vejë edhe kjo! – tha dhe hodhi tute bishtin e cigares.

Vetëm një gjë nuk harronte dot: atë gjerdekun e dësh-tuar të natës që shkoi, i qe ngulur si një gozhdë në tru, megjithëqë Sheqerja e kish kënaqur në mëngjes, si nga-hera. Iu duk sikur ia dëgjoi zërin e butë, ledhatonjës: «Me mua e ke shpirtin, bej... me mua! Të vesh ku të vesh, me mua e ke shpirtin!» Dhe Sheqerja kish të drejtë: me të e kish shpirtin Xheladin beu. Dhe s'di se si, i vinte keq që ia kish falur nallbanit, baxhanakut. Më në fund tha:

– Prapë imja është. Kur të dua...

I futi mamuzet pelës dhe e ngau vrap përpara. Më tej dërgoi një qehaja të lajmëronte të parin e akëcilit fshat se do t'i vinte për drekë e pastaj u fut nëpër kori-je, pas gjahut.

Gjahu i vajti shumë mirë atë ditë: turtuj, thëllëza, pëllumba... Ai vriste, langonjtë e qehallarët ia sillnin.

Drekën e hëngri jashtë, në «jeshillëk», pranë Kroit të dardhës plakë, se aty kish kërkuar vetë. Të trapiturat pas gjahut, rakia e mirë, e ftohur brenda në krua, mezetë e shijshme ia hapën oreksin sa për katër barqe. Beu mbushi vetëm një, sepse aq kishte, po e ngjeshi mirë, si targaç kurbati: hodhi brenda shumë, nga të gjitha.

Tani, ndërsa trimat ishin shtruar e po hanin pak më tej, në një brinjë, beu rrinte shtrirë në qilim, me të mblën e djathtë të mbështetur në pëllëmbë: Burrat e fshatit, pothuaj të gjithë bujq në çiflig të beut, kishin lënë punën e grindjet dhe kishin ardhur t'i faleshin, t'i bënin nder, siç e do puna. Këta rrinin nja dhjetë çape larg, poshtë, kush më këmbë e kush më bisht a më gjunjë, duke pritur një shenjë, një urdhër. Ca të tjerë u shërbenin trimave të beut, që hanin bukë e mish e ua hidhnin kockat langonjve. Beu mbajti pranë tij vetëm disa pak burra nga parësia, me qosteqe e pafta ergjendi në gjoks e «peqepeqe» në gojë. Këtyre u hodhi vëp e vëp nga një cigare të hazërtë, që ishin shumë të mira, sepse i kish dredhur vetë Sheqerja e i kish ngjitur me pështymën e saj.

Drita e ditës ishte e butë, e ëmbël, si e kulluar nëpër gjergjir. Beu foli për punët e mëdha e të vogla të mbretërisë; për «diellin e dynjasë», Baba Sulltanin, që ia kish vënë këmbët në një këpucë gjithë «Avropës» ia kish hedhur hallkën tejpertej nëpër hundë e bënte të lozte si ari. Së shpejti, Baba Sulltani do të nxirrte këllëçin e madhe e do t'i bënte hi e pluhur të gjithë kralët e mëdhenj e të vegjël, do t'u merrte gratë e çupat e do t'i mbyllte në haremin e Stambollit. Domsodo, ato që do të tepëronin, do t'ua falte të mëdhenjve të mbretërisë. Tha se ai, Baba Sulltani, mblidhte njerëz me harxhe, paguante tink-tink alltën e argjend. Pastaj papritur, vuri re se

burrat që kishin ardhur t'i merrnin dorën ishin të paktë.
Fyeti:

– Efnm, vetëm kaq burra paska fshati? Ku janë ata të tjerët?

– Ka vdekur një si çun e vogël, bej. Kanë shkuar ta kallin në varr, – tha njëri.

– Ka vdekur edhe një si grua, me nder zotrisë sate, një nuse e re, – tha tjetri.

– Hëm, hëm, xhenaze biçimi... Dy të vdekur në një ditë. A mos i ka rënë murtaja fshatit? – pyeti beu edhe si me të qeshur, po edhe me frikë.

– Murtaja jo, bej, po na grinë ethet. Edhe dje...

Beu s'pyeti më tej si e qysh, si nuk pyeste kurrë për punë vdekjeje. «Këta derra çifçinj janë të shtuar si fara e sinapit... Vdesin, po nuk shuhën fare. Po të kenë bukë misri, shtohen gjene, se ato dosa fshatarake pjellin stërc e stërc, për mot.» Aty për aty e ktheu bisedën: «Më keni mbetur borxh kaq grurë e kaq misër, kaq dru... Dushk i dua. Mjaltin s'ma keni sjellë. Harruat ku jeni? Do t'ju dërgoj Zylfon a Zykon që të ndajmë hesapet bashkë. Hëm... hëm...» Fshatarët dëgjonin me sytë përdhe. «Grurin e misrin i kemi larë. Edhe drutë i kemi larë. Sot dërguam të fundit.» Dhe me gjysmë goje: «A mos i ka mbajtur Zylfua për vete?» Po fjalët e tyre s'i ranë në vesh beut, se askujt s'ia mbante të fliste me zë të lartë. Beu ligjëroi:

– Shkoni, bre, andej, me harxhe, – dhe tregoi tutje me dorë. – Të mbushni qeset e të lani borxhet. Dovleti ka haznë të madhe, ka taraphanë. U jap kartë për tim vjehrr, pashanë, se më ka bërë haber: do njerëz. Dovleti ka luftë, lufta sjell pare, të mbush me plaçkë.

Dhe, si rrinte kështu, me cigaren të shuar ndër gishtërinj, e preu një gjumë i lehtë, i ëmbël, pa jarnani e jarnana, po me gurgullimë kroi, me shushurtimë fletësh të zverdhura, që shkundeshin e binin duke u tundur në-

për erë. Sapo e preu gjumi, ata me qosteqe në gjoks u shikuan sy në sy e u larguan, së prapthi, ngadalë, duke shkelur në majë të gishtërinjve.

Trimat kishin mbushur barqet e çlodheshin duke kruar dhëmbët me ndonjë kleçkë. Langonjtë rrinin aty pranë me gjuhën jashtë, të kuqe, të varur si llapë.

Kur u zgjua, Xheladin beu pa se kish përsipër një mbulesë të lehtë, që ia kish hedhur Rizai. E largoi tej, u ngrit shesh, fërkoj sytë e tha:

– Efm, më paska marrë gjumi.

Ndënji sa ndënji kështu, pastaj shtoi:

– A ikim, o Riza?

– Si të urdhërosh zotrote, bej.

U ngritën të shkonin, po nuk shkuan. Moti i ëmbël e gjahu i mirë i mbajtën gjer vonë, kur dielli kish kthyer më të perënduar. Edhe një copë herë të mirë çiftet e tekot krisën bambum, nëpër korije.

Vetëm një qajah nuk pa me sy kësaj radhe: çupa e nuse. Në asnjë nga fshatrat që shkeli. Ta pret mendja: ish hapur fjala anembanë se kish dalë beu për gjah dhe... «Ama derra këta çifçinj! I mbajnë dosat mbyllur!» Pa beu aty-këtu ca plaka leckamane të ngarkuara me dru e karthie, po ç'i do këto? Janë si ajo pastërmaja e dhisë. Beu s'desh pastërma; desh mish fëllëze.

Tani qjendej në një çukë me këlpishte. Rizai vinte prapa me torhat plot. Kuajt prisnin tutje, në udhë, në anën tjetër. Fërshëlleje me dy gishtërinj në gojë e vinin sakaa. Po nuk fërshëlleu njeri. Aty poshtë, midis sallkëmësh, ishte një pus me çikrik, që bënte gau-giu kur zbriste e ngjitej kova. Që aty vinin ca zëra të hollë, zëra cupash. Qeshnin, i thërrisnin njëra-tjetrës. Beu mbajti çapin e i bëri me dorë Rizait: mos luaj nga vendi! Dy turtuj topolakë kishin qëndruar në një degë këlpishteje mu mbi krye të tij. Çiften e kish të mbushur. Po nuk u ra. Më në fund, ndajnata i sillte një gjah tjetër në gry-

kë të dyfegut. Çupat e fshatit e dinin të ikur dhe kishin ardhur të mbushnin ujë.

Vragës-vragës, Xheladin beu zbriti çukën, hyri nëpër sallkëme, iu afrua pusit. Aty ishin nja shtatë a tetë çupërlina që flisnin e qeshnin. Ca kishin mbushur stomnat, ca po i mbushnin e nja dy prisnin radhën. Namëta, ai me një këmbë u nxori përpara Xheladin benë! Çupërlinat klithën sikur të paskej rënë ujku, lanë stomnat e u përhapën ku mundën: kush hodhi ledhin, kush çau drizat e kush mori vijën tatëpjetë. Shumë gjemba hynë atë ditë në mish të butë, po më mirë nëpër gjemba se sa në dorë të beut... Sa të mbyllësh e të hapësh sytë ikën të gjitha. Të gjitha, veç njëje, që i ra stomna nga dora e iu kthye. Çupa e shikonte bejnë si zogu gjarprin, që i afrohet t'i hedhë helmin, dhe s'ikte dot. Sikur e mbante të rëndët e dheut. Një cifël e stomnës së thyer ia kish gjakosur njërën këmbë, po shkaku nuk ishte ky: frika e kish mbërthyer në vend. «Qenka pëllumbeshë e butë, peshqesh nga zoti» tha beu me vete dhe iu qas më pranë. Çupa sikur s'ish nga kjo botë, po nga bota tjetër: një hyrije e veshur e tërë në të bardha: linjë të bardhë, shami të bardhë mbi leshrat e verdha, trup të hedhur, sy të gjelbër si bari i njomë i kënetës. Beu e peshoi me sy, që nga kiskat e holla, mbi noçkë, ku zbriste një fije gjaku, gjer lart në pulpat që ngjiteshin nën linjën, pastaj lart, në belin si të shkuar nëpër unazë, edhe më lart, në gjinjte e vegjël, në qafë, në gojën e vogël, me ca buzë të tulta, të kërcyera, me hundën të derdhur si qiri, me sytë e blertë kënetorë dhe ballin e sheshtë, të bardhë. «Shiko, shiko, efm, ç'bereqet bëka çifligu i Këlpishtes e unë s'ditkam gjë. Hyrije e zbritur nga xheneti! Po t'ia dërgoj padishahut më bën menjëherë pasha. Jo, s'më duhet pashallëku! Imja është e do ta mbaj vetë. Kjo ia shkon njëqind herë Gurijes e gjithë të tjerave. Do ta marr që tani! Sonte, në jatak...» Kur iu afrua më shumë, sa

ta prekte me dorë, çupa u drodh, po më fort iu drodh buza e poshtme. Dhe ndërkaq, nën linjën e qëndisur me të kuq e të zi gjinjtë ngjitu-zbrit, ngjitu-zbrit, sytë iu mbushën plot lot. Por beut s'iu bë vonë; ai ish mësuar me gjëra të këtilla: qengjet blegërijnë kur u vë thikën kasapi, çupat qajnë kur i merr beu në dyshek. Pastaj, kur e shkon në hell dhe e pjek, qengji bëhet shumë i shijshëm; çupa e marrë së dyti së treti në jatak bëhet më e shijshme sesa qengji.

Xheladin beu zgjati dorën, i çiku lehtë faqet dhe ndjeu një ëmbëlsi të madhe në trup, sikur u përtëri e u bë djalë njëzet vjeç.

– Mos më qaj, moj sulltane, mos... Unë të kam xhan, unë s'të ngas. Do të të bëj zonjë mbi zonja.

Çupa u drodh edhe më shumë, u mat të ikte, po beu i shtrëngoi krahun si në mengene. Atëherë ajo lëshoi zërin e klithi:

– Nëëëno! Nëëëno, moj!

Beu u ngrys, po i foli butë:

– Jo këushtu, moj sulltane, jo këushtu... Mos thirr. Si të thonë? Ti je çupa e çifligut; çifligu është imi! Edhe ti je imja. Do të të marr në konak, do të të bëj...

– Nëëëno! Nëëëno!

Nuk shkoi shumë, e u dëgjua një zhaurimë e madhe nëpër degët e varura, sikur të çante udhën ndonjë derr i egër nga ata të mëdhenjtë. Beu ktheu kokën andej. Jo, s'ish derr, po një grua e gjatë, e thatë, e nxirë si çotillë lisi që e ka djegur rrufeja. Gruaja u turr, i shkëputi beut çupën nga dora e i thirri:

– Po ta bësh edhe këtë punë, s'të djeg as zjarri i xhehenemit, Xheladin bej. S'të tret dheu!

«Ç'është kjo e krisur që më del përpara?» – tha Xheladin Beu me vete dhe u zbyth. Çiften e kish në dorë, të mbushur, me imniet të hequr. Mund ta zbrazte, po nuk e zbrazi: u praps edhe më tej. Ai u praps, gruaja

e ndoqi ballë për ballë. Tani vetë beu ish si një zog që sheh gjarprin tek afrohet e nuk ik dot. E mban të iëndët e dheut. Gruaja u kthye e i thirri çupës:

– Ik shpejt!

Kjo s'priti t'i thosh së dyti: hodhi ledhin e ua mori me të katra. Kish qenë e s'ish më.

Xheladin beu e shikonte gruan e s'fliste dot. Kjo ish e gjatë, e thatë, po ndryshe nga Xhixhiko-hanëmi. Dukej nga nishanet se dikur kish qenë e bukur, kurse e bija e pashait kish qenë ngahera një thes me kokalla si ato të gomarit të ngordhur që kish parë udhës. Dhe ishte e fortë: të të binte një herë me atë pëllëmbë, të linte në vend e vinin të tjerët të të ngrinin në trirë e të të hanin hallvën.

– Ta dish, o pushtanik, – thirri gruaja si iku çupa, – po të bësh atë punë me këtë çupë do të ta hanë mërshën krimbat, do të t'i qitin sytë galat! Jo galat, po do t'i qit unë, me thonj. Çnderove gjithë çupat e botës, tani kërkon të çnderosh edhe tët bijë!

«Ç'po thotë kështu, kjo e marrë? Ku kam unë çupë? S'kam as çupë, as djalë...»

Gruaja mori vrull, e zuri bejnë për jeleku, e tundi dhe e shkundi me atë dorën e fortë, sa i kërcyen edhe më fort sytë e skuqur.


– S'më njeh ti mua? S'e njeh Maron e Kovit, që e çnderove në të ri, se kishe kamxhik në dorë, se ishe i fortë? Ja, ajo që kishe pranë është jot bijë! Ta dish se unë do të ta shtyp kokën, si gjarprit, po të bësh me çupën, ç'bërë me mua! Y-y-y, murtajë. Pusht Stambolli! Matuf!

E shtynte, e hiqte, e tundte, e shtynte prapë, si leckë, dhe ai, Xheladin beu, zot kasabaje e zot çifligjesh, zgurdullonte sytë si të bufit e s'bëhej dot burrë t'i shkëputej nga dora, s'ishte i zoti t'i binte me çifte a të nxirrte këburen nga brezi.

MITRUSH KUTELI

SHABAN SHATES

MIRUSHAN AGRI



– Më ke marrë nderin, të marrtë zoti mendtë! Më ke lënë në turp të zi më të lëntë perëndia pa sy, të heqshin për peri! Më ke ngrënë jetën, të hëngërt mortjal!

E tundi sa e tundi, pastaj i dha një të shtyrë, sa beu i madh ment u shemb përdhe. Gruaja shkoi e mbloodhi copat e stomnës së thyer e ia hodhi përpara, ku mundi: këmbëve, gjunjëve, duarve, duke mallkuar pa pushim:

– Ia theve, thefsh arrëzën e qafës! U kalbsh së gjalli, përmbys, siç u kalb yt atë, që e hëngër krimbat! Ngorç në ndonjë përrua si qen i zgjebosur! Na shojte, t'u shojtë emri, të këndoftë kukuvajka në shtëpi! Ku është parë e dëgjuar të çnderojë i ati të bijën?

Copat e shtambës i vinin breshër, dhe ai, beu, rrinte i ngrirë në vend; nuk fliste dot, nuk ikte dot.

Gruaja u përkul mbi kovë e zuri t'u hidhte ujë syve, me grusht. U hidhte e mallkonte. Stërkalat e qullën Xheladin bejnë. I dukej sikur dheu kish nisur t'i vinte rrotull, sikur dëgjonte dajre e dauille bashkë: xhing-xhing, dum-dum. Dhe në mes të kësaj bubullime shquante zërin e çjerrë të Difes:

*Sa të dua unë ty,
Më rri mendja gjith ne ty:
Ato cicat sherbetli
M'i bëj meze t'i pi raki...*

Po Difja ishte larg, s'di se ku, Marua ishte afër. Dhe Marua u hidhte ujë syve e mallkonte:

– Të çaftë ulku e të nxjerrtë zorrët! Të pjekshin në hell, të gjallë! Humbsh e mos u duksh, mos u dëgjofsh!

Të gjitha i dëgjonte beu e s'thosh dot një fjalë, të paktën «efnm» ose «hëm-hëm», siç e kish zakonin. Sikur i qe kyçur goja.

– Na plase, më të plastë dhjamët e syrit! Na kalle

frikën, më të kallçin të gjallë në varr! Na dogje, të djegshin lugat!

Fjalë e mallkim, fjalë e kanosje. Dhe më e keqja: ndofta e dëgjonin trimat përtej, ndofta e dëgjonte Rizai.

...Xheladin beu u zbyth pa bërë zë, rrotulloi çukën e doli në udhë, ku prisnin kuajt, i hipi Allçasë, i futi mamuzet e ngriti kamxhikun.

— Ike, mos u kthefsh; ike, të ikshin mendtë e kokës! Mos arrifsh i gjallë në shtëpi! — vazhdoi gruaja fill i vetëm pranë pusit me çikrik.

Allçaja u bë veri; i ndritnin potkonjtë e bardhë. Po ngrysej, po qielli kish edhe pakëz dritë — një dritë sedefi, si vragë, që e ndante nga toka e errur. Dhe mbi këtë vragë kish një brez të gjerë, të gjelbërth. Pastaj u shojtën të gjitha dhe zbriti mugëtira. Bashkë me mugëtirën nisi të frynte një erë e ftohtë, që ngrinte pluhurin e udhës.

— Hëm-hëm! — bënte beu, — Jezit-grua! Lanet-grua!

Trimat, me Rizanë në krye, që i kish hipur një kali çil, kishin mbetur prapa, sepse pela e beut s'e kish shoqin në vrap. Lluk-lluk, i bënte barku. Ferrat e pemët iknin si ca hije në të dy krahët e udhës.

Era e ftohtë i vëzhgëllinte veshëve.

Në ura e drunjtë po vinin ca qerre të ngarkuara me misërishte. Rrotat kërcisnin thatë, gau-giu. Pranë tyre dhe prapa vinin ca fshatarë më këmbë. Beu shkoj si shigjetë pranë tyre dhe ata as që patën kohë ta shihnin mirë cili ish. Ikte, ikte, si i ndërkyer.

Pas një copë here tha:

— Ç'po bëj kështu? Unë po e vras Allçanë...

Lehtësoi mamuzet, hoqi frenë, bëri «trrrp» dhe pela zbuti vrapin; më tej nisi t'ia merrte me hap. E arritën trimat nga prapa.

«Ç'është kjo grua?» tha me vete.

Dhe ngadalë, kur po e mbulonte botën errësira, Xhe-

ladin beut nisi t'i bëhej përbrenda një dritë e hollë. Ja se ç'pa nëpër këtë dritë:

...Pranverë. Kish mugulluar bari, kish çelur dardha. Beu kish dalë në fushë. Jo për gjë, po konakët nuk e nxinin dot. Pranverë, kjo! I vlonte gjaku. Sheqerja e ato të tjerat s'i dukeshin gjë, s'e ngopnin më. Donte gjësend tjetër e s'dinte ç'donte. Dhe kur po bridhte kështu, me dëshira shumë, poqi udhës një çupë fshati, të njomë, sindozot kjo që kish parë sot ne pusi me çikrik. Çupa u mundua të ikte, po beu e arriti. Ajo luftoi me tërë atë fuqinë që e jepte moshja e re; e shtyu, i shpëtoi nga dora, iku, thirri, po beu e arriti, e goditi me kamxhik, e rrëzoi. Luftoi përsëri, e goditi bejnë, e kafshoi, e gjakosi. Kjo e ndezi më fort Xheladin bejnë dhe i ra së dyti me kamxhik. Çupa i kish sytë të mëdhenj, të blertë si barishtat e kënetës, dhëmbët të bardhë, të mprehtë. Dhe luftoi përsëri, po gjithnjë më dobët. Luftën e vendosi kamxhiku. Po të mos kish qenë ky, nuk do të kish ndodhur ajo që ndodhi. Beu iu hodh si ujku deles. Ajo thirri përsëri dhe thirrjen e saj e dëgjuan disa grari që ndodheshin aty pranë, po kush guxonte t'i dilte përpara Xheladin beut? Çupa nuk lotoi, veçse kur u ngrit që poshtë me linjën të çjerrë, me vajzërinë të humbur. Ndenji kryeunjur nën një pemë dhe atje lotët filluan të pikonin përdhe. Kamxhiku i kish lënë në trup vazhda të përgjakura. Edhe beu e kish kërcen e veshit të ndarë më dysh. E pyeti si i thonë. Ajo e shikoi si ulkonjë dhe nuk iu përgjigj... U ngrit e shkoi çalë-çalë, humbi nëpër lule e blerime. Por beu ia gjeti tragën: i thoshin Marua e Kovit. I ati hiqte nga oftika, në rrogoz, në kasolle. Beu u përpoq ta merrte kopile, në konak, si shumë të tjera. S'desh. U përpoq ta shtinte prapë në dorë; s'mundi. Trimat e beut e rrahën Kovin. Ky lëngoi edhe pak kohë, pastaj vdiq. Beut i ra në vesh se Marua kish mbetur e iëndë. Atëherë i bëri fjalë një bujku që ta merrte grua.

Bile, i taksi një pendë qe e s'di çfarë, po bujku krisi e iku s'di se ku. S'kish dashur të bëhej «baxhanak e ortak» me Xheladin bejnë, siç bëheshin vezirët e pashallarët me sulltanët e Stambollit. Më tej beu ra pas epshesh e gazesh të tjera, mori grua Xhixhi hanëmin, që të ngrinte lart e më lart oxhakun, e ia humbi gjurmën Maros sylbertë. Kjo ishte, si i thonë një fjale, «fis i shuar», pa krahë. Lindi një çupë, punoi dhenë, si bujkeshë, pleqëroi e varrosi nënën dhe rrojti e veçuar, e përçmuar, e egërsuar në një cep çifligu. Dalngadalë iu shua bukuria e dikurshme, iu rreshk e u rrudhos fytyra, po çupën nuk e braktisi. Dhe ja tani, pas kaq vjet, i del përsëri përpara. Çupën e ka t'i presësh kokën. I tha se kjo çupë ishte e tija. Dhe beu i zuri besë... Po në e gënjeu? S'ka se si të jetë e bija! «Këto dosa çifçesha gënjejnë si ata derrat çifçinj.»

– Më gënjeu! – thirri Xheladin beu me zë dhe e ngau pelën përpara.

Dhe ç'fjalë të rënda i tha ajo deli-grual! «Y-y-y, mur-tajë; pusht Stambolli! Matuf! Të marrtë zoti mendtë! Të lëntë perëndia pa sy! Ngorç në ndonjë përrua, si qen i zgjebosur! Të këndoftë kukuvajka në shtëpi! Të plastë dhjamët e syrit! Të djegshin lugat!» Beu i kujtonte të gjitha mallkimet, s'kish harruar asnjë. Dhe gruaja iu kanos t'ia shtypte kokën, si gjarprit. E shtyu, e pështyu. «Si i durove këto të gjitha, o Xheladin bej?» – «U ndodha gafil.» «Gafil, apo pate frikë?» «Unë... frikë? Unë...» «Hajde, bej, hajde... Edhe për tët atë të tha fjalë të rënda nga ato që nuk i ngre kandari.»

Kështu jepte e mernte Xheladin beu. Trimat e dëgjonin e s'bënin zë.

Ish errur natë. Cicërinin bulkthet. Lart, në qiell, ndriçonte kllçoçka me gjithë zogj. Tërë fusha sikur mernte frymë. Befas çau erën një zë i çjerrë, si zë grifshe. Beu u tremb, po e mori prapë veten: trimat i kish prapa. Tha:

– Do të kthehem ta rrah me kamxhik atë deligrua. Më gënjeu... I marr të bijën edhe e sjell në konak. Kështu! Ment ktheu pelën, po atë çast i ra një mendje tjetër.

– Këtë punë e kam në dorë. Dërgoj nesër trimat dhe e mbarojnë. Evet, efnm.

Dhe përsëri: të kthehet, të mos kthehet...

– S'kthehem dot, u bë vonë. U lodh pela. Nesër, qëmenatë, u bëj urdhër trimave e ma sjellin. Këtë punë e mbaron Rizai. Ajo, ime bijë? Jo! më gënjeu plaka.

Era e mbrëmjes sillte një kundërmim të rëndë; udha shkonte pranë vendit ku gjendej kërma e gomarit të ngordhur. Beut iu duk sikur e kish zënë dikush për gryke dhe e shtrëngonte. «Kërmë, krimba. Kështu do të bëhem edhe unë nesër?» Pastaj doli nga vendi i kundërmimit e iu bë sikur pa Rizanë, kaluar, me çupën përpara, të mbështjellë me një çarçaf të bardhë. Dhe u gëzua. Do ta bënte të tijën, jo si Maron, përdhe, në fushë, po në jatak. Do ta rrihte, po ta donte puna. Edhe do ta përkëdhelte. Ja kështu...

Pastaj të gjitha këto u shembën siç shembet një shtëpi plitharësh që e merr lumi. «Mirë, po cili është Rizai?» «Rizai? Djalë fshati». «Djalë fshati, po i kujt?» «Djali i asaj, si i thonë? Aha, më ra në mend: djali i Xhemiles!» E bukur kish qenë Xhemilja, i bukur ishte dhe Rizai. Djalë pa baba. Jetim? Jo, nuk ishte jetim, po pa baba. Beu e mori në konak, më parë... ndryshe, dyber-hesapi, pastaj qehaja, se ai i pari qe mplakur. I ati i Rizait (që s'ish tamam i ati, sepse Xhemilja ia kish sjellë djalin, si i thonë, përpara kalit) kish qenë plak dhe e kish marrë Xhemilen për pleqëri, me gjithë djalë, siç i kish dhënë urdhër beu.

Pastaj mendimi iu çakërdis. I bënë veshët sikur dëgjoji një këngë të vjetër, të harruar:

O çun, çun; çun, çun,
Gushën si pëllumb,
Mos ma pi rakinë,
Se të bën zullum...

Hëna! Doli hëna! E kuqe, me njerën anë si të ngrënë, po edhe kështu siç ish bënte mjaft dritë. Bashkë me rrezet e parë, që i goditi bishtin e syrit, Xheladin beut iu duk sikur dëgjoji një zë që tha: «Po vjen yt bir kaluar e po të sjell tèt bijë për gjerdek. Vëllai i sjell motrën baba-it... Hajde-hajde, ku degdise o Xheladin bej! Si qentë e si derrat!»

Kush foli kështu! Askush! Aty pranë s'kish njeri. Po atëherë kush?

Dëgjoji çape kuajsh që afroheshin. Ktheu kokën dhe njohu kalin e Rizait. E iu duk sikur Rizai kish përpara një gjë të bardhë: i sillte beut të bijën. Vëllai... motrën. «Ta solla, baba. Merre time motër, tèt bijë!»

...Që ku dolën këto gala? I prenë udhën, me hijen e tyre të rëndë, pastaj u zhdukën. U zhdukën dhe u dukën prapë, përsipër, mbi krye, duke krokëritur. Midis tyre ishte edhe një korb i zi, që e kish vrarë atij mëngjesi, sepse e kish pandehur pëllumb. Ky korb bënte më të madhe e këndonte si njeri:

Jaranani, jaranana...

Ku ta dish? Korbi ka tre shpirtëra e prandaj rron treqind vjet. Rron, se ha kërmë. Ngjallet lugat. Jo, ky s'është korb, po lugat!

Xheladin beut i hipën të dredhura. Aty, mbi udhë, kish ca varre që i kishin mbytur ferrat. Iu duk sikur pa një dritë e sikur dëgjoji një zë:

— Hajde, se të presim, o Xheladin bej! Të presim të

na vish në tabut floriri, me qefin mëndafshi, ashtu siç të kanë tundur në djep.

Dhe galat, lart, që i printe ai korb i zi:

– Ga, ga, gaaa...

Jo, s'ishin gala, se natën s'ka gala. Ishin bufë kënete.

Hëna hyri në re. Zotëroi errësira.

Xheladin beu i nguli mamuzet pelës, ngriti kamxhikun, goditi. Pela u bë furtunë. Në të ikur e sipër, beut i ra kamxhiku nga dora. Papritur, ia preu udhën një hije. Xheladin beu nxori koburen nga brezi dhe e zbrazi. Po vritet hija? Ajo i preu udhën përsëri.

Pela ish mbytur në djersë. Ment pëlciste.

...Xheladin beu i Shemshedin beut të Xheladin pashës, njeriu i gjakut, i ahengut dhe i frëngjyzës, kish humbur mendjen. Dhe ikte nëpër fushë, natën, në udhë pa udhë, kurse dheu, pemët, hijet dhe çdo gjë e gjallë dhe e vdekur këndonin pa pushim:

Jarnana, jarnani...

M'i bëj meze t'i pi raki.

.

Jarnana, jarnani...

III

E gjetën të nesërmen në një hendek. Të gjallë. Nuk njihte njeri. E shpunë me një trirë, në konak, ta përkujdeste Sheqerja. Po si përkujdeset i çmenduri? Domosdo, i lidhur. Pëlliste. Hante nën vete.

S'di kush i bëri fjalë Xhixhi hanëmit. Ajo erdhi shpejt,

me të vëllanë. Pas tri ditësh Xheladin bejnë e kallën në varr. Xhixhi hanëmi mori ç'mori e u kthye, me karvan e suvarinj, në pashallëkun e babait. Çifligjet i shiti më vonë.

Po Gurija ç'u bë?

Ku ta dish...

Bukuresht, 1929

Ripunuar më 1965

Natë muaji shëmbitër¹⁾

(Rrëfim i parë i Argjir Vlonjatit)

Kisha dalë një ndajnatë vet i vet të shëtis buzë liqerit, përtej Gurit të Mullozhdit.

Shiu që pat rënë pakëz më parë kish platitur pluhurin e rrugës e kish larë e shpëlarë zallin.

E më të perënduar e sipër, përtej maleve të Mokrës, dielli, si gjithmonë, i vuri zjarr botës gjithë. E në një çast e lart këto retë e qiellit, kjo Galiçica e thatë së bashku me Shëndaumin e një pjesë e liqerit ku s'kish rënë hija e maleve, u bënë flakë e prush i gjallë. Pasaj, dalngadalë, zjarri se ç'u ngrit lart e më lart, liqeri u mahnit e u terr, korijet u hirosën e Mali i Thatë fort i mjeruar veshi medoemos gunën e dhirtë.

Era e ndajnatës që zbriti nëpër njëqind e ca gryka filloi të hapë gjer tejpertej vraga me zhubra mbi faqen e liqerit. Atëhere pata vënë re edhe unë që afër anës, përtej kallamishtave të rralluara, se ç'u javitën mizëri rosa të egra, lajmëtarët e dimrit tonë. Se, më pat dalë menç t'ju them se asohere ishim në palcën e vjeshtës e gjithë pylli e vreshtat bashkë ishin veshur me ndryshk.

1) Emrat e shenjtorëve autori i përdor në trajtën që i përdorte populli në të folmen e përditshme.

E sindozot se rrija buzë liqerit e vështroja fort i mje-
ruar ndryshmëritë e motit, ja se, pa një pa dy, ç'më pat
shkrepur në fiqir një pyetje:

– Vallë, ku gjendet këtij moti ky Argjiri ynë, Argjir
Vlonjati?

Pyeta të parin njeri të njohur, që më doli mbudhë.

– Argjiri i Vlorës? – tha ky, – e si t'u paska kujtuar
ky Argjir i Vlorës? Atij s'i gjendet kurrë gjurma. Gjoh
pa gjurmë, ai! Vjen e shkon, shkon e vjen e nuk zë qen-
dër në botë. Ish këtu njëviti, po iku e s'di ku i rrahin
barqet tashi. Vlonjat ai! Vlonjat sot e Vlonjat mot!

Hodhi një vështrim mbi liqer ku shtrohej mugëtira
edhe pa vetë me syt e tij shpesërinë e vjeshtës.

– Ja, – tha, – ja karabataku përtej! Argjiri ka qenë
ustaf i esj. Te paska qenë këtu Argjiri, nuk dilte karabataku
ARËS. Prandaj mos t'u pat kujtuar ky Argjiri i Vlorës?

– Prandaj, – thashë unë.

I dhashë tungjatjeta e u largova.

Në shtëpi pyeta gjyshen:

– Ku është Argjir Vlonjati?

Sado e zemëruar që ish në veten e saj, me Argjirë,
kjo ime gjyshe gjith e desh me zemër e i merрте anën,
në mungesë e sipër. Ia merрте në mënyrën e saj.

– Pse, bir-o, i thua Vlonjak këtij Argjirit tonë?

– ...

– Mos, bir-o, mos... Jeni një zjarr e s'të bië t'i thuash
Vlonjak.

Se, që ta dini e ju, gjyshes sime i dukej se emri
Vlonjat, a Vlonjak, si i thosh ajo, – i është vënë Argji-
rit për t'u tallur.

– I them edhe unë siç i thonë tërë fshati, i madh
e i vogël: Ar-gjir Vlo-nja-ti, – i fola unë duke qeshur.

E me të vërtetë, gjithë bota i thosh kështuzë, si pa
gjë të keq, edhe Argjiri nuk i mbante askujt mëri. Për-
kudrazi, i kish më krye e sipër. Emrin Vlonjat Argjiri e

kish fituar me gjakun e vet, në luftën e Vlorës, ku kish punuar trimëri të madhe, sa kish bërë të mbeten me gojë hapur gjithë lalotët e Labërisë. Se kur ziente dyfeku e lehte mitralozi, Argjiri hidhte gunën e dhirtë mbi telin me gjemba e lëshohej si fërtymë drejtpërdrejt mbi mitraloz. E rrokte me dorë e ia kthente italianit. Nuk e zinte plumbi i vdekjes, sikur të paske pirë ujë të gjallë.

Kur u kthye në fshat, nuk solli përveç se disa plagë të mbyllura, emrin Vlonjat edhe disa kujtime trimërie që u tretën e u harruan me vjetet. Emri Vlonjat i mbeti edhe sot, duke i zëvendësuar emrin e parë: Argjiri i Stefanit.

– Lëre, bir-o, fshanë t'i thotë si të dojë, se fshati e ka gojën të madhe. = ma preu gjyshja fjalën e kuvendin; = e ti thujja omri që i ka dhënë zoti, se jeni aje zjarr.

– E qysh, moj gjyshe?

– Bir-o, t'i thuash Argjiri i teto Marinës sonë.

– E pse vallë i teto Marinës e jo i Stefanit?

– I teto Marinës, si të them unë, se ajo e rriti si e rriti.

Pas pakëz ime gjyshe filloi të kuvendojë me vetveten e të më qortojë mua e Argjirë bashkë.

– E rriti e mjera Marinë me brenga shumë si djalë pleqërie e nuk i pa beb' e syrit ditë të bardhë: as gëzim, as martesë, as fëmijë që t'i ngjallë emrin në botë, po hop e hop! me dyfek në dorë ku s'ta pret mendja. I ziu Argjir, i ziu Argjir! si e shthurri jetën e tij! E përse? Për një çupë e një zemëratë.

E lashë pakëz gjyshe gjer t'i shkojë ngashërimi i parë edhe pastaj e pyeta rishtas:

– Gjyshe, a nuk më thua tashti, se po të pres me dorë në zemër, ku ndodhet Argjiri i teto Marinës sonë?

Gjyshja këputi mallëngjimin e buzëqeshi, si njeriu që i bëhet volia.

– Në Amerikë, bir-o, në Amerikë të Zezë: gjashtë muaj ditë, gjashtë muaj natë, njerëz me bisht e me një sy në ballë, hanë breshka e nepërka... Shëndaum i 'rgjëndë e pastë kujdes! Shërmëria e sjelltë shëndoshë!

Sa të mbyllësh e të hapësh sytë, gjyshja ndërroi prapë fletën:

– Qen i urgjisur nuk dërgon as fjalë, as kartë. E mjera Marinë, vdiq me emrin e tij në gojë. A, të më vijë njëherë, pa ka për të parë. Do ta martoj pa pyetur!

E lashë time gjyshe ta qortojë vetë Argjirin e Marinës edhe dola rishtaz të shëtit.

Në fshat mora vesh se Argjir Vlonjati kish ikur, aty e disa vjet, për në Amerikë e që aty ish hedhur në një mërgim të ri, ja në Argjentinë ja në Australi, një nga këto të dyja... Këtij vendi gjyshja i thosh Amerikë e Zezë, ku njerëzit janë me një sy në ballë e hanë nepërka.

Po në qoftë se fshati nuk ish i tërë i një mendimi për vendin ku gjendej Vlonjati, ish i një fjale kur ish puna të thotë e të vulosë se Argjir Vlonjati nuk i binte botës fund e krye as për flori as për argjend. Kish mall e gjë në fshat e ara në mal e në fushë e sido të vinte puna, nuk i qanin fëmija për bukë.

– Mirë, keni për të kuvenduar ju, në kish mall e gjë në fshat, ç'kërkonte vallë matanë kaq male e dete me ujë?

– Këtu, beşa, nuk di as unë si t'ia u kthej.

Që kur e di unë Argjirin, ky na ka pasur një etje të pasosur për mërgime e për rreziqe. Prej njëzet e tetë vjet pareshtur po i bie botës anë e kënd e asgjëkund nuk e mban për të mbajtur, as dheri as deti.

A nuk u ngrit e iku në mërgim të parë kur ish djallë tetëmbëdhjetë vjeç? A nuk u javit, si e dinë gjithë bota, pas nja dy vjet në Durrës, si vullnetar i Princit? A nuk luftoi krah për krah me kolonjarët, krah për krah me trimat e Themistokli Gërmënjit? Pastaj, kur u hap

Lufta e Vlorës, a nuk luftoi në ballën e lalotëve, kundër atij taljan-jeziti? A nuk erdhi që andej, si pata thënë, me kaq plagë në trup e me emrin Vlonjat?

Arriti puna që të mos ndizet luftë e zjarr në viset tona, pa ftuar Argjir Vlonjatin. E kur pushoi dyfeku e kur u shojt zjarri e si më s'kish asgjëkund vrulle e rreziqe, ky Argjiri u ndie fort i zi e i mjeruar. Filloi asohere të rrahë mërgimet poshtë e lart e ja, sot qenka hedhur në Argjentinë a në Australi. Mos u çuditni fort që si nesër ta vështroni në fshat. Do rrijë këtu disa muaj a një mot të tërë, do shëtitë malet e fushat me hutë në krah e pastaj do xhavulojë rishtas ku ta di unë i mjeri ku.

Në një nga këto fanitje më pat rrëfyer mua brengën e madhe të shpirtit të vet, brengën që i pat bërë jetën fije-fije e që e shtynte mal më mal e det më det.

Rrini e dëgjoni, në doni ta dini edhe ju:

Përpara dy a tre vjetësh, vjeshta pat ardhur me lagështirë të madhe. Njëzet e ca ditë me radhë, gjer afron ditës së Shëmbitrit, një shi i ngadalshëm pat rrahur dhënë. Ditën e Shëmbitrit ka dalë një erë thëllimi e ka qëmëtuar pakëz. Kur kam hedhur sytë mbi liqer, (e kam nër sy e sot), kam vënë re se ky nxinte nga shpësëritë që i ishin afruar anës një të shtënë me hobe.

— Pa fjalë, kam thënë unë me mendtë e mia, blata do jetë shpësëri e gjallë.

Vajta me nxitim t'i shpie Argjirit këtë lajm.

— Mirë, ka thënë ky, në është kështu, t'u vemi që sonte, se më tej do ngjitem në mal.

Ka qenë si sot e kësaj dite, më të perënduar. Edhe si sot e kësaj dite digjej ndër flakë i tëri Mal' i Thatë. Argjiri ka marrë çiften, unë teken; kemi hedhur sikush gunën supit e kemi zbritur buzë liqerit. Ky sapo ish platur e flinte, i lodhur si një foshnjë në djep, kurse zgalemët krahëbardhë ngriheshin e zbrisnin mbi faqe. Hipëm

në lundër: unë hiqja më të djabatë, Argjiri mbante dy-
menë më të mëngjër e pinte duhan, cigare pas ciga-
re. E si ishim të ndenjur e të etosur për largim, hoqëm
si burrat e arrimë shpejt ne Ur' e Gurtë, ku Voloreka
vinte nxituar valë-valë.

– Shtrënga dredhjen e hiq sa më mund, – foli Argjiri.

Dy herë lumi na mundi e na ktheu prapë: rem' e tij
e sumbullisur na rrëmbeu e na shpu gjer përtej, ku
shqipkat e guzat na vështronin me qesëndi. E se na qesë-
ndisnin e nuk i bënëin udhë lundrës unë u dhashë zjarr
me teken. Ato u fundosën e dual pak më tej e na vësh-
truan më me qesëndi se më parë.

– E treta e vërteta, thirra unë edhe përvesha krahët.

– Bëju burrë, – foli Vlonjati. E kësilloj, ca me të
thirur e ca me të hequr me lopatë e ca duke u mbajtur
nga shelgjishtat që derdheshin mbi kryet tona, kaptuam
grykën e dolëm përtej, në blatë. Kjo na ish e qetë e fa-
qendryshkur. Hapëm shteg me shushëllime ndër kallami-
shtra e shavare, gjersa ramë në një vend të volit-
shëm për ushë.

E ja, pa u shtruar mirë, një tufë rosash po ngjit
Volorekën përpjetë, duke ardhur nga liqeri.

– Bam-bam! – çiftja e Argjirit.

– Bam! – tekja ime.

Ushëtiu asohere blat'e tërë gjer tej rrëzë Krastës. E
nga vallja e shpesërisë u këputën disa e ranë tatëpjetë.

– Blluf! – bëri uji që i përpiu.

U hodha në lundër e vajta t'i mbledh.

– Një!

– Dy!

– Kërko më, – thirri Vlonjati që nga usha.

– Tri!

– Mjaft, i kemi, – ktheu.

E gjeta Argjirë me një cigare në buzë e me tjetrën
ndër gishtërinj më të dredhur e sipër. Rosat ishin të plota,
me sytë të pulitur për gjumin e plumbit.

Përsëri:

– Bam-baml – çiftja.

– Baml – tekja.

Gjer të zbresë nata, ushëtiu, disa herë blat' e tërë, sikur të shkonte mbi të qerrja e Shëndëllisë. Gjah i mirë, Patëm shkëlur me këmbë të mirë.

Dalngadalë liqeri filloi të hiroset e malet u kaltëruan. Pastaj male e liqer bashkë humbën nëpër t'errët. Pa, sapo na pllakosi nata, blata kurdisi avazin e saj të vjetër: shushëllinin kallmishtat, fërfëllonin shpesëria e më e vogla gjë e gjallë, e humbur ndër shavare e barishta, u mbante zënë. Fërr-fërr, fiu-fiu, ciu-ciu e përtej një zë kaba: uak-uak, uak-uak! E ja, tashti, në mes të kësaj bote të platur, ç'u dëgjua papritur bërtitja e tmerruar e një bretkose, sa u drodh gjithë bota e blatës.

– E zu gjarpri të mjerën...

Pastaj bërtitja u shojt e blata iu shtrua rishtas këngës së vjetër.

E sidozot rrinim e dëgjonim të magjepsur avazin e blatës, ja-o! që përtej, nga vetulla e Malit të Thatë, ç'u javit hëna-portokalle, e ç'mbuloi një çip të liqerit me një linjë të kuqezë që u zbardh dalngadalë e u përhap mbi gjithë botën që përtej Peshtanit e Terpezicës e gjer këtej, mbi Mokër, mbi Rrëzhan e mbi Kamje.

– Natë si kjo s'ka qenë kurrë! – fola unë.

– Ka qenë, – tha Argjiri.

Dhe ndenjëm e vështruam pastaj si të magjepsur bukurinë vjeshtake të kësaj nate shqiptare.

– Dale, foli ky pakëz më vonë, ti s'ma di si m'u bë jeta fije-fije. Dua të ta rrëfej po nuk di që ku ta nis e ku ta mbaroj... Vështroi pakëz përtej ndër ato argjende të endur prej hënës mbi liqer edhe filloi të flasë:

– Në një natë si kjo jona kam dalë nga fshati për në mërgim të parë. Marsit që shkoi u mbushën njëzet e pesë vjet. Njëzet e pesë vjet e mua më duket sikur ka qenë dje a njëdizaj. Jam nisur asaj nate me të bir' e Nestorit, në t'errët. Hëna na ka zënë këtej shelgjeve e dielli matanë, në fushën e Prespës.

As mua, as Kuzin e Nestorit nuk na ka përcjellë njeri i gjallë, si përcillen ata të kurbetit: As nënë, as motër, as vëlla... Kemi ikur vetë-filli, me nga një torbë krahut e me nga një shkop në dorë. Vetëm Buzua i shkretë më ra pas erës e më ndoqi gjer përtej. Kur arrimë në Krastë, mbi gjol, unë e kam bërë të largohet, me gur në dorë e me lot në sy.

Argjiri ngriti cigarishten në gojë, fryu jashtë një tym të imët e kuvendoi:

– Ty sikur të shoh pak si të çuditur. Më duket se do të më pyesësh gjësënd. E marr me mend. A nuk do të dish përse ikëm natën si hajdutë mali? A nuk do të dish përse nuk na përcollën njerëzit e shtëpisë? Mos u nxito. Ta kam për të thënë unë me gojën time edhe pa pyetjen tënde. As hajdutë kemi qenë, as të liga kemi bërë e as borxhe kemi pasur. Të tjera brenga kemi pasur. Sikush të tijat. Njëra e zezë e tjetra më e zezë. Njëra shafran e tjetra më shafran.

Dëgjo këtu:

Ky bir' i Nestorit (s'di në ia ke ndjerë emrin) ka ikur asoherë nga frika e Kahreman beut. I kish vajtur puna vëngër me benë e beu kish rrahur gjoksin se nuk e lë të gjallë në botë. Ku ta dish ç'i ka bërë? – do thuash tinë. – Asgjë prej gjëje! As dorën ngritur, as gojën hapur. Që ta dish ti, ky Nestori qëndronte fort mirë n'atë kohë. Kish, si thonë bota, një shinik mexhite të bardha të fituara

brenda në Stamboll, me punë robi. E se i kish dora, i biri na kish sjellë një pelë nga Myzeqeja, na i kish rënë në vesh Kahreman beut e ky i bën fjalë t'ia japë peshqesh. I bir' i Nestorit s'do. – Kam pesë kuaj, thotë, të urdhërojë të zgjedhë cilin të dojë e ia kam për të falur me gjithë zemër, pelën jo! E kam për qejfin tim e për damaz.

– E hapa gojën, thotë Kahreman beu. Kërkova pelën, jo tjetër kalë. Tashti: ja pelën, ja kokën e të birt' të Nestorit. Hynë miqtë të ndreqin punën që pat marrë fill të lig, po kotmëkot. Më në fund u bë njashtu si bëhej aso-herë, kur i shkrepse Kahreman beut për gjësend. Dërgoi dy trima, plagosën të bir' e Nestorit edhe rrëmbyen pelën me gjithë shalë. Volja iu mbush beut, po zemërata s'i doli. Gjer të palcohet pakëz me darova e me kokë të unjur përdhe, si bënte gjithë robi, Kuzi i Nestorit mori Vllahinë. Që atje më s'u këthye prapë as kur i doli zemërata Kahreman beut. Ra e vdiq e iku fir.

Puna ime ka qenë ndryshe. Unë kam ikur se kisha rënë në luftë me gjithë të shtëpisë. Mos ke dëgjuar qysh erdhi e plasi dyfeku? Jo? Prit se ta them vetë. Që kur paskesha qenë foshnjë, shtëpia më paske zënë për të martuar. Me cilën-o? Me të bijën e Ndrio Belortasë. I thoshin Argjirë. E di ti vetë tashi cila është, se rron e sot. Der' e mirë kjo e Belortasë, s'ka fjalë e kuvend. E dëgjuar. Çupa në s'ish rënë qielli, nuk ish as për të qeshur. Kish lezetin e saj si një mollë majhoshe. As syri për të qeshur, as vetulla, as goja. E lëvdonte tërë fshati. E tërë ky fshat kish vendosur e priste të lozë dasmën e Argjirit e të Argjirës. Mua s'më pyeste njeri. Ziente fshati, po mua s'më thosh shtëpia gjë prej gjëje. Kur më foli nëna drejtpërdrejt kështu e kështu, u hodha përperjetë e thashë: Jo! M'u vunë të shtëpisë dit' e natë, – qante nëna, qanin motrat, shanin vëllezërit, tundte kryet babai – unë: jo! Më ranë në qafë farefisi e gjithë miqësia e vatrës, unë jo e jo!

– Përse paske punuar kështu, Argjir? – ke për të thënë ti.

Dale, Mitrush, dale; mos u nxito se fjalën ta kam e ty në torbë. Që ta dish ti, mua më kish hyrë asoherë një tjetër vashë në shpirt. E si hyri, zbriti thellë e më thellë brenda në gjak e nuk doli më. E kam edhe sot, ja këtu brenda në zemër, pas kaq gjëmë vjete e pas kaq lebete që më kanë parë sytë. E kam të gjallë e të bukur fort, posi qëmoti. E do ta kem gjer të më rritet lëndina mbi gjoks...

Ky Argjir Vlonjati pat folur me zjarr të zemrës. Pushoi pakëz sikur të çlodhet. Hëna e larë në argjend ish mbi kryet tona.

– Mos u çudit fort, se të flas kështuzë. Ta kam e ty fjalën në torbëzë, se dardhia e ka bishtin prapa. Ka për të ardhur dita kur ke për të ditur edhe ti ç'është dashuria. Asoherë i thoshim sevda, po gjithë ajo punë është.

Do të të hyjë e ty dikush në zemër brenda e do ndjesh të dhembur e të brejtur jetë pas jete, kudo që të vesh, kudo që të shkosh. Mos u nxito të thuash jo. Ajo s'të pyet, sindozot që s'më pyeti mua kur erdhi.

Vashës sime i thoshin Selvi e vogël. Dy Selvi kish fshati. Imja ish më e bukura! Nuk ish nga der' e parë si e bij' e Belortasë, nuk kish mall e gjënë e saj, nuk e hante bukën shkuar në tri sita. Po më kish një sy kjo Selvi e vogël e një nur në ballë, si s'kish tjetër vashë në fshatin tonë e në fshatrat rrotull. Nga bukuria nuk kish shoqe ndër shoqe. Ish përmbi të gjitha!

Herën e parë, si u rrit pakëz, e kam parë lart, në gështenjat. Ka qenë prill e korija kish lulëzuar. Gështenjat ishin ngarkuar me lule si kisha me llambadhet e Pashkës. Poshtë këmba na shkelte poleska e manushaqe.

Unë ndiqja një lepur të plagosur, Selvia e vogël mblihdite lule për llazore. Pakëz më rëposh, ne burimi, vashat e fshatit këndonin këngët e tyre. Kur shkela në shkorrëta, Selvia ktheu kryet, e trembur si një mëllenjë mali. E kur më njohu, u skuq e më foli:

– A, ti qenke, Argjir...

Mua se ç'më mbyti asohere si një dallgë era e poleskave – ja, për herën e parë vija re se ka poleska në botë e se era e tyre të deh! – e sikur gjithë trupi m'u mbush me marauzhga që ngjiteshin e zbrisnin pa pushuar. Djalë i ri-ore! E shëmbëlleja e s'e shëmbëlleja dot Selvinë e vogël. Gjer nj' atij moti e dija vogëloshe e ja, tashi, më dilte përpara e hedhur si vllastarja në vresht. E më ishte e bukur si rusp' e rënë qielli. Ja, edhe sot, kur rrah të mbyll sytë e mos e shoh, më fanitet përpara njashtu siç e pata parë atje lart; me leshrat si gruri, me sy të qëndisur e me bel të këputur. E them se nuk do ta harroj as kur të zbardhet pend' e korbit...

Kur pikasi se po e vështroj me sy të etosur, unji kryet tatëpjetë e foli:

– Unë do shkoj tashi, se më presin shoqet. Rri me shëndet, Argjir!...

Ngriti kanistrën që përdhe e bëri dy çape.

– Merr ca lule, Argjir, se ti s'ke ngé të mbledhësh. Ne kemi aty poshtë një tog të madh. Se për lule kemi ardhur.

E si më kuvëndoi kështu, më zgjati kanistrën me poleska e manushaqe e pastaj u nis e iku.

Mua se ç'më hidhej zemra si një shpes i zënë ndër leqe. Më vinte të ngrihem e t'i dal përpara e ta vështroj pareshtur në sy, në buzë e në gji. Po nuk zbrita, nuk i fola gjë. Ajo ish më e shkathët se unë, e më pat folur, unë jo.

Ja, edhe sot kur s'kam tetëmbëdhjetë vjet po dyzet e tre njëri mbi tjetrin, kur e sjell ndër mend e mia,

më mbyt era e poleskave të prillit e më hidhet zemra si një zog i zënë në leqe.

Ti a ke ndjerë gjer më sot si hidhet zemra përpjetë? Jo? Ndofta nuk do të më thuash. S'prish punë. Nëse ke ndjerë, ke për ta ndjerë. Se unë ta kam fjalën në torbëzë. E kur ke për të pikasur se të hyn në shpirt një vashë, do të të vijë të qarët e të kënduarët bashkë, si shi me diell.

Të them si kjo Selvi e vogël më doli asohere mbudhë e më iku prapë si ik nusk' e Lalës. Kur do dredhonte vragën, më vështroi e njëherë e ia krisi me nxitim të madh, rëposh, ku shoqet këndonin:

*Nd'e zu gjarpri u shëroftë,
Nd'e zu trimi u trashëgoftë.*

Ky ka qenë gëzimi im i parë.

Një verë të tërë, kur bota fliste për yllin me bajrak, unë isha i lumtur si s'kish njeri në botë. Sikur kisha krahë e fluturoja. E sado druhesha të mos e shoh, gjithë piqeshim sy në sy. Piqeshim ne burimi, kur vinte për ujë; piqeshim ne rem' e jazit; piqeshim ne ur' e lumit, midis shelgjesh e kulprash të gjalla. Desha ta lë udhën e saj për syt' e botës, po zemra më thosh: shko e një herë, shko e dy, shko e tri gjer t'i shikoj qoshen e shamisë e nurin e ballit...

Herën e dytë e kam parë Selvinë, së afërmi, në vjeshtë, kur vilen vreshtat. Zbriste nga udh' e madhe me rijë shportë rrush në dorë.

– Që nga më vjen, moj Selvi e vogël?

– Nga vreshti i ri, Argjir... Merr ca rush, Argjir, i kam zgjedhur me dorën time për t'i ruajtur. Do t'i varim në trarë me penj.

Zgjata dorën. Mora dy rrush. I fola:

– A i gjetët shumë këtëj moti, moj Selvi?

– Shumë, sa s'pandehëm, Argjir, u terr e s'po mbarojmë dot.

E bëra zemrën gur. U pamë sy në sy e i fola:

– Ti Selvi, a e di se të dua fort?

– Edhe unë, Argjir, të dua...

Kur më pat thënë rri me shëndet, kur pat zbritur shtegun me driza, kur-kur, nuk di as unë. Ta shikoje atëherë Argjirin si zbriti në fshat i gëzuar, sikur kish pendë për të fluturuar! Sikur kodrat i unjeshin më gjunjë! Sikur shkelja mbi lisa e lisat më dukeshin barishte!...

E nga gazi i madh më vinte të pushtoj në krahë gjithë botën...

E nuk di, për Shëndaum të 'rgjëndël si pat ikur vjeshta atij moti. Im më bëhej gati për dasmë. Në muajin Shëmbitër plasi dyfeku.

– Argjir, do të të martoj!

– Argjir, do të të martojmë!

– Argjir, dasmë!

Nusen ma kishin në kamare, si të thashë. E di cilën: mollën majhoshe të Ndrio Belortasë.

– Jo! – thashë unë. Nuk dua!

Kanë qeshur të gjithë, si pa gjë të keq.

– Naze dhëndërie...

– Naze, naze, naze...

– Martohem, i fola nënës veças, po jo me mollën majhoshe të Belortasë. Dua Selvinë e vogël!

Nëna u hodh përpjetë, sikur pat shkelur një gjarpër me këmbë.

Kështu, o Mitrush, u pat prishur menç Argjiri i Stefanit! Se thoshin se u prisha menç.

– Jo! – tha nëna.

– Jo! – motrat.

– Jo, jo! – farefisi.

Sa për tim atë, ai s'kish vulë në shtëpi. Nëna thurte, nëna shturte.

– E përse jo-jo?

Se ish 'der' e unjtër, nga dor' e dytë.

– Çupa e bukur, e bukur, thoshin të gjithë, po dera?
Im gjysh, zoti e ndjeftë ku ka rënë, më ka thënë me ngadalë në vesh, që të mos dëgjojnë të tjerët:

– Merre, Argjir, Selvinë e vogël, merre mos iu ndaj se kështu, me sevda, e kam marrë unë tët gjyshe.

E se nuk duroja dot grindjen, u ngjita në mal ku kishim arat e një bulk që i punonte.

Si zien sa zien, afër Kërshëndellave u hodhë në anën time e të Selvisë një nga motrat e dy nga emtat, po bylyku me tim më, mbeti përtej. Shtëpia e Belortasë lojti dhe ajo nga vendi. Kahreman beu, që vriste e priste asaj kohe si i desh zefku, hyri edhe ai në valle se e kish mik të vëllanë e Ndrio Belortasë e mori ryshfete sa plasi, si bej, që ish. Më dërgoi fjalë me një mik që të mbledh mendjen se ndryshe s'më bëhet mirë.

I bëra edhe unë fjalë:

– Unë s'jam i bir' i Nestorit, njëzet e pesë lira më bën manxeri...

E sepse ky manxeri i nëmosur e paska hijen e rëndë e sepse gjithë bota ia dinte kokën Argjirit kur ish puna për gjak, nuk më trazoi njeri as në fshat, as në mal, as në fushë. Dit' e natë isha mbudhë me dyfek në krah e me kokën lart. Ta dish prej meje, se kur njeriu e ka shpirtin në majë të dyfekut e kur lot gishti, e Kahreman beu, sado bej i rëndë që është, di t'i vërë fre vetes.

Thashë:

– E dua Selvinë e vogël e do ta marr, po të jetë për të dhënë! Në mos qoftë për të dhënë, do ta rrëmbej e do iki!

E se nuk kisha gjë prej gjëje, një mik që kish qenë në mërgim më tha të vete edhe unë pesë a gjashtë muaj sa të mbledh ca groshë e të vij prapë e të bëj shtëpi

më vete. Kur dëgjoji se ç'më shkante në fiqir, erdh e u bë e verdhë si limoi:

- Mos më lër, Argjir, vetël
- Kam frikë, Argjir, kam frikël

Unë e kandisa.

- Mirë, tha, bëj si të jetë më mirë.

E kam pushtuar asohere në krahë, e kam puthur në ballë, e kam puthur në sy, e kam puthur në buzë. Ajo u drodh e përdrodh si një kulpër në krahët e mia... Si një kulpër që shtrëngon lisin.

Kështu ka qenë.

Protomars u nisa për në kurbet. S'i thashë as njeriu se do iki. Kam dalë nga fshati me të bir' e Nestorit. Na zuri hëna këtej shelgjeve e dielli përtej maleve. Ik e ik gjer ku na pat thënë. Gjeta miq e zura punë. E rëndë ish puna, po e madhe shpresa. Në prill mora një kartë, gramë gërqishte, fjalë shqipe. Më thosh se e brengosnin, po ajo do më presë e njëqind vjet. Në maj një tjetër kartë, pakëz më e errët. Pastaj kartat u prenë. Pas ca muaj ka zbritur në skelë Komi i Bojanës. Burr' i thyer, një palë fëmijë mbi krye, një palë brenga. Më mori mënjane të më thotë gjësend.

- U bëre burrë, Argjir!

E mora vesh se desh të më rrëfente një gjëmë e s'dinte si të fillonte.

- Fol, usta Komi, fol ç'ke për të folur.

- Ja, po të flas, ti Argjir u bëre tamam burrë...

Më tha pastaj se Selvia vdiq ditën e Shërmërisë.

- Si vdiq?! - thirra unë edhe e zura për gryke.

- Vdiq si gjithë bota. I erdhi, e vdiq.

Dalngadalë, kur unë rrija me kryen të anuar e laja me lot dhenë e kurbetit, Komi nisi të shturë zemrën. Më rrëfeu si pati ngjarë, që në pe e në gjilpërë. Kah-reman beu bëri emër të martohet. E ka rrahur t'anë e Selvisë me dru gjer tha: mirë. Vetë beu i gjeti burrë,

një shop, nga fshatrat e Ohrisë. Pastaj, kur e pa me sytë e tij Selvinë sa e bukur ish, ndryshoi fletën.

– Kam një mollë bukur, tha, ta mbaj në gji a t'ia jap tjetrit?

E iu përgjigj vetvetes.

– Mbaje, për vete, o Kahreman bej!

E përzu dhëndrin edhe dërgoi trimat t'i rrëmbejnë Selvinë e t'ia sjellin në shtëpi. Kur i pa Selvia, lojti menç. Ata ishin tre, ajo një, e grua. E morën si kishin emër. Mbudhë u shpëtoi e mori gështenjat përpjetë të më kërkujë mua. Pastaj vreshtave, pastaj brigjeve, pastaj arave... Lojti menç e shkreta. Nga lebeti e beut, lojti.

– Fundi?

– Ra e vdiq ditën e Shërmërisë.

– Kaq?

– Kaq, – tha Komi.

– Kahreman beu-ë?

– Është i fortë, Argjir. Bën ç'të dojë. Ti bëhu burrë. Mos shkel më në n'atë vend. Ç'të kërkosh atje? Ne që jemi mezi rrojmë. Me dorë në zemër, si raja që jemi. Kështu na ka qenë e shkrojtur të rrojmë. Kemi fëmijë e s'ndahemi dot, se ku ka bej si ky yni, ik një sahat më parë. Zoti e gjykoftë për lotët, për djersën e për gjakun e robit.

– Mirë, thashë unë, nuk do të shkel më. Rri me shëndet.

Kështu foli e u nisa për në fshat. Mbudhë mora vesh se u ngatërrua bota e se krisi dyfeku me turkun. Udhët ishin të mbyllura, po kur do njeriu, i hap. U shkrojta dobrovoliat në Serb. Dobrovoliat kaluar në ballën e taboreve. Luftë paq lufte, këmba këmbës pas Xhavit Pashës gjer në fshat. Në fshat s'më njohu njeri. As që desha të më njohë. I vajta Kahreman beut në shtëpi. Shtëpia bosh. Kahreman beu, që pat punuar të një mijë e njëqindat, kish ikur të shpëtojë kokën. I rashë portës e hyra kaluar brenda. S'gjeta gjë. Jo, gjeta. Gjeta dhjetë

teneqe gazi. Gjeta bar në mullare. Bar i hollë. Bar fushe ky! Ndofta as gazin as barin nuk e kish paguar Kahreman beu me djersën e tij. I derdha poshtë lumë. U vura zjarr e mora kalin e ika. Kish qereste të thatë kjo shtëpia e Kahreman beut. Qereste të sjellë nga Mokra. Pa punuar me krahë, pa paguar me qese. U dogj e tëra si dëllinj' e thatë. Sikur ish e gëzuar se i ra zjarr! Mora të përpjetën në varret që t'i them Selvisë të ngrihet të vështrojë si digjet shtëpia e Kahreman beut. Varrin nuk ia gjeta e u thirra gjithë të vdekurve:

– Ngrihi, o të vdekur, të shikoni si digjet shtëpia e Kahreman beut! z

S'lashë vend pa kërkuar beun. Nuk e gjeta. Pastaj u ngatëruan leqet e luftës. U ngrita e ika. U hodha në Villahi. Desha të punoj si çdo njeri e s'punoja dot. E kisha mendjen ne Kahreman beu. S'më mbante dheu gjëkund. S'më zinte gjumi as natën, as ditën. Dëgjova asohere se u bë Shqipëri.

– Këtu të jam, i thashë unë Princit, kur u nis për në vilajet. U shkrojta vullnetar. Luftova në Durrës. Princi iku, ne u thyem. E si u thyem, mora një pelë Myzeqeje e u nisa për në fshat.

– T'ia shpie darovë Kahreman beut, se ndofta iu mplak pela e të birt të Nestorit.

Mal më mal e shteg më shteg e brenda në fshat. E kam gjetur Kahreman beun përtej, në luadhet. Dyfeku e kish varur në një degë kumbulle.

– Tungjatjeta, o Kahreman bej!

– Cili je ti, bre?

– Më harrove, o bej? Ne jemi miq të vjetër. Ja, të solla një pelë Myzeqeje.

– Fol, ç'je ti bre?

– Jam Argjiri i Stefanit që iku në kurbet. Ti më rrëmbeve çupën, çupa vdiq. Unë të dogja shtëpinë. Nxirr tashi divitin e bëj hesap. I mençëm je vetë. Në mos me

divit, bëje me dorë ndë zemër: këtu një çupë e vdekur e unë dy, aty një shtëpi e djegur. Kahreman bej, të them për emrin e zotit se kandari rëndon nga ana jote. Ja, ta bëjmë patepat.

– Ne kemi qenë miq, o çun' i Stefanit, miq të vjetër gjysh-stërgjyshi.

– Miq, bej, miq.

– Tashi, ç'të do zemra, o bir?

– Dua të të jap një selam.

Ja dhashë selamnë në lule të ballit. Hipa pelën e ika.

– Kaq të mirë më ka dhënë zoti mua: kur dua, nuk më shkon plumbi kot.

Dhe që asohere jam në gjak, me shpirtin në majë të dyfekut se beu të vret me dorën e tjetrit.

Argjiri pushoi.

Më nuk kish gjë për të thënë.

Hënën e kish zënë gjumi ndër ujërat e blatës. Drita e saj e bryllët hapte një kube të thellë rëposh, ndër resa e barishta.

– Fësh-fësh-fësh, – shushëllinte kallmëri.

Fërr-fërr-fërr, – krahët e shpesërisë.

Ciu-ciu-ciu, – zogëzat e platurës.

– Të ikim, tha Vlonjati se po shtrohet vesa.

Kur dolëm në liqer, Argjiri mori përsëri dymenë e këndonte ngadalë, me zë të mallëngjyer:

Errësirë m' është bota,
Kur zotrote nuk më je...

Errësirë... Errësirë...

Bukuresht, 1935

Më kot...

Xhezarit iu duk sikur u zgjua nga një gjumë-harresë: i rëndë, i thellë, i gjatë. S'dinte ku ishte. Shtatin e kish të mpirë, kapakët e syve të plumbtë, qepallat të mbërthyera. Errësirë. U mundua të hapte sytë – s'mundi. Bëri të ngrinte dorën – nuk e ngriti dot. U çudit: «Ç'është kjo punë?» Mendimet, sapo i shkrepnin në tru, treshin përsëri si ai avulli i hollë i pranverës në një faqe mali, kur e zvarrit era, e çepkat, e dagëndis, dhe, fundja, e tret. Mezi merrte frymë. Befas ndjeu sikur aty pranë rrihte një bare e rëndë nga ato të kovaçëve të Korçës: dang-dung, dang-dung. Bare ishte kjo apo pendë mulliri nga ata të Dishnicës, në muaj mars, kur rrema mbushet rrëc me ujë, që zbret rrëmbyer nga malet? Edhe ashtu, edhe kështu: bare kovaçi dhe pendë mulliri...

Ndënji kështu një copë herë të gjatë. Bota i rrotullohej jo si kuajt në lëmë, po si vetë lëmi përqark strumbullarit, me gjithë kuaj e duaj, me gjithë mullarë kashte e togje drithi. Dhe i rrihnin tëmthat.

Pastaj iu bë sikur një dorë e madhe, e padukur, çau errësirën, ia liroi sytë. Ndër qepallat i hyri një rreze e mugët drite.

Dielli i vjeshtës mezi shquhej midis reve të muzgë-

ta. Fusha lëngonte nën një dritë të përzier me mugëti-rë. Krokërinin tufë galash e gallofësh, që herë ngrihe-shin lart, herë binin poshtë si ca gurë të zinj.

Xhezarit iu duk sikur e pat zënë gjumi në luadh, në një kopicë bari të fragjepsur në diell. Po, po: i kish dalë fare nga mendja se gjendet në fshatin e tij, në fushën e Devollit. Një çast ndjeu edhe erën e barit të porsakositur, të përzier me luleshqerra, paparunë, kokoçelë e sa e sa lule të tjera, pastaj ua humbi gjurmën të gjithave, sepse e plakosi dhe e mbyti një erë tjetër, më e fortë, e athët, cimbonjëse: erë ciknovine, tymi e shkru-mbi. Domosdo, kënetat e Maliqit është aty pranë. Kushedi, ndofta u ka rënë zjarri kallamishtave, kulmakut e shavarit të blatës përçark kënetës, dhe era e fortë e Lenjës sjell gjer këtej tymin e shkru-mbin. Xhezari shquan midis resh majat dhëmbë-dhëmbë të Malit të Thatë. Sheh edhe damarët e bardhë të shkëmbinjve të thepisur, që zbresin gjer poshtë. «Posi, posi tha, më doli fare nga mendja. Qenkam ngritur menatë, paskam kositur një copë të luadhit, qenkam lodhur e unjur të çlodhem, e më paska prerë gjumi. Shiko,shiko: më paska lagur vesa! Ajo më ka rënduar kështu e s'ngrihem dot, s'lëviz dot. S'e kanë keq pleqtë që thonë se, po të zuri gjumi në bar të njomë, kur je i dirsur, vjen e të plakos një pllënë e rëndë, të ogradis, të mbërthen e të mban gjersa të këndojë këndesi i tretë a të vijë ndokush që të të çnamatisë.»

Po, po, ashtu është, si thotë Xhezari: e ka zënë gjumi në luadhin e Devollit. Ja ku zverdh shushaja me pluhur të butë, ku të fundoset këmba. Njëra anë e shushasë të shpie në Bilisht e më tej, brenda në Follo-rinë, në Kostur, kurse ana tjetër të shpie brenda në Korçë. Ja ku është gardhi me kurorë ferrash të njoma e dëllinjash të thata. Tym dhe era e shkru-mbit vijnë nga moçalet rreth Maliqit, se i sjell lenja. Kështu thotë edhe shushurima e butë e burimit, që del në krye të

luadhit. Sapo i zuri veshi këtë shushurimë, Xhezari ndjeu se i qe tharë qiellëza. Balli e gjithë trupi i digjeshin zjarr. Desh të shuante etjen. Bëri të lëvizte, po e preu një dhembje e madhe. Dalngadalë kjo dhembje e shpërndarë në gjithë trupin iu mblodh në dy pika: në brinjë e në këllk. Mbylli sytë. Tëmthat zunë t'i rrahin fort e më fort, si tokmak. Më tej dhembja i taraksi pak. Atëherë iu duk sikur u ngrit, sikur eci këmbëlehtë nëpër luadhin e kositur, iu afrua burimit, ra në gjunjë, zgjati kryet mbi ujë, u përkul dhe piu dëng e dëng, gjer sa u lodh. Sa i mirë ishte ky ujë! I kulluar, i lehtë, i ftohtë. Ndërkaq, duke pirë, Xhezari e pa fytyrën e tij të pasqyruar në faqen e burimit. Po sa e errët, sa e tretur ishte kjo fytyrë! E tija? Po, po, e tija. Ka të ngjarë të mos e njohë njeriu fytyrën e vet? Jo! Dhe vazhdonte të pinte. Uji i shkonte nëpër gurmaz si xhirit akulli, i hapej rrëmbë më rrëmbë në gjithë shtatin. Por çudi: në vend që ta ftohte, uji e ndizte edhe më shumë! U ngrit, u hodhi ca grushte syve, duke përhapur rrotull stërkala që binin në faqen e burimit, bënin flluska e r Rathë dhe këta r Rathë e shtynin njëri-tjetrin gjer në anë. Prapë nxehtë...

Këto ëndërrime ia preu një zë i zvarritur, si më të qarë:

– Ooof!... Ujë!... U-u-ujë!

«Kush thërret kështu? – tha Xhezari me mendje. – Pse s'ngrihet të pijë, siç u ngrita e piva unë? Ja ku është burimi!»

Atëherë në mendjen e tarkalisur i shkrepën një nga një fije kujtimesh nga ngjarjet e fundit.

Jo, Xhezari s'ish në luadh, në Devoll. Ishte në një vend tjetër, që s'ia dinte as emrin. Kur bëri të lëvizte e të shikojë se ç'ka rreth e qark, i theri tërë trupi. Megjithatë, i mposhti të gjitha dhembjet, mblodhi tërë fuqinë, u kthye në brinjë dhe i hodhi një shikim vendit.

Aty pranë kish plot të vrarë e të plagosur: kush shtrirë në kurriz, krahëhapur, kush përmbys, kush mbledhur kutullaç, ashtu siç e kish zënë vdekja. Ktsh edhe nga ata që i kish zënë kapule njëri mbi tjetrin, të kapur për fyti dhe i kish ngurosuar ashtu. Dhe gjak; kudo gjak.

I theri brinja e djathtë, iu përgjigj, këllku i mëngjër, thellë. U drodh, iu errën sytë e ra prapë, siç kish qënë, në kurriz. Tani shihte vetëm një copë të qiellit dhe disa krerë të maleve. Dheu unje e ngrihej, unje e ngrihej, si një lundër e madhe ndër valë. Malet herë binin poshtë, fundoseshin sa s'dukeshin fare, herë kërcenin lart, si ca pela të hazdisura, me krifat në erë. Kur e kur dëgjoheshin krisma dyfegjesh, plasje gjylesh, që binin s'di se ku, larg. Kaloj përsipër, pothuaj rrafsh dheut, një tufë galash e gallofësh, kaq afër, sa Xhezari ua ndjeu fërfëllimën e krahëve, që tundeshin si ca erashka të zeza dhe ua pa gjokset e thinjura e sqepat e gjakosur, pastaj ra prapë në një gjumë-humbëtire.

Kur u zgjua për së dyti, era i kish shtyrë retë tutje, dielli kish zbritur poshtë e ish bërë i kuq si një vatër me prush. Edhe galat e gallofët, që vinin vërdallë, lart ishin të kuq. Të gjitha rrotull ishin të kuqe: retë, qielli, majat e drurëve, kreshtat e maleve. Xhezari qeshi me vete: «Ç'janë këto gala të kuqe? E ku ka në botë gala të kuqe?» Frynte një erë e thëllimë nga ato që ndjellin dëborën. Kur e kur kjo erë sillte e hidhte ndonjë pikë shi, që i binte Xhezarit në ballë, në buzë. Mbylli sytë, se ia vriste drita e përgjaktë. Dhe, veç dritës, ia fshikëllonin pikat e shiut që sillte era. Po edhe kështu, symbyllur, Xhezari «shishte të ngatërruara: xixa drite lloj-lloj ngjyrash e stërngjyrash – të kuqe flakë, të kuqe verë e vishnjë, të kuqe mare, pastaj të gjelbra, të kaltra... – të kërlëshura me shtëllunga të mëdha hiri e qymyri. Të gjitha këto i rridhnin si një lumë herë i përshkënditur e herë i errët.

Pastaj, dalngadalë, kujtimet e ngjeshura njëri mbi tjetrin, si ca sende në një sepete, zunë të shpalosen e të kthjellohen ashtu siç kullohet uji i burimit kur bien lëvizhdat poshtë, në fund, dhe njeriu mund të shihet brenda si në një pasqyrë.

...Ka vjete që vendi është turbulluar e s'po gjen karar. Ca thonë se kjo punë ka filluar pas hyrietit, ca thonë se ka filluar përpara hyrietit. Pleqtë tundin kokën e thonë se kështu ka qenë ngahera, vendi nuk ka qenë shtruar kurrë, po se tani trazira është shtuar. Maleve, fshatrave, e brenda në Korçë kërcet dyfeku. Jo vetëm natën, po edhe ditën në drekë. Kanë dalë ca njerëz që i thonë vetes «shqiptarë» dhe kanë sjellë një fjalë të re: liri. Për këtë fjalë luftojnë, për këtë fjalë vrasin e vriten. S'u dhimbset asgjë: as jeta. Nuk e duan festen e kuqe, nuk e duan hënzën me yll. Hyjnë e dalin nëpër fshatra e brenda në Korçë, me dyfek nën gunë, ia shkrepin. Përse? Për atë fjalën e re. Dhe çudi: këtë fjalë të vogël nuk e mbyt dot asgjë – as «hyriet-adaleti» i memurëve, as shtrëngesat e hyqymetit, që bastis shtëpi e fut njerëz në hapsanë, as mallkimet e dhespotit e ato të myftiut, as paret. Këta njerëz s'duan të dinë për asgjë. As për kishë e xhami! Këndojnë me të tallur:

*Prifti ne mana, hoxha ne thana:
Jemi vëllezër, s'na ndajnë dot!*

Edhe bum-bum, u bien atyre që hiqen osmanllinj ose grekomanë. I thanë dhespotit: «Foti, mos të zëntë motil!» Dhe nuk e zuri. Shkoi teferiç në botën tjetër. I thanë myftiut të Korçës: «Myfti, të hëngërt mortil!» Dhe e hëngri. Mu në mes të Korçës plakë, një djalë i ri shtriu përdhe, të vrarë me plumb, Rexhep Pallën, të flamosurin Rexhep Pallë, që i kish kallur datën një kazaje të tërë me shumë nahije. Xhezarit i kujtohet edhe emri i këtij

djali: Vasil. Thonë se është qepallëbardhë, me ca sy të hirtë, i hollë, pa mustaqe, as i gjatë as i shkurtër. S'ka gjë se është i hollë, i ri e pa mustaqe; dyfekun nuk e zbraz këрма, po zemra. Rexhep Palla ia kish shtruar me të pirë e kish rreth e qark plot zaptije e devrije që e ruanin, plot miq e shokë që dëfrenin, po atij djalit të ri s'iu tremb syri. Nxori patllaken e ia shkrepiti ballë për ballë. Rexhep Palla u rrëkëllye që në plumbin e parë, u zhgërrye përdhe duke derdhur gjak nga goja, pëlliti si gomar, gjersa kafshoi gjuhën e ngordhi. Miatë e shokët ngrinë në vend, me kupat në dorë. Zaptijtë e devrijet u turrën ta zinin atë djalin e ri, po u prapsën menjëherë, sepse ua preu udhën dyfeku i Themistokliut me shokë: Dora e Zezë! U prapsën e ikën si lopët.

Ç'njerëz janë këta që hahen me një mbretëri? Si u luftuaka me një goxha mbretëri? Ja, u luftuaka. E kush lufton? Ca djem të rinj.

Pak kohë më parë, kur sapo kish hyrë drapri në grynjat e fushës e kosa në luadhet e malit, krisi dyfeku në Orman-Çiflig, dy çape larg Korçës. Asqeri e zaptijtë e dovetit luftonin me çetën e Spiro Bellkamenit e të Qamil Panaritit, që e kishin rrethuar nga të katër anët. U luftua gjashtë ditë e gjashtë net. Buçiti tërë fusha. U vranë shumë asqerë e zaptije. Më në fund, çeta çau udhë e doli nga çarku, po la gjashtë të vranë. Xhezarit i kujtohen edhe emrat e disave; njërit i thoshin Bajazit Rehova, tjetrit Nuçi Lapi. Të tjerët nuk i sjell dot në mend. Aha, iu kujtua edhe një: Kristaq Krastafilaku.

Vendi është mbushur me çeta: në Kolonjë, në Gorë, në Frashër. Të gjithë me një fjalë në gojë: «Ja vdekje, ja liri!» Fshatrat s'duan të japin të dhjetat, s'duan të paguajnë xhelep e vergji.

Aty më parë u hap fjala se kish plasur luftë në Tarabolluz, me italianin, se mbretëria mbledhte njerëz për

sefer: redifë, bedelë gjonglinj. Dhe ja, një ditë çatisi në fshat një çausht me ca zaptije prapa, thirri myftarin e gjithë pleqësinë. Ra daullja. U kënduan emrat e redifëve që duhej të shkonin në luftë. I doli emri edhe Xhezari. Edhe shumë të tjerëve. Disa djem s'deshin të shkonin, dhe nuk shkuan. Ca morën malet, ca ndenjën në shtëpi. Edhe Xhezari mund të bënte siç bënë të shumtët, po nuk bëri. Të vëllezërit i thanë: «Mbreti ka dasmë të madhe e fton nga një për derë. Ti je i ri, beqar. Duhet të shkosh... Po të mos nisesht, kushedi ç'do na bëjnë zaptijet kur të vijnë së dyti. Dera jonë s'është sido-kudo, po derë e parë. Mos na bëj për faqe të zezë.» Pra, meqë dera e tij ishte derë e parë, Xhezari u nis redif, vetë i tretë. Nuk i përcolli njeri. Fshati mbeti prapa, i heshtur. Xhezari ktheu kokën, shikoi shtëpinë që kish mbetur prapa midis pemësh. Asnjeri në dritare, asnjeri në oborr. Ai e dinte se atje brenda ishte nëna. Ndofta tani ajo fshinte lotët me qoshen e shamisë, fshehur, që të mos e shohë njeri. Nëna s'kish dashur që i biri të shkonte në sefer...

Arriti në këmbë në Debojën e Korçës, në gazemat. Priti atje gjersa të mblidheshin të gjithë ata që duhej të shkōnin. Mërzitej. I vinte të kthehej prapë në fshat ose t'ia merrte malit përpjetë, ku kishin shkuar shokët që kishin thënë: «Pse të shkojmë të vritemi në Tarabolluz? Për kë të vritemi? Vendi ynë do të bëhet së shpejti më vete. Po të jetë për të vvarë, më mirë le të vritemi këtu, në vendin tonë. Do t'i vëmë dyfekun mbretit e mbretërisë.» Aty, në gazemat, Xhezari dëgjonte se shumë fshatra u kishin vënë drunë çaushtëve e zaptijeve, u kishin marrë armët e fishekët dhe atëherë kish thënë me vete: «Ç'po bëhet kështu?» S'desh të shkonte në Tarabolluz, po nuk vendoste dot. U kish zili njerëzve që vozitnin udhës, sikush në punë të tij. Kjo zili i shtohet edhe më shumë, kur dilte nëpër pazarin e Korçës. Gjithë bota

punonte. Kërcisnin çekanët e kovaçëve, të këpucëtarëve, të teneqexhinjve. Herë-herë thërriste tellalli që të mblidheshin njerëzit e të shkonin në luftë, po nuk ia varte askush. Korça edhe e tërhiqte Xhezarin, po edhe e trembte. Bënte shumë zhurmë. Njerëzit dukeshin të akrosur e s'ia peshonin askujt.

Në kazermat, ata të mëdhenjtë – mylazimi, yzbashi, bimbashi – dukeshin të brengosur, të trembur. Natën binin dyfeqe – në anë, në mal, e brenda në Korçë, afër gazermave. Devrijet fshiheshin qosheve e kaushëve. Ia kishin frikën Dorës së Zezë.

Në krye u hap fjala se redifët do t'i nisnin për në Manastir. Pastaj e kthyen, i nisën për në Selanik. Kur mori udhën e Bilishtit, Xhezarit i rrahu zemra. Fshati i tij zbardhte përtej, midis drurëve. Ktheu kokën të mos e shohë dhe hoqi përpara. Arriti në Follorinë. Aty nuk e ndjeu veten si në vend të huaj. Follorina i ngjante Korçës. Në pazar, në udhët – në të hyrë e në të dalë, këtej e andej lumit – valonte shqipja. Vetëm shqipja. Kudo: këtej e andej lumit, në mëhallët e kodrës dhe në mëhallët e fushës. Këndohej shqip. Aty u bashkua me redifë të tjerë, shqiptarë. Të gjithë i hodhë në Selanik, në ato kazermat e kuqe afër Beaz-Kules. Aty, në *sheshin e madh të Hamidies* përpara gazermave – që nga *përroi i mehtepit frëng* e gjer afër atij shatërvanit të *madh, Hamide Çeshmesit*, Xhezari bën talim në Hyriet Mejdani. Buçet zëri i onbashit: «Hazër-oll!», «Rahat-oll» dhe pastaj: «Saabak!» – «Sollabak!» Dhe përsëri: «Hazër-oll! Ilderem, marsh!»

Xhezari u mërzit me këto fjalë turçe, që e ndiqnin edhe në gjumë, si një ëndërr e keqe, po e mbante veten, sepse ishte me shokë. Sa shumë shqiptarë kish aty! Nga të gjitha anët. Edhe nga brenda, nga Selaniku, ku rronin me gjithë fëmijë.

Lufta e Tarabolluzit mbaroi: humbi Turku, fitoi Ita-

liani, siç e kish prerë Evropa. Atje në Tarabolluzë u vranë edhe shumë shqiptarë. Xhezarin e Devollit nuk e lëshuan të kthehej në fshat. U duhej. E bënë suvari, se ishte i gjatë, i shkathët dhe ia kish ënda të ngiste kalin. Ja tani kapërcen me të katra gropa, gjerdhe, hendeqe, lëshon kalin nëpër fushë. Era i fërshëllen veshëve, e deh. Të premtën, kur valiu shkon të falë xhumanë në Aja Sofja-Xhami, me një tufë suvarinjsh përçark llandonit, buçet kënga «Kallkën en vatan arslan». Fjalët i mban mend, ndonëse s'di se ç'thotë. Turqit këndojnë: «Ordumëz eti jemin./ Titratı haq i-zimin», kurse daullja e madhe buçet dum-dum, pa pushuar, sikur mundohet të flasë: «ordumëz... ordumëz...» Shqiptarët rrinë hijerëndë, të vrenjtur. Ata s'dinë e s'duan të këndojnë kësi këngësh. Përbuzin ata që bashkohen e këndojnë me turqit; u thonë: «Ordumëz, domuzmës». Dhe çudi, aty të gjithë shqiptarët janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin, sikur të paskeshin qenë të njohur që në vogëli. Rrinë veç, dua të them veç nga të tjerët e bashkë shok me shok, bisedojnë bashkë, shëtitin bashkë. Dhe kudo që shkojnë – rrotull Beaz-Kules, në Jalli-Xhadesi, në Kapalli Çarshi, në Sabri Pasha Xhadesi apo në Hamidie Sokak, në Beshçinar, Iart, në Jedi-Kule apo tutje në lagjen e dëfrimeve, ku bien gazet, në Karagaç, takojnë kudo shqiptarë. Xhezarit i pëlqen më fort andej nga Jeni Xhamia, që është xhamia e shqiptarëve. ty pothuaj tërë lagjja flet shqip. Atij i bëhet zemra mal kur dëgjon fëmijët që thërresin e shajnë shqip. Edhe gratë shqip flasin. Njerëz që s'njihen e s'janë parë kurrë e ndjejnë veten të afërm posa takohen, i marrin krahun njëri-tjetrit. Ç'është kjo? Kush i afron? Kështu e kish pyetur veten shumë herë dhe më në fund e kish zgjidhur punën: gjuha, fisi? Ne jemi të gjithë një! Jo vetëm Xhezar me Xhezar, Hysen me Hysen, po me cilindo që ka thithur shqipen bashkë me qumështin e nënës: Xhezar me Kristo, Hysen me Kostë. Tamam si Bajazit Rehova me Odhi-

se Pjaston, me Kristaq Kosturin apo Kostaq Furrxhinë, që ranë bashkë në Orman-Çiflig, apo si Spiro Bellkameni me Qamil Panaritin, që hapën udhë me dyfek në dorë dhe dolën nga rrethimi.

Nëpër biseda, Xhezari dëgjon fjalë të çuditshme, të ëmbla: «Do të vijë një ditë, thotë dikush, dhe kjo ditë është e afërme, kur të gjithë shqiptarët do të bëhen më vete, siç kanë qenë. Këtij vendi do t'i thonë Shqipëri. Shkollat do të jenë shqipe. Ushtria do të jetë shqiptare». Xhezarit i pëlqen, po kur do të bëhen vallë këto që thuhën? Rreth tij, në gazermë, thonë se gjithë «ordumëzi» është osmanlli dhe do ta mbajë vendin për jetë e mot.

Ka dëgjuar se brenda në Selanik del një gazetë shqipe, po kujt i shkon në mendje t'ua shpjerë redifëve në gazermë? Edhe sikur t'ua shpjerë, kush do ta këndojë? Xhezari s'di shkrim e këndim, s'ka parë shkollë me sy. Dhe sa keq i vjen... Do të kish qejf të dinte se ç'bëhej në botë e më fort në Shqipëri.

Ë Pastaj Selaniku mbetet larg, në mjegull, me gjithë gazermat e kuqe, me gjithë Mamidien e Beaz-Kulen, që ka Limbozin përballë, përtej limanit, ku tymosin pamporët e zbardhin pëlhurat e anijeve. Ka plasur luftë me të katër kralët.

...Topi reshti. Fusha u fundos në heshtje, po kjo është një heshtje e ankthshme, që paralajmëron një sulm të ri. Dëgohen rënkimet e të plagosurve në lloj-lloj gjuhë. Armiku ka hapur tutjeistikame dhe është futur brenda. Edhe këtej kanë hapuristikame. Xhezari me shokë gjendet në një korije, me kalin për freri. Pret urdhër. Kris një mitraloz, andej. I përgjigjet një tjetër, këtej, po vetëm me tri-katër të shtëna. S'kanë fishekë, as bukë. Armiku i shtyn gjithmonë, luftë pas lufte. Janë prerë udhët, nuk vijnë ndihma. Përtej nxin një trumbë kalorësh. Dëgohen të thirrura: «...oos, oos». Dhe trumba përhapet, hidhet në sulm. E nxit pa pushim një zë i ngjirur:

«Embros! Embros!» Mitralozi leh një çast, pastaj hesht. Krisma të rënda manxerësh turku, si alurima qensh stani. Herë-herë edhe krisma dograje. Përgjigjen krisma fërshëllenjëse maliherësh greku, si të lehura langonjsh gjahu. Të dy armët – manxerët dhe maliherët – janë të forta, me nga pesë fishekë në krehër, dhe vrasin, sepse për të vrarë i ka bërë gjermani, për të dy palët.

Kur trumba afrohet më shumë dhe njerëzit e istikameve nisin të tërhiqen, dëgjoet zëri i çjerrë i mylazimit: «Hazëroll! Syngjitak! Ilderëm, marsh! Yxhym!» Dhe turqit ngrihen me bajoneta të mbërthyera në grykë të manxerëve. Andej – bajrak bojë qielli, me vija të bardha, me kryq; këtej – bajrak i kuq, me hënë të bardhë. Edhe një bajrak jeshil. Trumbeta, daulle, të thirrura, nga të dy anët. Dhe krisma, batate, bubullima bombash, flakë që ndizen e shuhën.

Xhezari, si ngahera, gjendet në radhët e para. Armiku rrallohet, bie poshtë, se e kosit manxeri. Por të tjerët i marrin vendin. Dhe afrohet, afrohet. Xhezari ia ngul mamuzet kalit, kapërcen ledhe e gropa. Shokët e ndjekin. Të gjithë shpatëzhveshur, me dyfeqet e shkurtra krahaqafë dhe gjashtaret e varura në rrip. Kuajt hingëllijnë të dehur nga vrapit e nga era e barutit. Andej «embros» këtej «ilderëm», dhe të dyja valët përpiqen ballë për ballë. Kuajt ngrihen me këmbët e para. Disa shemben me gjithë kalorës, të tjerë mbeten pa zot dhe ikin të lehtësuat me lelet në erë, duke tundur vithet.

Xhezari ish i gjatë. Kaluar dukej edhe më i gjatë.

U ngrit më këmbë në yzengji, thirri, goditi më të djathtë e më të mëngjër. Dhe sa herë që i sëllonte, bënte «ëh! – sikur të çante dru me naxhake. Shembi njerëz e kuajt. Valë djerse i njomnin tërë trupin. U fut me shokët në mes të armiqve, duke i thirrur njëri-tjetrit: «Bjeri!» «Ruaj!» «Armiqtë i njohën e i thirrën: «I arvanites! I Arvanites! Mas efegan i arvanites!» – dhe u prapsën, zbritën

nëpër gropa dhe hendeqe, qëlluan me maliherë gjermani dhe bomba ingjilizi. Fjala «arvanites» kish çarë udhë vetiu. Grekët zbytheshin, ndonëse ishin të shumtë. Po ja, që përtej, u vërsul një trumbë tjetër kalorësish, gjithë shpatë-zhveshur. Një shok i Xhezarit, djalë i ri nga Kosturi, u gjend i qarkuar. Godiste, mbahej, po nuk e kish të gjatë. Xhezari u turr andej duke hedhur pragje kufomash njerëzish e kuajsh, trupa të plagosurish. Arriti, goditi, shembi. Ish nxehur furrë. E nxori shokun nga rrethimi. Atëherë ndjeu një të thumbuar në këllk, sikur ta paskej pickuar një grerë. Ndërkaq, një armik iu turr nga e mëngjëra. Xhezari ktheu kalin tërthor dhe lojti shpatën, duke shtrënguar dhëmbët: «ëh!» dhe goditi rëndë. Armiku ra duke thirrur: «Bjeri, Pilo. Më vrau turku!» Xhezari u çudit: «Ç'është ky grek që flet shqip? Po ky Pilo? Po ky turk ç'është? A mos tha për mua? Unë s'jam turk!» Në këtë kohë, një djalosh i gjatë, pothuaj sa Xhezari, kaluar mbi një kalë çil, që lëshuar duke tundur shpatën që vezullonte. Klithi: «Erdha, Guri!» Xhezari e mori me mendje se ky ishte Pilua dhe i thirri: «Qëndro Pilo! Kthehu!» dhe e ngau kalin vëngër. Pilua u hutua një çast – a mos e hutoi, vallë, fjala shqipe? – dhe e humbi drejtimin. Në këtë mes Xhezari, që nuk desh ta vriste, ia goditi lehtë shpatën me të vetën, ia shkëputi nga dora dhe ia hodhi tej. Kali i Pilos mori vrundull përpara, po i zoti e mbajti, e ktheu përballë Xhezarit, nxori revolen nga këllëfi dhe e shkrehu: «Na, turk! Prite!» Xhezari ndjeu një gjë të ngrohtë në brinjën e djathtë dhe u drodh; freri i shpëtoi nga e mëngjëra, shpata iu shkëput nga e djathta, dhe pastaj ai vetë rrëshqiti ngadalë poshtë. Kali kërr ktheu kokën, e shikoi i çuditur, si njeri, ndenji ca çaste ashtu, i mahnitur, pastaj iku duke kërcyer prag më prag. Pilua u mat t'i afrohej Xhezarit të shtrirë e t'ia zbraste tërë revolen, po ai djaloshi i Kosturit ia preu udhën, e goditi dhe e hodhi poshtë, të vrarë...

Pastaj Xhezari dëgjoi si nëpër ëndërr të thirrura turçe e grekçe, po më shumë shqipe, nga të dy anët e valëve që përpiqeshin të tërbuara, shtyheshin njëra me tjetrën: «Bjeri!» «Na!» «Ah, qen!» «Qen!» «O, nëno!» Dhe goditje të rënda shpatash që prisnin krye, krahë, hynin thellë në mish, në kockë. Gulçime, çape, vrape... Rrënkime, krisma koburesh fare afër, të zbrazura drejt në mish, të shtëna maliheri dhe manxeri këmbësorie dhe pushkësh të shkurtra kalorësie, plasje bombash. Të gjitha këto të përleshura njëra me tjetrën si një lëmsh tërë kokla. Aty, drejt këtij lëmshi mishi, vraponin nga të gjithë anët ushtarët e të dy palëve, hidheshin, griheshin vriteshin... Xhezari ndjeu disa të sëmbuara të reja në trup – plumba të ftohtë, cifla bombash dhe pastaj u fundos në një pus të errët, të thellë, dhe nuk dëgjoi më asgjë.

Këshu pat qenë.

Sa kohë kish ndenjor Xhezari, aty, në atë pus të errët, të thellë? As vetë s'dinte.

– Ujël U-u-ujë..., – dëgjoi pranë tij atë zërin e parë. Dhe pas pak:

– Of, nëno! Nëna imel! Ku je? Pse s'vjen? Pse s'më sjell pak ujë? – Dhe pastaj përçartje, fjalë të nisura e të pasosura.

«More, ky flet shqip! – tha Xhezari. – Kërkon ujë. Këtë zë e njoh, e kam dëgjuar. Po ku? Duhet të jetë ndonjë nga tanët. Thirri: «Nëno, nëno! Siç duket, e ka keq. Burri e thërret nënën vetëm atëherë kur s'e ka veten në dorë.»

Dhe njeriu iu duk i dhembur, i afërm...

Nënë kish edhe vetë Xhezari. Dhe i thosh pikërisht kështu: «Nënë». Kish edhe motra, vëllezër. Motrat e vëllezërit ishin martuar, kishin fëmijë... Shtëpia e tyre ziente si zgjua blete. Megjithatë, Xhezarit i dukej e zbrazët kur s'ish nëna aty. Po, ai kish qenë shumë i shtënë pas nënës, siç u ndodh shpesh të vegjëlvë, «djemve

të pleqërisë». Kur kthehej nga puna, gëzohej sapo e shihte nënën në oborr. Nuk i thosh gjë, por vetëm gëzohej. Dhe këtë gëzim e mbante të fshehtë. Ajo e pyeste: «Erdhe, bir?» – «Erdha, nëno», «Mbarove». «Mbarova». «Mirë, të lumçin krahët. Do të të sjell të hash?» «Jo, pastaj.» «Bir, po na mbarohet mielli. Nesër ngarko kuajt e ngjitu në Dishnicë, të bluash.» «Mirë, nëno.» Kaq ishte bisedimi i tyre. Por kur s'e shihte, Xhezari e ndiente veten pa krah. Pyeste: «Ku është nëna?» «Brenda. Do ta thërres?» «Jo. Pyeta, ashtu.» Kthehej, shkarkonte kuajt ose çmbrehte qetë, i grazhdonte, fërshëllente. E ndiente zemrën të ngrohtë. Kur s'kish kë të pyeste, i afrohej pragut e thosh me zë as të lartë, as të ulët: «Nëno! Këtu je?» Dhe zëri i nënës: «Erdhe, bir? Ja po dal të të ndihmoj të shkarkosh.» Po Xhezari nuk priste. I mjaftonte kaq, t'ia dëgjonte zërin e pastaj shkonte në punë të tij. Nganjëherë e qesëndisnin: «Dale, dale, do të mar-tohesh e nuk do të pyesësh më për nënën, po për atë syzezën.» Po Xhezari nuk besonte. E donte nënën me gjithë zjarrin e dikurshëm të vogëlisë.

Dhe ja tani, ky tjetri thërriste: «Ujë! Nëna ime!» Shqip! Ku ta dish, ndofta edhe ai vetë, Xhezari, e kish thirrur nënën në çaste kur ish fundosur në atë pusin e errët. Dhe i bëhej sikur i dilte përpara ajo vetë, nëna: e gjatë, e thinjur, e dhemshur.

Zgjati dorën në matarë (Xhezari nuk e mbante matarën si shumë të tjerë, në shalë të kalit, po në kollan, mbi këllkun e mëngjër, që ta kishte për më voli kur i duhej). Matarja ish plot. Edhe atij Xhezarit, i digjej gurmazi, po e mbajti veten, nuk piu. U hoq zvarrë, rrotulloi një kalë të vrrarë, të shembur mbi një grek, dhe e gjeti njerinë. Ky ish një burrë kalesh, mustaqezi, pa kapë. Pikërisht ai që kish thirrur: «Pilo! Më vrau turku!»

– Ujë... U-u-ujë... O-of!

Xhezari zgjidhi matarën, ia hoqi tapën. Burri dëgjoi

zhurmë, hapi sytë dhe po e shikonte i ngrysur, me të drojtur.

– Të solla ujë, – i tha Xhezari. – Na, pi. Hap gojën.

Ai tjetri zgurdulloi sytë. Ç'po bëhet kështu? Një turk me hënë në ballë, po i jep të pijë. Dhe i flet shqip!

– Pi, – i tha Xhezari së dyti. – Jam shqiptar.

Ku e kish gjetur, vallë, tërë këtë fuqi Xhezari të hiqej zvarrë, me dy plagë të mëdha e shumë të tjera të vogla, të zgjidhte mataren, të fliste? Kush ia dha?

Kaleshi hapi gojën. Buzët i kish të thara, të zbardhlyta. Xhezari i afroi mataren, që i dridhej në dorë. Ai tjetri hoqi një gllënjë, dy, tri, më shumë. Pinte dhe e shikonte drejt në sy, me habitje, me mirënjohje. Edhe si me të pyetur: «Ku e kam parë këtë njeri?» Pastaj mbylli gojën, shenjë se nuk dësh më. Xhezari ngriti mataren dhe piu ato pak pika që kishin tepruar. Dësh të kthehej në vendin e parë (Përse? As vetë s'dinte), Po s'mundi. Mbeti aty ku ish, pranë ushtarit të huaj, shtrirë. Matarja e zbrazur i ra nga dora. Fajinji nisi të lëvizë (siç duket, e kish gjallëruar pak uji) dhe pyeti me zë të zgjatur, të butë, si këngë:

– Shqiptaar?

– Shqiptar.

– Nga je ti, vëlla?

Vëlla! Sa ëmbël tingëlloi kjo fjalë! Ajo e dëhu Xhezarin, e dërrmoi më shumë sesa plagët që kish marrë. Dhe me të shpejtët e vetëtimës, iu kujtua lufta e Orman-Çifligut, ata të gjashtë që kishin luftuar dhe kishin rënë krah për krah. Përse? Për Shqipëri, për liri. Kundër kujt? Kundër Turkut, kundër zgjedhës. Mirëpo hataja e madhe ishte se ata të gjashtë nuk i kish vrarë dora e turkut, po ajo e shqiptarit, të gënjyer, të verbuar. Dhe ja tani, kjo hata ish përsëritur edhe këtu, afër Janinës; shqiptarët ishin vvarë vëlla me vëlla, ca

për Turkun, ca për Grekun... Ai vetë, Xhezari i Devollit, kalor turku, e kish shembur nga kali këtë burrë, kalor greku. Dhe shoku i këtij, Piluq e kish shembur Xhezarin. Më tej Pilon e kish vrrarë ai djaloshi i Kosturit, shoku i Xhezarit. Dhe më tutje një lëmsh i tërë burrash, të gjithë shqiptarë, që thërrisnin dhe godisnin njëri tjetrin: «Bjeri!» «Na, qen grek!» «Na, qen turk!»

Kështu kish ndodhur edhe në Trakë, në Maqedoni.

– Nga je ti? – pyeti burri.

– Nga Devolli – ia ktheu Xhezari.

Ai tjetri u ngrit në bërryl, u mundua ta shëmbëllente, u drodh, ra.

– Nga Devolli? Qenkemi të aa...fërt, vë...lle...zër...

Unë... unë jam... nga Sinica.

– Nga Sinica? Oh, si s'të njoha nga të folurit! Ju, sinicarët, e keni gjuhën si të butë, të zgjatur.

– Po, nga Sinica. Ne, andej, jemi të varfër, s'kemi ara. Rrojmë më shumë me kurbet. Kështu babai, kështu unë. Në Thesali. Babai kish punuar atje shumë vite. Vinte-kthehej; vinte-kthehej... Më mori edhe mua. Ndenja ca kohë, punova, u ktheva në fshat, u martova. S'desha të vete më në Thesali, po... babai mbeti në fshat. Plak njeri. Kam tre... tre...

Nuk e mbaroi fjalën. E filloi përsëri, po ndryshe:

– Atje ka shumë shqiptarë, Merr vesh?

– Ku?

– Në Thesali. Po, shumë. Grekët na thanë: «Ju jeni të krishterë, si ne. Ejani në luftë që ta shpiem turkun ne Moll' e Kuqe, ku ka qenë. Ta marrim Korçën, e ta...» – Korçën?

– Korçën? Ç'do ta bëjmë Korçën?

– Po, Korçën, Ta bëjmë Helladhë, thanë...

– Ç'është kjo Helladhë?

– S'ditke? Greqi, Junan. Ishim shumë shqiptarë bashkë. Nga Thesalia, nga Maqedonia, nga Epiri – Kostu-

ri, Follorina, Vodena. Edhe nga Athina, nga Moreja. Ne na kanë vënë gjithnjë në krye të luftës. Zumë Selanikun, zumë Verien, Negoshtin. Ehu, sa e sal Na lëvdonin. Ama u bluam, u pakësuam ditë për ditë. Ja, si këtu, Po, po, shqiptarë...

Xhezari kish dashur ta pyeste për punën e Korçës e të Devollit, se ç'do të bënin aty grekët, por e humbi fillin.

– Paska edhe andej?

– Çfarë?

– Shqiptarë.

– Ehel Shumë. Flisnin gjuhën tonë. Ty si të thonë? Qenke djalë i ri. Më vjen keq...

– Xhezar. Po ty?

– Guri.

– E gëzofsh, – tha Xhezari sipas zakonit të vendit, megjithë që tani, me kaq plagë, kjo fjalë dukej pa vend.

Guri ia ktheu po aq thjesht:

– Edhe ti e gëzofsh!... I martuar je, Xhezar? Jo? Sa keq!... Unë kam tre fëmijë...

Heshije. Krisma të largëta. Krokërima galash.

Pas pak, Xhezari pyeti:

– Ç'e kishe Pilon, o Gur?

– Pilon? Ku e njeh ti Pilon?

– E njoh... Një djalë i gjatë.

– Po, i gjatë... Sa ti... Është barbaç.

– Barbaç?

– Po, shqiptar nga Athina. Kështu u thonë atje shqiptarëve të vendit. Tërë fshatrat rrotull Athinës janë barbaçë. Burra të bukur, pale gratë... Andej thonë një fjalë: «Trim si barbaç; e bukur si barbaçe.» Po, po, kështu... Nuk përzihen me grekët. E mbajnë gjuhën, sa mundin.

Sinicari kish harruar plagën e fliste pothuaj me qejf.

Pranë tyre hingëlliu me të madhe një kalë i plagosur, u përpëliti një copë herë duke goditur rëndë dheun me thundrën e mbathur dhe, më në fund, gulçoi thellë, pastaj u qetësua, s'levizi më. Ngordhi. Në fillim galat u trembën dhe u ngritën me krokërima, po pas pak u doli frika dhe zbritën prapë, pas kërmës. Erdhën edhe të tjera, se i ndillte era e gjakut. Retë zunë të humbisnin ngjyrën e kuqe dhe të merrnin ngjyrën e jargavanit, të errët, gjithnjë më të errët.

– Gur...

– Fol, Xhezar.

– Ti ke nënë?

– Nënë? Jo. Më ka vdekur, – tha sinicari i pikëlluar.

Xhezari u mat ta pyesë: «Po pse e thirre qëparë?» – por e ndryshoi mendjen: nëna mbetet ngahera nënë! Edhe pasi të ketë vdekur. E thërresim me përgjëratë në vogëli, e thërresim me mall në të ri, e thërresim me dhe- mbje në pleqëri, sidomos atëherë kur vuajmë, e grishim të na vijë në ndihmë në çastet e vështira, ndonëse e dimë se është tretur prej kohësh nën dhë.

Bisedimi u duk sikur u këput, po pëpritur Guri pyeti:

– Ti ke?

– Çfarë?

– Nënë.

– Kam.

– Atje?

– Atje.

Dhe pas pak, prapë Guri:

– Të pret?

– Ehl Më pret... – Dhe ment shtoi: «Do që të më martojë. Jam vluar. Po tani...»

Dhe s'di se si iu kujtua ajo kënga shumë e hidhur, që e këndonin dikur pleqtë, shtruar si me të vajtuar: «Mbeçë, more shokë, mbeçë/, Mbeçë ne ur' e Qabesë.../ I bëni selam nënesë»... Dhe më tej: «Ndë

pyestë nëna për mua/, I thoni se u martua;/ Ndë pyestë se ç'kalë hypi,/ Kalë at këmbë pe druri;/ Ndë pyestë se ç'krushq i vanë;/ Tre priftërinj, tre hoxhallarë;/ Ndë pyestë në ç'od e mbyllë,/ Odë pa der' e pa penxhere...»

Dhe, duke përtypur në mendje këtë këngë të hidhur si fletë shpendre, ndjeu se iu njomën sytë.

Guri e kuptoi; u mundua t'i japë zemër:

– Ti, djalë, mos u bëj merak: do të kthehesh në shtëpi. Ndofta plagën e ke të lehtë. Do të të mbyllet. Ti do shërohesh, do të martohesh, ehe! Unë do të mbe-tem këtu... do të vdes. Babai është plak, fëmijët janë të mitur, duan...

Xhezari u mat t'i thotë; «Jo, nuk e kam të lehtë, se ma ka bërë vëllai. Plaga e vëllait është shumë e rëndë. As ti s'e ke të lehtë. Të godita unë. Ta dish, unë e kam dorën të rëndë.»

Po të kish qenë herë tjetër, në vend tjetër, me njeri tjetër, Xhezari nuk do të kish biseduar kurrë për nënën. Ndofta as me njeriun më të afërt. Por tani ndryshonte puna. Gurin e Sinicës, që e kish shtrirë përdhe me shpatë, duke thirrur «ëh!», e ndiente si më të afërmin e të afërve. Pshërëtiu e tha:

– U vramë e u premë vëlla me vëlla. Më kot...

S'di në i dëgjoi Guri këto fjalë, sepse atë çast po murmuriste me zë të mbytur: «Oh, më dhemb...» Edhe Xhezarit i therën plagët. Dhe sikush u kredh në të tijat. S'di se si, pas pak Guri e mori përsëri veten e foli zvarrë:

– Do të kish qenë mirë të hynim ne të parët.

– Kush?

– Ne, ushtria

– Ku?

– Atje... Në vendin tonë. Në Korçë, në Devoll... Ne jemi ndryshe, ushtri. Ata janë të egër.

– Të egër? Kush?

– Andartët, Vrasin. Djegin. Shkretojnë. Ehl

Xhezari u drodh. Pastaj heshtje. Dhe prapë e humbi fillin.

...Në Selanik, në ato kazemat e kuqe afër Beaz-Kules, të mëdhenjtë u thoshin redifëve se mbreti i Osmanllisë është «llamba e dynjasë» dhe se ata, redifët, duhej të jepnin jetën e tyre për këtë «llambë», që të ndritë ngahera botën. Kushedi, ndofta ashtu i kishin thënë edhe Gurit, përtej: mbret Jorgua i Helladhës «drita e botës» dhe se ai me shokë duhej të jepnin jetën e tyre për këtë «dritë», që «do të ndizte përsëri qirinjtë e Shën Sofisë së Stambollit. Xhezarit iu duk sikur dëgjoji rishtas daullet e luftës që bubullonin me të madhe: «Ordumëz eti jemin... Ordumëz... Ordumëz...» lu kujtua edhe një gjë tjetër. Për t'ua rrëmbyer shpirtin shqiptarëve, një hyrietçi-itilafçi e kish kthyer shqip këtë këngë: «Dhe betim kjo ushtëri,/ Të vdesë për mbretëri...» Pra, përsëri vdekje. Përse? për «llambën e dynjasë», për «mbretëri...»

Mirëpo atë «llambën e parë të dynjasë» apo hijen e zotit mbi dhe» – gjakatarin e të urryerin sulltan Abdyt Hamit Han – e kishin shembur nga froni xhonturqit dhe e kishin degdisur ca kohë, syrgjyn, në Selanik, në konakun e jahudiut Allatini (që kish atje dy fabrika të mëdha), pranë konakut të jahudiut pasanik Modiano, buzë detit, afër skelës së vogël të fabrikës së tullave të një jahudiut tjetër, Allatinit. Aty, duke bërë rojë te dera, me pushkë e bajonetë gjermane në dorë, Xhezari e kish parë kaq e kaq herë kukudhin e llahtarshëm të Ildizit, sulltan Hamitin, «hijen e zotit mbi dhe» apo «filullahin filgalemin», siç i patën thënë dhjetëra vjet me radhë, «llambën e botës», të kërrusur, të trembur (shikonte anash, me bishin e syrit), të nxirë si shejtan. Dhe Xhezari i Devollit kish thënë me vete: «Ptu, o filullahi filgalem! Ptu, hije e zotit mbi dhë! Ptu, llambë!» Kështu kish thënë ai,

ndonëse nuk dinte se me kockat e shqiptarëve të vrarë me plumb, të mbytur me litar, të helmuar me helm, të hedhur në dete apo të kalbur në burgje, të syrgjynosur në Jemen e më tej, me urdhrin e kësaj «llambe» – sulltan Abdyl Hamit Hanit – mund të ngriheshin pirgje të tëra. Pastaj, më vonë, Xhezari kish parë edhe atë «llambën» tjetër, të renë, «hijen e zotit mbi dhe», sulltan Mehmet Reshatin e Pestë – të trashë sa një vozë, matuf si buf, të cilin xhonturqit hyrjetçinj dhe itilafçinj e kishin nxjerrë nga haremlëku dhe e kishin ngritur në fron të perandorisë. Dhe kish dëgjuar britmat e këtyre: «Padishahëmëz çok jasha!» dhe përsëri kish thënë: «Ptu, llambël Hije!» Tani i kish marrë dreqi të gjithë: «hyriet-adaletin». «padishahëmëzin», «ordumëzin»... dhe përsëri ish derdhur më kot shumë gjak shqiptar. Sot, këta të tjerët, grekët, po suleshin të shkelnin Janinën, mbase edhe Devollin. Atje ishte nëna e Xhezarit, motrat, fëmijët... Atje ishte edhe...

Dhe përsëri kujtime. Në ato gazemat e kuqe të Selanikut, një shqiptar nga Kosova kish ngritur krye kundër të gjithëve: kundër çaushit, kundër mylazimit, kundër bimbashit, kundër mirallait, kundër pashait dhe kundër vetë padishahut, «hijes së allahut mbi dhe», kish mbledhur shokët e u kish thënë: «O vllazën! Ne jomi shqypnar, s'jomi tyrk. Pra, të luftojmë për Shqypni, për atdhe! N'Kosovë zin pushka. Hasan Prishtina, Bajram Curri e Isa Boletini po luftojnë për Shqypni. Me shok! Duen me dbue tyrkun prej toke shqyptare. Ata luftojn me flamur shqypnar. Ky flamur u ngrit në Deçiç, në Kaçanik, në Shkup, në gjith Kosovën. Prej gazermave të Manastirit shum shok Teto-vet kan mor armët e kan dal maleve. Merrni ene ju armët dhe hajdeni të ikim. Të vdesim për Shqypni! Për atdhe!» Dhe kish ikur me shumë shokë. Mirëpo atëherë, ai, Xhezari, s'kish vendosur dot të ikte dhe kish mbetur në gazermë, të luftonte për «mbretëri», për «filullah

filgalem»... Dhe pastaj mendimet iu ngatërruan: «Bajazit Rehova, Kristaq Krastafilaku, Kristaq Kosturi, Qamil Panariti, Spiro Bellkameni, Kostaq Furrxhiu, Sali Butka, Gani Butka»...

Një xhonturk itilafçi, bej osmanlli nga Kavalla, me çifligje, kish thirur: «Kardashër, mos dëgjoni dinsëzët e imansëzët! Kini bërë jemin të luftoni për mbretëri. Kush ik, do t'i digjet shtëpia, do t'i vriten të gjithë të afërmit».

Dhe përsëri daullja e madhe: «Ordumëz... Ordumëz...»

– Gurl!

– Hë, vëlla...

– Përse luftove ti?

– Unë?... Që ta shpie turkun ne Molla e Kuqe, të marr Stambollë e t'i vë fronë Jorgos. Korçën... Po ti?

– Unë? Për...

Nuk e mbaroi fjalën, dhe e ktheu:

– Oh, më kot...

– Më kot... Më kot... – përsëriti dikush aty pranë, pa dyshim ndonjë shqiptar pa emër, nga shqiptarët e shumtë që kishin luftuar atë luftë, në të dy krahët, ca për Turkun, ca për Grekun.

Xhezari u ngrit me mundim të madh, në bërryl, shikoi rrotull dhe pyeti: «Cili je ti, vëlla, që fole?» – po s'mori përgjigje. Ndofta ai tjetri kish thënë fjalën e fundit dhe kish vdekur. Ku ta dish? Xhezari iu kthye Gurit: «Gurl! Gurl!» Prapë asnjë përgjigje. Edhe Guri kish vdekur. Sytë e tij, si xham i zi shëndritës, këqyrnin qiellin që po errej, dhe tufat e galave, që rrotulloheshin, me saqepat të përskuqur. «Ah, tha me dhembje, unë e vrava! Unë! Shqiptari vrau shqiptarin. Përse? Më kot...»

Nuk dëgjoheshin më krisma maliheri dhe manxeri, as vrape kuajsh, as thirrma njerëzish, po vetëm gjëmime të mbytura topash, që vinin nga larg, nëpër grykat e maleve. Disa ushtarë grekë po mblidhnin të plagosurit e tyre. Dhe armët e të dy palëve, të vrarë në fushën e luftës.

Në mes të heshtjes u dëgjua një zë i çjerrë, i dëshpëruar:

– Kiiita! Lllaaaj Kiiita!

Dhe përsëri: më çjerrë, më dhimbshëm:

– Kiiita! Kiiita!

Pas pak ushtarët që mblihdnin të plagosurit iu afruan vendit ku dergjej Xhezari.

– Bobo! – tha njëri. – Këtu qenka bërë kanare e madhe. Kapule të vrarësh. Koka të prera, duar të prera, krahë të prerë. Lemer! Shiko: Guri shqiptari! Edhe Pilua, Mërtiri, Kosta. Ja edhe të tjerë. Sa shumë! Qenkan grirë shqiptarët. Si andej buzë lumit, ku ranë në thikë me turqit. Këtu luftuan kalorës. Trima! Spartiatë! Edhe turqit kishin shumë nga këta.

– Çfarë?

– Shqiptarë.

– Po, kishin. Shqiptarë ka në çdo luftë. Dhe luftojnë, jo shaka.

Njëri u përkul mbi Xhezarin, u mat t'i merrte revolen nga këllëfi dhe dyfekun e hedhur krahaqafë, Xhezari e shikoi grekun me ca sy që vrisnin. Ushtari u spraps, sikur ta kish shtyrë tej një fuqi e madhe.

– Këtu, – i tha shokut, – ka një turk të plagosur. Djalë i ri. Si të bëjmë?

– S'kemi urdhër t'i ngremë. Më vonë, ndofta. Tani kemi tanët.

U dëgjua përsëri ajo thirrja e çjerrë, e dëshpëruar:

– Kiiita! Fraaate!

Ushtarët shikuan andej.

– Dëgjon? – pyeti i pari. – Rita Vllahu kërkon të vëllanë, Kitën. Nuk di se Kita u vra...

– Po, u vra. Në luftë me shqiptarët, buzë lumit. Kita e thërret në gjuhën e tij. «Frate» do të thotë «vëlla». Unë e di pak këtë gjuhë, se e fliste babai. Xhezari tha me

vete: «Edhe këta, vllahët, e kanë kot... Nuk e duan grekun, po vriten për të. Edhe greku i ka griirë, me andartë.» Dhe iu kujtua ajo ngjarja e Plasës, kur çobankat dolën me furka dhe e rrahën dhespotin e Korçës, që kish vajtur t'i kthente e t'i bënte grekë. Po ja, këtu...

U dëgjuan ca krisma të thata koburesh: pak! pak! Ushtarët u binin galave, që t'i largonin nga kufomat.

Nja njëzet çape më tej, katër ushtarë zunë të rëmonin një gropë të madhe për të hedhur të vrrarët. Rëmonin edhe gulçonin. Xhezari dëgjonte kthjellët goditjet e kazmave. Dëgjonte edhe gulçimën e atyre që rrëmonin dhe të atyre që punonin lopatën. Ngriti kokën dhe shikoi andej: buzë gropës dheu po ngrihej kukumale. Dhe atij iu duk sikur ajo kukumale ngrihej e rritej mbi shtatin e tij – e shtypte, e mbytte. Ndjeu edhe erën e njomë të dheut, të përzier me erën e athët e të mykët të rrënjëve të këputura. «Unë, tha, do të vdes e do të më varrosin këtu. Po ç'do të bëhet atje, në fshat, në shtëpi?»

Mendjen e kish gjithnjë atje, në fshat. Ndërkaq dy ushtarë vinin e shkonin duke mbajtur me tezgë të vrrarët. I shpinin buzë gropës, i bënë stavë, si drutë në pash.

– Kjo luftë, – tha njëri, – ka qenë më e ashpër nga të gjitha ato që kam parë gjer më sot.

– Po, – ia ktheu tjetri, – shumë e keqe. Duket nga të vrrarët. Nuk zumë robër. Kështu ndodh kur luftohet trup me trup, me thikë e me shpatë; nuk zihen robër. Njeriut i ndizet gjaku, vret e vritet, po s'jepet. Ama ata u mbajtën. Të paktë ishin po qëndruan. S'kishin bukë. Nuk u punonin mitralozët, se s'kishin fishekë. Po të kishin, do të na grinin. Pastaj ne ua morëm krahun, u dolëm prapa.

E shpunë Pilon, Gurin, Kostën, Mërtirin e atë tjetrin – shqiptarin e panjohur, që kish thirrur befas: «Më kot... Më kot...» dhe u kthyen prapë. Zunë të mblidhnin

kokat e prera, krahët, duart. Ndërkaq bisedonin midis tyre:

– Kur do të kthehem në shtëpi, – tha i pari, – do të martohem menjëherë. Do ta marr Margullën. Lufta ma mbushi mendjen.

– Margullën, the?

– Po, Margullën.

– E mirë është. Të do?

– Ajo? Çmendet pas meje. Po mua më dukej sikur nuk e doja. Lakmoja Marikën, se dinte të bënte naze. Tani e kuptova se kjo nuk më donte, shkante me të tjerë. Një natë e zura kur po kthehej që s'di se ku, me Spiridhonin. U rrahëm, u gjakosëm. Ajo rrinte e shikonte; s'i mbante anën as Spiridhonit, as mua. Unë dola më i fortë. E shemba. Ment e vrava. Pas tri ditësh fillova prapë me Marikën. Më kish hyrë në gjak, më kish helmuar. Nuk ndahesha dot.

– Marika është bishtdredhur, – ia preu shoku. – Ca kohë... ehe!

– E di, prandaj...

– Kështu është njeriu: do atë që nuk e do.

– Ke të drejtë. Unë isha si i verbër. Na la të gjithë e iku me një djalë nga qyteti. Margulla i shihte të gjitha, po duronte, më donte. Tani e kuptova. Ti nuk e di si është Margulla. Llokume me arra. Kur e shtrëngoja në krahë, trupi i bënte këerc, këerc... I thashë një ditë, po ajo ma ktheu: «Jo, jo! Kur të martohemi!» U zemërova e shkova prapë me Marikën, gjersa...

– Ptu!

– Tani e kuptova se ç'vajtë është. Besnike. Do ta marr! Sapo të kthehem në shtëpi.

Ai tjetri qeshi:

– Do ta marrësh, po ta gjesh. Ndofta ta ka marrë ndonjë tjetër.

– Thua?

– S'dihet...

– Do t'i shkruaj kartë, të më presë. Thua se lufta do të zgjasë shumë? Do të mbahet turku?

– As kjo s'dihet. Andej nga Janina na presin male të lartë. Bezhani... Thonë se Turku ka ushtri të madhe. Po të mbahet siç u mbajt këtu, ta dish se do ta kemi vështirë.

– Më vjen keq, Margulla ime...

Siç duket, ai tjetri u mërzit e ia preu:

– Mjaft, budalla! Gjete vend të flasësh për Margullën... Në mes të të vrarëve! Kur e kishe, shkoje pas Marikës, dhe tani...

Bisedimi u këput. Pas pak njëri tha:

– A ndezim nga një cigare?

– Ndezim.

Ashtu bënë. Era ia sillte Xhezarit tymin në hundë, po atij nuk i bënte asnjë përshtypje.

Po turqit këtu do t'i lëmë?

Adhuronjësi i Margullës u përgjigj me vonesë, i fyer: – Turqit? Do t'i mbledhim kur të vijë urdhër. Ndofta nesër.

– Nesër? Sonte do të bjerë shi i madh.

– S'ka gjë. Ata të vdekur që të vdekur janë, aq u bën: në shi, në gropë, kudo...

– Të vdekurve, e di se aq u bën. Po të plagosurve?

– S'di gjë. Duhet të pyesim. Kush ka nge t'i mjekojë turqit?

U dëgjuan të lehura qensh, që i tërhiqte era e gjakut. Ata të dy mbaruan cigaret, dhe zunë të mblidhnin përsëri të vrarët.

Shkrepi lart një yll, i vogël, i vetmuar. Pastaj edhe një. Xhezari i shikonte. Ndiante të mardhura. Befas iu duk sikur u ngrit një burrë i gjatë pranë tij dhe thirri me

të madhe: «Ngrih, o shqiptarë! Nisemi në luftë. Për Shqipëri!» Edhe Xhezari u ngrit pendë i lehtë, i gjatë, i fortë, ashtu siç kish qenë kur kish ardhur nga Devolli; me shpatë në dorë. I fërshëlleu kalit. Ky erdhi sakaq, me të katra, qëndroi pranë, hingëlliu, priti. Sa të mbyllësh e të hapësh sytë, kërcyen më këmbë gjithë shqiptarët. Një ushtri e tërë! Vijnë kaluar e më këmbë, me thika të mbërthyer në dyfek, me sytë flakë. Dhe çudi: tani rrinë krah për krah ca me hëna turku e ca me kryqe greku. Ai vetë, Xhezari i Devollit, ka në të djathtë Gurin e Sinicës, më tej Mërtirin, Kostën, Shahinin e Kosturit, Fejzon e Kalarit, Pilon e Athinës e sa e sa të tjerë. «Bre, sa shumë qenkemi! Një botë e tërë. Tutje na presin të tjerë. Kish pasur të drejtë ai kosovari që na ftoi atëherë të shkonim e të luftonim për vendin tonë.» I hipi dhe priti. Atëherë buçiti përsëri ai zëri i parë: «U mblodhët, vëllezër?» «U mblodhëm!» «Haj, nisuni. Për Shqipëri!» Edhe një çudi tjetër; ushtarët nxjerrin thikat dhe diç presin nga kapat. Bien poshtë hënëzat e turkut e kryqet e grekut. Vendin ua marrin shqiponjat, ashtu siç kishin pasur në kësulë Bajazit Rehova e Nuçi Lapi. Pa nisët tërë kjo ushtri e madhe, kalon fusha e brigje, lufton, hap udhë me shpatë e plumb, u vë fshesën gjithë pengesave.

Sa mirë! Xhezari është prapë i fortë, kaluar, më shpatë në dorë, me dyfekun krahaqafë. Dhe lufton.

— Ja, — tha, — tani mund të themi se nuk luftojmë më kot!

Më tej në këtë ushtri derdhen ushtri të tjera, si lumenjtë e vegjël në një lumë të madh. Dhe ushtria sa vjen e shtohet?...

...Papritur pamja ndryshon. Xhezari gjendet fill i vetëm. Dhe ku? Afër fshatit. Ja tek duken kreshtat e Malit të Thatë, damarët e bardhë të shkëmbinjve, xhadeja e Korçës. Ja ku është edhe kroi. Qëndron. Unjet. Pi.

Fshin buzët. Aty pranë është një gur. Sa e sa herë ka qëndruar Xhezari në këtë gur. Po kësaj here s'ka ngë të rrijë. Merr udhën e fshatit. Nxiton.

— Po ç'është kjo? Pse mban erë shkumb e tym? Fërkon sytë, që të shohë më mirë. Fshati është djegur. Gërmadhat e tymosura të shtëpive derdhen udhëve. Ja edhe shtëpia e tij, derë e parë, siç i kishin thënë vëllezërit kur e kishin nisur redif. Një grumbull murishtash. Heshtje si në varr. Po ku janë njerëzit? S'pipëtin gjë e gjallë... Por ja, nga murishtat del një vogëloshe me duart e këmbët të djegura, me leshrat tërë blozë, me sytë të fundosur në gropëzat e ballit. Xhezari habitet: si mund të jetë e gjallë kështu? Si mund të ecë me ato këmbë e të shohë me ata sy? Po ashtu siç është, ajo është e gjallë. Vrapon e thërret:

— Xhaxha Xhezar! Xhaxha Xhezar!

Xhezari e njeh, është Fetija, e mbesa.

— Fetije! Bijë! Nuse! (Kështu i thosh Xhezari kur e përkëdhelte: «nuse!»)

Vajza bie në krahët e Xhezarit. Ky e shtrëngon në gjoks. Fetija mban erë shkumb.

— Ku është nëna, Fetije?

— Nëna? Nuk e ditke, xhaxha Xhezar? Nënë plakë e dogjën në shtëpi andartët me mjekra. S'e sheh shtëpinë? Po ti ku ishte, xhaxha Xhezar? Asqer ishe? Pse s'erdhe më parë, xhaxha Xhezar, t'u bije me dyfek? Nënë time, xhaxha Xhezar... nënën time... xhaxha...

Sa shpejt flet kjo vajzë. Pse flet vallë kaq shpejt? Xhezari i sheh të gjitha, i di të gjitha. Andartët vranë pleq e plaka, fëmijët. I nxorrën gratë nga shtëpitë e i u a futën brenda në çitjane, i goditën me stap. Dhe qeshën, gajasën, ndërsa ato thërrisnin, lebetiteshin. Edhe tmerre të tjera... Një plakë leshlëshuar i ra me sëpatë një andarti që donte t'i çnderonte të bijën dhe

ia ndau kokën nga trupi. Një nuse e re ia nxori sytë me thonj një andarti tjetër.

Po ç'është kjo? Nga murishtat del nëna: e gjatë, e thinjur, e rreckosur. Mban për dore një vajzë të re, të gjakosur, me sytë përdhe. Xhezari e njeh dhe i rreh zemra. Kjo është... kjo është... (Ah, nuk ia thua dot emrin asaj që e do me shpirtin!) Po, po, me këtë vajzë kish dashur ta martonte nëna Xhezarin. E kishin lidhur fjalën dhe e mbanin fshehur gjersa ai të kthehej në shtëpi. Sa shumë qenka zbukuruar! Edhe më parë ishte e bukur, po tani ua shkoi gjithë shoqeve. Mirë, mirë, po ç'po bëhet kështu? Nënës dhe vajzës po u afrohet një burrë i shkurtër, me një mjekër të zezë, të rrumbullakët. Sytë i ndritin si ata të një maçoku të zi, natën. E shtyn tej nënën e Xhezarit, e shemb dhe matet ta zerë vajzën. Atëhere Xhezari thërret me të madhe:

– Qen! Qëndro!

Dhe zgjohet nga thirrma e vet, hap sytë. Binte një shi i ngadalshëm vjeshte. Mbi Xhezarin ishin përkulur dy ushtarë që donin t'i merrnin armët, mbase dhe rrobat. Fjalët «qen, qëndro!» i kish thirrur me një zë kaq të fortë, sa ata të dy u trembën, u prapsën.

– S'paska vdekur, – tha njëri me zë të dredhur. – Shumë i fortë paska qenë. Desha t'i marr dyfekun dhe...

– Lërja. Këtu e kemi. Atje ku do të vejë s'ka nevojë për dyfek.

Dhe u larguan.

...Xhezarit iu ftohën fare plagët,

– Eh! – tha. – Më kot... Më kot...

Nga larg vinin gjëmimet e mbytura të topave. Grekët kishin hyrë brenda në Toskëri. Digjnin. Shkretonin. Vrisnin pleq e fëmijë, mundonin, çnderonin.

– Oooh! – gulçon Xhezari dhe mbylli sytë përngahera.

Bukuresht 1935
Ripunuar më 1965

Xha Brahua i shkumbanores

Që kur gjelbëronin shelgjishtat e jazit e gjersa skuqeshin e shkundeshin fletët e pjergullës, ne, vegjëlja e fshatit, ishim ditë për ditë e çast për çast mysafirët e paftuar të xha Brahos të Shkumbanores. Këtë mall kaq të madh për buçimën e ujit të shkumbëzuar, për trokëllimën e trokës e për pahun e bryllët të miellit, e kishim trashëguar nga shokët tanë më të mëdhenj, të cilët, radhë pas radhë, i rrëmbente puna e fushës dhe e mallit, ushtria dhe mërgimi.

S'di se qysh, po edhe sot, pas kaq vjetësh mërgimi, kur e kujtoj atë mëngë të fshatit: mullirin e vjetër të Shkumbanores, me çati të zbardhylët e të kërrusur nën degët e arrës, myshkun e gjelbër të remës, kulprat e varura, shkumbën e bardhë që dilte vrulltas ndër mijëra stërkala e ylbere dhe ujin e rrahur të pendës, që e pinim me grushte e s'ndienim të nginjur, them, kur i kujtoj këto të gjitha, vjen e më rëndon në zemër një mallëngjim që nuk e tregoj dot me fjalë e nuk e shkruaj dot me shkrim.

Sikur e shoh edhe sot xha Brahon tonë, atje, nën hijen e pjergullës, nën arrë, duke kalitur gurët e vjetër a duke gdhendur ndonjë fletë pende a ndonjë dallëndyshkë, kur ne dilnim fësht e fësht nga kulprat e anës së

poshtme të jazit, me këmbët të lagura gjer mbi gjunjët e me fytyrat të nxehura. Xha Brahua ishte ashtu siç kish qenë gjithmonë: i paktë nga shtati, i eshkët, me shpatullat të kërrusura nga pleqëria, i pahitur i tëri, nga koka gjer në këmbët.

Ne e përshëndosnim të gëzuar:

- Të ardhhtë mbarë, o xha Braho!
- Mirë se të gjejmë, o xha Braho!
- Tungjatjeta, o xha Braho!

Dhe pakëz më vonë cicërinte zëri i hollë i ndonjë cinxulli-minxulli të vogël që, bot e bot, mezi dilte, duke gulçuar, nga drizat – se na kish humbur tragën e kish mbetur prapa – i skuqur si thana e shëmbitrit:

– Tunateta, o xa Bao! Tunateta, tunateta!

Përgjigjja e të zot të mullirit ndryshonte sipas dëmit e ngatërresave që i kishim bërë një ditë a një orë më parë. Po për ne gjithë ajo punë ish, sepse e dinim xha Brahon tonë e s'na bëhej vonë as kur i hipte zemërimi: xha Brahua ishte i mirë, i dashur; xha Brahua na donte, xha Brahua mërzitej kur ish vetëm.

Pastaj, si pa gjë të keq, shtroheshim të pafuar në lëndinën e njomë përpara derës dhe hanim krap e krup kumbullat majhoshe, që i kishim përllarë vreshtave si në mallin tonë. Hanim gjersa na mpiheshin dhëmbët dhe nuk na e hiqte të athëtit e gojës as uji i rrahur i pendës së mullirit.

Kur e tepronim me zullumet tona, sepse shpesh vilnim ndonjë veshul aguridhe nga pjergulla, thyenim me gurë ndonjë qeramidhe të çatisë (fajin s'e kishim ne, po ata verdhshët që qëndronin tamam atje, në majë për të çukitur myshk a fije bari dhe ne s'kishim vend tjetër më të volitshëm që t'i vrisnim), apo i këputnim, pa dashur, në të lojtur e sipër, ujin e koritës, xha Brahua na ndiqte gjer buzë jazit e që aty na thërriste:

– A, jezitë! Në ju zëntë Qamili, në ju zëntë! A,

në ju zëntë Qamili t'jua bëjë veshët oputë për opinga...

Në fillim ne qemë trembur me gjithë mend nga ky Qamil i panjohur, që vinte të na shkelte të drejtat tona në mullinë e Shkumbanores e të na i bëte veshët oputë opinga dhe ishim futur thellë e më thellë nëpër shelgjishtat, nëpër kulprat e drizat. Po kjo punë nuk zgjati shumë. Një ditë, më nge, kur kish qenë në orë të mira, xha Brahua na tha vetë se i nipi, Qamili, gjendej prej shumë vjetësh në Vllahi a në Vullakë të Misirit – as vetë nuk e dinte mirë se ku – dhe se së shpejti do të vinte të merrte mullinë e gjithë mallin në dorë. Që atë ditë na u bë syri pishë e nuk bënim këmbë nga mezhda, prisnim gjersa t'i dilte inati xha Brahos e pastaj të ktheheshim prapë në lëndinë.

Kështu shkante koha asohere: uji rridhte, mulliri bluate, pahu i ëmbël mbushte me erën e tij të këndshme gjithë atë mëngë të fshatit, Xha Brahua kalitte e përëritte gurët e vjetër, ne rriteshim dita-ditës.

Çudi e madhe: nuk e gjenim e nuk e linim kurrë pa punë xha Brahon tonë! Kur s'kish gurë për të kalitur e fletë rrote për të bërë, zbriste poshtë, në felaqi të mullirit, për të ndrequr cifunin, pendën a dallëndyshen, hynte në koritën e kalbur, t'i hidhte ndonjë mballomë pllashte gështenje e ndonjë dajadë, që ta mbannte edhe ca, gjersa të vinte Qamili e ta bënte mullinë «fambrikë Avrope». Pastaj ndreqte koshin a podin, i vinte ndonjë furkë pjergullës. Kur s'bëntë asnjë nga këto punë, duke pritur ndonjë myshteri që kish shpëtuar s'di se si nga pritat e mullinjve të tjerë, më të mirë, të radhitur tatëpjetë jazit, grinte kërsh e kërsh me thikë, ca duhan kërxxhall, që e mbillte vetë në nja dy rrogoza vend përpara mullirit. Këtë vend e plehronte me fushqi, sepse fushqia e forcon duhanin dhe e bën të kërcasë.

– Mjaft punove, o xha Braho, se je plakl – i thoshin myshterinjtë duke ngarkuar thasët.

– Plak-plak, pø puna do bërë, – ia kthente xha Brahua. – Ja, edhe ca, gjersa të më vijë nipolli, pastaj do të heq dorë e do t'ia lë atij, do të marr trespiket e do rri në hije.

Kështu thosh xha Brahua: të rrinte në hije me trespiket në dorë, po ne e dinim se kish edhe një dëshirë tjetër; ta martonte Qamilin e ai të bënte fëmijë, shumë fëmijë. Edhe një tjetër: ta bënte mullinë e Shkumbanores «fambrikë Avrope», me dy gurë që të vërtiteshin kaq shpejt, sa të mos i shquante syri i njeriut e ta nxirrite miellin të hollë, të butë, që të çuditej tërë bota.

Nganjëherë, kur s'ish shumë i mahnitur, se Qamili po vonohej tepër andej, larg, se mulliri, selishta, luadhia e shtëpia do të mbeteshin pa zot e do t'i mbylledera, xha Brahua na mësonte të nxirrnim glyra e buzukë nga bisku i gështenjës dhe pizga e bilbilë nga ai i shelgut. Në ndajnatat e qeta të pranverës na tregonte ndonjë rrëfim të lashtë me hazna të fshehura nëpër shpella pa fund, ku nuk shkel dot këmba e njeriut, a nën gurë të mëdhenj me shenja të gdhendura, na fliste për Të Bardhat e për lugetërit, që vinin t'i këputnin natën rëmën e mullirit a për trimëritë e ndonjë burri me nam si Petro Kapedani, që kish luftuar e ish vrarë në ata dy Gurët e Bardhë, Shahin Matraku me shokë apo Kapedan Kajo Babjeni, të cilëve u këndoheshin këngët edhe në ditët tona. Kapedan Kajo, thosh, e kish mik me kokë që në vogëli e ky i kish ardhur shpesh në mulli, kur e ndiqte hyqymeti me një tabor zaptijesh. Pastaj e këputte fillin e rrëfimit, sepse i errej balli nga ndonjë dhembje e thellë, dhe na pyeste:

– A keni dëgjuar, o kapedanë (kështu na thosh: kapedanë, sepse pas mendjes së tij, s'kish gjë në botë më të madhe e më të mirë se sa të jesh «kapedan» e të luftosh), cili kral është tashi në viset tona?

Për xha Brahon, të gjithë të huajt që na shkelën

vendin ishin «kralë». Më i ligu nga të gjithë ishte ai i Karadakut. Pastaj vinin të tjerët, me radhë: ai i Serbit ishte katraves, ai i Grekut gjuhëhollë, ai i Bullgarit rrumbullak. Pastaj vinin ca të tjerë, «më të vegjël», si krali i Frëngut – titiz e nopran; krali i Nemces – barkosh e gjakatar; krali i Ingjilizit – fiknaxhi i propë.

– Kur na pyeste kështu, ne i përgjigjeshim të gjithë me një zë, batore dograje:

– Shqipëria.

– Shqipëria?!

– Shqipëria! Shqipëria!

Plaku çuditej e binte në të thella. Turk kish parë; serb, grek e bullgar kish parë; edhe austriak e gjerman. Po ashtu kish parë frëng e kalakul. Të gjithë kishin hyrë e kishin dalë me luftë e gjëmë. Krali i Serbit e kish shkelur shumë herë vendin, e kish shpallur «Serbi e Vjetër», kish vrarë e prerë, kish djegur e çnderuar, kish zbrazur hambarë e kish vënë përpara shumë gjë të gjallë, ua kishin tharë lugën njerëzve. Edhe krali i Bullgarit e kish shpallur vendin «Bullgari e Vjetër», kish vrarë, prerë e çnderuar, kish shkulur shumë fshatra dhe i kish hequr njerëzit – pleq, gra, fëmijë – tutje në Shkup, edhe më tutje: në Serbi e Bullgari, ku kishin lënë kockat përjetë. Ashtu kishin bërë edhe të tjerët duke lënë prapa varre dhe jetimë. Krali i Nemces kish sjellë zinë, ai i Frëngut sëmundjet e lapërdhitë. Kishin luftuar aty njëri-me-tjetrin, kishin shkatërruar vendin, pastaj i kish përpirë dheu të dy palët. Dhe ja, kish ardhur dita të dëgjonte se paskej shkelur një kral i ri: Shqipëria.

Pyeste:

– Kur paska ardhur, bre, ky kral i ri?

– Ka qenë, xha Braho, – ia kthenim ne propë si batore dograje.

– Kush ka qenë, bre?

– Shqipëriiiiiia!

Xha Brahua mbetej gjysmë i çuditur e gjysmë i çoroditur nga përçartjet tona, vriste mendjen, pastaj ia fillonte rishmë:

– Unë po mbush një brez njeriu që kullos këtu, në Shkumbanore, e s'ia kam dëgjuar emrin këtij krali të ri!

– Është i vjetër, xha Braho, shumë i vjetër. Sa malet, sa perëndia! – i thërrisnim ne, sindozot se na kish thënë mësonjësi i fshatit për pellazgët dhe ilirinjtë, të cilët i përzienim e i bënim ujem me Pirron, me Skënderbenë e Ismail Qemalin.

Xha Brahua kruante mjekrën e thinjur, tundte kokën, i binte takijes dhe e shpinte gjer në gropë të qafës, pastaj na thërriste i egërsuar si ai uji i bardhë me stërkalat, që dilte nga penda e mullirit:

– Kush e bëri, bre?

– Skënderbeu!

Kur dëgjoi për herë të parë emrin e Skënderbeut, u platit si mulliri kur i vihet pengorja e nuk bluan më. Ment na zuri besë. La sqeparin, drodhi një cigare, e ndezi me eshkë, nxori tym nëpër hundë e gojë dhe na shikoi një nga një. Ne s'bënim zë, që të mos e ndiznim më shumë e të mos na dëbonte nga lëndina e mullirit, ku pahu i miellit ishte kaq i ëmbël dhe kënga e pareshtur e trokashkës na bënte të lumtur.

Edhe vonë, kur hijet e natës nisnin të ngjiteshin nga poshtë nëpër faqet e maleve e kur bubullima e mullirit bëhej më e shkoqur, plaku na pyeste rishtaz në u bë luftë e madhe kur hyri Skënderbeu. Pa ne, që na punonte mendja si flakë e zjarrit, i tregonim disa nga trimëritë e shpatës e të kalit të Skënderbeut, të cilat i shtonim e i shumonim me ndonjë çudi nga ato të përrallave. I thoshim se si e kish marrë Skënderbeu kështjellën e Krujës, se si kish ngritur flamurin e kuq me shqiponjë të zezë me dy krerë, se si i kish dhënë dërmën turkut. Kur largoheshim nga mulliri, ndofta xha Brahua

kish dëgjuar këngën tonë «Që nga na vjen, vallë, trim o kapedan», që e këndonim me të thirrura dhe e mbyllnim me fjalët:

*Mbren' e Shqipërisë,
Skënderben' me nam.*

Të nesërmen, të pasnesërmen e më tej na pyeti përsëri për punën e Skënderbeut: si e qysh, a ish burrë i madh, e kështu me radhë. Ne ia thamë shkoqur të gjitha ato që dinim e ato që s'dinim, e ngritëm la e më la heroin tonë të dashur, që e ndienim kaq të afërm, sa harrojmë fare se kish vdekur në Lesh dhe pandehnim se rronte e luftonte më, diku, në malet. Xha Brahua na dëgjoi heshtur, me sytë e tij në sytë tanë, nuk na qortoi as për qeramidhet e thyera, as për aguridhet e vjela. Më në fund na pyeti:

– A është trim i madh?

– I madh, xha Braho, si s'ka në botë! Dridhet dheu kur del kaluar.

– Lufton?

– Ehel Lufton e gjëmon. Vrink, me shpatë.

– Po shokë ka?

– Shumë, xha Braho! Tanushin, Aranitin, Dukagjinin, Muzakën. Të marrin gjak në vetull.

– Mirë. Tashi hajt, shkoni, se po ngryset e dalin lugetërit.

Shkuam, siç na tha, dhe e lamë të menduar në prag të derës, midis xixëllonjave të shumta që dilnin nga shelgjishtat, nga kulprat, nga shpëndrat e sillnin drithë të ri. Po xixëllonja më e madhe ishte cigarja e Xha Brahos, që shkrepnte në errësirë. Udhës, si ngahera, kënduam këngën e Skënderbeut.

Vonë e kuptuam përse xha Brahua ynë na kish pyetur kaq hollë për Skënderbenë e përse binte në mendime sa herë që ia dëgjonte emrin.

Një ditë e gjetëm derën e mullirit të mbyllur me atë katinarin e madh që peshonte një okë. Kjo s'kish ngjarë kurrë. Uji i remës ish këputur e derdhej drejtpërdrejt në lumë. Porta e mëregave ish unjur në kllapë. Aty-këtu shtrati i remës kish zënë të fragjepsej nën ato lulebasanet e verdha e të gjata që përkuleshin në të dy anët. Nëpër pellgjet kërcente ndonjë bretkosë e gjorë, që kërkonte lagësi. Të tjerat rrinin shuk, gojëhapur, me sytë të kërcyer dhe shikonin qiellin. Rreth e rrotull qetësi e madhe. Tani, po të donim, mund ta vilnim tërë përgjallën, mund të bënim ç'të donim. Po asnjëri nga ne nuk zgjati dorën të marrë ndonjë aguridhe. Mulliri, re-ma, selishta e tërë vendi rreth e qark na dukeshin sikur kishin mbetur pa shpirt, sepse shpirti i tyre kish qenë xha Brahua, dhe xha Brahua s'ishte më aty. Trokashka ish mekur, s'ndihej erë pahu. Trokitëm në derë të gjithë bashkë, thërritëm:

– O xha Braho! O xha Braho!

U trembën galat, po nuk u përgjigj njeri. Zbritëm e shikuam pendën me pengoren të futur në dhëmbë

– Ç'bëjmë?

– Të hymë brenda. Ndofta...

Të hymë, po si të hymë? Njëri tha të futeshim nga baxha, si laraska; i dyti, nëpër hatuj, si qelbaku; i treti nga penda, si gjarpri. Sikush nguli këmbë në të tijën. Hodhëm shkurtën: fitoi laraska. Çatia ish e ulët. Vumë një furkë e hipëm një nga një me kujdes që të mos thyenim qeramidhet e mbuluara me myshk e barishte. Hymë në baxhë. Minjtë u trembën e ikën me të katra.

– O xha Braho!

Mulliri gjëmoi përbrenda. Thirrëm e nja dy a tri herë të tjera, dëgjuam oshëtimën e zërave tanë e na hyri

frika. Zbritëm nga çatia. Si u bë kjo punë? Njëri tha se ndofta xha Brahua ish ngjitur lart, në gështenjat, për të prerë ndonjë hu a ndonjë qepërë, siç bënte shpesh. Mirë, mirë, po po të kish qenë në gështenjat duhej të kërciste sëpata. Mbajtëm vesh: asnjë sëpatë... U kthym pik e vrer në fshat dhe shpumë lajmin se xha Brahua kish humbur, se ndofta e kishin ngritur Të Bardhat dhe e kishin shpënë kushedi se ku. Të mëdhenjtë qeshnin:

– Të Bardhat s'e ngasin, se i ka të tijat. Ato marrin ndonjë djalë të ri, kur çelin lulet.

– Po xha Brahua humbi...

– Nuk humbi, jo! Kushedi ku ka shkuar.

Ndajnatë dëgjuam ç'kish ndodhur.

Atë ditë xha Brahua kish veshur fustanellën e dikurshme me treqint kinda, që e mbante në sepete, kish veshur mëngoren dritë të bardhë, çepkenen me otra e gajtan, tirqit, kish ngjeshur silahun tërë pafta. Shkurt: ish nisur si dhëndër. Kish nxjerrë pastaj nga hatulla atë shishanen e gjatë sa mund të flinin dyzet pula njëra pranë tjetrës (këtë shishane me çark e kish trashëguar nga i ati, përpara se të dilte dograja e martina), kish mbushur vezmet me barut e plumb, kish varur palcorën me vaj, kish futur në silah një stringë me strall e agzot, kish vënë takijen mbi vetull e kish shkuar drejt në qytet.

Përse?

Të piqej me Skënderbenë e të fliste për punën e Qamilit.

Në të vajtur udha vinte tatëpjetë. Xha Brahos i bënin fap-fup mëngët e çepkenes, fap-fup kindat e fustanes, që i vinte dy pëllëmbë më e gjatë e dy a tri pëllëmbë më e gjerë sesa në të ri. Hija e trupit e hija e shishanes shqisnin e thyheshin nëpër ferra e driza.

Mirëpo në të hyrë të qytetit dolën e ia prenë udhën

katër a pesë nga ata të kralit të ri, të veshur me rroba të murme, tërë dizga, pllaka e rripa, me ca shapka me shqiponja në kokë, me të folur të vrazhdë, nëpër hundë.

– Ndall!

Atëherë zëri i xha Brahos bubulloi sa u tund vendi:

– Ç'doni, bre?

– Lidhu!

– Kush, bre?

– Ti! Hidh dyfekun!

– Unë të hedh dyfekun? Na, haj ta marrësh! Nga gryka!

Tha kështu, u ra me bërryl mëngëve të çepkenes, zuri vend prapa një guri të madh, mori shenjë e mend i dha zjarr agzotit, që të bëhej batërdi në mish të gjallë.

– Hapni udhë, se unë do ta shpie gjakun gjer në gjul

Mirëpo ndodhi aty një burrë i urtë e shpirtmirë, që s'desh të derdhej gjak. Pyeti me zë të butë:

– Cili je ti, o plak? Nga na vjen?

– Jam kapedan Brahua i Shkumbanores! Po ju ç'jeni, bre!

– Shqiptarë.

Kjo fjalë ia ngrohu pak zemrën, po prapë nuk i zuri besë.

– Nga keni ardhur, bre?

– Nga Shqipëria.

– Me Skënderbenë jeni?

– Me Skënderbenë.

– Unë dua të flas vetë me atë të madhin tuaj, se kam një punë.

Ata u shikuan sy në sy, vunë buzën në gaz e i thanë:

– Haj të të shpiem ne.

Po xha Brahua rrinte prapa gurit me gishtin në çarku i shishanes. I pyeti:

– Me besa-besë, o burra?

– Me besa-besë.

– Mirë, po vij.

La pusinë, hodhi shishanen supit e shkoi ta shpien përmes pazarit. Udhës u ranë pas shumë njerëz, të mëdhenj e të vegjël, që pyesnin: «Ç'është ky kapedan me dyfek të gjatë si njëherë e njëkohë? Nga ç'shpellë a nga ç'limer ka dalë? Kush e ka mbajtur me bukë? A mos vjen të falet?» Kështu, e shpunë me bujë të madhe në nënprefekti.

Në zyrë kish shumë njerëz. Në mes ishte nënprefekti – një burrë shishko, me ca mustaqe të përdredhura, i veshur pothuaj evropiançe, po me kallpak të zi në kokë. Pa dyfek. Vetëm një kobure në të mëngjër, nën setër. Xha Brahos s'ia mbushi synë. Njëri nga ata që e kishin sjellë plakun bëri për nder me dorë në shqiponja e shapkës, iu afrua nënprefektit e diç i pëshpëriti. Plaku e shikoi me të dyshuar e nuk e lëshoi nga dora shishanen grykëgjatë, që arrinte pothuaj gjer në tavan. Synë e kish pishë. Nënprefekti e shikoi, u koll e tha se Shqipëria s'linte tani që njerëzit të mbanin armë pa leje.

– Cila Shqipëri, bre? – i thirri xha Brahua me të madhe, sikur të gjendej pranë pendës së mullirit, që të shurdhon veshët, e të ngre përpjetë me buçimën e saj.

– Shqipëria, qeveria e vendit, – i tha me buzë në gaz një toger, burrë i hollë e finok, me dy kobure varur në brez – një këtej, një andej. – Tani vendin tonë e ruan ushtria.

Po ty, ore, pse të lënka me dy stringa e mua jo? – ia preu xha Brahua. – Unë jam burrë, s'jam grua. Burri s'rri dot pa armë. Dëgjon apo jo?

Ata të zyrës e shikuan sy në sy e pastaj ia plasën gazit sa ment u thyen xhamat e dritareve.

Ama, çudi: të gjithë këta burra – nënprefekti, togeri, ushtarët e ata të tjerët – flisnin shqip si ti e unë!

Xha Brahua i shikoi një nga një e i pyeti me zë të egër, sikur të paskej qenë kadi që i gjykonte:

– Po ju ç'jeni, bre? Ç'bëni këtu?

– Shqiptarë. Qeverisim vendin, e ruajmë.

Xha Brahos i erdhi të qeshë e të pyesë, siç qeshte e pyeste dikur kapedan Kajo Babjeni: «Ama, yrnek, valla-hi! Më qenki mbledhur kokë më kokë e ruaki vendin...»

– po e mbajti e nuk ua tha. E ktheu ndryshe.

– Po atë të madhë fare ku e keni?

– Cilin të madh, o xhaxho kapedan?

– Skënderbenë, të parin tuaj. Më kanë thënë se është trim e kush është trim është edhe i mirë. Kam ardhur të flas e t'ia qaj hallin.

Burrat mbetën pa gojë. Gjer të marrin vetën e të flasin, xha Brahua u ul këmbëkryq, poshtë, me shishanen pranë e nisi t'u tregojë dhembjet e shumta që kish në zemër: se si djalin e madh ia kish vrarë krali i Serbit, kur kish shkëlur e zhveshur vendin, se si djemtë e tjerë e nipërit i qenë shuar atë mot që iku Nemcja me zinë e hyri frëngu me sëmundjet, se si nuk i kish mbe-tur njeri në shtëpi, e po i shuhej fara, se po i shembej mulliri i Shkumbanores e s'kish kush t'ia punonte selishtën. Për ne, të vegjëlit, nuk iu qa. U tha se i nipi, Qamili, kish krisur e ikur në kurbet e nuk i dërgonte fjalë e kartë, se bota priste të vdiste që t'ia zaptotin mullinë e gjënë, t'ia mbyllte derën.

Të gjithë ata që ndodhën atje – vendës, dibranë, kolonjarë – u mallëngjyen, sa qanë me lot. Po asnjë nga këta burra s'mundi t'ia mbushë dëshirën që të flasë gojë me gojë me të parin e tyre, me Skënderbenë. Nga ana tjetër, asnjë s'pati zemër t'i thotë se ky, Skënderbeu, kish pesëqind vjet që kish vdekur... Nuk donin t'ia thyenin zemrën e shpresën. Nënprefekti mori pendën, e ngjeu në bojë e shkrojti në kartë emrin e Qamilit të Smail Brahos nga Shkumbanorja e i dha besën e burrit se do t'ia gjente gjurmën atje ku ish e do t'i dërgonte fjalë të kthehej në shtëpi.

Ndërkaq, xha Brahua e kish marrë veten e u tha me të thirrur:

– Dëgjoni, o burra! – Unë dua që Qamili të vijë në shtëpi, të më hapë derën, të mos më shuhet fara. Kështu dua. T'i bëni të fala atij të madhit tuaj, Skënderbeut, e paçim sa malet e i rrofshin çunat! T'i thoni se i bën falmeshëndet kapedan Brahua i Shkumbanores që të ma sjellë këtu nipin e kur të ketë nevojë për luftë me kralet, le të na thërresë, se do t'i vemë të dy bashkë, të luftojmë e të vritemi.

Pastaj zëri iu egërsua shumë e më shumë:

– Të vijë Qamili. Nuk dua kurbet, nuk dua pare kurbeti. Do të rrojmë këtu siç kanë rrojtur ata që ishin përpara nesh. Po të mos dojë të vijë, bëj be për atë dhe, për atë gur e për atë bukë se ndonjë ditë do të më mbushet mendja, do të marr dyfekun e do të zhavuloj në Vllahi a në Vullakë, ku të jetë, do ta zë për veshi e do ta sjell në mulli. Dëgjuat, apo jo?

Si tha kështu, vuri dorën mbi stringën e silahut, që të shihte në e kish a s'e kish aty, hodhi shishanën e krahut, kapiti takijen mbi sy, u përkul pak, që maja e dyfekut të mos godiste pragun e sipërm dhe doli i krekuar.

Nga tërë kjo tevatyrë, xha Brahos nuk i mbeti veçse një gjë: emri «Skënderbe». Këtë emër ia thoshin midis tyre njerëzit e fshatit e ata të fshatrave të tjera, që vinin për të bluar në mulli të Shkumbanores, po druhashin e nuk i binin kurrë në sy. Dhe me të vërtetë, xha Brahua i ngjante mjaft, nga fytyra, Skënderbeut tonë: i trettur, mjekërbardhë, hundë me samar – tamam hundë shqiptari. Dhe gjithnjë i paepur, si shqiptar.

Dhe shumë kohë pasandaj, në mullinë e Shkumbanores jeta rrodhi siç kish rrjedhur dikur: pa brenga për ne, të vegjëlit, plot brenga e dhembje për xha Brahon tonë.

Doli vera, hyri vjeshta; pas vjeshtës, dimri. Tani xha Brahua kish më shumë myshterinj, sepse njerëzit kishin mbyllur punët arave dhe kishin nge për të bluar e biseduar. Domosdo, kishin edhe dasma, të hyra e të dala, që donin shumë miell për bukë. Kur u ftoh moti, xha Brahua zuri të ndizte një zjarr të madh me shkarpa e kërcunj në vatrën e madhe të mullirit. Aty rrinin e ngroheshin myshterinjtë që prisnin radhën për të bluar, me gunat krahëve. Xha Brahua kish hequr takijen e verës e kish vënë në kokë një rrezhgë që kish qenë dikur e kuqe dhe tani ish tërë miell e zgjyrë djerse, kish lidhur veshët me një shami të trashë, të kuqe, kish marrë gunën. Në dimër, tërë gryka e lumit mbushej me mjegull të zbardhlyt, drurët ngarkoheshin me sinjak, korita lëshonte poshtë krongjij të bardhë, të ndritur. Kur frynte e binte, ne, vegjëlia e fshatit, rrinim brenda në shtëpi, po me t'u hapur koha mblidheshim zhgan e ia merrnim nga mulliri i Shkumbanores për të vënë ndonjë krazë për të zënë mëllenja, torozhanë, qypa, plevicore e verdhashë, se aty vinte shumë shpesëri, pas drite. Po aty lonim shpesh, nën koritë: u binim me stap krongjijve të akujve, që tringëllonin si zile e këmborë, gjersa thyheshin me krismë e binin bërlok. Kur mardhnim shumë, hynim brenda në mulli për të ngrohur duart e skura, të mpira. Xha Brahon e gjenim gjithnjë aty, pranë zjarrit, herë vetëm e herë me miq. Nuk na thosh kurrë fjalë të keqe, po pinte parreshtur duhan kërxfhall dhe hiqte ç'heq gjarpri ndënë gur, në dimër. Hiqte e vuan-te, po nuk epej: gjithnjë kroçkë e gdhe.

Buzë vere, kur sapo kishin lëngëzuar shëlgjishtet e rëmës, ndodhi një e pandodhur: u kthye Qamili nga Vllahia! Nënprefekti e kish mbajtur fjalën, kish shkruar atje ku duhej. Namëta, xha Brahua ynë u krekuar, u përtëri. Shtati i kërrusur sikur iu drejtua e mori rishtas të

përpetjën. Mëngët e çepkenes, që gjer atëherë i kishin ndenjtur të varura si ato degët e shëlgut të varreve, zunë të tunden përsëri si qëmoti, kur fluturonin breg më breg. Ne, djemurlia e fshatit, u bëmë befas të urtë e të shtruar, s'bënim më këmbë përtej mezhdës ku sundonte një zot i ri, i fortë. Ehe, kish ikur ajo kohë kur kishim qenë gjysmëzotër të asaj mënge të fshatit e kur bënim ç'të donim! Xha Brahua s'na e varte fare, s'na shihte. Shëlgu e gështenja ishin tërë lëng, po ai s'na ftonte më si kohërat e para që të na nxirrte glyra, pizga, bilbilë. S'kish nge për ne. Ishte i gëzuar. I shkëlqenin sytë. Ëndërronte ta martonte Qamilin, të hapte derë e shtëpi, ta bënte hasmin të pëlciste nga nakari.

Po ky gëzim i ndezur së voni, si ai dielli që del nganjëherë nga reja dhe shkrep përsëri, më të perënduar, nuk zgjati shumë. Fjalën e parë të keqe e dëgjuam në fshat: thoshin se Qamili s'kishte sjellë qese të madhe nga Vllahia e se mbase me qesen e plakut – ato pak para që kish mbledhur me kaq vuajtje, për pleqëri, për qefin e varrim. Qamili kish hapur fjalë se vallha ia kishin vjedhur paret udhës, po fshati, që ta këndon kartën në xhep, nuk i zinte besë. Thoshin se së shpejti Qamili do t'i jepte dërmën mallit e gjësë, do ta shiste e përshiste gjer ne pragu, e mbase edhe pragu.

Me të vërtetë, pas pak kohe dëgjuam se xha Brahos i ranë mbi krye andralla të reja, më të zeza sesa të vjetrat. Gjer ahëre kish vojtur, po kish pasur një gjë të madhe: shpresën. Tani s'kish asgjë... Sepse kurbeti e kish prishur fare Qamilin. Ky rrinte ditë e natë në ato kafet e unjtëra të qytetit dhe lonte kumar: hidhte e priste zaret. Dhe jo bosh «për sport» – siç kish dalë kjo fjalë atëherë – po «plot», me pare. Linte zaret e merrte kartat: lonte kupën, shtatë e gjysmën, tretënjënë e sa e sa lodra të tjera që ka namatisur mendja e ngeshme e njeriut. Herë-herë i binte edhe tavllës, sheshbeshit, dor-

xharit. Kish pasur një pallto e s'e kish më; kish pasur një palë këpucë me qafa e as këto s'i kish më. Pastaj një qyrk me qime, një shami aliskë nga ato të Stambollit, ca xhingla... Një ditë, ndonëse ish maj e mot i ngrohtë, Ikbal kumarxhiu, një djalosh i gjatë e i thatë, kish dalë sullacë nëpër qytet veshur me qyrkun e Qamilit, i mbathur me këpucët e Qamilit e me shaminë aliskë të Qamilit hedhur qafës. Dhe mbahej më të madh, se ia kish fituar në kumar. Fshati i dinte të gjitha. Qamili thosh se sapo t'i kthehej zari për të mirë, do t'ia mernte të gjitha prapë, do ta linte lakuriq. Po zari nuk i kthehej, sepse Ikbali dinte shumë marifete, kështu që Qamili në vend që të fitonte ato që kish humbur, humbiste të tjera. Fundi, mbeti rrip daulle, hyri borxh, u fundos thellë e më thellë. Xha Brahua kish pasur ca krerë bagëti, që ia kish dhënë një miku t'ia mbante në mal e t'ia shtonte. Qamili shkoi i mori, i zbriti, i shiti. Pastaj iu turr pulave e rosave të mullirit. I shiti edhe këto, humbi paret. Rrallë e tek, kur ndodhte t'i kthehej një çast zari (thoshin se Ikbal kumarxhiu e bënte këtë punë apostafat, që ta ëmbëlsonte, ta tërhiqte) e të fitonte gjësend, e bënte menjëherë fora: qeraste gjithë botën në mejhane e kthehej në fshat tezgane, xurxull, duke kënduar ndonjë këngë lapërdhare nga ato të Vllahisë. Pa shante, bërtiste – shuaje zot! Shpesh as nuk degdiste fare në shtëpi, po shembej e flinte hendeqeve e mend e çarfalitnin qentë e fshatit, se nuk e njihnin. Kështu, në pak muaj, qesja e plakut shterroi. Ashtu edhe bagëtia, shpesëria. Në selishtën e mullirit futi qetë dhe nisi ta lëronte fqinji. Ky kish shumë vjet që ia kish vënë synë e tani i kish ardhur dita: ia kish blerë Qamilit me vulën e xha Brahos. Qamili e gënjente plakun, thosh se do të bënte tregti e trimëri, do të merrte të dhjetat, do të fitonte. Një kohë hapi fjalën se priste t'i vinin pare nga kurbeti, atje ku i kish lënë që t'ia ruanin. Gjer atëherë shiti gështe-

njat, pastaj nisi t'i vinte vërdallë mullirit. Po aty gjeti sharra gozhdën. «Jo!» tha plakur dhe u mbajt.

Një ditë, tak rrinim urtë në lëndinën e mullirit e bisedonim me xha Brahon që gdhendte kot më kot ca drurë, dëgjuam zhgrap-zhgrup ca çape nëpër kalldrëm (i njohëm menjëherë: ishin çapet e Qamilit, që tani mbante opinga me gozhdë) dhe pas pak u duk ai, dora vetë në anën e sipërme të mullirit, midis shëlgjesh. Qëndroi një çast, shikoi i ngrysur, u koll thatë, pastaj shkuli një purtekë gardhi e u lëshua si ulk nëpër kalldrëmin e ngushtë të vragës, që zbriste në mulli. Ne kërcyem e u përndamë si një tufë rabeckash kur u sullet skifteri. U fshehëm ku mundëm: kush nëpër shëlgjishta, kush nëpër kulpra e nëpër shpendra. Zemra na rrihte, sepse e dinim se Qamili ishte i krisur nga kondaku. Po nuk largoheshim më tej. Rrinim aty, të tultur, pa zë, e prisnim gjersa të thyente zverkun. Qamili iu afrua plakut, me purtekë në dorë. Tani ish veshur vendçe: me befça shajaku, nga ato që kish gjetur në shtëpinë e shuar të t'et, të të vëllezërve. Ish djalë i pashëm, i gjatë, vetullzi, po ç'e do?

— Hë, baba plak, a të erdhën mendtë?

Ja kështu: as puna mbarë, as tunjatjeta, po «a të erdhën mendtë».

Xha Brahua ngriti kryet, e shikoi me ca sy si të për-lotur, pastaj i unji prapë e vazhdoi të gdhendë kot më kot, siç kish bërë tërë jetën.

— Baba plak, — i tha së dyti Qamili me zë më të kërcyer, — ty po të flas. Pse s'ma kthen?

Plaku gjithnjë çak-çuk, po ne e shihnim se i dridhej dora e druheshim se mos i binte me sqepar, padashur. Atëherë Qamili ia plasi:

— Fol, viran!

Xha Brahua lëshoi sqeparë, vuri dorën strehë mbi sy, e shikoi mirë e mirë të nipin.

– Ç'më shikon ashtu? Apo s'më njeh? S'më ke parë?

Ne, ndonëse të vegjël, kishim parë e kishim dëgjuar të flitej për shumë vrazhdësi në botë, po një gjë të tillë s'kishim parë e s'kishim dëgjuar. Gjer atëherë asnjeri s'kish guxuar t'i fliste kështu xha Brahos sonë.

– Ç'do, bre? – e pyeti xha Brahua.

– Ashtu, de! Goja të erdhi, po a të erdhë edhe mendtë? Në s'ma jep mullinë përfare, nëma ta vë bilbefa, të marr pare borxh, se po shiten të dhjetat. Këtë borxh do ta laj pas dy-tre muajsh.

Dhe ndërsa plaku po e shikonte i heshtur, Qamili shtoi:

– Të bëhet si të bëhet, malli është imi. Imi, e do ta marr edhe sikur ta bësh dhëmbin sa të kalit. Ti je me një këmbë në varr. Si nesër të vëmë në tabut, e hajt matanë! Nëm vulën me të mirë.

Kështu, Qamili zuri të rëndojë shumë e më shumë në fjalë. Atëhere xha Brahua ia ktheu:

– Dëgjo, o çun i Smailit të Brahos! Mullinë s'e jap sa të më regëtijë shpirti! Nuk e jap, ore! E kam mall nga babai e dua të vdes si zot malli. Të tjerat, sa kisha, t'i dhashë, se ishin të miat. I kisha blerë vetë, me djer-sën e ballit.

– Punë e madhe ç'paske blerë ti... Një shinik farë selishtë, një rrogoz vend. Bre, bre!...

– Një rrogoz vend, po e kisha blerë dhenë okë-okë, me punë ditë e natë, me të kursyer. Ngjitesha në gësh-tenjat, prisja bisqe, thurja kosha, ia shisja botës. Kam kursyer edhe kafshoren e gojës. Mullinë s'ta jap, jo!

Unji kryet, i lodhur – më shumë i pikëlluar sesa i lodhur – mblodhi disa bluashka, i hodhi tutje e ndenji i ngurosur.

– Ma nxive zemrën, o çun i Smail Brahos. Ma bëre purë, qymyr të zi...

Zëri i plakut dukej si i lagur me lot.

- Të prisja të më zbardhësh ditët në pleqëri, të të shoh në radhën e burrave, që të na kenë zili bota, po ti më nxive... Ik që këtu, në ke shpirt njeriu. Shporru!

Qamili rrinte më këmbë e e shikonte me qesëndi. Ne rrinim fshehur dhe shtrëngonim grushtet e njoma. Po ashtu siç ishim, të vegjël, ishim gati t'i merrnim krahun xha Brahos tonë, po qe se na thërriste, dhe na vinte keq se s'ishim të mëdhenj që ta shtronim në dru, kurbaçe, Qamilin e lig.

- Në ke shpirt njeriu, o djalë, hiq tu tje, - tha xha Brahua - S'dua të të shoh më. Më dhembin sytë.

Ne dolëm nga vendet ku ishim fshehur morëm ca gurë e dolëm në mezhde gati t'i biem Qamilit.

- U matufe, baba plak. U bëre fëmijë. Ja, si këta u bëre - dhe Qamili na tregoi me dorë, me qesëndi.

- Këta janë të vegjël e të dashur, siç kishe qenë ti njëherë e njëkohë. Kur shkove në kurbet, mora pare borxh që të të nis. Këtë borxh mezi e lava, me fajde mbi fajde. Ti s'ishe për kurbet, se këtu e kishe punën në vijë, po krise e ike, se ashtu të desh qejfi. Ndenje atje kaq vjet, sa u bëre rrozgë fare e më erdhe këtu të shesësh mallin e gjënë, të më mundosh në pleqëri. Turp, bre!

- U matufe, baba plak, u bëre si buf. Ama duhet ta dish: kjo kockë do ta marrë mullinë, - tha Qamili, i ra gjoksit me grusht dhe ktheu krahët e iku.

- Allah-allah! Sa gazep...

Zëri i xha Brahos sikur ish njomur me lot, po i mbante, i gëlltiste. Qante përbrenda. Ne s'kishim zemër ta turbullonim e rrinim ca çape më tej, të turpëruar. Xha Brahua ynë, që nuk i qe trembur asnjë krali nga ata që kishin shkëlur vendin tonë e që i kish duruar të gjitha të zezat - kaq vdekje në shtëpi! - tani ish pikë e vrer. Pas pak ngriti sytë, na pa e na shfryu:

- Hajt, ikni edhe ju! Të mos u shoh më! Sot jeni të mirë po nesër do të bëhi gazep, si ky emërharruari!

Ne u larguam kryeunjur, fajtorë, për një faj që s'e kishim bërë.

Kështu, tërë atë verë dhe vjeshtën e parë, xha Brahua e u bë urë e gur, hoqi, duroi, po nuk ia dha të nipit vulën e mullirit: as ta shesë, as ta vërë peng. Fundja, siç pat qenë e thënë, një ditë prej ditësh, plaku e mulliri i Shkumbanores u bashkuan përjetë e mot.

Kjo ndodhi në vjeshtën e dytë, kur mblidhen e shtrydhen retë. U err gryka, vetëtiu, gjëmoi sa u tundën mallet. Edhe kësaj here, ne, vegjëlia e fshatit, ndodhëm të jemi mysafirë të paftuar të xha Brahos sonë. Po ky s'na mbajti shumë në mulli. «Ikni, na tha, se tashi do të vijë lumi e do të teptisë në mulli!» Bëmë të futemi nëpër kulprat e shelgjishtat, po ai na thirri: «Jo, aty, djem, se do t'ju mbytë! Lart, mbi udhë!» Na erdhi të qeshnim: lumi kish vetëm një fije ujë, sa për rosat, e ai na thosh do të na mbytë... Mirëpo kësaj here zëri i xha Brahos ishte kaq urdhëronjës, kaq ndryshe nga i rëndomti, sa ne iu shtruam: e kapërcyem e zumë vend nën kumbullën e Zykos. Xha Brahua mori shatën e shkoi përjetë, zuri remën, e ktheu jazin në lumë. Ne u çuditëm e thamë: Ç'po bën kështu xha Brahua ynë? S'është në vetel» U kthye shpejt – i lagur e i baltosur – la shatën, mori dyfekun nga hatulla, e mbushi, e ngjeshi me harbi.

Namëta plasi një gjëmë e madhe, që na shurdhoi e na bëri të na ngrinte gjaku. Po vinte lumi: i egër, i verdhë, me kreshta shkumbe. Rrodhi ca çaste në shtratin e tij, pastaj u rrit e u ngrit lart e më lart, i vuri fshesën ledhit që ndante jazin, e sheshoi e iu turr mullirit. Xha Brahua shkrehu dyfekun. Kështu bënte ngahera kur vinte lumi, që ta tarakste, ta kthente. Krisma e shishes grykëgjatë ishte shumë e fortë, po kësaj here mezi u dëgjua, sepse buçima e ujit ishte edhe më e fortë. Xha Brahua e mbushi edhe një herë, e ngjeshi e

ia bëri prapë zhgëdau! Pastaj sërish e sërish. Ne kërcenim nga gazi e thërrisnim:

- Bjeri, xha Braho, bjeri!
- Bjeli, xa Bao! Bjeli lumit!

Xha Brahua mbushte e zbrazte dyfekun si në të ri: çarut, plumb, lecka, prapë plumb, vinte agzot... edhe çam! nuk kursente gjë. Si në luftë e më fort se në luftë. Kësaj here armiku ishte shumë i fortë: lumi vetë.

Po çado që i binte, ky rritej e hapej: i turbulluar, i sumbulluar. Vinte e sillte tatëpjetë gurë e drurë, lisa të tërë, që godisnin me tërbim muret e thata të mullirit. Nëpër kreshtat me shkumbë shihnim herë-herë kërcunj të mëdhenj e s'pushonim së thirruri:

- Bjeri, xha Braho!
- Bjeli, xa Bao!

Ça të hapësh e të mbyllësh sytë, lumi u ngrit disa pëllëmbë dhe po u binte fort e më fort mureve të mullirit. Shkreptiu, gjëmoi, nisi të bjerë shi e breshër. Zume kokën me dorë, u qullëm gjer në kockë, po nuk u larguam nga kumbulla e Zykos. Faqja e ujit u mbush plot dredhka të zbardhyta.

Po ç'është kjo? Xha Brahos nuk i ndezi më dyfeku. Ndofta i qe mbaruar baruti, ndofta i qe lagur agzoti, ndofta nuk i shkrepte stërralli. Hyri brenda në mulli. Atëherë u dëgjua një bubullimë e madhe. Kish batisur e ish shembur korita, se lumi kish gërryer e rrëmbyer të gjitha furkat që e mbanin. Ne thirrëm me llaftar, pothuaj me të qarë:

- O xha Braho, o xha Braho!...

Po zërat tanë të njomë s'ishin gjë përpara bubullimës së lumit; mezi i dëgjonim e vetë. Breshri pushoi, shiu vazhdoi.

- Një dele!
- Dy, tri, katër!

– Obobo, tufa e Qazimit!

Nga dera e hapur e mullirit teptisi gjyryk një lumë më vete. Ne e dinim se xha Brahua ishte i fortë e kish një jetë të tërë që e njihte lumin e tij, po prapë na hyri frika në zemër. Nja dy a tre s'duruan dot më tej: u këputën e ia morën tatëpjetë, udhës së madhe, me sytë plot lot, për të thirrur berihaj në fshat, se lumi po e mbytte xha Brahon. Ne të tjerët qëndruam në vend e bubutimë sa na hante zëri:

– O xhaaa Braaaho! Diil, o xhaaa Braaaho! Ooooh

Lumi na dukej si një sprijë nga ato të përrallave. Ai sillte me vete tërë malin, godiste themelet e mullirit. Tani uji hynte nga lart e dilte grykë nga dera. U afruan kaq shumë sa uji i turbullt na vinte gjer në gjunjë. Që aty ku ishim dëgjua disa herë kismën e shishanes së xha Brahos dhe na erdhi zemra në vend. Xha Brahua ynë luftonte. Xha Brahua ynë nuk epej.

– Bjeri, o xha Braho!

Po, pas një çasti e kthjem:

– Dil, o xha Braho!

Dhe qanim me lot. Atëherë ishim penduar për të gjitha të këqijat që i kishim bërë dikur të zot të mullirit dhe e kishim lidhur me besa-besë që të mos ia vilnim më kumbullat e aguridhet, të mos ia thyenim me gurë qeramidhet e myshkura, ta ndiqnim me gurë Qamil kurmarxhiun.

Dhe kur betoheshim kështu me vetveten u duk lart, në baxhë, gryka e dyfekut të xha Brahos, pastaj mëngorja, takija. Thirrëm:

– Dil, o xha Braho!

– Dil, o xa Bao!

Po gëzimi ynë s'e pati të gjatë. Shkulmi kish shkullur themelinë e mullirit. U dëgjua një gjëmë e madhe;

çatia lojti nga vendi dhe shkau poshtë, u shemb në valët e turbullta së bashku me xha Brahon tonë.

Ne u hodhëm përpjetë, përpoqëm duart me llahtar dhe morëm udhën e fshatit duke qarë e lebetitur:

– Obobo, xha Braho! O xha Brahol O xha Brahol

– Obobo, o xha Brahol...

Shkruar në Bukuresht, 1938
Ripunuar më 1965

Gjonomadhë e gжатollinj

Ju falem, o burra të mirë, që rrini e këndonj këtë kartë, Ju falem e ju marr dorën t'ju pyes një fjalë e dua të më ktheni përgjigje: keni parë a s'keni parë, ore, trima në botë? Ama ta dini: unë s'ju pyes për trima sidokudo, për kokëshkretë, nga ata që s'i merr as kandari, as kalemj, po për trima të vërtetë, për burra që hanë bukë veç.

«Kemi parë...» mund të hidhet e të thotë ndonjë që s'e ke marrë vesh mirë pyetkën time, që nuk e ka pleqëruar mirë punën e që ngutet tepër.

«Mirë, ta zëmë se keni parë apo ta zëmë se keni dëgjuar, po urdhëroni e më thoni — me fjalë burri e jo me dëngla e me dangra-dangra, nga ato që të gërvishtin veshin: a kanë qenë këta tuajt më trima se sa ata të derës së Gjonomadhëve nga Shëmërtia e Sipërme?»

Ja, tani më duket se zutë ta merrni vesh pyetkën time: po ju shoh se qysh shtypi e përshtypi, vrisni mendjen, varni vetullat e nuk më jepni dot përgjigje. Pa në doni të dini të vërtetën, ju them se vrisni mendjen e varni vetullat kot më kot. Unë, ore, ju flas me të drejtën e zotit, me dorë në zemër, se ja, u thinja e sot jam nesër s'jam, e s'dua të shkoj matanë me një gur mulliri varur në qafë. Se kështu është gënjeshtria: gur mulliri varur në qafë. Për njatë qiell të lehtë, që na fal, e për këtë dhe të rëndë,

që na mban, s'di të ketë pasur ndonjëherë trima më të fortë se sa ata të derës së Gjonomadhit! Meshkujt e kësaj dera kanë qenë njëherë e njëkohë veç botës, jo vetëm për punë shpate e punë hute, që i punonin si punon bulku parmendën e muratori çekanë e mistrinë, po edhe për mendjen e ndritur e për zemrën flori që kanë pasur të gjithë, ashtu siç i ka hije burrit të vërtetë. Ata s'e kishin vënë kurrë vdekjen në kandar, s'i qenë drojtur kurrë. Gjonomadhët e kishin trimërinë, si t'ju them unë i mjeri, gjëkafshë që nuk veçohet dot nga burri, sindozot se nuk veçohet mishi nga thoi. E kishin, them, të tyren, siç e ka zogu erën e peshku ujin.

Në s'ju vjen të besoni e druhi të ma thoni, urdhëroni e dëgjoni dy fjalë: në Shëmërtinë e Sipërme e në gjithë fshatrat përfaqark nuk mbahet mend brez pas brezi që ndonjë burrë nga dera e Gjonomadhëve të ketë vdekur dalngadalë, në pleqëri, kur s'i mund më këmba e dora, kur i soset vaji i kandilit.

Jo, more, jo!

Meshkujt e Gjonomadhëve kanë rrojtur, që të gjithë, sa kohë u ka regëtirë shpirti, më këmbë e jo më gju-një, me shpatë në dorë dhe kanë vdekur gjithë me vdekje burri: plumb e shpatë, që është vdekja më e shkurtër e më e ëmbël nga të gjitha. Po, besa, burra të fortë kanë qenë!

Ja, ejani të ngjitemi bashkë në remën e kohës, ku rrjedh pa pushim uji i jetës e i njerëzimit – se edhe ne ujë jemi e si uji shkojmë në këtë botë – e keni për të parë me sytë tuaj dëmet e kësaj dera bujëmadhe.

S'di sa breza më parë, një Pjetër Gjonomadhi ka luftuar sa ka luftuar këtej, i ka mundur kundërshtarët e pastaj, meqë s'kish me kë të luftonte, është ngritur e hedhur kaluar, tutje, në Frëngji, me katër djem si katër lisa mali e me njëqind e sa huta të tjerë, më të shumtit nipëri e farefis. Atje, në Frëngji Pjetër Gjonomadhi

me shokë, veshur me fustane të bardha, me tirq të bardhë e me kapa të bardha në kokë, me shpatë të ndritur në dorë, ka çuditur tërë botën me trimëritë që ka punuar nëpër luftëra të mëdha e të vogla. Këto gjëra i ka parë vetë me sytë e tij mbreti i Frëngjisë. I ka parë e ka mbetur gojëhapur. E si ka mbaruar lufta, ka thirrur pranë e pranë Pjetrin me shokë, i ka përçafuar, u ka dhënë nga një shpatë të artë, nga një qese me florinj për shoq e nga dhjetë qese bashkë për çdo flamur që i kishin shkukur nga dora armikut në luftë e sipër. Po më shumë nga të gjithë e ka lëvduar e shpërblyer zotin Pjetër, që ishte koka e të gjithëve. E kur është kthyer në Shëmërtinë e Sipërme, me lavd e pre, shumë kohë bota i ka thënë Pjetër Frëngu. Më vonë Frëngjia ka ndezur luftëra të tjera, është gjendur ngushtë dhe ka dërguar e ka thirrur Pjetrin me shokë të vejë e të luftojë. Ky ka shkuar, ka trimëruar e nuk është kthyer më. Them nuk është kthyer, po ka lënë nam të madh në botë.

Disa Gjonomadhtë të tjerë, që kanë pasur në krye Gjini Gjonomadhini, janë hedhur s'di se kur në mbretërinë fusharake të Maxharit e kanë luftuar për mbretin e atij vendi kundër mbretit të Tataristanit, kokërruarit që vinte kaluar, rrëke-rrëke, me jatagan në dorë, që vriste e digjte, rrëmbente gra e fëmijë e i hiqte tutje. Ky, Gjini Gjonomadhi me shokë, ia ka prerë hovin Tataristanit, ka luftuar si burrë e ka shpëtuar nga mortja shumë gra e fëmijë. Prandaj mbreti i Maxharistanit ia ka shpërblyer nderin me nder dhe e ka mbajtur andej, në bukë të madhe. Shumë Gjonomadhtë të tjerë – një Pal, një Gjon, një Pjetër (të tjerëve nuk ua mbaj mend emrat) kanë luftuar për Vojvodën e Vllahisë së Sipërme e për atë të Vllahisë së Poshtme, që ishin nga gjaku ynë, dhe këta i kanë ngritur në shkallë të lartë e i kanë mbajtur andej që t'i kenë dorë të djathtë kundër atyre që deshin t'u mihnin varrin. Një Gjonomadh – s'di si i thoshin: Gjergj

c Kostandin – ka shkuar me nipër e shokë gjer tutje në Axhemistan e ka luftuar për mbretin e Stambollit. Edhe ky, kur ka dëgjuar për trimëritë që ka bërë, është ngritur më këmbë, ka përpjekur duart e ka thënë: «U lumtë burrave të dheut!»

Në s'i keni dëgjuar këto e shumë të tjera të kësaj dore, që janë shumë të lashta, patjetër besoj se ia keni dëgjuar emrin Selfo Gjonomadhit e këngën që ia ka kënduar bota dy a tre breza njeriu. Ky, Selfo Gjonomadh, ka luftuar me manxhura e me shpatë në dorë brenda në Misir me ata felahët këmishëgjatë. Atje, në Misir, ka lënë edhe eshtrat e tij, që iu zbardhën e iu tretën në rërën e valë. Njashtu duhet të keni dëgjuar për Upe Xhufkëmadhe e për Bido Shëmërtinë, që kanë nderur xheng të madh edhe e kanë tundur tërë Rumelinë, për Myrto Nishanllinë, që e kish një të shtënë e dy të vrarë, për Selfo Mustaqemadhë e për shumë burra të tjerë nga dera e Gjonomadhit, që kanë lënë nam në Janinë, në Allasonë e në gjithë mbretërinë e madhe të Turkut. Në çdo vend ku ka plasur luftë e zjarr, Gjonomadhët janë hedhur në krye të burrave, herë vetëm me shpatë, herë me karajfile e manxhura, me shishane, shishopo, me dogra e martinë, me pisqollë e s'di çfarë armë; nuk i janë drojtur vdekjes.

«E pse s'janë shkruar në kartë gjithë këto trimëri?» do të hidhet të pyesë ndonjë shkollar nga ata të rinjtë, që e kanë mendjen vetëm nëpër kartëra, nëpër divitë e kalemë kallmri.

E kush t'i shkruante, o djalosh i mirë? Në atë kohë në vendin tonë njeriu nuk lindte e nuk rronte me kartë, divit a kalem kallmri, po me shpatë e me hutë. Se po të paskeshim pasur edhe njerëz të atillë, ne do të kishim sot një kartë të madhe sa fusha e Domuzovës!) –

1. Është fjala për fushën e Domosdovës

që në Urakë e gjer në Rrajcë e që aty gjer poshtë në Përrenjë e në Lëngajcë, të mbushur dinga me rrëfimet e trimërive të burrave tanë.

Po, vaj e vaj, të gjithë këta trima të ndjerë e derdhën gjakun e tyre për botën, për të tjerët, ca me njërin e ca me tjetrin, bjeri t'i biem e tym më tym, trimëri për trimëri... Ja, kjo ka qenë e keqja jonë... S'doli një burrë që të thotë: «Dale, ore, ku po shkoni kështu? Mblidhni mendjen e mbani dorën, mos u vrini për të huajin.» Nuk doli e shkoi e vate...

E kështu, o të mirë që rri e këndon këto kartë, më falni se preva fjalën, për nam e trimëri ndër të huajt, u shkallmua e u blua ajo dera e ndjerë e Gjonomadhëve të Shëmërtisë së Sipërme.

Sa u dilte pushi faqeve e sa e ndienin veten burrë, meshkujt e kësaj dera martoheshin, që të linin prapa ndonjë hutë për t'u zënë vendin e pastaj, pas dy a tri vjet, merrnin dyfeqet, ngjeshnin pisqollat e jataganët dhe i binin kryq e tërthor mbretërisë, nëpër luftëra, apo hidheshin nëpër mbretëri të tjera. I ndillte, bre, kjo e uruar vdekje në vende të largëta, me shpatë në dorë, sikur të paskej qenë mjaltë, jo vdekje.

Po sado shumë trima që kanë hequr e bluar vendet e largëta, prapëseprapë më shumë ka ngrënë gjaku që ka pasur dera e Gjonomadhëve të Shëmërtisë së Sipërme me derën e Gjatollinje të Shëmërtisë së Rëposhme. Gjaku u ndez, s'di se si e s'di se kur, për një çupë edhe pastaj, bjeri t'i biem, vrini të vritemi, mbajti shumë brëza, gjersa Gjonomadhët e Gjatollinjtë iu afruan buzës së varrit e mend iu shua fara të dy palëve. Sepse e vërteta është e vërtetë: as Gjatollinjtë nuk binin më poshtë nga trimëria. Derë më e re, afër menç, po më e shtuar sesa ajo e Gjonomadhëve. Po t'i merrje kokë për kokë binin nëntë me një. Mirëpo Gjonomadhët

kishin nam të madh e shumë miqësira, se ishin derë e vjetër, kështu që kandari vinte pothuaj pat e pat.

Ehej, o të mirë, të paskeshit qenë atyre maleve të larta e të paskeshit parë kur ndizej dyfeku midis Gjonomadëve e Gjatollinjve! Dilnin gjithë këta burra – me vëllezër e djem, me nipër e stërnipër, me miq e miq të miqve, me nunëri e krushqi, me të afërm e të largët, që i kishin ngrënë bukën e kripën njëri-tjetrit, e sa të tjerë – dilnin, them, gjithë këta burra me armë në dorë e zinin majat e shkrepat, qafat e grykat, kronjtë e përrenjtë e ia lëshonin shoqi-shoqit flakën mes për mes; vriteshin, priteshin. Gjëmonte gjithë vendi nga krismat e dyfaqeve grykëgjatë, mjegullohej nga tymi i barutit, që nuk e kursente as njëra palë, as tjetra. E nuk shtinin kot së koti, në erë, po në mish të gjallë, vetëm në mish të gjallë. Edhe sa shpejt i mbushnin dyfeqet me barut e plumb, sa shpejt i ngjishnin, zhap e zhap, me harbi, sa shpejt e vinin agzotin atje ku duhej, sa shpejt e merrnin shenjën dhe e shkrehnin dyfekun! Nuk hanin e nuk pinin, nuk mbështeteshin në ndonjë gur a dru për të marrë një sy gjumë, po vetëm luftonin. Shpesh, ditën apo natën, njëra palë përpiquej të kaptonte ndonjë kreshtë a ndonjë qafë mali e t'i dilte krahut palës tjetër. Dhe atëherë – hej, hej! – sa njerëz mbeteshin të nderë, pa shpirt, gërxeve e brinjëve, sepse dyfeku s'bën shaka: vret.

Po fundja, burrat mërziteshin së luftuari me dyfekë të gjatë, larg e larg, e me pisqolla, afër e afër. Edhe, papritur, dilte ndonjë e thërriste me të madhe: «Heeej, dëgjoni! Kush i thotë vetes burrë, le të dalë këtu, në shesh të burrave, që të pritemi me shpatë!» «Këtu më ke!» – ia kthente tjetri, që matanë. Aty për aty linin pritat e dilnin këta burra fustanëbardhë, me shpatë në dorë, bënë përpara, afroheshin e luftonin vetë për vetë, në sytë e të dy palëve, gjersa njëri apo të dy shembeshin poshtë të mbytur në gjak. Pastaj bënë përpara dy nga dy, tre

nga tre, pesë nga pesë e pritëshin shoq me shoq, kurse të tjerët rrinin e shikonin, u jepnin zemër me fjalë njezve të tyre.

Lufta e gjaku s'mbante pak, po javë e muaj të tërë, hop këtu e hop përtej, mal më mal e breg më breg, kur njëra anë më e fortë e kur tjetra. Atëherë mbylleshin gjithë udhët e gjithë shtigjet. Ata që s'merrnin anë as nga njëra palë e as nga tjetra rrinin brenda në shtëpi, që të mos i zinte ndonjë plumb i ftohtë. Karvanët e nisur ndërronin udhën a ktheheshin prapë; ujqit e arrinjte tulitëshin nëpër shtrofka.

Luftë, kjo!

Luftonte Gjonmadhi me Gjatollinë, si mbret me mbret.

Edhe mbushëj vendi me të vrrarë të pakallur në varr e me të plagosur. Të plagosurit vuanin shumë, se u ftoheshin plagët, po nuk rënkonin që të mos gëzohej armiku e të mos i thyhej zemra mikut. Ata që shkonin t'i ngrinin mbetëshin shtrirë në vend. E sa më shumë zgjatte lufta, aq më fort ndizej gjaku e mëria, aq më shumë shtoheshin të vrrarët brinjëve, gërxheve, shkrepave, sepse burrat hidheshin si të verbër në krahët e vdekjes.

E kur shikonte kaq burra të nderë pa frymë, hynte në mes ndonjë shpirtmirë, i paanë, sidomos Rushan aga Muzaka apo Hodo Selmani, ose që të dy bashkë, mudoheshin të platitnin gjakrat, me fjalë të buta, edhe e ujdinun punën që të pushonte huta e shpata ca ditë, ca javë, a ca muaj, gjersa të kalleshin të vrrarët në varr, të hiqeshin të plagosurit, të lidheshin e të shëroheshin plagët, të mblidhej bereqeti e të nxirrej gjëja e gjallë në kullotë a të vozitnin udhëtarët nga një anë tek tjetra. Po kur nuk e prisje, si ajo rrufeja në të kthjellët, plaste prapë xhengu, buçisnin grykat, tymosnin shkrepat e hapehin varre të reja.

Mirëpo qëllonte që në meş të zjarrit e të luftës vinte ndonjë tabor i madh i turkut, që donte të çante udhë e

të shkonte tutje, në punë të tij. Atëherë kumandari – mylazim, miralla, pasha a s'di çfarë – u dërgonte urdhër të dy palëve: – «Ore, shuani zjarrin, hapni udhë të shkoje pastaj bëni ç'të doni, vrituni gjersa të shuhi të gjithë!» Fjala ishte aq e vrazhdë, sa që të dy palët – Gjonomadhe e Gjatollinj – merreshin vesh fët e fët njëri-tjetrin, me të fërshëlyer e të thirrur a me lajmës, pushonin luftën midis tyre, bashkoheshin e zinin vend krah për krah, ia kthenin hutën turkut: e gërmonin, e shuanin, i merrnin armët. Pastaj e nisnin prapë, shoq me shoq...

E, që ta dini sa e madhe ishte mëria, duhet ta dini se qëllonte që të dy palët ta ndiqnin njëri-tjetrin, me luftë, gjer tutje në Grekëri, në Rumeli e s'di se ku, edhe atje vriteshin e priteshin si deshin vetë e sa deshin vetë e s'guxonte njeri t'u mbante dorën.

Po gjëra të këtilla qëllonin vetëm rrallë e tek, sepse, kur gjendeshin larg vendit, sikush shikonte punën e vet e nuk e ngiste hasmin. Bile, kish ndodhur rasti që ta ndihnin shoqi-shoqin në luftë me të huajin. Kështu, rrëfejnë se ai Selfo Mustaqeziu, që zumë në gojë aty më parë, me tetëdhjetë e ca huta, është hedhur e i ka marrë krahun Nure Gjatolliut, të cilin e kish qarkuar armiku në atë Grekëri të shkretë e e mbante si në kllapë, pa bukë, pa ujë. I mori krahun, e theu të huajin dhe e çlirroi Gjatollinë nga çarku i vdekjes.

«O Selfo, i thanë ca burra, ç'pate që i dole zot hasmit? Ti je në gjak me derën e Gjatollinjve.» «Ke të drejtë: unë jam në gjak me atë derë, po nuk dua t'i ha hakën. Hasmi im është trim, burrë. Prandaj nuk desha që t'i vejë fir trimëria për bukë e ujë, në dhé të huaj. Ne vritemi shog me shoq, se ashtu na ka vajtur filli, po s'duam të na vrasë i huaji. Ja, kështu! Në dhe të huaj s'jemi më hasmë, po vëllezër, se flasim një gjuhë.»

Edhe atje tej, në Grekëri, gjatollinj e Gjonomadhe bashkë, me Nuren e Selfos në krye, duke shkelur mbi ku-

fomat e armikut të thyer, u pushtuan e u puthën si vëllezër, hëngrën e pinë bashkë dhe e lidhën besën që të harrojnë të shkuarat e të shuajnë gërnjën e vjetër. Kjo lidhje mbajti njëzet e ca vjet. Të dy fiset iu vunë punës, rritën kopera të reja, mbushën hambaret me drithë, ndër-tuan shtëpi të reja, u shtuan e u forcuan, gjersa mbyllën sytë krerët e pastaj, s'di se qysh e s'di përse (thonë se në këtë punë ka pasur gisht valiu i Manastirit, që ua shtiu ujët nën rrogoz), plasi përsëri dyfeku, më fort se qëmoti, u bë urgji e madhe.

Gjak sot gjak nesër, varr sot varr nesër, ja, së fundi, erdhi çasti i lig e nuk mbeti nga dera e Gjonomadhëve veçse një mashkull, po edhe ky ishte djalë i ri, i njomë. I thoshin Sefedin, ish tetëmbëdhjetë vjeç, mbante dy nuse (se desh të bënte djema që të linte huta prapa) e nuk i trembej syri as nga mbreti as nga hasmi. Gisht e syri i tij bënin çudira, se e kish trashëgim nga gjyshstërgjyshi të shtënte një e të vriste dy. Edhe kur Gjatollinjtë hidhnin rromuze poshtë e lart, duke thënë se i kish edhe buzët me qumësht e nuk mund të matej me ta, Sefedini dërgoi nia katër a pesë në botën tjetër, që t'i bënte të fala babait e betohej se nuk do të shkelte të njëzetat përpara se t'i shuante gjithë Gjatollinjtë. Po as këta s'flinin: e ndiqnin këmba-këmbës e nuk e shtinin dot në çark, se ishte finok i madh, syshqiponjë, këmbëlehtë. Ata e qarqonin, ai u dilte prapa krahëve e ua shkrepse; ata i ngrinin pritë në shteg, ai u dilte tutje, në një shkrep, e aë atje: zhgëdau! me martinë, i bënte kopan. Të nuhaturit e kish më të fortë se të langoit; vendin e dinte me pëllëmbë. Binte në dyfek, vriste, plagoste e hiqej shpejt, ku nuk ta priste mendja. Njëherë u bë si i vrarë, nën gunë. Ata të tjerët ia bënë gunën shoshë, me plumba, pastaj iu afruan ngadalë, dhe, kur s'e prisnin, Sefedini ua shkrep i që prapa një lisi të shembur, i griu. Dy herë e vunë në kllapë, po mbetën nderë lëndinave,

si lëvere, gjersa erdhën i ngritën shokët, me trira, pa armë. Çuditej një botë e tërë: ç'njeri paska qenë ky? Sefedini e linte të çuditej e shikonte punën. Për një shterpar që i vranë, nga inati, sepse thoshin që kish qenë kallauz, vrau dy të parë nga dera e Gjatollinjve, dy desh me këmborë, siç u thosh bota. Ndajnata e zinte në shtëpi, mëngjesi në qafë të malit; dreka në stan të pëllejave, darka mbi luadhet e Gjatollinjve, mun pranë shtëpisë. «Ky është nishan! – thoshin njerëzit. – Ecën e s'i dëgjohet çapi, shkel e s'lë gjurmë. E kur nuk e pret, të del në brinjë.» Atëherë Gjatollinjët e ndryshuan tropon: u shpërndanë në të katër anët: po s'e zumë këtu, do ta zëmë andej, se s'ka se si të bëhet zog me krahë. Atë desh edhe Sefedini: të përhapeshin të holloheshin, që t'i grinte një nga një. Mirëpo miqësia thosh ndryshe: shtamba shkon shumë herë për ujë gjersa thyhet. Vanë i thanë Sefedinit që të mbyllej brenda ca kohë, gjersa t'i lindte ndonjë mashkull. Sefedini dëgjoi, tha «peqe» e bëri sikur u mbyll në shtëpi, prapa mazgajve. Tha dhe e hapi fjalën anembanë, që ta mernte vesh edhe hasmi. Ky besoi e s'besoi dhe, me të besuar e pa të besuar, e humbi toruan. Këtë desh Sefedini dhe i ra ku s'e priste.

E ja një ditë – në pranverë, kur sapo kish lëshuar fletë lisi – ranë ca dyfeqe lart, mbi fshat.

Pesë Gjatollinj, të gjithë burra të regjur, me mustaqe të gjata, kishin ndezur luftë me Sefedin Gjonomadhë ne Guri i Pjetërkalit. Ata pesë, ky fill i vetëm. Gjatollinjët kishin zënë pusi edhe, siç e dini, pusia të vret, sado i fortë qofsh. Që në batare të parë, Sefedini mori dy plagë: një në lje e një më lart, në brinjë, dhe u ul poshtë. Gjatollinjët thanë se ishte vrarë e u turrën, yrrja! t'i marrin armët. Mirëpo Gjonomadhët s'janë nga ata që i lëshojnë armët me një e dy, sa kohë që u regëtin shpirti, se edhe të plagosur dinë, ta punojnë dyfekun. Punoi e punoi ky dyfeku i Sefedinit, gjersa tre Gjatollinj mbetën

shtrirë në rrah, sa të gjatë të gjerë. Lufta shkoi më tej, dy me një. Dhe ja, Sefedini ia futi njërit Gjatolli plumbin në grykë të dyfekut, ia vulosi. Mbetën tani vetëm dy dyfeqe që punonin e i përgjigjeshin njëri-tjetrit: një dyfek Gjonomadhi e një dyfek Gjatolliu.

– Dil sheshit, në je burrë! – i thirri Sefedinit ai Gjatolliu me dyfek të vulosur e u ngrit më këmbë me gjashtore në dorë. – Dil sheshit ta bëjmë flakë më flakë!

Burrë burrë, po edhe plagët plagë... Dhembin, të shkretat, rrjedhin gjak. Sefedini i harroi plagët e bëri të ngrihet, po në atë çast i ranë dy plumba, që e muar mes për mes: një plumb martine e një plumb gjashtoreje.

Ra i vdekur.

Kur dëgjoji bota, përpoqi duart me gjëmë e tha: «Medet, u mbyll dera e Gjonomadhit!»

Trim o Sefedin, ç'e ka qarë e vajtuar gjyshja, ditën e parë! Vetëm të parën, jo të dytën e të tretën. Se, duke ndenjtur e mekur, leshlëshuar, me kokën në ashmak të vatrës, iu shti si në ëndërr – ama ëndërr nga ato me sy hapur – Sefedini vetë me katër plagë me gjak të mpiksur. I tha: «Erdha të të marr dorën, zonja gjyshe. Të të marr dorën e të të falem. Gjakun tim e kam marrë vetë: kam vrrarë dhjetë e kam plagosur tre. Mos më qani, se kur më qani, muaj më dhembin plagët...» Si tha kështu, Sefedini u ul, i mori dorën e djathtë, e puthi me buzë, e ngriti në ballë. «Nurija, tha, do të lindë një djalë. Këtij djali do t'i vinin emrin tim. Si të rritet, i thoni të dalë lart, ne Guri i Pjetërkalit, të luftojë e t'ia marrë hasmit dyfekun tim, se më vjen rëndë nga shokët që kam këtu: të gjithë e dinë se dyfekun tim e mban Selman Gjatolliu.»

Atëherë hanko Dudia kërceu më këmbë e u bëri emër nuseve të pushonin gjëmën e vajin:

– Dhjetë burra shtriu përdhe një djalë i ri, Sefedini, zogu i malit. Gjakun do t'ia marrë i biri. Që sot s'ka më zi e vaj në shtëpinë tonë.

Nuk shkuan as tre muaj, ndërsa Gjatollinjte vozitnin pa drojtje mes për mes Shëmërtisë së Sipërme, tundu e shkundu, me armët e Sefedinit në krah e në brez, brenda në shtëpinë e vjetër të Gjonomadhit shkrepri një shkëndijë e re: lindi një foshnjë.

– Gurl – thirri zonja e madhe, që e priti stërnipin në pëqi.

– Gur, na ruat! – thirri nusja e parë, që kish dy çupa dhe vetë ishte në të shtatat.

– Gur..., – murmuriti lehonë me zë të qarë. – Gur, shpirt i nënës, e s'ka kush të zbrazë një dyfek, që ta dijë gjithë fshati se na u ndez prapë zjarri në vatër.

– Hesht, nuse bijë, mos qaj, se dyfekun e zbraz unë vetë për djalin! – thirri zonja e madhe; e mbështolli foshnjën në pelena, ia ta në pëqi nuses së parë, rrëmbëu një dyfek të mbushur, nga ata që ishin varur në peronat, e nxori grykën në mazgalla edhe e zbrazti dang e dang, tri herë.

U gëzua gjithë miqësia, afër e larg.

Djalit i vunë emrin e t'et: Sefedin.

Zonja e madhe, stërgjyshja, harroi sëmundjet e pleqërinë, u krekua, u përtëri si menjolla, ngriti kokën lart, si qëmoti. Natën e të tretave vuri djepin në këndin e djathtë, të burrave, e qerthulloi me degë lisi të njomë, i vuri një dyfek në krye, një pisqollë, një shpatë, vezme.

– Burrë u bëfsh, trim u bëfsh e gjakun mos e harrosh kurrë!

Që kur ish foshnjë, Sefedin Sefedini prekte me gish-tërinjtë e tij të njomë llozin e ftohtë të dyfekut, e përkëdhelte. Në motin e gjashtë, kur e kish edhe kraharrin plot me rypa argjendi njëri mbi tjetrin, si ato luspat e peshkut, zbrazti dyfekun e parë nga dritarja. Ky dyfek s'ishte as karajfile, as manxhura, as martinë e as dogra, po manxer tringo i ri, që merite brenda një krehër me pesë fishekë. Manxeri ishte i shtrenjtë – njëzet

lira flori njëra mbi tjetrën. Edhe fishekët ishin të shtrenjtë. Po zonja e madhe nuk kursente asgjë: e mësonte Sefedinin të merrte në shenjë. Ajo mbush, ai zbraz; ajo mbush përsëri, ai zbraz përsëri, gjersa dora nuk i dridhej fare e syri nuk gabonte. Fluturonte lart petriti, laraska a korbi e plaka thosh:

– Bir, ja një Gjatolli!

Dhe pa mbaruar mirë fjalën, «Gjatolliu» këputej e binte poshtë, sikur e thëthinte gremina.

Herë zonja e madhe, herë nëna e herë gjithë Shëmërtia këndonin trimëritë e Gjonomadheve; Sefedini i dëgjonte i menduar, i vrenjtur. A dinte vallë se ai ishte Gjonomadh i fundit i gjithë këtyre brezave bujëmëdha? Domosdo e dinte. Ky ishte ushqimi i përditshëm që merrte shpirti i tij.

Zonja e madhe priste të rritej edhe ca, të martonte edhe pastaj, pas martesë, ta niste që t'ia bënte fora luftës me Gjatollinjë. Sepse zonja e madhe ngulte këmbë e nuk donte të ndahej nga kjo botë para se ta naopte shpirtin: të dëgjonte se stërnipi kish lidhur fillin e letës së tij me atë të gjyshstërgjyshëve, se kish marrë ajakun, se armiku kalbej në varr' e se shtëpia e këtij ishte veshur në zi. Po e para nga të parat: martesë.

Kështu donte zonja e madhe, po puna doli ndryshe.

Një ndajnatë, aty nga zemra, ranë ca dyfeqe lart mbi fshat ne Guri i Pjetërkalit. Bile, njerëzit i njohën pas krismës:

«Ky është manxeri i Sefedinit! Ndofta gjuan ndo një egërsirë.»

Po nuk ish egërsirë, sepse pas pak u dëgjua një dogra.

«Kjo është dograja e Sefedin Gjonomadhut që e mban Selman Gjatolliu. Po pse s'përgjigjet maliheri i Nures? Nurja e Selmani s'ndaheshin kurrë.»

Mbajtën vesh e pritën. Krisi përsëri tri a katër herë

rresht manxeri i Sefedinit. Dograja s'u përgjigj më. Hesh-tjë. Nuk shkoi shumë – ja, sa të dredhësh e të pish një cigare duhan – dhe zbardhi në ata gurë të zinj fustan-nia e Sefedin Sefedinit. Zbardhi, zbriti e shkoi mes për mes Shëmërtisë së Sipërme me tre dyfekë: dy krahut e një në dorë, me tre kollanë fishekë të ngjeshur kryq e tërthor, me tri kobure në silahe. Kaq? Jo. Sefedin Sefe-dini mbante varur në kraharor edhe tre qostekë argjen-di, me pafta të mëdha, si mburoja. Njëri ishte i tij, tje-tri ishte i t'et, që ia kishte marrë Nure Gjatolliut dhe i treti ishte i Selmanit. E panë me sytë e tyre të gjithë ata që ishin mbledhur e rrinin për fjalë e kuvend në hajat të xhamisë. E panë, i kthyen tunjatjetën e thanë me vefe:

«Vajti haka ne i zoti. Gjonomadhi Gjonomadh mbe-tet.»

«Dardha nën dardhë bie.»

«I lumtë njajo dorë!»

Edhe ku u ngjit bota lart, ne Guri i Pjetërkalit, gjeti Nure Gjatollinë të vrarë në gjithë atë vend që ku e kishin ngritur katërmbëdhjetë vjet më parë Sefedin Gjono-madhë, t'anë e Sefedin Sefedinit. Pakëz më tej ish shtri-rë Selman Gjatolliu me një plumb në ballë.

«Hajde, dorë Gjonomadhi, hajde!»

«Mënon, duron, po s'harron...»

Pa kur ma pa zonja e madhe dogranë e të nipit, të Sefedinit, ma mori në krahë, ma puthi, sikur të paskej puthur të nipin e ma lau me lot, ma fshiu me cullufet e bardha të kokës. Me cullufet, ore, ore! Se katërmbëdhje-të vjet kish pritur ajo të merrte prapë dyfekun e të birt të të birt! Katërmbëdhjetë vjet në hi të vatrës, kryeu-njur, pa gëzime. E shponin në zemër, si tryelë, gozhdat e opingave të Gjatollinjve, që shkonin e vinin aty, mbi udhë, me armët e Sefedinit në sup.

Priti shumë, po nuk priti kot.

Ja, stërnipi ia shkuli gozhdën nga zemra: vrau kre-
rët e fisit të Gjatollinje.

U gëzua gjithë miqësia anembanë, afër e larg.

Me t'u platitur vala e parë e gëzimit, stërgjyshja i
tha:

– Bir, zgjidh e merr një nuse a dy, cilat të të dojë
zemra, se dua të bëjmë dasma. Në s'do të zgjedhësh
vetë, lërmë mua të të zgjedh.

– Të puth këmbë e dorë, nënë e madhe: martesën
ta lëmë për më tutje. Gjer tani s'më ka pjekur ylli
me asnjë.

Zonja e madhe u pikëllua:

– Në s'do martesë, mbyllu brenda, se ata emër-
shuarit duan të të vrasin. T'i kanë zënë të gjitha pusitë.
Ca të tjerë vijnë vërdallë.

Sefedini qeshi:

– A ke parë, zonjë e madhe, mashkull Gjonmadhi
të mbyllet brenda, si gratë?

Zonja e madhe u zu ngushtë.

– Jo, bir, s'kam parë. Po atëherë si do t'ia bëjmë.
Mos dhëntë! Sipërmi të na shuhet kandili, që mezi
na u ndez! Plumbi shpon mish të gjallë...

Plaka ra në të thella: e hodhi e priti me mendje,
dha e mori natën e ditën, pastaj tha:

– Sefedin, bir: ti je mashkulli i vetëm i derës – u
shtofsh e u bëfsh njëqind oxhakë! Në s'do të martohesh
e as të mbyllesh brenda, merr dyfekun e ndonjë
shok të besës e shko larg, në Gegëri. Atje dera jonë
ka shumë miq. Pas motmoti, jo më vonë, kthehu të bëj-
më dy a tri dasma njëren pas tjetres. Nuset ja zgjidhi
vetë, ja t'i zgjedh unë.

Sefedin Sefedini i mori dorën zonjës së madhe, i
mori dorën nënës e shemrës së kësaj, që e donte si sytë
e ballit, puthi motrat e u nis pa lindur dielli. Jashtë
e pristë një shok i besës, mik me kokë i derës së Gjo-

nomadhëve. Dy të tjerë, që kishin qeruar udhën, prisnin më tutje. Fërshëlljen, morën përgjigje, u nisën. Vetëm katër veta. Sefedini nuk ktheu kokën që të shikonte shtëpinë që mbeti prapa majë një magulli. Nuk e ktheu, sepse i dhimbsej shumë. Dhe shperëtiu. Përse? lu kujtua se në kohërat e para Gjonomadhët dilnin nëpër botë me njëqind e ca dyfeqe...

... Andej, në Gegëri, miqtë dhe miqtë e miqve e pritën kudo krahëhapur. Mirëpo koha ishte shumë e turbullt. Ziente dyfeku në të katër anët. Si mund të rrinte duar-krig në mes të kësaj bote, ai, djalë i njomë, po zemërfortë, që e kish zbrazur kaq herë dyfekun? Pra, bëri ashtu siç bënë miqtë dhe miqtë e miqve: u hodh vorbull më vorbull, luftë më luftë. Së pari, i ktheu dyfekun Turkut kur ky donte të shkelte Dibren. Pastaj iu dëgjua emri në të dy Dibrat, iu dëgjua në Kosovë e brenda në Shkup, ku kosovarët trupgjatë e plisbardhë thanë përpara gjithë botës – me britmë e pushkë – se janë shqiptarë dhe duan që vendi i tyre të jetë Shqipëri, si qemoti. Pastaj krisi lufta më të katër kralet, vendi u mbush flakë e zjarr. Dhe kështu, luftë pas lufte, u gjend, s'di se si, në Shkodër, në mes të redifëve të Esat pashës, dhe i vuri dyfekun Nikollë popit – siç i thoshin asohere knjaz Nikollës së Karadakut, që s'ngopej me tokat që kish rrëmbyer e donte të gllabëronte toka të tjera të vendit tonë – nuk e la të bënte këmbë këtej. Mirëpo Nikollë popi u bashkua me kralin e Serbit e zuri të godasë me topa të mëdhenj, dërgoi mizëri njerëzish me mitraloza të ngrehur më tri këmbë. Ftohtë. Dëborë. Sefedini nuk luftonte dot si shumë të tjerë, futur në gropë. Jo. Dilte e luftonte sheshit, siç kishin luftuar të parët e tij. Po kujt t'i binte? Ata me opinga derri qëllonin nga larg me top. Mori dy plagë e humbi një nga të tre shokët. E shpunë në Dibër, gjersa t'i mbylleshin plagët.

E me t'iu mbyllur; u hodh prapë në luftë, sepse krali i Serbit kish shkelur Dibrën, kish vënë zjarr anembanë, kish çnderuar, kish vrarë. Sefedinit iu ndez gjaku. U ngrit krah për krah me dibranët dhe i vuri dyfekun katraveshit me opinga derri, e nxori nga të dy Dibrat, e ndoqi gjer në Gostivar e në Tetovë, iu afrua përsëri Shkupit të Isa Boletinit. Luftonte, shikonte e çuditej: përkrah kish jo vetëm miqtë e tij, po edhe armiqtë e miqve të tij. Njerëzit kishin lënë mënjanë mëritë e vjetra, gjakrat e vjetra dhe ishin bashkuar të gjithë kundër të huajit që shkelte e çnderonte vendin. Nisën t'i lindnin mendime e dëshira të reja më të forta se sa ato të luftërave që kishin bërë fisi i tij me atë të Gjatollinjve. Por këto dëshira ishin edhe mjaft të mjegullta, të turbullta, – ashtu siç ishin edhe kohë e çhershme. Sidoqoftë, i dhambi shumë kur dëgjoji se Esat pasha ish shitur e hequr nga Shkodra e i kish hapur udhë Nikollës...

Dhe përsëri turbullira. Kur iu kujtua porosia e zonjës së madhe, tërë vendi ynë ish bërë copë-copë: e kishin shkelur e djegur të katër kralët e vegjël e katër nga ata të mëdhenjtë: Austria një, Gjermania dy, Italia tre, Frëngu katër. Po njerëzit ç'bënin? Ishin ndarë e përçarë. Shumë kishin vrarë kralët e vegjël e të mëdhenj, shumë të tjerë i kishin shkullur nga vendi e hequr tutje, syrgjyn, që vendi të mbetej hambull, lëndinë. Dhe kudo të hidhje sytë, nuk shihje veçse vdekje, sëmundje, skamje.

Tani Sefedini ish rrahur me vaj e me uthull, kish hyrë në moshën e burrërisë. Trupi i tij kish shumë plagë të mbyllura, po shpirti i tij kish një plagë shumë të madhe të hapur, të përgjakur. Kish harruar tshatin e shtëpinë...

Dhe ja, një ditë, në atë mëngë të vendit, në Shëmërti, sosi një togë e një tabori të Esat pashës. Ky tabor hante bukën e Frëngut e luftonte përkrah Frëngut kundër Nemces, brenda në Shqipëri. Njerëzit ishin veshur me rroba shajaku bojë vaji, si në të gjelbër, ashtu siç

ishin veshur algjerianët, marokanët, tunizianët dhe ushtri të tjera që kish sjellë Frëngu në vendin tonë. Këta mbanin feste të gjata, të kuqe, me hënëz mbi ballë; esatistët mbanin qeleshe të bardha, herë me hënëz e herë me shqiponjë. Toga e taborit të Esat pashës kish «kumana» Sefedin Sefedinin nga dera e Gjonomadhit.

«Po ç'është kjo turbullirë? – do të thuash zotrote. – Pardje në Dibër e në Shkup kundër Turkut; dje në Shkodër kundër Karadakut e në Dibër kundër Serbit; sot me Esat pashën, që kish qenë herë mik i Turkut e herë mik i Karadakut e i Serbit...» Fjalën e the mirë, o këndonjë: tamam «turbullirë». Po, turbullirë e madhe në gjithë vendin, turbullirë e madhe në shpirtin e shumë njerëzve. Këtë turbullirë na e sillte ajo e keqja e madhe dhe se s'kishim dritë.

Po më falni, se dua ta lidh përsëri fillin e rrëfimit, ashtu siç ka qenë, ashtu siç ka ndodhur. Thashë: toga e esatistëve kish në krye Sefedin Sefedin Gjonomadhin, që kish nisur të fliste nëpër hundë e me fjalë të shkurtra, të prera. Toga këndonte një këngë që e kish sjellë me vete nga Shqipëria e Mesme:

*Esat pasha gropa-gropa,
Karadaku lufton me topa..*

Bashkë me togën këndonte edhe vetë Sefedini, duke

ngritur lart e më lart zërin.

Thirri e këndoi gjer brenda në fshat. Aty s'këndoi më, nuk thirri më. Zonja e madhe, stërgjyshja, kish mbyllur sytë e kish shkuar tek të shumtët. Me ankth kish rrojtur, me ankth kish vdekur. Se s'është punë e vogël të presësh sosjen, kur di se jeta e fisit tënd është e lidhur me një fill të hollë dhe nuk di as se ku gjendet ky fill. Nëna me shemrën ishin në shtëpi, të mplakura para kohe, me një vajzë të vogël, të motrën e Sefedinit, që

kish lindur dy muaj pas tij. Dy të tjerat ishin martuar. Gjënë e gjallë e kishin grabitur të huajt, që kishin shkuar nepër tsnat si ujtit. Ato të dyja, nëna e shëmra, punonin vetë tokën. Gjatollnjtë keq e më keq. Lufta, zia, semunajet i kishin sheshuar barabar me dhene. Dhe kishin shumë shtëpi të djegura në të dy Shëmërtitë, të Si-përmen e të Reposhmen.

Setedinit iu duk sikur jeta ishte përmbysur. Kudo njerëz të brengosur, të urtuar. Prisnin me zemër në dorë të korrat e reja.

I ra rreth e qark fshatit, që i dukej i rrëgjuar, i zvogëluar, i shëmtuar, me ato gërmadhat e tij të shumta. Ujet e kronjve të ftohtë i dukej i pështire. Mezhdat e arave kishin mbetur pa hije, se pemët i kishin brejtur kuajt e mushkat e frëngut e ishin tharë. Njerëzit e shikonin si të huaj. Dhe me të vërtetë ishte si i huaj.

Shokët e togës s'dinin gjëra të tilla, që do t'i ndienin vetëm kur do të ktheheshin nëpër fshatrat e tyre, prandaj hëpërhë hanin pilafin e Frëngut me mish dashi Australie, ose mish deveje Misiri dhe ia thoshin këngës:

*Ee-sat paa-sha groo-pa grooo-pa,
Ka-raa-daa-ku luu-fton me tooo-pa.
O s'jiaan too-pat e Karadakut...*

Vendasit shikonin e dëgjonin të habitur. Kënga as i ngrohte, as i ftohte. Njerëzit me rroba bojë vaji, të ngarkuar me kollanë e vezme fishekësh, me bomba të varura në bel, me kobure të futura drejtpërdrejt në kollanë apo të futura në këllëfë e të varura në të mëngjër, që flisnin shqip, po si nëpër hundë, duke i këputur fjalët përpara se t'i mbaronin, u dukeshin sikur kishin ardhur nga një botë tjetër. Amā armët ua shikonin me zili. Domosdo: manxeri e maliheri kishin dalë sheshit, dograja e martina ishin futur hatujve.

Kumandar Sefedin Sefedini bëri emër të këndohej një këngë tjetër, ajo e katër kraveve. Dhe njerëzit e tij kënduan:

*Katër krave nisën lu –
Nisën luftë me Turkin.
Dua me hap rrugë në Shkodër,
Dun me da të mjerën Shqipni.*

Vendësit mbanin vesh e dëgjonin. Dëgjonin dhe kup-tonin, sepse ish fjala për Shqipëri. Dhe kënga ishte e mallëngjyshme, si më të qarë.

– Kumanar, – i tha Sefedinit një nga të tijtë, – kan ardh shumë burra e dun pushkë, dun me u shkruajt.

Dhe kjo ishte e vërtetë. Shumë vendës donin të hynin në bukë të Frëngut kundër Nemcit. Çështje e drejta, atyre s'u bëhej vonë për Frëngun e Frëngoren e tij, për Nemcin e Nemcoren, për djallin e djalloren që, thoshin, le t'i nxirrnin sytë njëri-tjetrit e le t'i hiqnin për peri. Ata donin bukë, se u kish hipur varfëria dhe, më shumë se bukë, donin dyfeqe e fishekë, bomba e mitraloza e më tej dinin vetë se ç'duhej të bënin...

Këtë punë e merrte vesh mirë e bukur Sefedin Sefedini. Dhe tha me vete: «Duhet parë se mos ka edhe ndonjë nga ata të Gjatollinje që kërkon dyfeku. Përse?» Ecte përmes grynjave të Shëmërtive me dy veta prapa. Vendin e njihte me pëllëmbë: lart ishin arat e Gjonomadhëve, pra të tijat; poshtë ishin ato të Gjatollinje. I ndante vetëm një mezhde e ca gorrica të egra. Sa e sa burra ishin varër njëherë e njëkohë, nga të dy palët, në këto ara që i ndante mezhda e gorricat e egra. Dilnin për të lëruar me parmendë a me damaluk të drunjtë, njomnin tokën me djersën e tyre dhe më tej – me gjakun e tyre. Ja, këto gjëra bluante Sefedini në mendje duke ecur gjatë mezhdës, Po ja – a mos i bëjnë sytë? –

Poshtë, rrëzë mezhdës, duket një çupë. Kjo bën të ikë, e s'ik dot. Rri në vend, e ngrirë, sikur është ngulur brenda në dhe. Pëllëmbën e mban mbi sy, që të mos ia vrasë dielli dhe shikon. Fytyrën e ka të bukur, të rumbullt. Portokalle? jo; shegë? jo; mollë? po. Mollë të kuqe nga ato të Shëmërtisë. Po të shikuarit e ka të ashpër. Sytë e saj shpojnë si gjemba. Sefedini afrohet, mban këmbët. Edhe ata që vijnë prapa qëndrojnë më tej.

– E kujt je, moj gocë e bukur? – e pyet Sefedini.

Ajo e shikoi nëpër qepallat e kreshpëruara si hala dëllinje. Sefedinit i rreh zemra. «Sa e bukur!» thotë me vete dhe e pyet së dyti:

– E kujt je, moj ftujake e njomë?

Vajza vrenjtet e më shumë.

– S'di – e kujt jam-a? – ia kthen ajo. Jo vetëm vështrimin, po edhe zërin e ka me hala dëllinje. Sefedinit i vjen të qeshë: kaq e bukur, po kaq e vrazhdë në të folur e në të vështruar. Megjithatë, nuk qesh; e mban veten si «kumanar» i vërtetë. Dhe përsëri me mend e tij: «Sa e bukur, sa e bukur!

I thotë së treti, me zë të butë (me zërin e Gjonomadëve):

– Jo, moj e bukur, s'di e kujt je.

– Jam e Nures.. A e ke njohur Nuren e Shëmërtisë së Rëposhme?

Tani i vjen radha Sefedinit të vrenjtë ballin, me dhe mbje. Me të vërtetë, pyetja e tij kish qenë e kotë. Duhet ta kish marrë me mend vetë; ara është e Nures, pra edhe çupa e Nures. Armiq i kish Gjatollinjtë, po nuk ua hante hakën: njerëz të hijshëm, si në burra e në gra. Psherëtiu e i tha me zë të butë, të pikëlluar:

– Qofsh e gëzuar, moj çupë e mirë! Mos ma merr për të keq se të pyeta. Jam i ardhur... Dera jonë me derën tuaj...

Çupa s'e kish pritur këtë fjalë nga goja e një Gjo-

nomadhi – nga goja e Gjonomadhit të fundit. Sefedini i kish folur me një zë kaq të dhimbshëm, sikur t'i paskej ardhur keq për gjithë ato që kishin ndodhur gjatë gjithë brezave midis dy dyerve, që ishin vrarë e sosur kot më kot.

Dhe përsëri Sefedini:

– Qofsh e gëzuar sot e mot! Babanë ta kam njohur. Trim ka qenë, burrë ka qenë, po unë... Kështu paska qenë e thënë. Mos më mbaj mëri. Aq më shumë se sot jam e nesër ndofta s'jam.

E bija e Nure Gjatolliut ngriti kokën më fort, hapi sytë dhe e shikoi mirë e mirë: me gjithë mend e kish, apo tallej? Jo, Sefedini nuk tallej, ishte i pikëlluar. Pa, meqë e mira ndjell të mirën, u mat t'i thosh: «Edhe ti qofsh i gëzuar, o kumandar», po aty për aty iu kujtua se nuk i flitet kështu hasmit të derës dhe aq më fort dorës që i kish vrarë babanë në Guri i Pjetërkalit. Doemos, ajo e dinte edhe se i ati, Nurja, i kish vrarë Sefedinit t'anë, pra... po jo, këto janë fjalë që s'i thotë dot kush ka gjak për të marrë. Më vonë, kur ta vriste i vëllai Sefedinin e të lante gjakun e babait, mund të thosh edhe ajo ndonjë fjalë të mirë për të, siç thotë tani Sefedini; sot – jo! Sepse hëpërhë, – Sefedini ishte fajtor. Pra puna e nderi e donte që të vritej Sefedini, të shuhej e të mbyllej dera e Gjonomadhëve. Dhe sa keq i vinte për këtë njeri, që rrinte i pikëlluar përpara saj, i gjatë, i hijshëm, me një gjurmë plage në njërën faqe, që mezi ta mbushte maja e mustaqes së zezë si pendë korbi. Ç'sy të fortë kish ky njeri! Ajo e pyeti veten: «Të kisha një kobure, a do t'i bija ta vrisja?» dhe u përgjigj: «Do t'i bija... dhe pastaj ndofta do ta laja me lot.»

Ja, këto gjëra i vinin vërdallë në kokë së bijës së Nures, atje në mezhdën që ndante arat e Gjatollinje nga arat e Gjonomadhëve. Vrugoi ballin, rrahu ta mbushë

me zhubra, po më kot: sepse zhubrat i sjellin vitet e jo dëshirat. I tha:

– Mirë që e paske njohur babanë. Pandehja se ndofta e kishe harruar.

Sefedin Sefedini, që kish luftuar në Kosovë, në Shkodër, në të dy Dibrat e aier tej në Gostivar e Tetovë, që kish parë kaq zjarre e aiak e aë ish kumandar mbi shumë njerëz. vuri dorën në zemër, uli kryet e iu fal çupës së hasmit, pastai u larqua nga mezhda që ndante Gjonomadhet nga Gjatollinjtë. Ata dy burrat e ndoqën nga drapa.

Atë ditë Sefedini u larqua, po të nesërmen u kthye përsëri. E aiet të biiën e Nures tek po erte eairin e arashinën, midis gryniave. I skuqte shamia mbi krve. Shamia ishte e kuqe, po faqet e së biiës së Nures ishin edhe më të kuqe. Era e hollë e aershorit tundte kallinitë, aë unjeshin e nariheshin dallaë-dallgë. Sefedini aëndroi, mbaiti këmbët tart, në mezhde dhe shikoi. Kësaj radhe ishte fillikat, na njerëz drapa aë ta ruanin.

Nurija – kështu i thoshin çupës së Nures – mori një krah bar, cau ngadalë arunjat dhe iu afrua mezhdës tek rrinte Sefedini.

– Puna mbarë, moj çupë e mirë! – i tha Sefedini.

Aio bëri sikur s'e pa, sikur s'e dëgjo, meqithëaë ai ndodhej dy cape afër e afër. Unji shaminë e kuqe mbi ballë, shikoi me bisht të syrit, u mundua dhe bëri të hynte drapë në arvniat tek skuanin paparunat.

– A di përse dera jonë është në ajak me derën tuaj, moj e bija e Nures? – pyeti Sefedini.

Aio u kthye, e shikoi ashpër me pëllëmbën mbi vettullat e holla e iu përgjijaj:

– Ti më pyet a? Ti që më ke vrarë babanë?

– Mos ma merr për të keq se të pyeta. Sa për babanë, ti e di se edhe yti vrau timin, që kur isha në barkun e nënës. S'kisha ç'të bëja. Po të mos e vrisja

nuk rroja dot. Pastaj do të më vriste. Ai ishte burrë, unë isha katërmbëdhjetë vjeç djalë.

– Ishe si ishe, ishte si ishte, ai të pret andej, që t'i shpiesh të fala nga Shëmërtia.

Nurija futi dorën në gji e s'di ç'kërkoi atje. Shaminë për të fshirë djersën e ballit? Jo. Sefedini e mori vesh se ç'kërkonte dora e së bijës së Nures, po nuk u tund nga vendi, nuk vuri dorën në brez ku mbante koburen të mbushur. E shikoi i pikëlluar, qortonjës dhe i tha:

– Ne jemi në gjak, se qëmoti një nga të mitë u zu me një nga të tutë, për punën e një çupe, që e donte edhe njëri edhe tjetri. Për këtë çupë është derdhur një lumë gjaku. Kështu më ka thënë stërgjyshja kur isha i vogël.

– Ka qenë si ka qenë, unë s'dua të di. Sot dera jonë ka për të marrë një gjak nga dera juaj. Do t'ju shuajmë fare, do t'ju fshijmë nga faqja e dheut.

Sa ashpër fliste e bija e Nures!

– Doni gjak, thua? Doni të na shuani fare? Përse?

– Përse e përse, ja nga koha që ka re, – ia ktheu çupa me të qesëndisur.

Sefedini u mat t'i thosh: «Unë e di se ç'ke në gji. Ke një kobure. Mirë, nxirre e vramë me dorën tënde.» Dhe fërkoj sytë, i mbylli pak, duke pritur, edhe me pikëllim, po edhe me përbuzje. Ajo kuptoi ç'kish dashur t'i thosh, nxori dorën nga gjiri, këputi një kalli të njomë dhe zuri të shkoqë një nga një koqiskat qumështore. I shkoqte dhe i kafshonte me dhëmbë.

– Mos u nxito, gjakun do të ta marrin tim vëllezër. A mos kemi frikë se je kumandar i atyre kokëlakrave?

Dhe vazhdoi:

– Apo të thotë mendja se ne e harruam gjakun e Gurit të Pjetërkalit?

Sefedin Sefedini psherëtiu, iu kujtuan të gjitha:

– Atje, – tha, – ne Guri i Pjetërkalit është vrarë edhe imi edhe yti. Unë...

Rrinim tani ballë për ballë: ajo si e nusëruar, me duart grusht nën gjinj, ai si i dhëndëruar, me duart varur. Era u forcua e më shumë, përkulte sa ment përthyente grynjat e derës së Gjonomadhëve e grynjat e asaj të Gjatollinjeve, pothuaj i bashkonte, i gërshetonte. E si rrinin kështu, papritur Sefedini bëri buzën më gaz, sepse tha me mendt e tija: «Pse s'është këtu nëna e madhe, ta pyesja në i pëlqen të marr nuse të bijën e Nure Gjatolliut? Ajo desh të më martonte.» Cicëriu një zog i vogël në grynjat, pastaj edhe një tjetër; iu përgjigjën shumë zogj të tjerë nga drizat, nga pemët, nga qielli. Edhe Nurija e Nures, padashur, vuri buzën në gaz. Vetëm atëherë Sefedini vuri re se e bija e Nures kish gropëza në të dy faqet. Dhe sa lezet i kish kur vinte buzën më gaz! Në atë çast, në qoftë se ajo do të kishte nxjerrë koburen nga gjinjte e do të matej t'i binte, Sefedini nuk do të kish lojtur nga vendi, po do ta kish pritur plumbin i gëzuar, do të kish vdekur i gëzuar. Nga dora e saj, vetëm nga dora e saj! Sepse vdekja është e ëmbël kur vjen nga dora e asaj që ti e do mbi të gjitha.

Aty për aty Sefedini u err pak e tha me zë të dhimb-sur:

– Po të jetë puna për të shuar e për të mbyllur derën, mund të shuhemi e ta mbyllim tehtë të dy palët. Marr një-qind burra, nga ata që i kam nën urdhër, zbres poshtë, në Shëmërtinë tuaj, e nuk lë gur mbi gur. I lag të gjithë me gjak.

Ngriti zërin e shtoi me tingull të përzemërt, të butë (prapë zëri i Gjonomadhëve që, siç thoshin të gjithë, ishte bar për plagë):

– Dëgjo, Nurije (dhe zëri iu drodh kur ia shqiptoi emrin). Unë s'dua të shuhet as fisi im, as juaji. Dua të rrojmë edhe ne, të rroni edhe ju. Mjaft gjak u derdh më

kot këtu ku jemi, ne Guri i Pjetërkalit, rreth e qark.

Nurija ia ktheu:

– A nuk ikën tani, o djalë? Se ta dish, po erdhi Selmani, të vret në vend, ja, për këtë bukë! – dhe hapi të dy pëllëmbët mbi halat e kallinjve të njomë.

– Mirë, – tha Sefedini. – Meqë ti po më përzë, unë do të shkoj.

Dhe bëri t'ia merzte nga kish ardhur.

– Jo andej! – i thirri Nurija e trembur. – Mos shko andej! Nuk dua të shkosh andej! Mos!

Zëri i Nurijes dukej i trembur, i njomur me lot. Shtoi:

– Merrja këtej poshtë, nëpër vrage, – dhe i tregoi me dorë një vrage në anën e kundërt.

Sefedini diç kuptoi, si nëpër tym, ngriti pëllëmbën e fërkoj sytë, shikoi rrotull, gjër larg, vuri dorën në brez, i hodhi një vështrim lamtumire e mirënjohjeje Nurijes dhe ia mori andej, vrage që i kish treguar ajo.

A doni t'ju them tani, o këndonjës, se ç'ndodhi më tej?
Dëgjoni.

Të nesërmen, toga me kumandar Sefedinin në krye u ngrys e s'u gdhi. Iku.

«Kështu e ka kanuni i atyre që shkojnë në luftë» do të thoni ju.

Mirë, po a thotë kanuni i atyre që shkojnë në luftë të rrëmbejnë çupat e botës?

Se kështu ndodhi andej, në Shëmërti: Sefedin Sefedin Gjonomadhi rrëmbeu të bijën e Nure Gjatolliut. Jo, nuk e rrëmbeu, po u rrëmbyen. Çupa desh e iku. Nuk e shtrëngoji njeri. E shtyu zjarri i zemrës. Ra në dashuri pas amikut të shtëpisë.

Thoni se për këtë të pabërë u ndez gjak i ri? Jo, nuk u ndez gjak i ri, po u shua edhe i vjetri.

U mbush kështu fjala e atij burrit të thinjur e të ushtuar që kish thënë njëherë e njëkohë: «Një thembër

ndezi zjarrë midis Gjonomadhëve dhe Gjatollinje, një thembër do ta shuajë.»

— Kjo fjalë s'doli e kotë: gjaku u mbyll përnjëherësh, siç mbyllet plaga kur i vë një bar të mirë.

Tani Sefedin Gjonomadh i nga Shëmërtia e Sipërme ka pesë djem. Këta pesë djem kanë në damarë edhe gjak Gjanomadhi, edhe gjak Gjatolliu. Në s'i besoni fjalët e mia, ngjiti lart në Shëmërti e do t'i shihni me sytë tuaj.

Çështje e drejta, nga kjo punë doli një si ngatërresë e vogël: në shtëpinë e Gjonomadhut u bënë dy Nurije, vjehrra e nusja, po kjo s'ngre në kandar, sepse në Shëmërti s'e kanë zakon t'u thonë nuseve e nënave me emër — nusja i thotë vjehrrës «nënë» ose «zonjë» dhe vjehrra i thotë «bijë», «nuse».

Mbaroi rrëfimi?

Mbaroi, po kam t'u them edhe nja dy fjalë këndonjëse. Kur dëgjoji se ç'kish ndodhur e se si ishin rrëmbyer ata të dy, u ngrit më këmbë Dajlani i Kruabardhit, plak mbi të qindtat, që kish parë kaq gjak të derdhur nga të dy palët, e tha:

— Gjysma e punës u bë vetë. Gjysmën tjetër duhet ta bëjmë ne, që të forcohet miqësia e re.

— Si? — i thanë.

— O burrani t'ua mbushim mendjen të dy palëve që i biri i Nure Gjatolliut të marrë të bijën e Sefedin Gjonomadhut. Të motrën e Sefedit.

Nuk mënoi shumë e puna mori fund. Selmani i Nures mori nuse motrën e Sefedit dhe u bënë pat e pat: një dhanë, një morën.

Dhe rrojnë shëndoshë e mirë.

Rrofsh edhe ti, o këndonjës, që pate durim të këndosh gjer në fund rrëfimin tëm!

Shkruar në Bukuresht, 1938
Ripunuar me 1965

Natë kollozheku

Kur arritëm rrëzë Qafës së Bushit e do të merrnim përpjetë, xha Martini mbajti kuajt, e u hodh poshtë me një të kërcyer trimoshe, sikur të paskej qenë djalë njëzet e një mot. Ne, udhëtarët, ndenjëm ca çaste në vend, të mardhur, pastaj zumë të lëviznim nën gunat e mbuluara me një gisht dëborë. Udhë e gjatë me erën përballë, dhe fërtyma e kollozhekut na i kish mpirë këmbët që nën këllk e poshtë dhe prandaj na thernin thellë-thellë, sikur të paskeshim ndenjor në thika e shtija. Gjerësa të merrnim veten, xha Martini kish nisur kuvendin me kuajt. Këta turfollonin e nxirrnin nga goja shtëllunga avulli, kurse ai i përkëdhelte: u fliste në gjuhën e tyre, (që t'u jepte zemër), ua fërkonte veshët e ua shkundte dëborën e vitheve.

Pamë ç'pamë e zbritëm poshtë.

— Dëbora sitej e hollë, po e dendur, dhe mbulonte shpejt e shpejt vazhdat që kishin lënë prapa rrotat e qerres. Mjegulla zbriste që lart si lumë i rrëmbyer e po na rrethonte nga të katër anët. Edhe si derdhej kështu, dukej sikur malet vetë shkrynin e rëkëlleheshin poshtë.

Një nga të pesë udhëtarët — fytyrë e skuqur nën kapuçin e gunës së dhirtë e hundë me kërrabë — më zgjati pagurin stumbaq të rakisë. Hoqa një herë, hoqa

dy, hoqa tri, gjersa ndjeva se m'u ngroh trupi e zunë të më shkrinin rrembat.

Tani udha duhej bërë më këmbë, se vendi vinte thikë përpjetë e kuajt s'hiqnin dot.

— O xha Martin, ne do t'ia marrim tërthor, me të prerë, që të shkurtojmë udhë, — tha udhëtari hundëkërrabë. — Biem fillall ne Varri i Malush Agos e që aty, sa të pish një cigare duhan, dalim lart në Qafë. Atje të presim.

Xha Martini, që i njihte viset e kohën, tundi kryet si njëri që s'i zë besë fjalës që i thua, ngriti edhe nja dy a tri herë pagurin e atij mikut e na ftoi t'ia merrnim udhës drejt pas qerres, sepse dëbora ishte e madhe, si nuk kish parë prej vjetesh Qafa e Bushit, dhe kish mbuluar tërë vragat poshtë.

— Pa, helbete, si pyll që është, mund të ketë edhe egërsira: ulq, derra, — na tha ai që të na e mbushte mendjen të merrnim udhën e qerres.

Po meqenëse ne ngulëm këmbë të presim udhë e të dalim tërthor ne Varri i Malush Agos, xha Martini tundi kamxhikun, u thirri kuajve «iii, djem!» e na tha:

— Udhë e mbarë e u pjekshim shëndoshë!

— Hapni sytë, ore, se dëbora është si uji: s'ka besë. Të heq e s'të lëshon! — na thirri ai në të ndarë e sipër, duke ecur herë përbri kuajvë e herë përbri qerres.

Ne i bëmë me dorë (megjithëqë shenja jonë nuk dukej në mes të mjegullës), i thirrëm të ngjitej i shkujdesur dhe ia muarëm tërthor, ashtu siç kishim kuturisur. Në fillim puna na vajti mirë, po më tej na ngatërruan leqet: ramë në udhë pa udhë. As shenjë, as vragë, as gjurmë. Trëmba dëbore lart, trëmba dëbore poshtë e det i bardhë në mes. Nëpër këtë det të bardhë ecnim ne, të pesë udhëtarët, të mbështjellë me ato të uruarat guna. Kur e kur këmbët na fundosnin gjer mbi gju në dëborë e mezi i nxirrnim. Xhumblet e bushit, të shkoza-

ve e të dushkerkave, të tultura nën dëborë, na çirnin e na plagosnin keq. Iç ftohtët na bënte të lotonim. Zëmë të ecnim kuturu, njëri lart, tjetri poshtë, i treti s'di se ku. Dielli, që dukej si një lëmsh dëbore, po i murtuar, humbi fare përtej, në mjegull. S'e shihnim më shoku-shokun. Këtu shtrat i hollë dëbore, më tej gropë, pastaj votrome si puse, nga ato që me të vërtetë s'kish parë prej shumë kohe Qafa e Bushit. Qëndruam dhe mbajtëm vesh të dëgjojmë qerren e zile të kuajve. Asnjë pipëtimë, sikur zilet të paskeshin qenë mbushur me shtupë a me lesh. Ja këtu një tragë egërsire, më tej një tjetër. Mor-nica nëpër trup...

– Egërsira? Pse ua keni frikën egërsirave kur kemi barut e plumb? – tha udhëtari i pagurit, që të na jepte zemër. Pastaj i ra gunës me bërryl e na tregoi një karadakllie të ngjeshur brezit.

– Edhe unë kam një copë hekur në brez, – tha një tjetër, – po ulku e derri nuk tremben kollaj në dimër me një të shtënë e dy. Le që s'po na bëjnë as duart të shtiem. Puna është si do ta çajmë këtë dëborë e këtë mjegull e si do të arrimë ne Varri i Malush Agos.

– Unë, – vazhdoi ai i pagurit, që ish bërë çakërrqejf, – dua vetë të më dalë përpara ndonjë ulk a ulkonjë, që t'ia bëj lëkurën shoshë e pastaj t'ia mbush me kashtë.

Kësaj lëndate as që i dhanë përgjigje, se kishim bren-gën e udhës, tmerrin e mjegullës dhe të egërsirave që kishin lënë gjurmë nëpër dëborë.

– Më vonë, kur pamë se nuk i dilet dot në krye pyllit nëpër një dëborë kaq të madhe, u kthyem pas gjurmëve tona e zbritëm rrëzë Qafës. Që aty ramë pas vazhduarve të qerres, që mezi shquheshin dhe përpjetë – përpjetë, kaptuam Qafën.

– Bam! – krisi një armë tutje, përpara se të sosnim ne Varri i Malush Agos.

– Bam! – ia ktheu karadakllia e atij mikut të pagurit stumbaq.

... E gjetëm xha Martinë që po na priste me gjashtoren në dorë, pranë kuajve të mbuluar me mutafe e mutafet me dëborë.

– A jeni të gjithë? – na pyeti.

– Të gjithë, xha Martin, – i thamë ne, të penduar.

Nuk na qortoi as se e kishim vonuar, as se e kishim lënë fill të vetëm në atë të përpjetë të shqitë, ku kuajt duan ndihmë, sepse na pa që na qe marrë fryma. Tundi kokën e tha:

– Haj, hipni, se tani udha na heq poshtë.

Shkundëm gunat, hipëm në qerre dhe ngjeshëm kaçuçat në kokë. Xha Martini u thirri kuajve: «Hiii, djem!» dhe qerrja shqiti lehtë, butë.

Pas një copë here, kur na shqisnin përpara qepallave të pulitura ëndrra të ngatërruara, pa fund e pa krye – zjarr bubulak në vatër, erë pastërmaje, xixa vere në kupat dhe avull gështenjash të ziera – xha Martini na thirri:

– Zbrisni, o burra, se arrimë ne Hani i Olloman beut!

Ne as që kishim vënë re se qerrja kish qëndruar edhe se xha Martini ish hedhur poshtë. Zbritëm. Mjegulla ish holluar. Dëborë pothuaj kish taraksur.

Trokitëm ne porta. Një herë, dy...

U dëgjuan nga brenda ca zëra të mbytur që sikur vinin që ndënë dhe, kërciti një kanatë e vogël – derë në portë – dhe nëpër të çarat' e dhogave ranë ca fasha drite në dëborë. Kuajt hingëllinë: ndofta, ia ndjenë erën quarit, tagjisë.

– Ti xha Martin je-a? – pyeti një zë nga brenda.

– Unë, unë. Hape.

– Ja, tashi!

Rënkoi një lloz, nga ata që futen nga muri në mur, pastaj edhe një tjetër, krisi një *mandall* dhe hanxhiu na hapi portën duke bërë dritë me një copë pishë.

Hymë në oborr e që aty brenda në han, pastaj në odën e zjarrit. Në një vatër të madhe, pa hashmakë –

vatër hani, – digjeshin nja tre a katër kërcunj dushku të rrethuar me një vandak dru – ca të thata e ca të rjoma. Aty pranë rrinin nja tre udhëtarë, që i kish zënë moti i keq udhës.

Si qeverisi kuajt, xha Martini u kthye në odën e zjarrit, tha mirëmbërëma, nxori opingat e ngrita, çliroi liqet e tirqve, u mbështet e i vuri këmbët vatrës. Hanxhiu hodhi ca shkarpa, që t'u jepte ndihmë drunjve e kërcunjve. Sakaq bubulloi një flakë e madhe që mbyti me dritën e saj të fortë dritën e kuqe të pishtarit.

Jashtë kish dalë veriu me çomage në dorë e bënte kërdinë: frynte, alurinte, buçiste. Pemët rreth e rrotull hanit përpiqnin degët me degët, kurse hatujt fërshëllenin e ulërinin sikur të ishin mbushur me mijëra lugetër të dalë nga varret e ngrira a s'di që ku... Ne dëgjonim me trembje gjëmën e kollozhekut dhe ia ndienim edhe më fort ëmbëlsinë zjarrit, që na e kish sjellë zemrën në vend. Xha Martini rrinte i kapitur, qëpallëvarur. Një nga udhëtarët, si në moshën time, tha:

– Ky na qenka hani i Olloman beut... S'e dija. Ç'ka qenë ky Olloman be?

– S'ia paske dëgjuar emrin-a?

– Jo, ia kam dëgjuar. Gjyshja më trembte kur isha i vogël; «Shshsht... Vjen Olloman beu e të bën kësh-kësh, me thikë. Të shpie në hën, të hedh në pus...» Kështu më thosh. Po pse i thonë kështu këtij hani?

– Kështu i thonë, – tha hanxhiu, një burrë i gjatë, i thatë si çengel, zeshkan, me ca vetulla të trasha që, kur fliste, i ngriheshin lart duke bërë në mes një kënd si një kapuç gune, e me ca sy të futur thellë në gropëzat, sa nuk i dukeshin fare. – Kështu i thonë se i tija ka qenë njëherë e njëkohë.

– Po më parë?

– Kur më parë? – pyeti hanxhiu dhe hop, vetullat i kërcyen si kapuç gune.

– Në krye... Dua të them kush e ka bërë, kush e ka ndërtuar?

– Gjyshi im, Olloman beu vuri një njeri që e vrau e ia mori. Me të gjitha ato që kish brenda e jashtë. Brenda kish pare, mall, bar e tagji për karvanët, ushqime për njerëzit. Jashtë kish ara e vreshta.

– Po ti?

– Unë? Unë s'kam gjë. Hanë e ka blerë një tjetër; unë e kam marrë me qira. Tashi do ta lë, se u shkoi koha haneve që kur s'ka më karvane, – tha hanxhiu e doli se e thirri dikush jashtë, një zë gruaje.

Kur u kthye, nuk e pyeti më tej askush, kështu që fjala mbeti e vdekur. Vetëm pasdarke – me pastërma ftuje të pjekur në prush, me vezë gajgana të mbytura në gjalpë, me arme e turshi të mirë, me bukë të ngrohtë sapodalë nga çerepi – kur hanxhiu solli plloskat me verë të vjetër, fytyrat që i kish rrahur e vrenjtur kaq shumë fërtyma e kollozhekut filluan të kthjellen. Atëherë edhe xha Martini u çel e u krekua si një lule kur i bie vesa.

... Verë po verë bëjnë këta vreshtat e hanit, që gjen-den ballë diellit! Të mbyt damfi i fortë kur e shpie kupën a plloskën në buzë: erë trendeline e luleshtrydesh. Se me të vërtetë, trëndelinë e luleshtrydhe bëheshin njëherë e njëmot në atë rrahun e Skurës, siç i kish thënë qëmoti bregores së madhe me tokë të tultë.

Tani, si kthen pothuaj gjysmën e plloskës, xha Martini merr shpirt të ri e fillon të na tregojë ca ngjarje nga të moçmet. – as shumë të afërme, po as shumë të largme. Fytyra i skuqet, zëri i kthjelllet dhe, përnjëmend, krehet në remën e së shkuarës, duke na hequr edhe ne pas vetiu me një të folur të fortë e të dhembshme, që të tund e të shkund. Hanxhiu, me vetulla të dendura e sy të thellë dhe udhëtarët e tjerë, që i kish mbyllur dëborë në han, afrohen të dëgjojnë, sepse ia dinë shijen fjalës që del nga zemra.

– Pijanik? Kështu thua zotrote që këndon këtë shkrim?

– Ndofta, pijanik, po nga ata që t'ia pish dollinë tri herë rresht, me fund. Dhe në kam tani ndonjë brengë të madhe në shpirt, ta dini se s'kam tjetër veç brengës se s'mund të shkruaj fjalët ashtu siç i dinin nga goja. Ato ishin fjalë të ajalla, tërë ashk, tërë dhembje, që të rrëmbenin e të shpinin atje, në kroin e ngjarjeve të qëmoçme.

– Ehu, o djem, që më pyesni për hanë e Olloman beut, – ia nisi xha Martini, – e ku e dini ju, more, c'ka qenë në këto vise kur rronte gjëmëmadhi Olloman bej, mallkuar i qoftë emri!

Edhe dora e tij, dorë e madhe pune, e bumbyer nga shiu e breshri, larqoi nga balli kapën e zezë prej lëkure dashi me rrethin tërë zgjyrë.

– Po, ka qenë një kohë kur edhe foshnjat e djepit dinin ç'është emri Olloman bej. Sepse, Olloman bej dhe lemeri ishin një e një, vëlla e motër. Atë kohë në tërë këtë mënaqë të vendit – fusha, kodra, pye – zotëronte Olloman beu i Karafil aqait. Kur pyeste ndonjë që s'dinte: «E kujt është kjo fushë pjellore?» i thoshin: «E Olloman beut.» «Po ai fshat nën atë kodër?» «I Olloman beut.» «Po ato tufë bagëti që zbardhin nëpër ato kullota?» «Të Olloman beut.» «Po ai pyll që nxin atje tej?» «I Olloman beut.» Më gjithë sharra, me gjithë karvane. Me gjithë njerëzit që ngasin karvanet.» Të gjitha të Olloman beut!

– Llamje paska qenë? – pyeti ai moshatari im, i çuditur.

– Llamje, po! Ndofta më keq se llamja. Dorën e kish më të rëndë se plumbi, hijen më të hidhur se vdekja. Edhe dita-ditës zgjeronte rrethin e çifligjeve e numrin e bulqërve, që i mbante si bagëti. Po bagëtinë nuk e vriste, kurse bulkun... Sot dëgjoje se zптоi një koriye të re, nesër një mulli, një luadh, një han e ç't'i thosh goja. Kur

vritej ndonjë në mal a në fushë, në udhë a në shtëpi e i mbetej kufoma pa kallur në varr a kur i zhdukej ndokujt gjurma si uji në ujë, ta dish se kish pasur gisht Olloman beu. Edhe gishti nuk vonohej të dukej sheshit, sepse me t'i dalë shpirti njeriut, Olloman beu nuk mungonte të dërgonte trimat që t'ia merrnin arën, kalin, çupën... E ku kish mbret, more, e ku kish kral, more, e ku kish zot e hyqymet më të madh se Olloman beu?! Ai ishte vetë vali, vetë kadi, i priste palla më të katër anët, i shkonte vula në Janinë e në Stamboll.

Kur dilte Olloman beu pazarit me dyzet a pesëdhjetë trima të zgjedhur me kandar të zjarrit, të armatosur gjer në dhëmbë: me këto vezme, pallaska e palcore, me këto pisqolla me çark brezit, me këta jataganë, hedhur krahut dyfeqet e gjatë të lara me argjend e flori, e ku je ti, more, dridhej foshnja në barkun e s'ëmës! Më të djathtë e më të mëngjër sikur s'kish njeri të gjallë. Po të mos qenkeshin ato bataret e gozhdëve të opingave zhgrup-zhgrup, në kalldrëm, e ato taktaket e tiktiket e zhingërmingrave që kishin varur trimat në brez, dëgjohej miza një të shtënë dyfeku larg. Njerëzia nguroseshin sikush në vend, me pëllëmbën e mëngjër në zemër, kurse me të djathtën i bënin nga njëqind e pesë temenara e salavate, që nga dheu e gjer lart mbi ballë.

Edhe Olloman beu i Karafil agait shkonte në mes të këtij salltaneti duke tundur vap-vap xhufkën e festes së kapitur mbi vetull. Pa shikonte rrotull me një të pamë të ashpër, sikur desh të përpinte retë. Dridheshin, ore, ja për këtë kripë! – dridheshin si purteka ata që guxonin të ngrinin sytë e ta shikonin!

... E ku t'i dini ju, bre, ku t'i dini ju këto azape... Ju, o miq të mirë, që rrini e ngrohi sot rreth kësaj vatre e pini verë nga kjo e bekuara, po të ndodhte të shkonit këtej, si tashi, në palcën e dimrit, do të thoshit më mirë ta bënit gjumin jashtë, në dëborë, a në ndonjë shpellë

mali, me egërsirat, sesa të trokisnit në këtë portë e të hynit në këtë oborr ku kishin ndodhë kaq lebeti. Ja, aty në oborr, në të hyrë, ish druri e litari për të varur njerëz. Pak më tej ish çengeli, që i futej njeriut në grykë, së gjalli. Më tutje, pusi me kapak hekuri. Tashi pusi është mbushur e mbuluar, po sa kocka njeriu kalben brenda!

Hanxhiut iu ngritën ato vetullat e zeza, që u bënë tri-këndëshe, na shikoi si i verbër, ofshoi e tha:

– Ashtu është... Më ka thënë babai.

Xha Martini vazhdoi:

– Ca vjet më parë, kur u prish, s'di se si, një copë e murit të avullisë, dolën jashtë kocka njeriu të futura në ca si kamare të gjata. Kështu, hanxhi?

Hanxhiu ofshoi edhe më thellë, dhe u përgjigj me vonesë:

– Kështu, kështu... Kokalla, fyej të thyer. Shumë kamare, shumë kocka. I lamë me verë të kuqe, u hodhëm borzilok të thatë, i vështrullëm¹⁾ me pëlhurë e i kallëm në një gropë, të treten atje...

Tha kështu, ktheu kokën mënjanë dhe tundi pëllëmbën sikur desh të thosh: «Ehe... Ka edhe gjëra të tjera nëpër këta mure...»

Xha Martini vazhdoi:

– E ku i dini ju këto gjëra, o djem... Ju i keni edhe buzët me qumësht, megjithëqë thonj se ju ka ardhur koha t'i njomni me verë.

U përpoq të shpinte buzën në gaz, po u helmua edhe më shumë, ngriti plloskën dhe hoqi ca gllënjka, u ra vësht e vësht mustaqeve me pëllëmbë, shikoi një çast pishtarin, pastaj tha:

– Hyqymet kish sa për sy e faqe, se për të gjitha beu shkruante, beu vuloste, Ata pak zaptije që rrinin kotnasikot, me një çausht në krye, për çdo gjë i merrnin dorë beut. Kur

1) Per i mbështollëm

piqeshin me Olloman bejnë kthenin menjëherë poshtë grykat e dyfaqeve, se veç gryk' e dyefkut të beut dhe e zybave të beut duhej të ishin lart. Edhe të gjithë i bënin temena, po beu as që begëndiste t'i shikonte me sy, po dridhte e përdridhte më të madh ato shtullungat e mustaqeve bojë vaji. Kur vinte beu në Manastir, kaluar, me zybat prapa, pashai vetë ngrihej më këmbë dhe e priste si mik me kokë, se që të dy ishin ortakë: njëri djalli, tjetri dreqi.

Beu e ktheu botën prapë: i shembi të gjithë oxhakët e shtëpive të botës, se veç dera e tij ishte oxhak e duhej ta nxirrte tymin përpjetë, të tjerët: nëpër vërat e çatisë, nëpër hatujt...

Kur vinin kurbetlinjtë nga kurbeti, qëndronin më parë ne porta e beut, që t'i faleshin e t'i jepnin haraçet e peshqeshet, pastaj shkonin të shikonin fëmijët e gratë. Ata i sillnin nga larg jataganë të larë me flori, shishane me kondakë argjendi, pişqolla, opinga telatine, dengje me kafe Jemeni e sa e sa të tjera. Kështu bënin edhe ata që ngisnin karvanët, ata që shisnin e blinin: më parë ne porta e beut, pastaj në han e dyqan. Pa ndodhte shpesh që beu t'u priste kryet njerëzve me jataganët që i kishin sjellë vetë.

Kur desh Olloman beu t'i dërgonte imdate e peshqeshe Baba Dovletit, vezirit a pashait, që ta forconte vulën, një muaj të tërë kërciste dita me ditën dajaku mbi kurriz të rajasë – kurbetlinj, zanatçinj, tyxharë, bulq – që t'i kthenin mahmudetë e mexhitet e bardha me turren e Dovletit, se tërë paraja e tërë vendi, mal e fushë, qenkeshin të sulltanit edhe ai ua lënka sa kohë të dojë vetë njerëzisë e ua marrka kur t'i shkrepë qejfi. Edhe pastaj, kur njerëzia rrinin brenda që të shëronin plagët, gjysmat e parave shkonin me karvan në haznë të Stambollit, së bashku me qojlet e me nja dy a tri vasha të

bukura majë kalit. Këto i kishin rrëmbyer zybat e beut me urdhrin e beut, që ia dërgonte peshqesh padishahut. Edhe, si shpërblim, i vinte një ferman i madh nga Stambolli, që ia forconte rrënjët e ia madhonte vulën.

Pa shumë nga ata që nuk e duronin më zinë e babëzinë, turpin e shtypjen, merrnin fëmijët e gratë, pleqtë e plakat e iknin natën ky sytë këmbët e nuk kthenin kokën prapa të shikonin vendin ku kishin lindur e ishin rritur. Humbnin në dhe të huaj, nëpër fshatra e kasabara, bëheshin shqehë, grekë, frëngj e ku ta di unë çfarë, për të shpëtuar kokën e nderin nga dhuna e përdhuna.

Një sahat përpara se të perëndojë dielli mbylleshin gjithë shtëpitë e gjithë pazari, se lëshoheshin kuajt e Olloman beut për ujë. Se na kish ky beu një hergjele të tërë me kuaj dorinj, çilë, kërrë, karanj e balashë, të sjellë drejt nga Rabistani. E ku të peshonin, more, ty e mua e tërë botën këta kuajt e Olloman beut që ishin më të hazdisur e më të akrosur sesa sejmenët!... Būçiste tërë vendi kur potkonjët e tyre copëtonin gurët e kalldrëmit e mbushej udha shkëndijë e gjallë!

Pa kur dëgjohej se ka dalë e po shkon udhës Olloman beu i Karafil agait kyçitëshin me nga tre kyçe dyert e shtëpive, mbylleshin me lloze kanatet e penxhereve dhe tërë bota mbyllej në zëndan, në qivur. Edhe foshnjat, që janë foshnja, pushonin të qarët kur dëgjonin emrin e qahjait të beut. Vashat e nuset e reja dridheshin si fleta kur vjen fërtyma, e u binte faqeve kur të kuqtë e fruthit e kur të verdhët e verdhicës.

Se ku ta dini ju, more, se Olloman beu ish njeriu i qejfit e ahengut! Konakët e tij ishin rëngë me çupa të bukura të rrëmbyera nga lind e ku perëndon. Edhe sa herë që i shkrepse qejfi beut për ndonjë vajzë të njomë... Lebetitëshin gjithë fusharakët..

Këtu, zëri i xha Martinut u këput siç këputet e bie nga lart një zog kur kris rrufeja. U mundua të vazhdonte

rrëfimin, belbëzoi ca fjalë të ngatërruara, si përçarste, e m'u duk sikur i shkriu një lot në beben e syrit. Ngriti dollinë, që të mos ia pikasin hidhërimin, pastaj vazhdoi, po kësaj here me kryet përdhe:

Për punën e një çupe, një Xhoxhi-Xhoxhi, nga ata të Motovilës, i ra me dyfek beut. Plumbi ia mori këmbën beut, po nuk e vrau dot. Pastaj Xhoxhi iku s'di se ku, po shtëpia iu dogj e iu shkretua. Nga tërë fisi i Motovilës s'mbeti asnjë i gjallë. Ca morën malet e luftuan me dyfek në dorë, se i mbanin me bukë çobenjtë, ca të tjerë i vranë zybat e beut. Tërë malli e gjëja e fisit të Motovilës i mbeti Olloman beut.

Kur kish beu ndonjë rast gëzimi: dasmë, lindje, synet e ku ta di unë çfarë, a kur i shkrepse qejfi vetvetiu, në të ndenjtur e sipër, digjeshin rreth e rrotull mullarët e bulkut, ndizeshin togje shirrë bredhi të përzier me hi e u jepej urdhër gjithë njerëzve të loznin e të këndonin. E doemos, këta lonin e këndonin sipas gajdes, se si tha dikush një fjalë: «Lot prifti nga belaja, i miri nga maskaraja.» Kësaj i thoshin donoma. E në donoma e sipër, oborri i madh i sarajeve të Olloman beut, i qarkuar me dy palë mure, njëri më i trashë se tjetri, njëri më i lartë se tjetri, si kala Janine, mbushej me zjarre edhe trimat e beut dridhnin në hell deshinj të majmë të sjellë peshqesh (ama peshqesh me kërbac në dorë!) nga ana e anës. Edhe pastaj, tërë ditën e ditës edhe tërë natën e natës gjëmonte dyfeku. Shtatë male larg binte erë barut.

Gjithë vendi dridhej, o djem. Dridhej, rënkonte e lëngonte, si mos o zot, nën hijen e rëndë të Olloman beut. E kjo hija e tij ishte më e rëndë se plumbi, më e zezë se vdekja.

Pleqtë e asaj kohe luteshin:

– Zoti na dhëntë që t'i japim!

Bulqit:

– Zoti na faltë durimin, për hatrin e foshnjave!

Edhe rajaja gjithë, me një zë:

– Zoti i shtoftë zullumin!

Edhe zullumi shtohet e shumohet dita ditës e derdhej si rëke nga konakët e Olloman beut; turpërime, rrëmbime, vrasje, prerje, shkatërrime. Ky ishte mielli që bluate mulliri i tij.

Vetëm një Malush aga Katunishti ia ka prerë yryshin Olloman beut! – thirri xha Martini me zë të gjallë e të nxituar, sikur desh të shpëtonte nga hije e rëndë që e kish pllakosur gjer ahëre.

Sytë i shkëlqyen si dielli kur del nga retë.

– M'i ndriçin eshtrat e shpirtit në këtë e në atë jetë Malush agait, se ai i doli zot nderit të vendit edhe e mbrojti si burrë.

E që ta dini mirë, nga zullumet e të këqijat e beut, kurbetlinjtë iknin e s'ktheheshin prapë, dyqanet mbylleshin, karvanet ndërronin udhë e nuk shkelnin më në viset tona, punishtet pa punëtorë, shtëpitë të shkreta, arat pa bulq. Shumë nga ata që arratiseshin, qëndronin një ditë a dy – në udhë e sipër – në derë të Malush aga Katunishtit e ky i priste me bukën shtruar e me fjalë të mirë. S'ka pasur e s'do të ketë në viset tona njeri më zemërbardhë e më të mirë sesa Malush agai. Pa edhe njerëzit e kishin në krye e sipër e i kishin nxjerrë këngë që në të gjallë.

Kur e pa se do të përpiqeshe ballë për ballë me Malush aganë, sado abrazh që ish, Olloman beu i vuri gishtin kokës e u mundua ta ëmbëlsojë punën: i dërgoi fjalë të zbriste që të merreshin vesh bashkë.

«Ne jemi njerëz mali e nuk zbresim dot në fushë, se s'na lë driza, – i tha Malush agai njeriut të beut. Po të dojë beu të flasim, le të ngjitet këtu, lart.»

Kur dëgjoi fjalën që i kish dërguar Malush agai, beut i hipi gjaku në kokë e mend i ra pika. S'e nxinte më as lëkura, as konaku, as tërë vendi. I ziente zemërimi në

zemër, sindozot zien jashtë fërtyma e kolozhekut. Po me-
që e dinte se Malush aga Katunishti s'ishte burrë i paktë,
nuk e prishi menjëherë. Nisi i dërgoi ca trima, me të
fala, që Malush agai t'i jepte në dorë fusharakët që ki-
shin ikur nga çifligjet: «M'i jep mua, në dorë ata derra
bulq, pastaj shohim e bëjmë...» Kështu bëri një herë,
kështu dy, tri, po gjithnjë trimat u kthyen duarthatë:
Malush agai nuk ua dha njerëzit. Ca nga trimat e beut
u kthyen, ca s'u kthyen fare, mbetën në mal.

Kur e pa Olloman beu se po i binte vula poshtë, u
bëri emër trimave të lanin mirë armët, të mbushnin vez-
met me barut e plumb, dërgoi njerëz të qëronin udhët,
pastaj ia mori përpjetë në mes të bylykut, ca kaluar e
ca më këmbë.

Mirëpo Malush agait i kish rënë në vesh fjala se beu
donte t'ia shkelte fshatin e i doli përpara me pesë veta,
më këmbë (të tjerët kishin zënë vend atje ku duhej, që
të mos linin të fluturonte as zogu).

— Erdhe, o bej? Hajde, me këmbë të mbarë! Ne të
presim me sofrën shtruar, — i tha Malush agai e i dha
një tunjatjetë burri, me kryet lartë, me trupin drejt, si
lis.

— Tunjatë, Malush aga, — ia ktheu Olloman beu edhe
mbajti kalin.

Tashi na ishin ballë për ballë: aty poshtë, Olloman
beu me dyzet e ca dyfeqe; atje lart, Malush agai me
pesë veta. Ky ish një burrë i thyer e pak si i thinjur, po
kolonë: kish një sy të fortë që e vriste trimin me një të
parë. Syri i tij bënte sa për njëqind dyfeqe. E na kish
Malush agai një shkop thane në dorë, me kërrabë, e një
pishqollë në silahe.

— Mirë se na erdhe, Olloman bej! Të them mirë se
na erdhe, në vjen si mik... Derën tonë e ke të hapur.

Edhe e shikoi me një sy kaq të fortë, sa beu, nga
ulk na u bë qengj i butë.

– Në ke ardhur ndryshe, e mira e së mirës është të mos bësh një çap përpara, se...

Olloman beut iu drodh xhufk' e festës fër-fër, si dri-dhet maja e kallmërit kur fryn era. Pastaj, dalngadalë, e mblodhi veten, u hodhi një sy trimave, që prisnin urdhër e tha:

– Kam ardhur si kam ardhur, kjo është puna ime. Po ti, o Malush aga, të bësh mirë e të më japësh në dorë ata qena rajenj e ata derra fusharakë, që kanë lënë parmendat e kanë rënë në strehën tënde. – Të më japësh se ndryshe, besa, ke të bësh me këtë kockë! – edhe i ra gjoksit me grusht.

– E shkele fare, o Olloman bej i Karafil Agollit. E shkele, e zure të lëndosh thellë. Këto viset tona, o bej, kanë hequr të zitë e ullirit, me kamje e skamje, me jetë e mortje, po nuk janë turpëruar kurrë, veçse në ditët e tua për punë nderi... Turpi qoftë yti e i oxhakut tënd, se edhe ti je nga këto vise. Turp, besa, turp!

Zëri i Malush agait, që zakonisht ishte i butë e i ëmbël si bar për plagë, tani qe egërsuar si një përrua mali, kur zbrat poshtë, vjeshtës, shkëmb më shkëmb.

– E ç'kërkon të na bëhesh ti, o bej? Ali Pashë Tepelenë kërkon të na bëhesh, ë? Po as Ali Pasha, që kish qenë pasha me tre bishtërinj, nuk shkeli kaq vëngër siç po shkel ti, o Olloman bej! Dëgjo të të them një fjalë: unë s't'i jap në dorë ata që më kanë kërkuar strehë e krah edhe sikur ta di se nuk do të mbetet gur mbi gur nga shtëpia ime!

Pastaj u kthye e u foli trimave të beut:

– Po ju, bre, si u bën zemra të bëhi qojle e vegla të këtij katili, që i punon qindin këtij vendi? Më thoni: si? Beu na zhvesh e na vret vëllezërit, beu na rrëmben e çnderon motrat, edhe ju: peqe-lepe! Përse? Për një koromane! Turp, bre, se edhe ju keni pirë sisë nëne e keni ngrënë bukën që e bën bulku!

Nga të dyzet e pesë trimat e beut, ca unjën kryet, ca kthyen sytë në të djathtë e në të mëngjër, se nuk guxonin ta shikonin Malush aganë.

— Po ti, o Lite, ku e ke mendjen? Kështu të ka porositur yt gjysh, që e kam pasur si baba, në krye e sipër? Edhe, yt gjysh i kish dalë njëherë e njëkohë zot këtij vendi, kish luftuar gjersa ish vrarë. Po ti, o Zenel? Edhe ti, o Kajo? Sa turp!

Atëherë disa nga trimat e beut i kthyen kurrizin Olloman beut, iu afruan Malush agait, kokunjur e i thanë: «Na fal, Malush aga. Ç'bëmë s'do bëjmë. U gënjyem.»

Beut iu drodh buza, siç i qe dredhur xhufka e festës. E si të mos i dridhej, kur pa se me një fjalë goje, Malush agai i mori gjithë ata trima? Malush agai, që s'kish në dorë veçse një kërrabë e në silahe vetëm një pishqollë...

— Jua bëj haram bukën! — u thirri beu trimave.

— Bukën e bën dheu e bulku. Me djersën e ballit. Ti nuk ua bën dot haram, se s'është jotja. Po të jetë për haram, ti, Olloman bej, je i pari që e ke haram këtë bukë, se e hëngre dhe e shkele.

Tre sejmenë kaluar vunë dorë në pishqollat e brezit e i nxorën që t'i binin Malush agait, po namëta ranë, që atje ku ranë shtatë e tetë dyfeqe bashkë edhe të tre sejmenët u rrëkëllyen poshtë, në këmbët e kuajve, përpara se ta shkrepnin. Kuajt mbetën pa zot e morën ta-tëpjetën.

Kur pa se qe kthyer fleta, Olloman beu ktheu kalin e mori poshtë në mes të bataveve të dyfeqeve që zbraznin në erë trimat e Malush agait e që thërrisnin me të tallur: «Isa-ha! Isa-ha! Zere, laro! Kafshoje, balo!» Beut i tundej në erë xhufka e zezë e festes së kuqe. Edhe ikte, ikte... Pas tij iknin ata njëzet e ca lanxho, që i kishin mbetur besnikë gjer në fund. Ama trimat e Malush agait, që kishin zënë tërë grykën, kishin dalë nga pusitë e u

thërrisnin: «Isa-hal! Isa-hal!» sikur t'u ndërsenin qentë e stanit.

Iku beu, si i thonë një fjale, me bishtin ndër shalë. Ama ish bërë tym e zjarr nga zemërimi. Kjo ishte hera e parë që kish gjetur sharra gozhdën.

... E ku je ti, more, ku je ti, se ç'ka ndodhur pas asaj dite në viset tona! Shkuan bumbashirët në Manastir e nga Manastiri brenda në Stamboll të shpien fjalën se Malush aga Katunishti ngriti krye kundër mbretit. Vetë Olloman beu u ngrit e shkoi me një torbë lira që të kërkonte imdat. Solli taborë me bashibozukë, topçinj e kumbaraxhinj e ku ta di sa nizamë të tjerë. Me që nuk u zinte më besë atyre të vendit, dërgoi e solli nga Dibra njerëz që i paguante me ylefe të madhe.

Plasi lufta. Bam këtu, bam atje, ditë e natë. Po ku e zinte plumbi Malush aganë? Nuk i druhej, po nuk e zinte. Pa edhe njerëzit e tij nuk e kursyen gjakun: fu-sharakë e malësorë bashkë, çobenjtë e maleve.

– Ashtu, ashtu! – ia bëri hanxhiu duke nagasur zjarrin. – Më ka thënë babai.

– U vranë nga të dy palët e nuk fitoi asnjëra. Më në fund, erdhi kartë nga Stambolli se mbreti kish zënë luftë s'di me kë e thosh që të dy palët – Malush agai e Olloman beu – ta linin të tyren për më vonë e të vinin ta ndihmonin mbretin. Erdhi edhe një ferman i madh që thosh se Malush agai ishte i falur, të mblidhte trimat e të shkonte në luftë për mbretin.

– Malush agai nuk i zuri besë e nuk shkoi të luftonte për mbretin. As Olloman beu nuk shkoi, por mblodhi e i dërgoi redifë e bedelë. Lufta u platit, pothuaj u shojt fare. Olloman beu nuk i ra më Malush agait, as Malush agai nuk i ra Olloman beut. Njerëzit punonin në mal e në fushë. Mirëpo uji fle, armiku s'fle. Olloman beu solli edhe njerëz të tjerë me ylefe. Këta i zunë njëherë pusi Malush agait në gryka ku lajthitët ju udhën qëparë,

kur deshët t'ia merrnit me të prerë, ne ai Lisi me dy bigla. Pas ca ditësh, kur beu kish shtruar drekë të madhe, nga gazi, një i biri i Malush agait ia lëshoi flakën mes për mes. E vrau.

Pastaj prapë taborë me bashibozukë e nizamë, e rrethuan Katunishtin. U luftua sa u luftua me plumb e zjarr e më në fund u nxehën këta burra e dolën sheshit, u prenë me jataganë... Fitoi turku: pashai i Manastirit...

Xha Martini këputi fillin e rrëfimit e mbeti i mekur me sytë në çengeli i vatrës. Kur filloi sërish, dukej shumë i lodhur e më plak se ç'ish.

– Po, u vranë, u shuan. Të nipin e Malush agait, që ish shkëndija e fundit e vatrës, e morën e e shpunë në Rabistan, atje ku piqet dheu me qiellin. Atëherë Hodua – se Hodo i thoshin të nipit – ishte i vogël: shtatë a tetë vjeç. Atje e mbajtën, atje e rritën, atje e martuan. Pas njëzet e ca vjet, turku e dërgoi kajmekam në viset tona. I thoshin Hajdar efendi...

Xha Martini fshiu ballin e dirsur, tundi dy a tri herë pëllëmbën e hapur përpara syve të përdëlisur, sikur të desh të largonte errësirën.

– Ëh, more djem, i keq qenka ky i verbosur dhe i huaj: ta merr gjuhën e nënës, ta shtrembëron shpirtin, ta prish. Atje, larg, Hodua i Katunishtit e kish harruar fare shqipen tonë, fliste vetëm turçe e arapçe, me terxhuman. Shumë thoshin se e dinte, po nuk desh ta fliste, se i vinte turp t'i thosh vetes shqiptar. Kajmekam Hajdar Efendi Katunishti u përpoq me mish e shpirt të shtronte malet nën këmbët e mbretit të turkut e të bejlerëve. Hajde-hajde: malet që kish mbrojtur i gjyshi, Malush aga Katunishti!...

Jashtë kollozheku ish ngritur më këmbë me të bijtë e të bijat e me soj e sorollop e bënte gjëmë të madhe që të shembte e të zhdukte çdo gjë të gjallë. Fjalët e fundit

të xha Martinit u shojtën me pishën e fundit të pishtarit e me plloskën e fundit, që mbeti e zbrazur. Llavat e ujqve, që i vinin rrotull hanit, alurinin, sa të kallnin lemerinë. Tufani frynte nëpër hatuj.

Zgjata kryet në oxhakun dhe pashë qiellin e kthjellët si pikë loti. Hëna ndriçonte flokët e dëborës që zbrisnin poshtë duke lojtur valle. U pështolla me gunën e tharë e bëra si gjithë shokët: rashë të flë. Fjeta e u zgjova, fjeta e u zgjova, sepse më dukej sikur dëgjoja të thirrura e të lebetitura. A mos thërrisnin njerëzit e gozhduar të gjallë në ato kamaret e avllisë të hanit të Olloman beut? Kushedi...

Shkruar në Bukuresht, 1938

Ripunuar më 1965

Natë marsi

Në motin e zisë, kur u bë fir gjysm' e botës e u derdhë për tatëpjetë gjithë fshatrat, u javit në Liqeras një plakushe e veshur krejt në të bardha. Zbriti drejt në shtëpi të Kote Komit ku gjeti një nuse që bënte vegël e i foli – më shumë i thirri se i foli, se zëri i saj ishte nga ata të njerëzve të malit:

– Nuse moj, a mos je ti, moj, e mbesa e Qyranës?

Nusja u ndodhke me shigjetë në dorë sa ta hedhë në gojën e majës edhe kështu si u ndodhke, ia dhënke përgjigjen:

-- Unë jam, moj zonjë...

– Ndë je ti, as më dëgjo, moj, të të them një fjalë goje: Unë, moj, kam qenë mike e motër me ndie-zot tët gjyshe. Kemi luar e kënduar bashkë këtu poshtë e atje lart në Bubullimë, sa jemi lodhur. Kur ka qenë gjallë e në jetë, më ka thonë se po të rrxohem nga fshati, të vi e të rri në të mbesat. Tashi unë erdha. Ku hyra, hyftë vetë Ristozi – i paçim uratën! – u mbushçin hambaret, u rritshin djemtë, u martofshin cucat!

Vazhdoi kështu, pa marrë frymë, me një torbë urime për njerëzi e bagëti, me sytë drejt në kora e Shënkollit. Goj' e saj ish qerthull-e-rodhan-bashkë e zëri i kish tingullin e ashpër të fshatrave afër Shkumbinit.

Nusja mbeti në fillim nemo-nemuçkë, me shigjetë në dorë, sikur ia pat kobuar plaka gojën. Ra pastaj më vete edhe foli:

– Uu, moj zonjë e Bubullimës, po ndë të paska thënë kështu ime gjyshe, miserdhe edhe e paç këmbën e mbarë. Shtrohu e rri si në shtëpi tënde. Ne një copë bukë që do na japë zoti, do ta hamë bashkë, zëre sikur m'u ngjall ime gjyshe, edhe...

Foli kështu nusja me shami gushpëllumbi në kokë edhe shkeli këmbën: krik-krik! bënë shkripeckat, fiu! – fë-shëlleu shigjeta që mënjanë më tjetrën edhe drang, – krehri, sa lojti vegla gjithë, edhe, së bashku me veglën, edhe çengeli i oxhakut.

Fëmija e vështruan me të drojtur si gjë mali edhe u hoqën më një çip të shtëpisë, mbi një tog hind e majë. Plaka u shtrua si pa gjë të këq në këndin e miqve, edhe nusja i vuri përpara bukë e djathë në misur, piperka turshi e arme në kupën e drunjte edhe i afroi bukin' e ujit.

Plaka uroi sa munda, me sytë ne kōra lart, bëri një kryq të madh e dy të vegjël, hodhi pastaj mbi krye çipet e leveres edhe filloi të hajë, se dukej e urtuar fort.

Befas, në mes të bukës, u hodh përpjetë edhe foli:

– Uu, më verboftë i sotmi! Harruash kolën ne portal Oburra o çuna ta shkarkojmë!

Një çun ish në shtëpi, një çun i vogël e dy cuca, po veç atij i foli plaka.

Kali, një copë kalë i murmë, me bishtin gjer përdhe, si ata të malit, rrinte në streha. Dy-tre djaj nga të fqinjërisë i sillëshin rrotull si grera që t'i shkulin leq. Një belcë e bardhë me theka e vija së zeza – mbi samar; një palë hejbe, një andej, një këndeje – në kocaqe; dy torba larushe me rraqe të vogla; kjo ish barra që kish kali i Plakës.

– Kaq munda, moj motër, kaq mora. Të tjerat, ç'kish

shtëpia i bonë plaçkë. Si bonë plaçkë vunë zjarr, që zjarr paçin në shpyrt dit' e natë!

Kështu pat zbritur në Liqeras plaka e Bubullimës. Emri i saj ish Qyrana e Thodrit, po bota i thesh Plaka e Bubullimës.

Nuk ish e gjatë fort, po e lidhur mirë në trup, edhe gdhe e fortë, se kish pirë ujë mali.

S'e kish për gjë as shinikun, as killën.

Vetë ngarkonte, vetë shkarkonte – si burrë e shkuar burri. Një vastangare të kish pranë edhe mbaroi puna!

Të fortët e saj i dukej në fytyrë, që i bëhej lulekuq kur përvishte krahun për punë.

Vishej krejt në të bardha, si graria e Mokrës: shami të bardhë për të lidhur flokët; dylben të bardhë përmbi shami, lëshuar mbi gërsheta e mbi gunë; gunë mëngë-gjatë të bardhë gjer më gju; këmishë të bardhë gjer në kërci. Mëngët e gunës i mbante të lëshuara prapa si mëngë-çepkene. Mbathej me çorape të bardha thurur me meqesme – si qëmoti – e me opinga të lehta të bëra me dorën e saj, lidhur me ovgjala, ndënë gju.

Mesit lidhte një tërkuzë kërpi të thurur me dorë.

Zuri vend në një çip të shtëpisë, ku nxori e radhosi ato të paka rraqe që kish zbritur edhe korën e zotit Shenkoll tymosur po jo djegur...

Nuk shkoi kohë shumë, edhe plaka zuri vendin e gjyshes në shtëpi të Kote Komit. Kënaqej me pakëz, se ish moti i zisë kur bota hante bukë elbi përzier me koçan të bluar a bukë ujemi me egjër shumë.

Plaka i ndihte nuses në punët e rënda, edhe kish mbi vete punët e jashtme. Jo rrallë, kur s'kish luftë, merrte kalin edhe shkonte për dru, në korije.

Kur i zinte egjri, nusja me fëmijët dremitnin e në dremitje e sipër u dukej sikur vërtitej shtëpia, sikur ngrihej e ulej tavani e sikur Plaka e Bubullimës, e madhuar njëzet herë, lonte valle me shami në dorë...

Si u dilte egjri, Plaka u rrëfente fëmijëve, me atë gjuhë të ashpër që kanë fshatrat afër Shkumbinit, ngjarje të lashta – me luftra e gjakra të mëdha. Përveç fjalës, i vij ndoresh për sende shumë: shëronte bagëtinë e njerëzisë me të kënduara, bënte linjë e prokavë në vegël, thurte tërkuzë.

E njihnin gjithë njerëzit e Liqerasit, si nga ana e nga vromi. Edhe ajo i deshte të gjithë.

Njëherë kjo Plaka e Bubullimës pat ngashëruar gjithë anën e sipërme të Liqerasit tonë. Varrosej asaj dite një djalosh i vrarë në udh' e sipër prej një gjakatori që i kish zënë pusi në ferrë. Tre plumba manxeri i kishin marrë jetën- edhe pas jetës: qesen, mëngoren edhe opingat.

Djaloshin e lau me lot e ëma, e qau farefisi, e qau fshati gjithë... Po më fort nga të gjithë e qau Plaka e Bubullimës. Vaji i saj buçiste që brenda e stolisej me fjalë që të bëjnë të lotosh dhe ti, i huaj. I kujtonte të rinë e bukurinë; i kujtonte dhëndërinë që s'u dhëndërua; nusërinë që s'e gëzoi dot; i kujtonte zhurin e nënës e të babës e gjithë farefisit, emër më emër. Edhe si mbaroi me të gjithë e si mallkoi gjakatorin, u anua mbi qivur, me dylben e bardhë unjur mbi ballë e nisi t'i flasë – me kuj e vaj – për djemëri e nipëri:

*T'i thuash tim biri, – o bir-o!
Se m'u shojt kandili, – o bir-o!
Se m'u shojt kandili, – o bir-o!
E më lojt fiqiri, – o bir-o!*

Plagë të vjetra që s'mbyllen kurrë, hapeshin përnjëmend edhe rridhnin rishtaz gjak.

Një lutje të fundit u dërgonte së këndejmi Plaka e Bubullimës.

*T'i luti Shërmillit, o bir-o!
Të më mar' e mua, o bir-o!
Këtë sterrë-jetë, o bir-o!
S'kam përse e dua, o bir-o!*

Aq mallëngjenjës pat qenë ky vaji i Plakës, sa bota gjithë, me uratën në krye, ia krisën vajit të ri...

Shumë lot kanë pikuar asohere në dhé si pika e qiririt. Vajtoi i madh e i vogël jetën e hidhur të njerëzisë, të shtypur e të shkelur ditë e natë, po më fort vajtoi Plaka. Kur e ngritën nga dheri kish vija të mavia ndënë sy edhe shkelte vëngër, sikur e kish zënë egjri...

Brenga e madhe e atij viti të zi ish buka.

Shembej foshnja e burri përpara teje për një kothere bukë e s'kishte qysh t'i zgjatje dorën. Bota ish plot me lypës veshur në thes, të zbritur nga ana e anës dhe hambaret bosh.

Prandaj kur erdhi fjala se doli misër në Gostivar – katër ditë të vajtur, pesë të ardhur, kush më këmbë e kush më gomar – bota gjithë ment u çmend nga gazi. Vrapuan andej pleq e të rinj, femra e meshkuj, kush me thasë e kush me torba.

Ai që kish një copë kalë a gomar që shkante kaluar e vinte ngarkuar më dysh, ish mbret më vete!

Asohere Zonja e Bubullimës që vështronte qysh trenen dita ditës fëmijët e Kote Komit duke gënjyer gojën me erën e bukës, ka marrë kalin bishtgjatë edhe ca meshxhite që kish mbledhur nusja, ka vënë gjashtoren brezit edhe ka marrë udhën e Gostivarit.

Vetë ka shkuar, vetë ka ardhur, se rruga e saj shkante nëpër Dibër, ku duhej të pyeste ç'bën Aziz Gega...

Po s'kish arritur në vend, kur fëmija filluan ta presin tej Vërzave. Vinin dita me ditën, gjersa Plaka çatisi përpara shokëve me një barrë misër në kalë – sa për

dy herë dyzet mexhite – e me një shinik të hedhur mbi kurriz.

Pa kur ka hyrë ky drithi në shtëpi e kanë puthur të mëdhenj e të vegjël... Edhe në sytë e tyre kjo Plaka e Bubullimës dukej si Shën e Diela e përrallave që vjen e ndihmon të urtit e të vojturit. E kanë shpënë me bujë të madhe në mulli edhe kanë ndenjur atje të shohin qysh bluhet kokërr pas kokrre e të ndiejnë erën e ëmbël të miellit. E si ka hyrë mielli në shtëpi brenda, kanë pritur të dalë që ndënë saç misërnikja e ngrohtë që ia shkonte asohere hojit të mjaltës. Se buka e misrit s'kish tani as egjër që të deh, as koçan që të ballos...

Gëzimi u përhap pastaj që lart e poshtë se u kthyen njerëzia të ngarkuar me drithë.

Kështu ka hyrë asohere marsi edhe fëmija kanë vajtur me gaz për zoga, me verore në byzlykn' e dorës.

Tani bota priste bukën e re të mbirë nga dheri edhe Plaka blinte një manxer të zjarrit, se i kish gjetur gjurmën Azis Gegës, brenda në Dibër, e desh t'i çojë të fala nga malet afër Shkumbinit. T'i çojë të fala e t'i thotë sa vlen paja e cucave, sa mban zjarri i shtëpisë e sa bën gjaku i rajasë kokështypur.

Kishin dalë asaj kohe shumë njerëz, që thoshin se u afrua fundi i botës.

Një thuthuq i hollë, i gjatë, rrëfente se s'di në cilin katund një ka i mbrehur i kish folur e thënë të zot:

– Ore im zot, mos më puno fort se kështu e njashtu, erdhi fund' i botës.

Një tjetër – kuqal ky, me gjashtë gishtërinj në këmbë e me një barrë preka në ballë e në faqe – paska hapur fjalën se aty afër një gjarpër paska qëndruar më këmbë qirithi e i paska thënë një gruaje që kthehej nga arat:

– Mori grua, deli grua! unë po të them se po vjen fundi i botës me sqfur e me katran.

Rrëfenin pastaj se në Devoll e tatëpjetë paske dalë

çinmaçini me kalakulë e se ishin lëshuar me satër në dorë për të therur botën.

Kështu thuhej e flitej asohere në motn' e zisë kur u firos gjysm' e botës nga sëmundjet e nga buka.

Një natë ranë ca miq në shtëpi të Kote Komit edhe fjalë pas fjale folën kush për thuthuqin e kush për kuqalë.

– Mbaroi bota, – u hodh e foli një burrë i thyer me leshra të thinjura. Erdhi koha të themi: hapi varre, ngrihi të vdekur të hymë të gjallët!

– Jo, mre, jo! – i thirri Plaka e Bubullimës. – Nuk u prish bota kur vajti gjaku gjer në bark të kolit, s'ka qysh priset tashi.

– Kur ka vajtur gjaku në bark të kalit, mori nëne?

– Kur ka hyrë turku në viset tona! Në bark e mo lart ka vajtur, po bota nuk mbaroi e s'osht shuar, se ai i lartmi rri e shikon që atje ku oshtë. E si shikon, vë dorën, i paçim uratën!

E meqë njerëzia iu lutën të rrëfejë si ka ngjarë kur ka ardhur Turku, plaka hyri në valle edhe foli:

«Kur ka hyrë Turku në viset tona, i ka çuar fjalë njatij të zot të Bubullimës:

– Ho, mre! Hap rrugë t'i bie Latinit me kreshtë e ty të fal të gjallë!

Ky i zot i Bubullimës, Kostandin ia thoshin emrin, oshtë ngritur e thonë Turkut:

– Ho, mre Turk! Dua tri ditë ta rraf mendjen si e qysh.

Tri ditë kërkoi, tri ditë i dha Turku.

Si shkuan tri ditë, Turku i ka çuar e thonë:

– Hap, mre, rrugë se përndryshe – për atë qime! – të boj shesh e londinë!

Edhe Kostandini i Bubullimës i ka thonë:

– Ho, mre Turk! Unë rrugë s'hap, se kam dhonë besë Latinit me kreshtë edhe kanuni s'ma jep ta shkel

besën. Në do rrugë shko tutje nëpër mal a në je burrë, hape vetë, se burri për luftë oshtë borë.

Ka mbledhur pastaj gjithë këta trima me xhoke, se ish zot mbi dyzet e kusur fshatra e mbi Gur-Top e u ka thonë;

Ho, mre, ho! Bini, mre, Turkut! E ç'plaçkë boni e mbani për vefte.

E të gjithë i kanë ronë Turkut si tha Zoti i Bubullimës.

E si i kanë ronë, më s'mbeti turk i gjallë që nga Bubullima e tatëpjetë. Të vdekurit i hongër galat në brigje e grigje, të gjallët ikën ne Moll' e Kuqe.

Plaka fliste me zë të ashpër si rrëke malesh edhe një e dy «ho, mre, ho!» – nëpër hundë.

– I fortë paska qenë, foli një nga ata që e dëgjonin. Edhe trim, se e mbajtke, megjithëse latinisht ia kish dhënë!

– I fortë, mre, e kush të tha se s'ish i fortë? Ai ka qonë burrë i pjellë, mre! Me kokën në tra, jo kërthi-një! Besën e mbante si burrat se për një fjalë që i dha Latinisht, zuri luftë me Turkun. Kur hiqte mamuzë me shtëng ia shkante trupit tejprtej, sa do i fortë të kish qonë trimi. Punonte shpatën e shtizën si kjo nusja furkën. I vinte keq turkut jo se i prishi njerzit, po se ky burrë s'ish turk që ta kish mbi krye e sipër.

– Ja, ja! – u çudit dikush në fund të odës.

Dhe u bë pushim

Ranë ca dyfeqe përtej edhe oxhaku u solli ushëtimën brenda.

– Një manxer e dy martina! – tha dikush.

– Manxer me llozë bosh! Ja njoh zënë, – tjetri.

– E ç'bëri Turku pastaj, si hëngri puparen?

– E hongri me shëndet e shkoi të mbledhë njerëz që t'i kthehet Bubullimës.

Si mbloodhi njerëz si miza i çoi prapë fjalë Kostandinit:

– Hap, mre, rrugë e kthehu me mua se të boj shesh e londinë.

– Unë rrugë s'hap as besën s'e kthej se më thonë nip kambane, po ruju, Turk, se të vrava!

E u bë pastaj luft' e madhe në kodra e male, sa erdhi Turku gjer në muret e Kostandinit. Po Kostandini me shokë i mori shpatullën edhe e theu, sa u mbush bota plot me të vdekur. Mbanin erë kërmë kronjtë e lumenjtë, sa u pëgër uji, po turku u prish. Si u prish, u ngrit e iku që ku kish ardhur.

Gojë pas goje i paska ronë në vesh mbretit të Turkut se Kostandini i Bubullimës me dyzet copë fshatra s'hap udhë për nga deti ku oshtë Latini me kreshtë derri. Udhë s'hap edhe turq vret sa do vetë. Si dëgjoji këto fjalë, mbreti u bo narden e s'hongri e s'piu asaj dite.

Si ndenj sa ndenj, mblodhi njerëz bylyk-bylyk, ca ka-luar e ca më këmbë, i hipi kalit edhe u nis për në Bubullimë.

Aty bori çadrën, vuri xhezven për kafe e çoi fjalë në Bubullimë:

– Mbreti kërkon të piqet me të zon' e këtij vendi.

– A na jep besën, mre turk?

– Ta jap!

– Mirë, ja po vij vet i tretë.

Edhe doli ky Zoti i Bubullimës e u poq me mbretin' e Turkut, brenda në çadra.

Folën ç'folën, ata vet e dinë, po për të marrë vesh nuk u morën.

Bota që ta këndon kartën në xhep, thonë se mbreti i Turkut kur paske parë këtë burrë sa një lis, u paske mahnitur e paske dashur t'i thotë vëlla, vetëm t'i hapë udhë t'i bjerë Latinit se oshtë i lig.

– I lig fort, po i kam dhonë besën.

– Latini s'ka besë e të lë në baltë.

– Latini s'ka, po unë kam!

E kështu u paskan ndarë.

Sa u ndanë, nisi lufta.

I ra mbreti Bubullimës me top gorrice nga ata të fortët. Po më të fortë se topi ishin burrat që luftonin me topuz në dorë. Turq vranë sa deshën vetë, po këta ishin si miza. Bamb e bumb! iu afrua Turku mureve. Turku mureve po matanë luftonin burrat e i ronë Turkut në shpatulla, sa ky e la Bubullimën e u kthye t'i ndjekë.

Kështu ka mbajtur lufta shumë ditë. Niste më të gdhirë e pushonte më të ngrysur.

Në luft' e sipër ky zot i Bubullimës i ka çuar fjalë Latinët:

– Më jep ndihmë, o Latin i zi, se po më çan Turku.

– Të jap, tha ky, po ja se pres nga deti të më vijë. Tashi të çoj vetëm të fala e bekime.

Po deti s'i dërçoi gjë e Kostandini mbeti vetëm me bekime në trajstë, ballë për ballë me Turkun.

Luftë ditë, luftë natë, iu pakësua krahu Turkut se e korrtë Kostandini me shokë. Ka çuar e dërguar pastaj mbreti i Turkut që t'i sjellin të tjera topa gorrice e të tjerë njerëz e oshtë betuar për këtë e për njatë se, po e mori Bubullimën, nuk pushon së vrari e preri, gjer mos i arrijë gjaku kalit në bark.

– Fundi, moj nëne? – pyeti një i nxituar të mësojë mbarimin.

– Fundi? Latini s'i çoi ndihmë, po vetëm fjalë. Kostandini ra në luftë si bien burrat edhe pastaj Bubullimën e mori Turku.

Si hyri Turku, zuri të therrë gra e fëmijë, pleq e plaka sa kish borë be t'i arrijë gjaku në bark të kalit.

Oshtë ngritur pastaj një plakë njëqind vjet e lart, Honë, ia thoshin emrin, Honë e bija e Mërtir Muzhaqit edhe i ka thonë mbretit të Turkut:

– Ho, mre Turk, mbaj dorën, mre, e mos vra fëmijët, se zoti!...

– Kam borë be, mori nonë, kështu e kështu, – ka thonë mbreti.

– Në ke borë be, mre Turk, haj, tha, të të zgjidh unë. Edhe e ka çuar mbretin në një gur të gdhendur thellë, ne kisha.

– Hyr, tha, këtu me gjithë kalë.

Edhe mbreti hyri.

– Merr tashi pallën e thermë mua. E pas meje gjithë pleqërinë e vendit, gjer të ngjitet gjaku ku do tinë. Po fëmijët na i fal.

Kështu bori.

Hipi gjaku gjer më bark të kalit edhe mbetën ca njerëz të gjallë.

Në s'ardhi fundi i botës, kur hyri Turku, më s'vjen kurrë. Dëgjuat a jo?»

Si mbaroi Plaka së rrëfyeri, u bë qetësi. Ranë prapë ca dyfeqe edhe oxhaku u solli oshëtimën, po askush nuk ua vari torbën.

Dhe në dritën e zjarrit kjo Plaka e Bubullimës sikur ish ajo Hëna e Mërtir Muzhaqit, që e theri mbreti i Turkut për të mbrojtur fëmijët.

Të nesërmen në mëngjes, me dyfekun më krah, plaka u nis për në Azis Gega t'i çojë të fala nga Bubullima.

Punën e mbaroi si duhej, po në Liqeras nuk u kthye prapë se shkoi drejt në Bubullimë t'u thotë varreve se Azis Gega s'është më i gjallë.

Bukuresht, 1938

Qetësi përpara fërtyme

Shtatë burra rrinin në shelgun plak të Çukës së Vogël, ku ndahet uji për të ujitur arat. Tre prisnin radhën, tre të tjerë s'prisnin asgjë, po rrinin aty për të shkuar kohën, sepse dita e gushtit është litar e gjatë kur s'ke punë. I shtati, apo më mirë i pari, Ago Zylali – plak thinjak e dinak – matte kohën me sahat, që t'i thosh sikujt se kur duhej të kthente vijën në arë a në kopsht, siç e kishin parë të udhës fshatçe ose siç e kish ndryshuar ai vetë për një shkak a tjetër. Këtë punë e bënte badihava, për shpirt e për rahmet, sepse vetë kish kohë që kish hequr dorë nga të gjitha të kësaj bote, pra ishte i ngeshëm. Ago Zylali s'kish arë a kopsht për të ujitur: të gjitha ua kish lënë djemve e nipërve, të bënëin ç'të donin. Këta i kishin mbjellë atë mot selishtat elb e grurë, i kishin korrur, i kishin lëruar prapë dhe i kishin mbjellë së dyti misër, që ish hazdisur si kallmri në kënetë, kish lëshuar xhufkë e kallinj të ngjeshur nga ata me bukë shumë. Thoshin se kështu ishte fara, se djemtë e nipërit e Ago Zylalit e kishin tëharur e prashitur me kohë, vetë e me argatë, po puna s'ishte as ne fara as ne shata. Dheu aty ishte i majmë, tul i zi, i plehëruar mirë me plehlope: vija e ujit i shkonte përkrye dhe, herë-herë, këputej vetiu, e tëra apo çika-çika, se e hiqte vendi... Po

ashtu ndodhte edhe në bostanet e në arat e tjera, kudo që ishin, sepse, siç thamë, vetë Ago Zylali, anëtar i kryepleqësisë së fshatit, ndante ujin, dhe si qenka e mundur të futësh gishtin në mjaltë e të mos e lëpish? Këtë mund ta bësh vetëm po të jesh budalla me brirë. Mirëpo as vetë Ago Zylali, as të bijtë e të nipërit s'ishin budallenj, sepse ky i uruar mjaltë s'është pak i ëmbël...

Veç kësaj, duke ndarë ujët e fshatit, Ago Zylali e kish në dorë t'i bënte ndonjë të mirë edhe miqësisë e stërmiqësisë, jo për shpirt e për rahmet, po për «mbajmë të mbaj, lajmë të laj» e kështu më tej.

Ata të tre që prisnin radhën ishin në të linjta, dua të them në brekë shumë të gjata dhe në këmishë gjithashtu të gjata e të gjera, të lëshuara mbi brekë, të spërkatura me ujë e të lerosura me baltë e me batak, të zbathur, të djegur nga dielli, thatimë, të parruar, me shatën pranë. Brekët i kishin ngritur mbi gjunjë e lidhur me lidhka, gati për të hyrë në çdo çast nëpër ujëra e baltëra; këmishët i kishin të shkopsitura në grykë e u dukeshin kraharorët e thatë, leshtorë, të nxirë.

Rrinin si në gjemba, të mërziur, të vrenjtur, sepse vapa e gushtit ia kish thithur dheut tërë vlagën, e kish bërë kroçkë e kish çarë vende-vende dhe po ua përvëlonte misrat e jonxhën, ua hiqte hajen nga goja, atyre vetë, fëmijëve dhe gjësë së gjallë. Pyesnin kur e kur, pra shpesh, sa ishte sahati, zbrisnin poshtë, llapashitnin këmbët në ujë e llucë, shikonin zilitarë ujin që rridhte e zhdukej nën gjerdhet e mbuluara me ferra e dëllinja, nëpër kopshte e selishta, dhe këto e përpinin si llamje. Edhe tre të tjerët i kish djegur shumë dielli, ishin të parruar, të zbathur, me ca zharga llastiku pranë – opinga të mëdha, të qepura me tel, si gjemi batalle, nga ato të moçmet, që i kanë batërdisur dallgët e fërtymat – po të qetë: njeri sepse e kish shkuar radhën dhe kish ujitur atë rrip are që i jepte emrin «bulk», dhe bashkë me këtë

emër, i jepte bukë misri për pesë a gjashtë muaj në mot, pothuaj gjysmën e idaresë, dy shoshë fasule e ca kosha kunguj të verdhë për të pjekur a zier në dimër, në vend të gjellës; tjetri sepse arën, një skërkë të varur në një rrëpirë shkëmbore, ku mbarsnin e pillnin breshkat, e kish lart në mal, pa ujë, kështu që të gjitha shpresat i kish lënë në dorë të fatit të shiut, që ishalla-mashalla mund të jepte zoti, po t'i tekej, dhe të vesës që sillte nata, dhe i treti sepse s'kish arë as në fushë, as në mal. Ish munduar ta bënin edhe sivjet pojak, po fshati kish zgjedhur një tjetër, që kish pasur rreth e miqësi më të fortë. Si rronte e si do të rronte ky? Hëpërhë i ndihmonte bazhdarit, që kish blerë nga bashkia të drejtën e tagrave për mallrat që hynin në pazar: u merrte nga një ose dy dru atyre që sillnin për të shitur ndonjë barrë, futte duart nëpër torbat e pazarakëve për të shkukur ndonjë lopkë, dua të them pagesë për vezë, pemë, fasule e kështu me radhë. Ditën e pazarit ruante poshtë e lart që njerëzit të shpinin bulmetin në kapani me pagesë e të mos peshonin jashtë. Ruante edhe pazarin e bagëtisë dhe kërkonte indisap.

Po Çuka ç'ish? Çuka s'ish veçse një tumbë e vogël dheu si samar gomari me gunga, njëfarë kinde midis një selishte me një arrë të rrëgjuar në krye, përbri udhës së madhe të fshatit, dhe të voglës, të lagjes, që bashkoheshin në cep të shtëpisë së Baba Rushitit. Kjo kindë e ngritur, që mbante emrin e bujshëm «Çukë» s'ishte veçse nja shtatë a tetë pëllëmbë e lartë, njëzet e ca pashë e gjatë dhe tetë e nëntë pashë e gjerë në njërën anë, më e ngushtë në anën tjetër, me një shelg degëvarur, për hije, një gorricë të egër, ca gjemba gomari e ca xhufka bari të thatë, të pluhrosur, që kishin dalë aty-këtu, brinjëve, ku nuk shkelte këmba e njeriut e nuk arrinte goja e bagëtisë që shkonte udhës.

Duhet ta marrim me mend se njëherë e njëkohë, kjo

tumbë duhej të kish qenë një çukë e vërtetë, shumë më e lartë, më e gjatë e më e gjerë sesa e sotmja, po njerëzit e kishin brejtur pak nga pak – dikush për të zgjeruar selishten e tij, tjetri për të marrë ca qerre dheu për plitharë, për të mbushur ndonjë gropë, për të shtruar ndonjë hajat a ndonjë odë, për të bërë ca baltë që të ndërtojë ndonjë mur a të lyejë ndonjë çatmë – siç ndodh gjithnjë në mall pa zot.

Ka ndonjë histori kjo çukë? T'ju them të drejtën, unë nuk di veçse shumë pak gjëra nga të rejat, të ditëve tona, të vjetrat i kanë ditur ata që kanë shkuar atje ku do të shkojmë të gjithë, kur të na vijë radha, ose i dinë pleqtë që janë edhe sot në jetë, po këta as i pyet njeri, as rrëfejnë pa pyetur. Tani, aty, në këtë kindë si samar gungaç, me atë shelgun plak degëvarur që zumë në gojë, mbliidhen njerëzit për të vënë në udhë punët e fshatit, shpesh jo të tërë fshatit, po vetëm ato të Lagjes së Poshtme, vijnë për bisedë, për të dëgjuar ç'ka në botë. Po aty rrinë shpesh këmbë mbi këmbë dhjetarët ose spahinjë, siç u thotë fshati ynë, sepse ashtu u ka mbetur emri nga koha e Turkut dhe, siç e dini, emri nuk ndryshohet lehtë. Rrinë, them, këmbë mbi këmbë, me defterët mbi gjunjë, bisedojnë sa t'i marrin këtij, sa t'i hedhin atij e sa t'ia ngjeshin atij tjetrit «më tetë një» (duhet ta dini se dhjetarët e fshatit tim nuk marrin një të dhjetën e asaj që bën dheu, po një të tetën, se kështu, thonë, ka qenë qëmoti, prandaj Halit kasapi, që s'mbjell e s'korr, po vetëm pi, pra s'ua ka frikën, u thotë «te-tarë» bile dhe «gjashtarë-gjynahtarë»), japin urdhër sa drithë e sa pare duhet t'u sjellë sikur për të lashtat e të vonat, për vreshtat e kopshtet, për pjergullat, për gështenjat, për pemët, luadhet, kullotat, për bletët e shumë të tjera të kësaj dore, ku duan t'ua shpien drithin, për sa shpirt t'ua shtrojnë drekë e darkë e shumë të tjera të kësaj dore. Dhe duhet të japësh doemos aq sa kërkojnë, t'ua shpiesh

drithin në hambar, që ku do ta blesh me çmim të dyfishtë, të trefishtë, mbase edhe të katërfishtë, në dimër a në pranverë, t'u numërosh paret në dorë, të shtrosh drekë e darkë me qengj e pula të pjekura e raki rrushi, për sa veta të thonë, sepse dhjetari është «gjysmë qeverie». Domosdo, dhjetar nuk bëhet kushdo, po kush ka harka të madhe, taraf të fortë, kapë mbi sy, një kobure në brez e një tjetër të varur prapa vitheve.

Gjithë aty vjen kohë më kohë edhe taksidari apo tagrambledhësi, hap defterët e vergjisë, të xhelepit e të udhës dhe thotë sa duhet të paguajë sikush. Të është shembur a djegur shtëpia? E ke vënë befa, me fajde? Të ka ngordhur gjëja e gjallë? Puna jote! Këto janë gjëra që s'i merr defteri. Paguaj si të thonë, pastaj shko e qahu ku të duash, me fjalë të tjera trokit në derën e shurdhit. Edhe taksidari është i fortë, me harka, gjithnjë i armatosur e me dy xhandarë pas vetiu. Bën urdhër: «Të më jepni paret, se unë ju marr çitjanet e grave! Ua zhvesh me dorën time e ua marr.» Kërcet ndonjëherë koburja ose dyfeku për një fjalë kaq të vrazhdë. Po, kërcet. Dhe ka krisur...

Aty, në Çukë, mbliidhet Lagjja e Poshtme për të zgjedhur kryeplakun e anëtarët e kryepleqësisë megjithëqë, ç'është e drejta, ata i caktojnë dy-tre burra nga parësia, myteberët, u japin vulën, e urdhrin se ç'të bëjnë, kurse të tjerët thonë «Aaamin!». Po aty zgjidhen edhe zgjedhësit e dytë, ashtu siç zgjidhet kryeplaku dhe anëtarët e kryepleqësisë, me urdhër nga myteberët.

Në këtë të uruar Çukë kërcet mot për mot – në verë të thatë – huri, shata e lopata, nganjëherë edhe koburja; gjakosen, vriten njerëz. Përse? Për punën e ujit. «Sot e kam radhën unë!» «Jo ti, po unë!» Pas fjalës, përfytja e huri, pas hurit – koburja e dyfeku. Rrahjet edhe përgjakjet e tjera, gjithë për punë të ujit, kërcasin arave e mezhdave, kur njëri ia këput vijën tjetrit. Me të drejtë e pa të drejtë – kjo është punë që s'dihet.

Po sa e sa gjëra ka parë Çuka e Vogël! Veç të moçmeve, të humbura në mjegullirën e kohës, ajo ka parë këto vjetet e fundit, që kur u prish Turqia, asqerët e thyer të uritur e të rreckosur të Xhavit pashës, (që atëherë ka mbetur në fshat shprehja: «Qenke bërë si asqer i Xhavit pashës», që i thuhet ndokujt kur është bërë copë e gojë;) ka parë ushtarët e Serbit që hynë në fillim me kapedan Kristiçin në krye dhe tri a katër herë të tjera s'di me cilin: vranë, dogjën, çnderuan dhe shumë prej tyre lanë, për këtë shkak, kokën gërxeve e gropave; ka parë ushtarët e Grekut, që qëndruan ca kohë në Pllaçë pastaj hynë këtej e mbetën gjithashtu gërxeve; ka parë ushtarët e komitetit mjekërzinj të Bullgarit (me kapedan Delon e Kosteneçit në krye, një shkurtabiq-trashaluq, kasap bagëtie, që u bë në vendin tonë kasap njerëzie), të cilët shkelën e shkretuan fshatra të tëra, shpërngulën gra, pleq, fëmijë dhe i shpunë syrgjyn, turpëruan, vranë; ka parë ushtarët e përzier të austriakut të butë e ata të gjermanit të egër, ushtarët gojëprishur të Frëngut, që hidhnin përpara, në luftë, marokenët shtatgjetë, algjerianët e tunizianët festekuq, me yll e hënëz trunxhi, senegalezët, që s'ishin mësuar me veri e dëborë dhe kërcëllinin dhëmbët nga të ftohtët, anamitet shtatpakë, që buzëqeshnin kur shihnin se s'merreshin dot vesh me vendasit. Shumë-shumë nga këta lanë kockat brenda dhe në rrethet e fshatit tim. Përse? Ndofta as ata vetë nuk e dinin...

Nga vogëlia ime e kaluar nëpër trazirat e luftërave, mbaj mend edhe një ngjarje shumë të hidhur: aty, afër Çukës së Vogël, u vranë më 1914 tre kolonjarë nga ata të Gani Butkës e të Zalo Prodanit, që kishin ardhur ta shpallnin Shqipërinë Shqipëri... Kolonjarët dëbuan Grekun dhe ngritën lart, në Kala, një flamur të madh, të kuq, me një shqiponjë të zezë në mes. Kësaj shqiponje «osmanllinjte» e fshatit dhe ata të rrethit, me Starovën në krye, i thoshin «breshkë» dhe e shikonin vëngër, sepse

donin hënëzën. Po aq vëngër e shikonin edhe «serbomanet», dhe «grekomanët», që donin kyaqin. Errësirë, vëllal Vetëm errësirë? Jo, edhe interes. Të parët e osmanllinjve donin të mbanin mallin që kishin e ta shtonin. Po ashtu edhe të parët e atyre të tjerëve. Thoshin se po të vijë «jona», do bëjmë kështu e kështu: do të hapemi e zgjerohemi në fushën e butë. Edhe një gjë tjetër: kralët derdhnin pare të madhe për hafijellëk e propagandllëk. Këta tanët s'ua dinin gjuhën kralëve, po i dinin tingullin arit dhe u qeshte buza për premtimet e mëdha.

Mirëpo kolonjarët doli i priti krahëhapur Myrto beu, një burrë shumë i gjatë ose shalapingo, siç i themi ne andej, gojëmadh, hundësamar, veshllapush, me një të ecur të përkundur, si lundra mbi vaië, tërë ledhe. «Mirë se ardhët, vëllezër! Shyqyr që pamë këtë ditë. Rroftë Shqipëria! Rroftë flamuri!» Hapi krahët i përqafoi, i puthi si vëllezër, i numëroi mirë e mirë, pa se ç'armë kishin e sa fishekë kishin e pastaj krisi iku, natën. Ku? S'dihet; nata është e zezë e nuk tregon.

Flamuri kuqzikuq valoi disa ditë dhe, pastaj, papritur, plasi dyfeku lart, në breg, në grendë, në Lodër, në Mbivreshtat, në Gur të Kuq, kodrave, grykave. Vinte Ethem bej Starova me Osman Çotën e sillnin hordhi të tëra errësire të shkulura nga gryka këtej e përtej Shkumbinit, të gënjyera. Me ç'armë? Me të gjitha: manxerë Turqie e manxerë Serbi, maliherë Greku, martina, dogra, shishane, stringa, shpata, kosa, lelekë, sëpata... Kolonjarët luftuan e u mbajtën si burra, po ata të përtejshmit ishin të shumtë. Dhe kolonjarët s'kishin fishekë, sepse Myrto beu me shokë kishin vënë punën në kallauz dhe kishin shtënë në dorë, afër Udënishtit, atë gjeminë me armë e fishekë që kishin sjellë nga jashtë, fshehurazi, Telemak Gërmenji e Memdu Zavalani, dhe ua kishin shpënë osmanllinjve.

Të mos e zgjatim: krisi lufta. Tym, erë baruti. Zalo

Prodani ra lart, në Breg, duke luftuar sheshit, më këmbë, shqiptarisht, me një nga të përtëjshmit, që kish dalë gjithë më këmbë, shqiptarisht, me të tre djemtë. Shqiptarë këtej, shqiptarë andej – po, vaj-vaj! u grinë të dy palët, vëlla me vëlla. Kolonjarët, që ishin të paktë, u prapsën, zbritën duke luftuar. Po me kë të luftonin më parë? Beshiri i Goricës me shokë u binte prapa krahëve, nga pusitë, nga avllitë, nga shtëpitë. Më poshtë u binin të tjerë: Mersini, Dyli e mbase edhe Ago Zylali.

U vranë, thashë, ata tre trimat, rrëzë Çukës, dhe njerëzit i kallën në gropë, të zhveshur, pa qefinë... Varret mos ua kërkoni, se nuk do t'i gjeni: trumbat janë sheshuar që qëkuri, përsipër kanë hipur ferrat e bari, që kullosin lopët. Më këteji, si u bë Shqipëria Shqipëri, brezi i ri i vuri udhës së Çukës emrin e Gani Butkës, siç i thonë edhe sot. Mirëpo duhet të dini se vetë Ganiu – hajde, trim hajde! – nuk është vranë aty. Ai ra andej nga Arat e Brahos. Kish marrë në luftë ca plaqë, ish ulur në mezhde t'i lidhte, të çlodhei. Dhe u çlodh për jetë e mot: e vrau një sahatçi osmanlli, strugar, nga dritarja, me manxer Turaië. dhe, si e vrau, u turr e zhveshi, i mori cizmet, armët. Shokët e tjerë, që mundën të hiaeshin xhadesë, drejt Pllocës, duke luftuar, i vranë bejlerët e Starovës, kardashët e Myrto beut, me të shtëna nga dritoret, nga ballkonet, nga baxhat.

Po ç'u bë Myrto beu? Kur zbritën poshtë hordhitë e Ethem beut e të Osman Cotës – ky mbante një feste të kuqe tonuze, me xhufkë ngjyrë manushaëe, shumë të ajatë, të derdhur supeve – në mes të tyre ishte edhe Myrto beu kaluar mbi një kalë të bardhë, me një këllëç Turqie, të zhveshur, në dorë, e me bajrakun e osmanllisë në dorën tjetër. Kish ikur me qeleshe të bardhë, me shqiponjë, dhe që kthyer me feste të kuqe me yll e hënë. Qëndroi në Shatërvani, në mes të bylykut, u ngrit në yzengji, tundi këllëçin e thirri sa i hante zëri: «Vëllezër

osmanllinj! Këtu Turqi ka qenë, Turqi do të jetë ngaherë. Ata zuzarët që i thonë vetes shqiptarë e kanë vendin në varr. Jashasën Baba Sulltani!»

Lart, në Kala, ra flamuri me shqiponjë, u ngrit një bajrak i madh me yll e hënë. Një tjetër u ngrit në Çukën e Madhe. Bajrakë të tjerë brenda në fshat... Memurët e qatipët e vjetër ose onxo-bonxhot, siç u thosh xha Mihal Gramenua, zunë vendet e mëparshme, me karabaçka turçe, me ylefëra e ryshfete.

Shqiptarët u pikëlluan shumë. Ata dy-tre krerë greko-manë-serbomanë, të bashkuar për hir të kryqit e të parasë, fërkuan barkun, u gëzuan. «Më mirë këta (osmanllinjtë e Ethem beut), sesa ata (shqiptarët e Gani Butkës). Po më e mira do të ish të hanin kokën të dy palët...» Krali i Serbit bënte sehir nga Shëndaumi, priste çastin të hidhej prapë këtej. Punonte hafijellëku, vinin urdhra: «Bëni kështu e prisni se do vijmë.»

Serbët – që i kishin halë në sy shqiptarët – e njohën menjëherë Ethem bejnë si «qeveri» më vete, e ftuan në Shëndaum, i shtruan drekë e darkë.

Myrto beu ngriti kadillëk në Starovë, për gjyqë. Zhvatte nga të dy palët: nga paditësi dhe nga i padituri.

Donomara. Dreka e darka. «Ti shtro për kaq shpirt, ti sill për aq.» Mishra të pjekura, bakllavara, më the të thashë.

Kaq?

Jo, ka edhe më. Aty ca vjet më parë, si mbeti Shqipëria Shqipëri, u ra në mend disave të ngrenë në sheshin e Tylbes së Kostandinit një rrasë përkujtimore ngjyrë hiri, ku ishin gdhendur emrat e trimave kolonjarë të vrarë për Shqipëri. U mblodhën shumë njerëz e u mbajtën fjalime. Atëherë ndodhi një çudi: doli ai beu i gjatë e veshllapush, Myrto beu, vetë dora, pak si i thinjur e i kërrusur, me borsalinë në kokë, nxori e shpalosi përpara gjithë botës një shami të bardhë, të madhe sa një qefin, fshiu

lotët që i vinin breshër, puthi me ngashërim flamurin, u përkul puthi gurin – një për një të gjithë emrat e gdhendur në të, duke filluar me emrin e Gani Butkës e atë të Zalo Prodanit – u ngrit, fshiu përsëri sytë, mbajti ngashërimin e thirri: «Vëllezër shqiptarë. Vendi ynë Shqipëri ka qenë Shqipëri do të jetë ngaherë. Armiqtë e Shqipërisë e kanë vendin në varr. Rroftë Lartmadhëria e Tij Mbreti! Rrofshin dëshmorët e kombit! Rroftë Skënderbeu!» Foli pastaj për Teftën e Pirron, për Lekën e Madh, për Skënderbenë, për Ganinë me shokë, po më shumë foli për Lartmadhërinë e Tij, të cilin e ngriti në qiellin e shtatë. Fjalimi i tij ishte kaq i zjarrtë, sa ment mori flakë tërë liqeni ynë i kaltër, me gjithë lumin e Rrethit e atë të Trahanit, dhe Blata e Starovës. I tha të gjitha. Vetëm një gjë nuk e tha: se si kish punuar hafijellëk e se si i kish vrarë trimat kolonjarë, në ç'plevicë ose hatull kish fshehur këllëçin e Turqisë dhe bajrakun e Osmanllisë, dhe kur kish ndër mend t'i nxirrte përsëri.

Të gjitha këto i di mirë Çuka e Vogël, ku ndahet uji për të ujitur arat, sepse disa i ka parë drejtpërdrejt, disa ka dëgjuar nga goja e atyre që mblidhen për të biseduar aty, nën hijen e shelgut degëvarur. Ajo di edhe një ngjarje tjetër të përgjakur: Telemak Gërmenji e Mendu Zavalani, që sapo ishin hedhur këndeje, fshehur, se i ndiqte krali i Serbit, nuk ikën dot për Korçë në luftë e sipër. Ata mbetën të mbyllur në shtëpinë e Rinkës të Silkës, mbi çezmë, dhe panë me sytë e tyre rrëmetin e errësirës së Osmanllisë të shkukur këtej e përtej Shkumbiut, Ethem bej Starovën kaluar mbi mushkën e Zalo Prodanit e me gunën e dhirtë të këtij hedhur krahëve, panë Osman Çotën, Myrto benë kaluar në kalë të bardhë me këllëç Turqie në dorë. Pastaj? Myrto beu dërgoi njerëz, i zuri, i lidhi, i hoqi tutje, të dy. Ku? S'di. Po di një gjë: pas disa ditësh njerëzit i pëshpërisnin njëri-tjetrit se valët e liqerit kishin hedhur anës dy kufoma – njërën

afër Tushemishtit, tjetrën matanë, në Shëndaum. Ç'ishin këto kufoma? Njëra ishte e Telemakut, tjera e Menduit. Duart e këmbët i kishin të lidhura..

Dhe shpesh, kur kujtoj ato kohëra të trazirta, më duket sikur këta të dy më dalin përpara, të gjallë, nga muzgu i kohës. Isha i vogël, aty afër çezmës, kur erdhi i mori Dulja bashkë me ca njerëz me dyfeqe e kobure.

Kish gisht Osman Çota në këtë gjak të ri? Luani vendit! Ai s'ish as bej as aga, s'kish çifligje. Ish njeri i varfër. Ai s'ish veçse errësirë... Nuk prishi, nuk rrëmbeu, nuk dhunoi. Të gjitha i bënë bejlerët vrasëtarë e rrëmbesatarë.

Vetëm gjëra të këtilla kanë ndodhur e ndodhin në Çukë?

Jo, shpesh, ndajnatave, si ikin pleqtë, e burrat, struken të rinjtë e ia thonë ndonjë kënge të moçme, herë shtruar, qetë, si ato ujërat e thella që flenë në liqer në një natë të ëmbël gushti, herë më të buçitur e uturuar, si ujërat e shkumbëzuara të pranverës, që rrokullisen tatë-pjetë Malit të Thatë. Të bukura, shumë të bukura, janë këto të uruara këngë të vendit tim, po, medet! – edhe këto flasin më fort për luftëra e vrasje vëlla me vëlla: se si njëri ia shkoi tjetrit flakën mes për mes, se si ia nguli plumbin në lule të ballit, se si e la të shtrirë që t'ia qitin sytë galat, se si e qanë dhe e qajnë e ëma, e shoqja, e motra.. Po këngë dashurie nuk këndojnë? Posi, posi. Me gojë e me fyell. Fshatarët e mi duken shumë të vrazhdë kur ndajnë ujin arave, kur grinden për punën e të dhjetave e të xhelepit, por këngët e ndjeshme e të dhimbshme. Njëri thotë se është gati të bëhet dërrasë e lug në krua, që të vijë ta shkelë syzeza vetullhollë, tjetri s'ka kujt t'i qahet për zjarrin që e përvelon dhe u qahet maleve me dëborë, kodrave e fushave me bar e lule.

Mirë, mirë, këto janë këngë, po dashuria ku është? E ku ta di unë i gjori! Ndofta është mbyllur në kafazin e krahavorit dhe del që aty me tingujt e fyellit e të zërit, natën, në hënë, kur hap gonxhet kumbulla e qershia, kur çel unapi erëmirë, kur fryn er' e malit që sjell amzën e athët të plisit, të rezhdës së gështenjës e sa e sa të tjera. E dëgjon, vallë, ajo që duhet ta dëgjojë – një çupërlinë cullufeverdhë, me sytë të kaltër si qielli i cingërimtë i dimrit, që e ka parë a ka lojtur me të në vogëli e që tani është rritur, pra rri mbyllur e nuk bën një çap jashtë portës, apo një tjetër, cullufezezë, me ca sy që të vrasin, trembëdhjetë a katërbëdhjetë vjeç, që ia ka zënë syri, s'di se si, nga ndonjë dritare, në kopsht a në lëmë, apo ndonjë leshgështenjë, që nuk e ka parë kurrë, po ia kanë lëvduar motra, kushërira e parë, teza, gjyshja, ose s'di se kush dhe atij i dukej kaq e afërme sikur ta paskej parë dhe njohur që qëkuri, i del në ëndërr, i qesh, e lë pa gjumë – kjo është punë që s'dihet. Dyert janë të mbyllura, dritaret janë të thurura me hekura përjashta e me kafaze përbrenda, ose anasjelltas; avllitë e gjerdhet janë shumë të larta dhe pas tyre ngrihen lart e më lart kosharet e misrit. Dhe djali s'gjen qetësi, shkon e vjen udhës, merr të përpjetën, sikur e kanë ngritur Të Bardhat (zot na ruaj!) Nuk e sheh dot atë që do, nuk e pjek dot, nuk i flet dot. Doemos, edhe përtej portave, përtej avllive, mureve, hekurave dhe kafazeve rrahin zemra të njoma, shkrijnë lot, ndërsa qentë e fshatit lehin me zë të trashë të thellë ose çafkëllijnë me zë të hollë.

Të pakta, shumë të pakta, janë ato vajza që ndodh të martohen me ata që duan. Të shumtat e të shumtave i martojnë prindërit e miqtë me mblesëri, pa pyetkë, pa përfillje, sikur të mos qenkishin qenie, po sende. Dhe rëndom nuk i martojnë (ata thonë i heqin qafe) brenda në fshat, në lagje, po larg, në fshatra të tjera, për

«harka», për të «forcuar rrethin e miqësinë». Vënë punën në udhë, lidhin fjalën dhe, kur çatis dita, mblidhen dasmoreshat, i vënë çupës këna e mazi, të bardhë e të kuq, bëjnë dasmë, i këndojnë nuses bukurinë: ballin e sedeftë, dorën e argjendtë, sytë e shkruar, vetullat e holla, buzën si bumbeskë trëndafili; i japin këshilla, e tapinosin mirë e bukur që të jetë e bindur, e shtruar, e duruar, pastaj vijnë krushqit, e hipin nusen në kalë a në pelë me samar të mbuluar me ndonjë copë qilimi të kuq me thekë – kur duhet ta shpien në ndonjë fshat lart, në malet, ose e futin në një qerre me qe, mbuluar përsipër me rrogoza e qilima – kur e shpien në ndonjë fshat fushe edhe hajt: u trashëgoftë e u mplaktë, «ku kallli këmbët i rënçin dhëmbët»! Ajo nuk shihet e nuk sheh, se është veshur e mbuluar si gogol, me ferexhe të zezë ose me çarçaf larush nga koka gjer në këmbët dhe e kanë hipur në kalë ose e kanë futur në qerre, që brenda në oborr. Shpesh – jo shpesh, por pothuaj gjithnjë – ajo ëndërron të gjejë, atje ku e shpien, një djalosh moshatar, syzi, sa dirsur mustaqja, dhe degdis në dyshekun e një mustaqepreshi, më i madh se i ati i saj, me dy gra të tjera, shemra, me shumë fëmijë, në odën matanë, dhe gjen «bij» e «bija» më të mëdha se veten. Dhe lot, vaj... Hapu varr të futem!

Të mjerat Nuriye, që s'gjejnë nur, të mjerat Shyqyrije, që s'gjejnë shyqyr!

Po Baba Rushiti cili është? – mund të pyesë ndokush. Oh, ju marr dorën e ju falem, mos ma trazoni baba Rushitin, se e kam mikun e gjyshit, moshatarin e tij. Mirëpo im gjysh ka një jetë të tërë që kur ka shkuar atje ku s'ka të kthyer, kurse Baba Rushiti rron. Doemos, gjysmë këtej gjysmë andej, në botën tjetër, pak si i shushatur, pak si i matufur, po dëgjon, shikon, pra rron. Dhëmbët i ka pa cënuar, të bardhë. Edhe leshrat i ka të pacenuara, të bardha. Dhe është i gjatë, me trup të drejtë. Vetëm në kohën e fundit kanë nisur t'i fryhen e t'i

buhaviten mjaft duart e këmbët, t'i bëhen topolake si kunguj Stambolli. Ashtu edhe fytyra: brumë qiçre i ardhur shumë, madje i kapërcyer. Dhe është rënduar, mezi çapet. S'e mban dot as stapi i fortë i thanës. Duhet ta zënë dy-tre veta për krahu, nipëri e stërnipëri, që ta shpien ngadalë në hijen e arrës, në një trung të madh, të luguar si fron. Rrallë e tek e nxjerrin ne porta jashtë, në sofat, që të kullosë sytë, të shohë botë, se ashtu i pëlqen. Rri, vështron, dremit, zgjohet; prapë vështron, prapë dremit, prapë zgjohet, e kështu me radhë. Kur e kur, vetvetiu, si rrufeja në të kthjellët, bën buzën në gaz dhe murmurit. Ç'thotë? Ku ta dish: vetë mendon, vetë ëndërron, vetë kuvendon e vetë dëgjon. Kështu gjer më drekë. Ama ta dini: drekën e do, nuk e harron kurrë. Dhe e do në kohë, me sahat. Me të kaluar sahati – sahat është hija e një plepi – nis i bie portës me stap që të vijnë ta marrin. Dhe ka uri, jo shaka. I pëlqen mi-shi i pjekur në hell e në furrë, i pëlqejnë të kripurat, të thartat, të ëmblat, të gjitha. Dikur ka qenë shumë i dhënë pas mjaltit; ashtu është edhe sot. Thotë se ia do shpirti. Ha mirë, dremit, zgjohet, shikon, shpie buzën në gaz, murmurit, prapë dremit.

Sa vjeç është xha Rushiti? Po ta pyesësh për moshën, ke për të parë se do të të shikojë me ata sytë e vegjël, të zbardhlyt si bryma e vjeshtës, të humbur thellë në brumin e fytyrës dhe do të të përgjigjet: «s'jam shumë. Ja, aty nja shtatëdhjetë. Dy më shumë a dy më pak. Jo, bir, unë s'e kam nga pleqëria. E kam nga sëmundja. Më ka zaptuar cerma, përdhesi.» Ashtu thotë ai, po bota qesh nën mustaqe, se baba Rushiti është tej qindit. Shokët kanë shkuar e shtruar konak matanë. Po ashtu edhe gratë. Ka pasur shumë gra, herë tek e herë çift; të gjitha i kanë vdekur. Po ta pyesësh cilën nga të gjitha do të zgjedhë të mbajë në botën tjetër, ke për të parë se do të shikojë i çuditur, nëpër qepallat e bardha e

do të të thotë: «Fjalë është kjo? Të pesta i dua. Të miat kanë qenë, të miat do jenë.» – «Si i do, Baba Rushit?» «Si i dua. Ashtu siç kanë qenë kur i mora: të reja, të bukura. E para, syzezë, e hollë si mënjollë. I thoshin... S'e mbaj mend... E dyta sybardhë, dorëborë, leshverdhë... Vdiq nga lindja. E treta, ehe! Ishte e gjatë, ballabane, leshgështenjë. E katra, e mbushur, e plotë. E pesta... Të gjitha i kam dashur, të gjitha. Fëmijë shumë. Kisha qejf ta kem ngahera shtëpinë plot me fëmijë: ca të rritur, ca të përkëmbur, ca në djep. S'rrri dot vetëm.» – «A të ka mbetur ndonjë merak në këtë jetë?» «Çfarë?» «Merak, qejf që s'e ke bërë...» «Merak, thua? Eh, më ka mbetur. Kam qejf të martohem edhe një herë, vetëm edhe një herë.» Mendohet, tund kokën e zbardhur si Mali i Thatë dimrit dhe thotë: «Njerëz jemi, ore. Të gjallë. I gjalli i do të gjitha. Po s'duan të dëgjojnë këta jezitë. Thonë s'bëka, s'paska lezet.. Po që të ngrish natën ka lezet? Ja, unë ngrij. A jezitet, jezitet!»

«Jezitë» u thotë nipërve e stërnipërve, se s'duan ta martojnë për të gjashtë herë.

Po mos ia merrni për të keq baba Rushitit. Është plak njeri.. I mirë si buka e ngrohtë. Në fshat nuk i është dëgjuar kurrë emri për të keq: s'ka vrarë, s'ka grabitur, s'ka futur spica. Bulk, ore! Arën e ka përmbysur e branosur qindra herë për të nxjerrë bukën. Ama gratë i ka dashur barabar me shpirtin. E si të mos i donte? Zeshkanet janë kaq të ngrohta, leshverdhat janë kaq të ëmbla, syblerat janë kaq turbullonjëse.

Po më falni: nisa të flas për Çukën e Vogël ku ndahet uji dhe degdisa, padashur, në histori e në dashuri. Zereni sikur s'i thashë këto fjalë e haj të kthehemi prapë.

... Pëlciste gjinkalla. Ata të shtatë rrinin të heshtur, hundë e buzë. Fjala s'mernte dot fill, ashtu siç nuk merr zjarr kashta e lagur. Ago Zylali ish munduar të hapte dy

a tri biseda, po nuk ia kish ushqyer askush. Dhe kështu, që të gjithë këta burra rrinin e shikonin në të djathtë a në të mëngjër e kush përdhe, tek rrëshpëronin vargje mizash dheu që mbanin ushqim për dimër, dëgjonin këllkishjet e gjinkallës dhe gurgullimën e ujit nëpër gurët e kthesat.

Pak më parë kish plasur një grindje e re për radhën e ujit midis Tares të Velës e djemve të Selmanit dhe kish lojtur shata e huri i gardhit. Qenë gjakosur ca koka. Kishin hyrë e i kishin ndarë miqësia, ata që u donin të mirën. I ndanë, po nuk i pajtuan dot. Dhe s'dihet ç'fill do të marrë puna më tej, ku ta dish se kur. S'është çudi, që me kohë e mot të flasë edhe dyfeku, se që të dy palët janë gjaknxehtë, të rrëmbyer e i bien gjoksit me grusht: — «Dale, pa ke për të parë!»

Kjo s'është punë e re, sepse kështu e ka uji në vit të thatë. Mot për mot, në korrik a gusht, derdhet qiak, vriten njerëz. Jo vetëm në fshatin tonë, po kudo, në fshatrat e malit e në ato të fushës. Ja, një iavë më parë, në Mokër u vranë me dyfek tre veta. Edhe këtej, matanë Plloçës, u kapanisën dy. Për Verdovën mos pyet fare: një e dy e bjeri me dyfek e kobure. Kur s'ke dyfek, krisja në lule të ballit me mykë e me hej të sëpatës, me kosë, me kopaçe e ç'të të zërë dora. Gjykatësi, doktori i bashkisë e xhandarët s'kanë orient se ku të shkojnë më parë tek rrihen, plagosen e vriten njerëz, Burgu është plot. Dhe duhet t'i mbajnë veç e veç, se edhe aty brenda... Prandaj ca i heqin tutje. Dhe gjyqë, ryshfete, ara që mbeten pa korrur, fëmijë që mbeten jetimë, pa bukë.

S'ke ç'bën. Ujë do të thotë bukë, pra jetë. Kur uji është i paktë, edhe buka është e paktë. Ose s'është fare.

Edhe kështu, këta të shtatë, kush i ngeshëm e kush i çngeshëm, kush i zbathur e kush me opinga llastiku nga ato të rrotave të vjetra të automobilave, të qepura me tel, rrinin të heshtur, të ngrysur, tërë hundë.

Doemos, këta njerëz xheç bluanin me mendje: ca mbanin anën e Tares së Velës e ca të djemve të Selmanit, sipas shkallës së miqësisë e të armiqësisë që kishin me të dy palët ose me miqtë e miqve të miqve e tutje më tutje. Tarafllëk, vëlla! Vendi të duket i qetë, i përgjumur në mes të nina-nanave të këlkishjeve të gjinkallave, të tungjatjetave e të merhabave me dorë në zemër e lart mbi ballë, të fjalëve të ëmbëltha ose pak si majhoshe, po brendapërbrenda zien si kazan me avull, që mundohet të hedhë tutje këltyrën, të shpërthejë jashtë, të lajë e shpëlajë çdo ndyrësi.

— Pa nxirrna edhe një herë atë qepën e Stambollit, o Ago Zylal, — tha ai që kish dashur të bëhej pojak, Shitja i Dylit, të cilit i kishin ngjitur nofkën Grendell, se ma kish kokën sa ajo Grenda e bardhë, që ngrihet mbi fshat.

Ago Zylali tundi kryet, sikur donte t'i thosh: — «Po ty ç'të hyn në punë të dish sa është sahati, o Grendell ruskudan e laskandur? Ti je rrip dauilleje; arë s'ke, luadh s'ke», po nuk i tha asgjë. Nxori ngadalë, hijerëndë, sahatin e madh të Stambollit, që e kish ndërtuar Gjermani, Japonezi a ndonjë malukat tjetër, duke e stolisur me yll e hënë, siç i ka hije një sahati të vërtetë Stambolli, e shkuli nga këllëfi prej meshini të butë, e shpuri ne veshi bashkë me kyçin e verdhë, si të artë, të lidhur me një fije otraje, që ta shihte në punonte a s'punonte, shkeli një sustë me thuan e nxirë të gishtit të madh, hapi këltyrën e parë, shkeli një sustë tjetër dhe çeli të dytën. U duk fusha e bardhë me shenja të zeza si ca gozhdë mushke nga ato të Kukë evgjinit. Agai ngrysi ballin, shikoi, numëroi me gishta, vrau mendjen e tha:

— Do edhe një e një çerek gjersa t'i vijë radha Sai-pit, do dy e gjysmë gjersa t'i vijë Danit të Lilos, po të mos e presë ndonjë, lart. Ti a do radhë, o Grendell?

— Jo, Ago Zylal. Radhën time jepja Cutes të vaditë

skërkat që të shtohen breshkat e hardhucat. (Cutja tundi kokën e psherëtiu). Ti s'e ke në dorë atë që dua unë. Ndofta edhe e ke, po s'do.

— Pojak, thua? E di se ta kënda të tundesh me dyfek krahut e të njomësh zorrën me ndonjë rrush. Më kujto mot, në maj a në qershor, kur të çelë gjineshtra.

— Jo, aga, hoqa dorë nga pojakllëku. Dua të shkruhem xhandar, se xhandari ka njëqind të mira bashkë: rrogë, këpucë me gozhdë, rroba...

— ... pula, zoga, pilaf, hoshaf, ryshfet, sherbet e më the të thashë, — u hodh e ia preu Dani i Lilos, që rrinte në brekë e në këmishë me këmbët në ujë.

Ago Zylali e shikoi me të qortuar Danin (nuk donte t'ia shaje xhandarët, se dy nipër i kish të këtillë: njërin kapter, tjetrin reshter) dhe i tha Grendellit:

— S'është keq të bëhesh «gushkuq», se gushkuqi është tabani i qeverisë, i qetësisë, po ti e the vetë se këtë punë nuk e kam në dorë. Shko fol me Myrto bejnë të të qanitë tak-tak një shkresë, me makinë, drejt ne mbreti e puna merr fund. Ama rrota do lyer mirë. I fole!) Myrto beut dy rroga në mot e ndonjë peshqesh tjetër. Se kështu është kjo botë: merr këtej e jep andej. Në do të marrësh, duhet të japësh. Allishverish, ore. Ta dish se xhandarllëku të nxjerr në selamet.

— More, unë i flas edhe tri rroga në mot, vetëm të bëhet.

— Bëhet, bëhet, se miku është der' i xhenetit, paraja ngre ujin përjetë. Ama edhe ne këtej mos na harro kur të të zerë lopata ujë, se helbete..

— Peqe, aga. Po edhe ti i thuaj një fjalë në vesh Myrto beut: se e ke mik të vjetër.

— Si vdekja. Kjo punë mbaroi.

Dani, të cilit i vinte radha pas dy orë e gjysmë e

1) për: i premtuan

më vonë, psherëtiu, u ngrys dhe ktheu kokën nga Pellgu i Zhabave. Ç'është e drejta, aty s'kish tani as pellg, as zhaba, si ca vjet më parë, po ashtu i kish mbetur emri. Kish vetëm varre të sheshuara, të vdekur, midis të cilëve edhe ata tre kolonjarët që zumë në gojë, mbi të cilët rriteshin ferrat dhe shpëndrat.

U duk udhës një burrë mustaqeverdhë, kapardisur mbi një pelë të zezë, të vogël e shumë leshtore, barsë, çalkë, me samar. Pas pelës vinte, me nder zotrisë suaj, një grua: e zbathur, me një xhybe pothuaj të zezë gjer ne thembrat e këmbëve, e pluhrosur, me kokën të lidhur me një dylben të bardhë, duke lënë një vend të hapur sa një plasurinë dërrase, për sytë, që të shihte pak a shumë se ku shkelte. Megjithatë, pengohej çap pas çapi nëpër gurët. Gruaja mbante në krahë një lyrek, që qante hope-hope. Veç gurëve të nëmosur, ajo pengohej edhe nëpër kindat e gjata të xhybes. Prapa saj vinin me të kërcyer dy çupërlina leshverdha e të zbathura, me dumane të gjata, plot arna e pluhur. Të tria – gruaja me lyrek e çupërlinat – mundoheshin të arrinin pelën që hiqte përpara dhe nuk e arrinin dot. Burri mustaqeverdhë i njihte ata që rrinin në Çukë, po as që ktheu kokën t'i shikonte e t'u jepte një tungjatjeta duke ngritur të paktën dorën në ballë. Helbete, siç ju thashë, ai kish prapa me nder zotrisë suaj, gruan e çupërlinat. Dhe kur ke pas vetes ngatërresa të këtilla, që s'ka lezet as t'i zësh në gojë, afërmenç, s'ka as lezet të përshëndoshesh me miqtë e me të njohurit, duhet të bësh sikur s'i sheh fare. Këtij i thonë burrëllëk. Edhe ata të Çukës bënë sikur s'e panë. Kalori mustaqeverdhë ktheu në të djathtë pelën barsë dhe mori udhën e Lagjes së Poshtme, bashkë me «ferrat» që e ndiqnin prapa.

Pas pak, udhës së madhe, andej nga Arra e Mukes, u duk një udhëtar me një kalë çil për kapistalli e me një

torbë larushe krahut, dha tungjatjetën me dorë e me gjysmë goje dhe bëri të shkonte përpara.

– Tungjatjeta, o ti nga fshati i ariut, – tha Ago Zylali me qejf e si me rromuz. – Si jeni, o burra, si shkoni? Si i kemi ata miqtë andej? Kush është vrarë e plagosur këto ditë? A ka kërcitur, të paktën, dajaku?

– Të gjithë janë shëndoshë e mirë, Ago Zylal. Të marrin dorën. S'ka as të vrarë, as të plagosur. As dajaku s'ka kërcitur. Njerëzit kanë rënë pas punës, pas bukës. Kush në mal, kush poshtë. Gusht, ky! S'po vëmë gjumë në sy.

– Haj, mos u qani, se gusht babaxhani të mbush hambarë. Në dimër fli sa të duash me këmbët ne vatra. Si dolët sivjet me të lashtat?

– Njëfarë gjëje. Ca i korrëm e i shimë, ca po i korrin. Po ç'e do? Punojmë kot.

– Si, ore kot?

– Kot, Ago Zylal, ja për këtë drithë që më zëntë sytë. Na piu të gjallë spahiu, dhjetari, si i thonë tashi viranit. Nuk vjen në arë të shohë, nuk vjen në lëmë të matë e të marrë sa i bie, më tetë një, po rri në mes të fshatit, ne xhamia, edhe e do me të prerë. Kaq të bën ara, thotë, kaq dua. Qesim, kuturu, më këmbë. Vetë shkruan, vetë vulos. Mos e ngri bereqetin nga ara, thotë, përpara se të më japësh atë që kërkoj.

– Jajaja! – tha Asllani. – Pse s'vini të qahi?

– Kujt t'i qahemi, o Asllan? Ti e di atë fjalën e kadiut, që thotë... Këta viranë dhjetarë janë bërë ortakë si kralet: shtatë veta kanë marrë dhjetë copë fshatra. Thonë se në këtë punë kanë gisht dhe ata të filancës.¹⁾ Pa duan drekë, darkë. Po të qahesh, do të të dërgojnë një zybë gushkuq me shtatë a tetë xhandarë, që të shohin. Doemos, edhe këta duan drekë e darkë. Na

1) Filancë – shtrembërim i fjalës «financë».

hëngër me gjithë lecka, i shoftë zoti! Mos mbiftë këmbë dhjetari, jarabi.

– Mos u qani, – e qortoi Ago Zylali. – Yshyri është yshyr. Kështu ka qenë denbabaden. Duhet paguar, se edhe dhjetari ka borxh t'ia numërojë paret çink-çink qeverisë, se ka vënë kokën, ka lënë tapinë e shtëpisë e mbetet në diell. Lëmë është ky i uruar: ka për të gjithë. Edhe për ju, edhe për dhjetarin: jep sa të kërkon e haje gëzuar atë që të mbetet. Mos mallko, se s'është mirë.

– Japim, po s'kemi, Ago Zylal. Që në shkurt do të mbetemi pa bukë në magje, ja, për këtë drithë! Do të na vdesin fëmija, do të mbytemi në borxhe të reja, veç të vjetrave. Bereqetin që na vjedh sot, do na e shesë nesër për një, dy, e më shumë.

– Mirë t'ju bëhet: fajin e keni vetë, – tha gjakftohtë Dani i Lilos, duke goditur me shatën e lagur një plis të thatë.

Udhëtari u kthye e shikoi i çuditur:

– Si the? S'të dëgjova mirë...

– Ashtu si thashë.

– Ç'faj paskemi ne?

– Keni faj se nuk dini një gjë: mishi i ulkut do dhëmb qeni. A keni dhëmb qeni? S'keni, le t'ju hajë.

– Kush të na hajë?

– Ulku.

– Ne s'na ha ulku, po dhjetari.

– Dhjetari është ulk, – tha Dani dhe këputi me shatë një copë plisi.

– Ulk?

– Ulk, ore. Ndofta më i keq se ulku. Është gjakpirës...

– Ta zëmë se është ulk... Ç'të bëjmë?

– Të bëheni qena. Të thashë: mishi i ulkut do dhëmb qeni.

Shata e lagur këputi edhe një copë tjetër plisi.

– Ti s'e ke të keqe fjalën, po unë jam ca i trashë

nga mendja; të marr e s'të marr vesh. Si t'ia bëjmë?
Mësona.

– Ta bëni fshatçe, të lidhi shok me shok. T'i thoni atij mikut, ulkut: ky është drithi, shikoje, mate, merr sa të bie, më dhjetë një, mbaj thesin të ta shtie, pastaj merre në kurriz e thyej qafën. Po të mos duash ta marrësh, lëre aty, të ta hanë galat. Drekë s'ka, darkë s'ka. Kopaçe, ka. Ama të gjithë me besa besë, me një fjalë. Mbahuni.

Fshatari qeshi.

– More, ne i japim edhe më tetë një, më shtatë një, po ai e do me të prerë, qesim. Ara të bën, thotë, dhjetë killë. Të dua një killë e një shoshë. Na vulën. Të jep një copë kartë me vulë e të thotë t'ia shpiesh bereqetin në hambar. Ne i mbajmë duajt në lëmë, i shijmë e na dalin katër killë. Hane dhjetë, sa thotë ai, hane katër, sa bën ara! Sa i bie? Në tri një... Për një copë kopsht, tri rrogoza vend, kërkon dy dollarë, tre, sa t'i teket. Po t'i blesh preshtë në pazar, të zënë më lirë. Punë i thonë kësaj? Punon bulku, ha ulku.

– Tamam ulk. Unë të thashë, ulku do...

– E di vetë ç'do ulku, mos më mëso ti: do plumb dograje në kokë, në mes të ballit.

– As ashtu s'është keq... bëjani bam.

– S'është keq, po halli se kemi fëmijë, kemi shtëpi, prishemi!

– Po të mos prishi një herë nuk do të ndreqi kurrë. Kështu e kanë këto punë: duhet të turbullohen, që të kullohen. Mbaje mend atë që të thashë: mishi i ulkut do dhëmb qeni.

Ata të Çukës dëgjonin të heshtur. E dinin se Dani i Lilos ish bërë si i akrosur që kur ish kthyer nga Tirana, ku kish qenë ushtar. S'di me kë kish ngrënë bukë andej, që fliste kështu, çapraz, me sëpatë: mos paguani borxhet, se i keni paguar dhjetë herë me fajdet, mos u

jepni gjysmën e drithit atyre që u punoni arat, mos jepni peshqeshe e ryshfete. I krisur nga kondaku! Guxoi t'ia prishte fjalën, bile, edhe Ago Zylalit, që është goxha aga, parësi, kryepleqësi, kamës, njeri që po e ngre lart e më lart oxhakun e tij. I tha se Selimka, si i thotë gjithë bota Selim beut të vogël, atij burrkës tri pëllëmbë, që mban dy kobure, bile nganjëherë edhe tri: një në brez, një në xhep e një prapa nones, pra tamam Selimka, mori nga financa të dhjetat e katër a pesë copë fshatrave, i zhveshi e i rropi mirë e paq fshatarët, mblodhi shumë pare e pastaj nuk i pagoi asnjë lopkë shtetit: «Vallaha të lashtat i prishi vrugu, të vonat i prishën shirat. S'kam e s'jap.» Shkoi në Tiranë, s'la gur pa lojtur (Selimkën e njuh edhe vetë mbreti, se e ka pasur në bukë të madhe, e ka vënë të vrasë kundërshtarët), gjersa e fitoi të tijën: ia fali borxhin. Pas dy a tri vjet kurdisi e bëri një ndërtesë të madhe – më të madhen e vendit – me tri kate e ia dha me qira shtetit me njëzet e pesë këndoganë – të gjitha brenda). Pastaj Dani hodhi edhe një rromuz: «Kështu, tha, kanë bërë edhe shumë burra të tjerë, ca çerekdhjetarë e gjysmëdhjetarë: morën drithin e paret, pastaj thanë s'kemi të paguajmë, dolëm me humsi bje se s'ra shi...» Një nga këta ishte vetë Ago Zylali.. E si t'i japësh ujë këtij njeriu? E si të mos e vrasësh me bukë në gojë? Radhën e ujit kërkon ta ndajë sipas numrit të dynymëve: asnjë dakikë më shumë, asnjë më pak. Punë është kjo? Ago Zylalit i duhet më shumë, se e ka plehëruar më tepër, se misrin e ka farëmadh. Ai: «Jo, jo!» Po si, ore, njësoj qenkemi të gjithë, si këmbët e dhisë? Bile, Ago Zylali i bëri udhë: «Merre, i tha pa radhë, – që ta largojë nga Çuka, – po të jap radhën time». S'desh. «Ti, aga, i tha, s'ke radhë, se e more sot e tri ditë, përpara shokëve. Dhe e mbajte katër orë më shumë. Kërkon të më japësh radhën e tjetrit që të bë-

hemi hasëm e të rrihemi me shata? Jo, s'dua, mbaj vendin si plak që je.» Tani, kur Dani po shante dhjetarët, Ago Zylali u mat t'i thosh: «Si, ore, ulk qenka dhjetari? Fjalë është kjo? Kur të flasësh për dhjetarin, duhet ta lash gojën tri herë me uthull, se dhjetari është qeveri. Ashtu ka qenë që në vaktit. Ty ta paskan çakllaisur mendjen. Dhjetarët janë burra me mendje plot, një okë, janë parësi me mall e gjë me qesen plot, me miqësi në të katër anët, gjer brenda në Tiranë. S'janë laskandurë, dorëhollë. Ulk qenka filani, që merr rrogë qeverie? Ulk qenka filani, që merr përsipër punë qeverie? Mbjaj gojën, djalë...» Po nuk tha asgjë, që të mos i japë gjes sherrit. Bëri sikur s'ia vari. Do ta shpinte fjalën atje ku duhej, në xhandarmëri, që ta bënin hi. Pyeti udhëtorin:

— Misrat si i keni?

— Ashtu e kështu: ca me kallinj e ca shterpë. Po ra shi, mirë; po s'ra shi, keq; po digjet si barat. Misërishtja ka zënë të karkanjoset si ajo hithra kur i ve saçin përsipër. Gusht, ore! Na është vardisur një e nëmosur baldosë me të bijat.. Ndiz zjarr sa të duash, bjeri me ura të ndezura, s'do t'ia dijë. Do martinë, e shkreta, po...

— I bini me mykë, ore, — tha dikush, si me të qeshur, duke e shqiptuar fjalën «mykë» vërdovarçe, me «y» të zgjatur. Udhëtari s'ia ktheu. Vazhdoi:

— Shterruan kronjtë. Ajo cërkë ujë që del nga çmërsi s'e ngrë dot gurin e mullirit. Kemi mbetur pa një dorë miell. Ja, ngarkova ca grurë e thekër që na la dhjetari dhe erdha të bluaj këtej, të bëjmë me shëndet bukë të re, pastaj si të jetë thënë...

Ago Zylali e shikonte, e dëgjonte, po mendjen e kish gjetkë. I vinte inat me fjalët që kish thënë Dani i Lilos. Njëherë e njëkohë, kur kish qenë i ri, Ago Zylali kish dëgjuar nga goja e një kadiu libohovit, burrë i vjetër e ballaban, me mjekër, që kish thënë: «Dovletin,

efendëm, e mban spahiu e zaptija. Domosdo, efendëm, e mban edhe vergjia me xhelepin, po në krye spahiu me zaptijen. Pa spahi e pa zaptije, s'rrohet dot.» Dikush e kish pyetur: «Kadi efendi, si është ajo puna e rryshfetit?» Kadiu kish qeshur bukur, ëmbël, midis mjekrës e mustaqeve të bardha e kish thënë: «Ryshfeti, evlat, është gjë e mirë, e ëmbël. Efendëm, njëri është razi të japë, tjetri është razi të marrë, ç'të keqe ka këtu? Paraja nuk humbet, nuk bie në gjol a në pus; shkon nga njëra dorë ne tjetra. Ryshfeti është i lidhur me hatërin; hatëri është gjë shumë e mirë, se afron njerëzit; Vetë allahu e ka punën me hatër, ca i bën të bukur, ca të shëmtuar; ca të pasur, ca të varfër. Bile, allahu e mban dynjanë për hatërin e të pasurve, se i pasuri është i dashur. Po t'i kish dashur, efendëm, të varfrit, do t'i kish bërë të pasur. Nuk i do, nuk i bën. Pra, i varfri është i varfër, se ashtu do allahu; i pasuri është i pasur, se ashtu do allahu. A do të ish mirë, efendëm, që dynjaja të ish gjithë fushë? Jo. Më mirë është me male, me fusha, me gryka, me gremina. Ashtu nuk është mirë që të mos ketë të pasur e të varfër. Një njeri merr, ta zëmë, ryshfet, tjetri jep para me fajde, bëhet i pasur. Me këto pare bën pallate, xhami, kisha. Allahu, efendëm, ia bën hallall. Pra, kush mund, le të marrë ryshfet, se ryshfeti është shumë i ëmbël.» Vetë kadiu libohovit merrte ryshfet me të dy duart dhe i nxirrte gjyqet të shtrembra. Ama të pesë vaktet i falte pa kusur, që të fitonte hallallin e xhenetit.

Ja, këtë po mendonte Ago Zylali.

— E hëngshi gëzuar, — u hodh e tha djali i Shaqos, një zeshkan me ca sy hajduti, ai që kish ujitur atë rripë e tani rrinte më lart se shokët. — Po me arinë si e keni punën?

Fshatari u ngrys, e shikoi me inat, po aty për aty u kthjell, u çel e ia ktheu:

— Ariu është shëndoshë e mirë, o djalë. Të puth

këmbë e dorë. Kur po merrja këtej poshtë, më tha i bëj të fala atij bandillit syzi e bukurosh që rri te Çuka e që pyet për mua. Dësh të më jepte një pusullë nga dora e tij, po s'iu ndodh kartë, kallmër e divit. Po të dojë, tha, syziu, le të vijë këtu në mal të mundemi bashkë e të shohim kush është më i fortë. Ti mos mëno: mbath opingat e ngjitu, se të pret; do të të gostisë me mjaltë e thelpinj arre. Në s'e di udhën, më prit këtu të ngjitemi bashkë, kur të kthehem nga mulliri. Do të të degdis gjer në vend, në shpellë. Atje bëj ç'të duash me arinë: mundu e stërmundu, puthu e stërputhu. Apo e kam keq, o burra?

Ata të Çukës qeshën, kush me të madhe e kush me të vogël.

– Mor të lumtë, – i tha Asllani, – se të ardhka ndoresh: ia vure barrën pas samarit.

Po as djali i Shaqos s'ia la veresie:

– Hapni sytë, ore, mos e prishni punën me arinë, se u zemërohen ata të Kakaçit. Kanë hedhur lutje në Tiranë ta bëjnë arinë kryeplak në fshat. Apo s'doni t'ua lini? Në s'doni, mbajeni për vete, ushqejeni me misra të njoma, të pjekura në prush, gjersa të bëhen gorricat cucka. Po ta merrni me të mirë, do t'ju ruajë nga baldosa e nga të bijat e baldosës.

Prapë dikush qeshi, dikush s'qeshi. Udhëtari s'i ktheu përgjigje: bëri një tungjatjetë me të djathtën e hoqi përpara. Atëherë Grendelli u hodh më këmbë e thirri:

– Dale, or mik. Ç'ke në atë torbë? A mos ke sjellë gjëkafshë për të shitur? Në ke sjellë, mos bëj një çap më tutje, se vallahi.. Dua paret për vulën e pazarit, se ashtu më kanë thënë.

– Bukë kam, ore, bukë! Elbishte! Për udhë! – ia ktheu udhëtari me inat, po Grendellit s'iu mbush mendja, e ndoqi, e arriti, i futi dorën në torbë mos a mos i shkulte

ndonjë lopkë, po nuk i gjeti veçse një copë bukë elbi, një qepë e pak kripë. U kthye kokëvarur.

Ata të shtatë mbetën prapë të heshtur, si kuaj të vjedhur.

– Ama burra u thënçin këtyre! S'qenkan të zotët të vrasin një ari e një baldosë. I lënë sallma t'u prishin misrat.

Këto fjalë i hodhi djali i Shaqos, po nuk i priti njeri, kështu që Çuka mbeti siç kish qenë, e shurdhër.

Shkuan aty pranë, nëpër vijë, katër a pesë çamarokë të zbathur, tetë a nëntë vjeç, duke lojtur me të lagur: i binin pllajq e pllajq ujit me potillën e këmbës dhe hapnin stërkala anembanë. Ca stërkala të këtilla vinin gjer ne shelgu i Çukës.

– A, gjidi malukatër, gjidi! – u thirri Ago Zylali për të nxjerrë dufin. – Nuk u nxë udha, që shkoni vijës e ia bëni harram ujin atij që ka radhën? (Kështu thosh Ago Zylali: po të prishte ndonjë ca pika ujë andej-këtej, ua merрте bukën nga goja njerëzve; po të kthente vetë tërë vijën, pa radhë, në arat e bostanet e djemve, ni-përve dhe farefisit, nuk ua merрте). – Ja, do të ngrihem t'ua bëj veshët oputë oping!

Djemurçinat s'ia varën fare e vazhduan me të tyren: pllajq-pllajq. E dinin se Ago Zylali kish më shumë fjalë se sa punë. Atëherë kërcëu më këmbë Grendelli e hungëroi me zë të trashë; çamarokët u trembën e ua mbathën me të katra.

– Ndize, o Cute, – tha Ago Zylali, që ta ndërronte fjalën, e i zgjati kutinë e duhanit sa një breshkë Cutes të Fatit, një burri midis dy moshash, me fytyrën të thatë e të zeshkët, sikur ta paskej tymosur një mot të tërë ne vatra e Koli Kovaçit. Cutja rrinte i përgjumur, i shushatur, se kish ngrënë bukë të re e e kish zënë egjri. – Ndize, ore, të nxjerrim nga një tym nëpër hundë, pa le

të bëhet deti kos. Allahu e ka hambarë të madh e do na japë të gjithëve.

– Ti e ke mirë, Ago Zylal: allahu e ka të madh, po unë i gjori e kam të vogël. Edhe atë pak grurë që bëra e kam plot egjër, se Shyqriu i bujqësisë s'më dha grurë qeverie për ferë. Ua shiti furrxhinjve e tregtarëve, që e lanë e shpëlanë edhe e bënë bukë. Ty të dha sa deshe. Bile të dha pa pare, borxh, që do ta lash damkuku, kur të këndojë qyaja nga bishti.

Agai bëri veshin të shurdhër, u kthye e tha:

– Ndize ti, o lugat i Shaqos.

– S'e ngas, aga.

– As mos e nga, se prish shtëpinë, po kur të jep kutinë një burrë plak, dridhe e mbaje cigaren prapa veshit e në fund të kapës; i vjen radha.

Ago Zylali kish bërë, si nga mot, zaire të madhe duhani se e kish plehëruar mirë me kakërdhi atë kindën e kopshtit, që ia kishin lënë djemtë për «bar të hidhur», siç i thosh duhanit. Për të grirë ia grinte Tosun Gega i Elbasanit, në havan, pa tagër shteti, pa pagesë, se edhe agai ia merrte krahun kur e desh puna. Kutinë e mbante gjithnjë plot, të ngjeshur, dhe e jepte anembanë për «zhymertllëk», e «agallëk», për të ngritur lart e më lart namin e oxhakut. «Mbahet agallëku me duhan kaçak» – pyete ti, o lexonjës? – «Mbahet, mbahet. Agallëku fillon me keca e mushka të vjedhura, me gjak e stërgjak, vazhdon me «jatak» për hajdutët e tjerë, të vegjlit, me «haraç», me «ylefe» hyqymeti a qeverie, me «spahillëk», «kapadaillek» e mirësi të tjera të këtij kallëpi, pra përse të mos mbahet me duhan kaçak të grirë në havan të Tosun Gegës? Ç'është e drejta, agait i rëndonte ca si shumë karta e cigares, që agjenti i «Stamblesit e shiste shtrenjtë: gjysmë leku ose gjashtë a shtatë vezë të mëdha për një defter pesëdhjetë fijesh të vogla, shpeshherë të shpuara si sitë kurbati e të kripura me ujë deti, po s'ke ç'bën: agallëku e mbretëria duan harxhe.

Dhe ndërsa «lugati i Shaqos» po mundohej të dridhte një cigare shtrembaluqe xhunga-xhunga, Ago Zylali kish nxjerrë qesen, kish zgjedhur një copë eshkë të butë, tri herë zier me hi, e kish vënë mbi stërrall, i kish rënë me masat, e kish ndezur dhe futur në majën e cigares së vet, të hapur si gojë zhabiku shullëri, kish hequr tymin e parë nga çibuku i argjendtë me kokë qelibari dhe po e nxirrte jashtë nëpër fyejt leshtorë të hundëve.

— Hë, o lugat, si u bë ajo puna e ariut? — pyeti agai, që t'i japë shteg të ri bisedës.

— Ja, ashtu si dëgjove, aga. U vete ariu në der' e shtëpisë, u troket taktak, mirë se ju gjeta, më shtroni drekë, edhe ata mbyllen brenda, me gratë, se u venë shtatë, e i thonë me zë të hollë: «S'jemi këtu, s'jemi këtu, ari kapedan...» «Ç'jeni ju? «Jemi gra, ari kapedan; gra me fëmijë të vegjël.» «Po burrat ku i keni?» «Në arat, në arat.» Mirë ua punon dhjetari që ua gjysmon drithin, si ortak. Ama burra! U rrofshin mustaqet që i mbajnë drizë, vesh më vesh, si Shemka ynë. Për këtë dhe e për këtë ujë, si nesër ariu do vejë t'u thotë. «Hajt, dilni nga fshati e thyni qafën tutje, se arat e kopshtet do t'i mbjell me ferra e gorrica,» e ata do të ikin me sytë përdhe e me bishtin ndër shalë, do t'ia lënë të gjitha ariut.

— Shakaja ishte shumë e trashë, po agai qeshi me të madhe megjithëqë pa lezet. Nja dy shpunë buzën në gaz sa për t'ia bërë qejfin.

— Po në Kakaç si u bë? — pyeti Ago Zylali me sytë të përlotur.

— Si të bëhet, aga? Keq e më keq. Zbret ariu ditë më drekë, bën yxhym brenda në fshat, thyen një portë, hyn në oborr, çan një gomar, matet ta hajë, po nuk i pëlqen gomari, se e ka mishin të thartë, e shkon më tutje, mes për mes, si bënte qëmoti Mallka i Zvarishtit. Qentë e ndjekin prapa, gam-gam. Ariu zemërohet. Kthe-

het e i bie njërit një shukretë, e hedh tutje; i bie tjetrit edhe e lë në vend.

– Po burrat?

– Burrat? Thuaj lolot, jo burrat. Dalin lart në baxhë e thërresin: «Berihaj, berihaj! Aman, ari bej, mos na trazo, se vallahi bilahi, do të të bëjmë kryeplak, kryetar komune, nënprefekt, ç'të duash. Po të kesh qejf, hedhim lutje në Tiranë të të bëjmë edhe deputet me zgjedhës të dytë.»

– Ha-ha-ha! Pastaj?

– Ariu s'do të bëhet as kryeplak, as kryetar komune, as deputet. Kthehet në mal, rri atje e po u çan ditë për ditë nga një viç të njomë.

Ata që kishin qejf për të qeshur, qeshën; të tjerët ndenjën siç kishin ndenjtur, të vrenjtur. Domosdo, lugati i Shaqos gënjen më fort se sa Filja e Rrapua i Vërdovës, të dy bashkë. Këtë e dinë të gjithë. Nuk e kanë keq ata që kanë nisur t'i thonë «deng me dëngla».

Kështu, Ago Zylali s'lë gur pa lojtur për të hapur ndonjë bisedë, po nuk i ndez. Njerëzit s'kanë qejf për dëngla, çoftë edhe nga ato të arinjve të Kakaçit, sepse, si i thonë një fjale: «Meta i di hallet e veta». Gushti po ua përvëlonte arat e po ua hiqte bukën nga goja. Ata ua kanë frikën atyre dy burrave: të shkurtit e të gjatit, domethënë muajit shkurt e muajit mars, kur do të mbeten pa një krodhe bukë në magje e do të duhet të dalin të kërkojnë pare borxh, të marrin hua një killë misër për të dhënë një killë e gjysmë grurë në lëmë.

U dëgjuan çape opingash me gozhdë dhe, pas pak, doli nga udha e Lagjes së Poshtme Tili Samarxhiu me dy gomarë përpara, që të dy të zbathur e të ngarkuar me thekërishte për të mbushur samarët. Gomarët ishin të vegjël, pothuaj kërriçë, e nuk u dukeshin veçse majat e veshëve nën barrën e thekërishtës.

— Ush, shtil! — u thërriste Tili gomarëve. — Haj, xhan, se po i afrohemi tagjisë. Do të hani, do të çlodhi, Shtil Shtil! — Dhe i shtynte me pëllëmbën e tij sa një lopatë lundre.

— A të dëgjojnë byrazerët, o Tili? — e pyeti agai gjysmë me shaka e gjysmë me të tallur.

— Jo, aga, s'para mbajnë vesh, — ia ktheu Tili i padjallëzuar. — Gomari, me nder zotërisë sate, është gomar. Do dru, po hallbu që mua më vjen keq t'i godas, se janë të lodhur, të zbathur, të pangrënë. — Dhe qeshi me ata dhëmbët e mëdhenj e të bardhë si qumështi, pastaj bëri një gjysmë tungjatjeta me dorën që mbante stapin: e ngriti në krye, e uli në zemër e tha: — Tungjatjeta, Ago Zylal. Si je, si shkon? Si i ke djemtë? Si i ke arat? Tungjatjetani, o burra? Ç'bëni, si ju vete puna e ujit? Vapë e madhe. Na zhuriti.

— Ti mos u qaj nga vapa, se s'mbjell, po korr. E nxjerr bukën në hije, me sqepar e gjylpyer. Na qaj hallin neve që...

— Ua qaj, aga. Po të mos keni juve, s'kam as unë, se ka hyrë leku në bri të buallit. Unë kullos mezhdave tuaja, rroj në saje tuaj.

— Ashtu, de. Tashi fole mirë. Hajde këtu, se ty të prisnim. Kemi mbetur të shurdhër, si në pus. Rri të pish një cigare duhan. Lëri ata veshgjatët të kullosin pranë ferrave; gjemba ka sa të duash.

— S'mund, aga, se nuk i kam të mitë. Duhet t'i shkar-koj t'u shtie tagji e t'ua shpie të zotërve, që ta kem derën çelur për tjetër herë.

Dhe prapë zbardhi dhëmbët, pa të keq.

Tili e ka emrin të shkurtër, po trupin të gjatë sa një poshtage, nga ato që shkundin gështenjat në muajin shëmbitër. Është kockëmadh e nofulldalë. Ndofta s'është tamam kështu, po kështu duket, sepse është shumë i thatë: lëkurë e nderë mbi eshtra e kokalla. S'është i zi,

po duket si qymyr, sepse është leshtor. Qimen e ka të dendur, të forte si tel, të zezë, saqë bota thotë, me të qeshur e me të ngjeshur, se kur i rruan lzet berberi faqen tjetër, e para i është bërë prapë për brisk e kështu me radhë. Sytë nuk i duken fare, se ia mbulojnë vetullat bubuzhele. Domosdo, mustaqet i ka të mbushura, të zeza sterrë, të përdredhura vetiu. Dhe sa lezet i kanë ditën e parë kur rruhet!.. Balli i bardhë, nofullat të bardha si në mavi dhe mustaqet të zeza të ngritura. Po, ç'i do... Dikur, në të ri, nuk i dridhte dot, se e piqnin të gjallë në hell (i pari Myrto beu... «Ai, thosh, një copë samarxhi, një qen bir qeni, një.. një... të dredhë mustaqet?»). Iani nuk e trazon njeri. Po as që ka qejf t'i dredhë, se i kanë hipur hallet. Rri në një karakatinë me dy kate e me një papafingo, me plitharë poshtë e me baglladi lart, të lyer me baltë të përzier me byk e lesh, që të forcohet. Kjo karakatinë vjen më e ngushtë poshtë, më e gjerë lart, pastaj prapë e ngushtë në papafingo, se i ati e ka nxjerrë anash për të fituar vend e për të dalë nga ngushtica. Kaq truall i kanë bejlerët qëmoti. «Mjaft e ke, derr!» Ama në dimër, kur del veriu me kuçka e stërkuçka, karakatina e Tilit të Mitit tundet e kërcet, sa thuaj se do të ngrihet e do të fluturojë s'di se ku, me gjithë papafingo e me gjithë baglladinë dhe ata që rrinë brenda. Drita e diellit nuk hyn kurrë poshtë, se e mbajnë shtëpitë e tjera të vëllazërisë e të nipërisë, që i kanë strehët pothuaj të puthosura me të tijtë. Brenda bën ftohtë, mban noti, erë myk. Thonë se vallaha nga ky shkak nuk i venë mbarë fëmijët: ia përpiu varri përpara se të mbushin të pesëmbëdhjetat: dy djem, tri çupa... As vetë s'i ka qiqrat të mbara: kollet dimër e verë me një kollë të thatë që i shkallmon kraharorin, pështyn gjak.

Tili punon zanatin e babait e të gjyshit në një rrip hajati, që niset nga oborri i vogël i çezmës së vllazërisë e del në pazar, në dritë. Ky rrip hajati me trarë e pa tavan

është ndarë me dy çatma dërrasash nga hajatet e tjera, që vijnë bri për bri. Është, si të thuash, edhe vend për punë edhe udhë për të vozitur tetë a nëntë shtëpi të vëllazërisë e stërvëllazërisë e shumë shtëpi nga të Cici-llarëve, Kostallarëve, Bashollarëve e të tjera, që s'kanë të bëjnë me vëllazërinë, po vijnë e shkojnë aty për të shkurtuar udhë. Dhe asnjeri nuk u thotë një fjalë goje: le të shkojnë, se nuk të hanë udhën. Aty, në hajatit me dhe të kuq gropa-gropa, rri Tili përdhe, me një poste dashi, me këmbët të gjata të shtrira një andej e një këtej dhe bën a ndreq samarë. Doemos, era fryn si fishesk nga të hyrët e të dalët, prandaj Tili, ndonëse është veshur dimër e verë me fanellë të trashë leshi, në mish, me rroba shajaku, prapë kollet, kollet.

Drutë për samarët – frashër e ah – shkon i pret vetë në mal, i epon e i përthyen vetë në zjarr, aty, në hajat, i laton vetë me sqepar, i gërryen e i zbardh me limë të madhe druri, sepse «lima i zbukuron të gjitha». Bën kaptella me kalore për litarë, kocaqe, brinjë. Edhe lëkurët i punon vetë: i krip me hi, i pastron, i mbush me thekërishte, i qep me spango. Samarët e rinj të mbërthyer me thumba druri, jo me gozhdë hekuri nga ato të Kukës, se këto e çajnë drunë, dhe të stolisur me pulla meshini e bakri, siç u pëlqejnë kurbetëve e merakçinjve – veç ata të kuajve e të mushkave, veç ata të gomarëve – i vendos si rrësk njërin mbi tjetrin në prag të portës, në kalldrëm, ditën e pazarit, që t'i shesë. Domosdo, kur i nxjerr pak jashtë, duhet të paguajë tagër për vendin, dhe paguan sa i kërkojnë. Po të paktë janë ata që u ka dora për të blerë samarë të rinj se, siç tha vetë aty më parë, «ka hyrë leku në bri të buallit». Më të shumtët vijnë u hedhin një a dy mballoma të vjetërve apo ndërrojnë dhogat e kocaqet edhe kështu e shtyjnë për ca kohë. Mirëpo edhe mballomat duan lekë: për lëkurë, për spango, për zabllof, punë, thekërishtë. Për këtlëkun e këtyre

të mallkuarve lekë qahen mushterinjtë e, meqë s'kanë nga t'ia mbajnë ia nxjerrin dufin Tilit e i thonë «spicer,» «frëng» e sa nofka të tjera. Dhe, meqë qahen ata që s'kanë, qahen edhe ata që kanë, pra qahet edhe Ago Zylali, që ka sa të çahet dhe vë pare të reja mbi të vjetrat. «Saraf i madh, thotë, spicer nga ata të Korçës, na e bën si frëngu pulën. I shpura, thotë, dy samarë: një kali e një mushke, që të m'i ndreqë pak. I futi dëng e dëng nga një dorë thekërishtë, u hodhi nga një mballomë lëkure e një copë zabllof, u ra nga tri e katër herë me gjylyper e m'i përllau dhjetë lekët. Pale, po erifi i desh paret në dorë, s'desh të priste gjer në lëmë, si gjithë bota...» Po Ago Zylali gënjeu si derr. Tili Samarxhiu punoi dy ditë që t'i ndreqte tre samarë: njërit i vuri kocaqe të reja, tjetrit i vuri kaptellë, të tretit i hodhi tri arna, me spangon e tij, me zabllofin e tij, me lëkurën e tij, dhe ai, burri i dheut, nuk i dha asnjë lopkë. I tha se do t'i paguante në lëmë, pastaj në vjeshtë dhe fundi harroi fare. Kur i vajti për së dyti, me samarë, Tili s'desh t'ia ndreqë pa lekë, s'desh t'i jepte veresie një samar të ri mushke. Dhe këtë punë agai ia mban vath në vesh. «Edepsëz njeri! – thotë. – Hajvan për të lidhur në grazhd. Mua të më kërkojë paret në dorë? Më ka marrë erzin ditën e pazarit, përpara gjithë botës. Bëri sikur vuri dorën në zemër e zuri miau-miau... Më paguaj, aga, atë hakën e vjetër, se dua të blë ca drithë, s'kam bukë. Ptu! Dale pa ia ndreq unë samarë Tilit edhe Tilevicës!»

Ago Zylali duket terbielti; kur flet me të mëdhenjtë, mban pëllëmbën në zemër dhe i ndrit fytyra sikur i ka rënë dielli i ahiretit, po me të vegjëlit është gojëpriður. Shan kaq rëndë, kaq thellë, sa të dridhen mishrat dhe të vjen ndot ta shikosh.

– Ush! – u thërret Tili veshgjatëve. – Ush, gjeçi belanë, se u vonuam.

– Nd'je turk e me din, o Tili (kështu u thosh Ago Zylali të gjithëve), po s'ndenje të pish një cigare, të flasim për atë borxhin.

– Mos e nga, Ago Zylal. Borxhin e resita... E lashë për në atë dynja, – tha Tili me pikëllim.

– Nuk dua të resitësh, se ta kam larë kaq herë, po ti s'i mban mend të mirat. Nejse, do të ta paguaj edhe një herë. Ja, sa të bëhen bathët a qiqrat, do të të dërgoj një shoshë plot, që t'i kesh zahire për dimër. Kthehu e rri, se dua të të pyes një fjalë, – tha Ago Zylali, që bëri sikur s'mori vesh ç'kish dashur t'i thosh Tili me fjalë «për n'atë dynja».

Po Tili ia kish marrë erën ftesës, u hoqi nga një stap gomarëve, (këtë e bëri ai, njeriu i butë, që nuk trazonte as mizën), saqë gomarët shtrembëruan vithet e ia morën me revan, duke vrarë thundrat e zbathura nëpër gurët e udhës.

– Kam punë, aga. Flasim një herë tjetër, se u vovova.

– Dale, ore!

Tili qëndroi, u përkul, u koll një copë herë, pa pësh-tymë, fshiu sytë, po nuk u kthye. Si mbaroi së kolluri, ngriti e tundi dorën sikur të thosh «Rrini me shëndet, o burra», pastaj u nis pas gomarëve. Atëherë Ago Zylali e thumboi si qrerë me atë fjalën që mezi e mbante në majë të gjuhës:

– O Tili, haj na thuaj, ore, me se i lyen ato mustaqet që m'i mban pizgë përpetë?

Samarxhiu nuk u përgjigj. Ndofta s'dëgjoji, ndofta dëgjoji. po s'desh t'i binte sherit prapa, aq më shumë me një qoxha Ago Zylali, që të shtie ujin nën rrogoz, të vret në gjumë me dorën e tjetrit. Në fshat qe hapur fjala se ajoja Tili i lyente mustaqet me dhjamë «të ndyri», siç i thoshin ca njerëz dërrit, prandaj e ngisnin gjithnjë zi-

litarët, dua të them qoset e gjysmëqoset e ata që donin t'u punonte veresie.

– Frëng fare është, – tha Ago Zylali, – saraf Ma-nastiri, spicer! – Dhe mbushi gojën me tym duhani. – Gjithnjë punë e punë. Ku do t'i vërë tërë këto pare, bre? Fiton si derr e qahet.

– Frëng, frëng! Paret t'i do peshin! Qahet se iu bë kët puna që kur s'po punon karvani i Elbasanit, po të enjteve grin lekë se i vë samarët stivë në mes të udhës. Hej të kesh ta zesh e ta lidhësh pas një druri andej nga Guri i Kamjes, – tha djali i Shaqos, që t'i marrë krahun agait. – Ta varësh për mustaqesh që të çuditet i madh e i vogël.

– Lëre, bre, me hallet e tij, – ia preu Saipi. – Ne e dimë të gjithë: është hallexhi, punon tërë ditën e mezi nxjerr bukën e gojës. Sqeparë ka vreshtë, gjylyperin ka arë; njeri i sëmurë. S'të nget, mos e nga.

– Djali i Shaqos nuk u platis.

– Pun' e madhel Ngahera në hije. Grin pare. Një mballomë e ta zhvat lekun. Frëng! Spicer!

– Yt, ore zarbo! Mjaft lehel Mbyll gojën! – ia këputi Dani, të cilit i kish ardhur shpirti në majë të hundës. – Ke tërë ditën gam e gam. Na shurdhove. I bie më qafë botës. Samarxhinë e dimë të gjithë: njeri punëtor, me halle. Punon si rob, për bukë goje. S'i bie më qafë njeriu. Ca i paguajnë, ca s'i paguajnë. Bejlerët, dihet, marrin e s'japin, si në kohën e vjetër. Tashi kanë dalë bejlerë të rinj, nga dora jonë. Duan të bëhen oxhak mbi kurriz të botës. Hyn në llonxha, nëpër batac. Po dale, dale se do të vijë radha... Po kujt i flas unë... Ditën ti rri mban kuvend këtu, shet mend; natën hyn nëpër arat e vreshtat e botës, zgrap e përllan ku mund, se ke dorën të gjatë, kërrabë. Ditën e pazarit... Tyt, mos nga nje-rëzit, se ta ndaj kokën më dysh me shatë!

Dani ishte nxehur shumë, megjithëqë mbante këmbët

në ujë. I kish kërcyer delli i ballit. Dhe ish i fortë sa për katër. Rizai i Shaqos e shikoi me bisht të syrit, po nuk iu përgjigj; s'ia mbajti... Ia dinte kokën Danit. Dhe grushtin...

– Edhe me ata të Kakaçit e të fshatit tjetër e teprove, – tha Saipi me zë të butë. – Shiko se po u vajti fjala në vesh vijnë e të zhufin, të bëjnë pestil, që të lëngosh një mot të tërë. Apo jo, o shokë? – e pyeti ata të Çukës, që rrinin të heshtur.

– Besa, – tha dikush, pas pak, – të ketë të dëgjojnë Maliqi a Zylyfi se si ia gojos fshatin e burrërinë, vjen e t'i numëron të gjashta në gojë e shkon si qeni në vresht? Helbete, gjuhën e ke të lagur e e kthen si të duash, po mos e tepro. Po ç'të vemi gjer në Kakaç e matanë? Qëparë u talle me mustaqet e Shemkës të Gorricës. S'ka lezet: është plak njeri, i urtë. Të të dëgjojnë të bijtë a të nipërit, vijnë e të zhgërryejnë në vijë, ia mbushin gojën me batak, me hithra a me të pëgërë qeni. Posi, posi... Mos e nga atë që s'të nget. Sikush i mban mustaqet si do vetë; ca i rruajnë, ca i qethin, ca i dredhin. Pas qejfit. Pse i bini më qafë Tili Samarxhiut? E dini se është i urtë, e dini se s'mund. Besa, të kisha qenë unë, a ndonjë tjetër e bëja sqeparin armë e ia krisja kokës atij që do të më binte më qafë: dy duar për një kokë! Në s'doni t'i paguani borxhet për punën që ju ka bërë, të paktën lëreni rehat të kollet e të qajë fëmijët që i kanë vdekur. Turp, vallahi! U bëtë si ato zdërret plaka: zdërr-zdërr tërë këtë bijë ditë...

Këtë pykë të fundit ia nguli drejtsëdrejti Ago Zylalit, po ky u bë si derr i shurdhër e zuri t'i frynte çibukut që të nxinte bishtin e ngjitur të cigares. Nuk i mori krahun Rizait. Nxori e shikoi sahatin, numëroi me gisht, e mbylli, e futi në këllëf e s'tha gjë.

– Eeeh! – ia bëri Dani dhe i ra me shatë një plisi. Edhe një copë herë të madhe u bë heshtje nën

shelgun e Çukës, ku ndahet uji i arave. Në këtë mes Ago Zylali xheç i pëshpëriti Grendellit. Ky e shikoi me sy të çapëlyer. — «Ashtu thua, aga?» «Ashtu.» «Të vete?» «Mos prit. Shkuli ca lekë.» — «Po këtu?» — «Ruan Rizai.» — «Peqe.» — Dhe kërceu më këmbë.

— O Riza, — tha, — unë kam ca punë në pazar. Ki mendjen këtu. Po të shkojë ndonjë me dru, me gjëkafshë për të shitur... Ti e di.

— Peqe, — ia ktheu Rizai, që rrinte kryeulur e shikonte mizat e dheut nëpër vragën e tyre.

Grendelli mori shkopin e trashë, që e mbante në vend të dyfekut, u hodh si ari nga Çuka e shkoi me çap të nxituar, duke hamullitur: «Dale, pa ia ndreq unë samarë...» Tani u duk, pas pak s'u duk më.

— Përsëri qetësi. Gjinkalla. Një krismë sëpate në gësh-tenjat. Edhe një tjetër. Shkoi një qen gjuhëvarur. Rizai i hodhi një gur, që i zuri dora aty pranë. Shkuan tre a katër veta me shata supit, për të prashitur; shkuan ca gra të zbathura, të fishkura, të rreshkura, kryeulura, pastaj një plakë e çalë me një peshtemall në kokë. Hop, çndej nga Arra e Mukes u duk Beshir pojaku, (ju kujtohet? Ai që u kish rënë kolonjarëve me dyfek), që hiqte një viç të lidhur për gryke me një brez të kuq. Pas tij vinin duke qarë dy fëmijë të vegjël, të zbathur. Qanin që të këputnin shpirtin. I luteshin Beshirit t'ua lëshonte viçin. Ky as që i dëgjonte fare. Thosh se e kish zënë kur kulloste në jonxhën e Cenos dhe e shpinte në bashki të merrte një dollar gjobë. Këtë dollar do ta ndante përgjysmë me të zonë e jonxhës, në qoftë se nuk do ta përllante kryepolici ose vetë kryetari. «Po jo, mor jo, nuk kish hyrë në jonxhë. Kulloste rrëzë gardhit, jashtë...» — thoshin fëmijët duke qarë. Ata u kërkuan ndihmë atyre të Çukës, po asnjë nuk ndërhynte dot, sepse, siç dihet, edhe pojaku është gjysmë qeverie. Ago Zylali u shfryu: — «Yt, bre varfanjakël Ju kam parë ngahera që mblidhni

bar mezhdave, në mall të botës. Pandehni se meqë jeni jetimë, do t'ju mbajnë në pëllëmbë të dorës, në pekule...» Pastaj iu kthye atyre që kish përreth e u tha: – «Këta janë djemtë e asaj... si i thonë, bre, se ia harrova emrin... Asaj që vete korr poshtë e lart, argate, e i lë fëmijët të futin viçin nëpër arat e hallkut.» Qeshi dhe shtoi: «Unë them se ky viç duhet therur që të shohim ka a s'ka jonxhë brenda në bark e pastaj ta futim me të katër këmbët në një tepsi të madhe, ta hedhim në furrë të Ndinit, ta pjekim e ta hamë. E ka mishin të butë, ta njom zorrën.» Dani tha nëpër dhëmbë: – «Zorraxhi plak! Zaptije turku! Duvaxhi i Ethem beut!» Këto fjale nuk i dëgjoji veçse Saipi e ndonjë tjetër që ndodhej afër tij.

Dhe përsëri gjinkalla, sëpata e gështenjave, gurgullima e vijës, ndonjë zë i largët: – «Ta kthej?» – «Ktheje, kthejel!» – «Hajde, se s'më lënë!» Njerëzit rrinin të mër-zitur. Ndofta edhe andej do të kërciste shata e kopaçja.

Po ndokush mund të pyesë: – Ç'është kjo Arrë e Mukes, që ke zënë në gojë kaq herë?» T'ju them të drejtën, këtë Arrë, që shtrin hijen mbi udhë, matanë shtëpisë së baba Rushitit, e kam përmendur sepse e ka dashur puna, po gjithnjë me pikëllesë. Të zonë e arrës, Muken, e mbaj mend. Edhe djemtë e Mukes i mbaj mend. Njerëz të shtruar, të butë, punëtorë. Punonin selishtën e tyre, bënin bukën e rronin. Shtëpinë e kish poshtë, nën udhë. Arra hidhte hijen e saj të dendur rreth e qark – në oborr, në selishte, në udhë dhe në kopshtin e baba Rushitit. Në atë kohë s'kish djalurçinë fshati që, duke shkuar udhës, në kohën e arrave, të mos hidhte ndonjë gur a ndonjë stap për të shkundur çaçanikë. Edhe sa të mirë ishin këta të uruar çaçanikë të «vjedhur»! I thyeje me gur, nxirrje thelpinjtë cipëhollë dhe ëmbëlsoje gojën. Dhe as Mukja, as djemtë nuk të thoshin gjysmë fjale. «Le të marrin, thoshin, ato degë janë të udhëtarëve»... Pastaj vdiqën të

gjithë, kur ra grip spanjoll, që e solli frëngu. Kaq tabutë vetëm në një ditël Dhe u mbyll dera.

E ahershmbja mos ardh të kurrë. Shumë fise të shuara, shumë dyer të mbyllura! Prandaj më dhimbset kur e përmend këtë arrë dhe shtëpinë e të mjerit Muke.

Dhe ja, udhës së lagjes, që fillonte nga shtëpia e baba Rushitit, shkonte pranë asaj të Pehlivanit, bënte nja dy dredha e shpinte te shtëpia e Ali Topallit, u duk Xha Dalipi. Vinte me çap të lehtë, si çap djali, me opinga kau vendi, të buta, me një takije të zgjyrosur, pothuaj të nxirë, me një jamullëk të vjetër krahëve e me një shköp në dorë. Këtë jamullëk, që një herë e një kohë kish qenë ngjyrë hiri, ngjyrë vaji, ngjyrë arre a kushedi çfarë ngjyre tjetër – kjo punë s'dihet, se lufta ka shumë vjet që ka mbaruar dhe vetë xha Dalipi nuk thotë se cilës skotë shkelësi ia ka marrë – s'e hiqte kurrë nga shpatullat: dimrit e vishte, verës e mbante krahëve dhe stinëve të tjera: herë kështu, herë ashtu, sipas kohës. Dhe mot për mot nga një, dy a tri arna lloj-lloj ngjyrash, sipas copës që i zinte dora kujt e arronte, kështu që ngjyra e fillimit ish zhdukur pothuaj fare.

Xha Dalipi është një plak i shkurtër, shumë i thatë, pak si kuqalosh, dua të them se mjekra e mustaqet i kanë marrë ngjyrën e atyre sheputkave të gështenjës, kur fishken e ndryshken buzë pranvere, pasi i ka rrahur tërë shiu i vjeshtës e tërë lloha e dëborë e dimrit. Ka dy sy të vegjël, të përlëngur, po dhelparakë, nja dhjetë fije qimesh në vend të vetullave, të gjitha ngjyrë ndryshku, si atë të gjembave të sheputkave që përmendëm më lart. Qepalla s'di në ka a s'ka, prandaj duket se sytë i mban ngahera të hapur, si peshku. Është gjithnjë i qeshur, po me një të qeshur të tijën, vetëm të tijën; mjekra i kërcen përpara si çekiç nallbani, faqet i zhubrosen e i thellohen midis nofullave, buzët i përvishen e i batisin përbrenda, sepse xha Dalipi ka vetëm nja dy çataj të zinj në vend të

dhëmbëve e të dhëmballëve të dikurshme dhe tri a katër copë rrënjë të humbura s'di se ku, nëpër mishrat e gojës. Bota thotë: «Kur bën të qeshë, xha Dalipi duket si cap i egër». Dhe kanë të drejtë, po vetëm përgjysmë: si cap duket, po i egër nuk duket. Sa vjeç është? Ku ta dish!.. Tutje nëntëdhjetave, po mendjen e ka top. Vetëm se flet me «thëthëthë», për shkak të dhëmbëve. Si rron? Vetë e di... Varfëria e helmi nuk i janë ndarë kurrë, po gjithashtu një fshat i tërë e di se nuk ka bërë kurrë ndyrësi, «punë me baltë». Ka rrojtur si njeri, me djersën e tij. Varfërisë e zisë së bukës nuk i është qarë e nuk i qahet, po ka humbje më të mëdha se varfëria. Vjet përcolli në var të birin, të madhin, shtatëdhjet vjeç burrë. Nuk qau. S'kemi ç'bëjmë, tha. Vdekjen e paskemi në kokë, jo për radhë e derë. Do të kish qenë më mirë të vdisja unë e të rronte djali, po kush më pyet?» Në të ri i kanë vdekur edhe fëmijë të tjerë: ca të njomë fare, ca të përkëmbur e ca të rritur, po këta i ka harruar. Vetëm njërin s'e ka harruar, dhe këtë mos ia kujtoni kurrë: më mirë merrni koburen e vrisni, sesa t'ia kujtoni! Ky është i nipi, Hajrushin, njëzet e një mot djalë, sapomartuar. I gjatë, i bukur, i qeshur. Nuk lëngoi, po u këput e ra si lisi kur i bie rrufeja. E la nusen të rëndë. Kjo lindi një djalë dhe pas gjashtë muajsh erdhë e morën të vëllezërit, e martuan me një tjetër. Foshnja po rritet në shtëpi të xha Dalipit, po ç'e do? Hajrushin e tret dheu. .. Që atëherë Xha Dalipi mundohet të mbahet e s'mbahet dot. Shpesh qëndron në mes' të udhës, i bie një guri me stap e thotë: «Moj mortje e ligë, pse ma more ti Hajrushin? Pse s'më hoqe mua? Ç'pate ti me djalin? Pse më le të thahem mbi dhe? Pse s'vjen të më marrësh? Ç'pret? Pse më mundon?» Dhe loton, gjykon jetën e vdekjen, godet gurin. Dhe lotët i rrjedhin zhubrave të faqeve e qimeve të mjekrës, i pikojnë përdhe. Pastaj përsëri: «Vdekje, pse ma more Hajrushin? Vdekje, pse s'më more mua?»

Kështu ngahera kur është vetëm, po kur është me njerëz ndryshon puna, i jep dajandë vetes. Por unë ju lutem një gjë; mos i bini në sy plakut kur jep e merr me vete, udhës: e ka zemrën plot plagë, vuan.

Xha Dalipi hoqi në Çukë, duke ia marrë anës-anës. Njerëzit u ngritën (vetëm Ago Zylali, si parësi, nuk u ngrit, po vetëm lëvizi pak) e i bënë vend. Filluan të përshëndoshurat, të zgjatura, të ngeshme, megjithëqë ishin parë atij mëngjesi. Ago Zylali i dha kutinë e duhanit, të hapur me defterin e letrave matanë shufrës me sustë. Rizai i Shaqos e një tjetër i zgjatën, me dorë në zemër, cigaret që kishin drëdhur aty më parë e nuk i kishin ndezur. Ndërkaq krisi një dyfek në gështenja; grykat ia thithën ushtimën.

— I bien ariut të Kakaçit. Si duket, ka kapërcyer sinorë këtej e kërkon të bëhet kryeplak gjekundi, — tha një me të qeshur.

— Jo, — ia preu Saipi. — Unë e njoh pas krismës, kjo është dograja e Grendellit, që i bie Tili Samarxhiut t'i shkulë ca lopka, se futi dy gomerë me thekërishte nëpër pazar, shkeli udhën, shkeli të drejtën e bazhdarit. U bë puna si në kohë të Serbit të parë, kur e bënë preshanik¹⁾ Vasil-dhaskalë: pëlliti një gomar, i zoti pagoi një mexhite xheza, gjobë, si i thonë sot. Lëshoi një bajgë, prapë një mexhite. Kaq bënte gomari me gjithë samar...

Dani e shikoi me përbuzje Ago Zylalin.

— Në ari qoftë, në njeri mos qoftë, — tha Dalipi me të folurën e tij thuthuqe, duke nxjerrë tymin e parë të duhanit nga goja. — Sa për punën e thëkërishtës që hyn në pazar, dëgjoni t'ju them unë një fjalë: kur e sjell vetë ai që e punon, sindozot samarxhiu, nuk paguan; kur e sjell ai që e shet, paguan për vendin. Ama pak: një lopkë nga këto të sotmet e më pak, për një barrë.

1) Shtrembërim i fjalës «presdenik» — kryetar bashkie

Ashtu edhe kulmaku, shavari. Tili nuk duhet të paguajë, se është zanatçi: vetë e sjell, vetë e punon. As kovaçi nuk paguan për qymyrin që sjell vetë. Unë kaq di. Sa për indisapin, po këtu s'ka punë indisapi...

Ago Zylali, që desh t'ia humbiste tragën kësaj bisede, i tha:

— Nd'je turk e me din, o Dalip, na rrëfe si të ndodhi atje në mulli të Ilo Mullëmadhit, kur ia përlave ato çepurkat me miell.

Plaku qeshi capthi, hodhi një sy përçark dhe e mori vesh sakaq se aty xheç kish; njerëzit rrinin sikur t'i kish ngrënë derri brumët. U kthye pak e tha:

— Besa, O Zylo, as unë s'di ç'të të them; u bëra, siç thotë bota, buf e matuf. Gjer aty më parë e pata ditur se jam turk. Mirëpo sot nuk e them dot këtë fjalë, se më vrasin nipërit e stërnipërit. «Është turp, gjysh, të thuash këto fjalë. Na bën për faqe të zezë. Ne s'jemi turq, po shqiptarë. Ngahera kemi qenë shqiptarë!» Pastaj nisin e më thonë se ç'paskemi qenë ne njëherë e njëkohë, se paskemi luftuar shumë me Turkun e se ky na ka sjellë shumë të këqija. Kështu, që thua ti, Zylo vëlla, s'ma mban të them se jam turk. Ata kolonjarët e Gani Butkës, që ne u ramë me dyfek e i vramë, paskeshin pasur të drejtë, ne — jo. Sa për dinin, që thua ti, e kam e s'e kam, se jo vetëm që s'falem, po edhe e pi rakinë. Nuk di se ku do ta shtroj konakun matanë. Ca thonë se do di se ku do më futkan në kazan me pisë të valë, ca se do të rri në lëndinë me lule, se unë s'kam vrarë njeri, s'i kam rënë më qafë tjetrit. Bukën e kam nxjerrë me djer-sën e ballit. S'kam ç'bëj, do vete ku të më shpien: ja në kazan, ja në lëndinë.

Qeshi përsëri, hidhur, shikoi e pyeti:

— Si e keni punën me ujin?

— Keq. Të paktë janë ata që mbaruan së vadituri, të shumtë presin radhën.

– Uji m'u duk si i paktë: Ashtu është apo më bënë sytë?

– I paktë është, xha Dalip, se gjysmën e ka kthyer sipërmarrësi i ushtrisë për të shuar gëlqeren.

– Ç'e do këtë gëlqere?

– Do të bëjë ca si ahure për kuajt e mushkat, do të mbushë qesen me pare qeverie.

Xha Dalipi tundi kokën, i çuditur.

– Allalla! Në këtë pisk vape e gjetkan, kur na pël-cet buza për një pikë ujë?

Nuk iu përgjigj njeri. Vetëm pas disa çastesh, Ago Zylali tha:

– Këto janë punë qeverie, s'ke ç'i bën. Ka bërë emër vetë mbreti.

Xha Dalipi bëri sikur s'dëgjoi dhe pyeti:

– Po atë ujë që mbetet mos e kobojnë aty-këtu?

– Jo, – ia ktheu Ago Zylali. – Kemi vënë njerëz që ta ruajnë. – Dhe tregoi emrat e atyre që ruanin poshtë e lart gjatë vijës.

Xha Dalipi qeshi.

– Ama i paski gjetur! Ata vjedhin edhe vezën nën kllloçkë. Domosdo, kobojnë edhe vijën për një lopkë. Ia japin atij që s'e ka radhën. – Pastaj u kfhye e pyeti. – Ore, mua më duket se ua kam rrëfyer se si më ngjau puna në mullinë e Mullëmadhit, apo jo?

– Jo, – nxitoi e i tha Ago Zylali. – Këtu në Çukë s'më kujtohet ta kem dëgjuar. S'di se kush më ka thënë si tevatyrë, nëpër tym, po mirë nuk e di.

– As unë, – tha Rizai, që sikur e kish marrë pak veten, ish krekuar prapë e donte të hynte në bisedë me pesë pare në grosh.

– Po ju, o djem, e dini?

– Jo, jo, – i thanë ca me gjysmë goje; të tjerët s'thanë gjë.

– Peqe, jua rrëfej. Ama ta dini: këtë po e bëj për hatër të Ago Zylalit. Se, që thua ti, duhan më dha...

– Hej, mos vdeksh kurrë, xha Dalip! – ia preu Rizai, po plaku s'ia vari dhe vazhdoi:

– ... zjarr më dha, që thua ti; tungjatjetën ma prit e ma ktheu.

Tha kështu e bëri të qeshte. Menjëherë faqet iu shembën në mes të nofullës së sipërme dhe asaj së poshtme, mjekra iu ngrit si çekiç.

– E, që thua ti, atë mot që u vra Murati në lëmë, ngrihem e ngarkoj një gomar drithë e shkoj ta bluaj në mulli. Jo, s'ka qenë atë mot që u vra Murati në lëmë, po atë mot që u vra Kipi i Xhipit atje lart, në kurriz të malit.

Ago Zylali bëri sikur s'e kish mendjen aty, shikoi nga pellgu, ktheu kokën nga Arra e Mukes, bëri sikur shkundi hirin e cigares, megjithëqë e kish të shkundur. Xha Dalipi e shikoi me ata sytë e përlotur e nuk iu nda: desh t'i fuste mirë e paq një shajkë të trashë nga ato të Qazos, me katër qoshe.

– Ti, Zyllo, – vazhdoi, – e mban mend, se ka qenë një mot i thatë, sindozot ky i sivjetmi. Po, po, i riu i mban mend të gjitha: ti ishe goxha djalë, sapo ishe shkruar zaptije turku, me manxer të ri, me rripa kryq e tërthor, tërë sytha të ndritur, me setër të mbyllur në grykë e plot kopsa të verdha si flori, me festen me xhufkë të vënë në kallëp, anuar mbij sy. Apo jo? Fluturoje si zog me krahë. Të gjitha të kishin lezet: edhe manxeri, edhe rripat, edhe kopsat. I ri, ore! E mbërthyet mirë Kipin e Xhipit andej nga varri i Serjanit, ia morët krahët e i ratë kur po ngjitej në atë kurriz mali.

Ago Zylali kish ulur kryet; shajka me qoshe e Xha Dalipit i kish hyrë mjaft thellë.

– Nejse, – tha xha Dalipi, si me të qeshur, – tamam atë mot ka qenë. Ngarkoj, them, gomarët e aty, o bir,

në mulli të llo Mullëmadhit, afër gjolit, ku bashkohet lumi me Jazin. Mulliri bluante ditë e natë, se kish gjithnjë ujë. Hyj në radhë, si gjithë bota. A e kam mirë, o lugat i Shaqos?

– Mirë e ke, Xha Dalip, – ia bëri Rizai tërë zjarr, pastaj iu kthye të tjerëve, si për inat të Danit, që rrinte me këmbët në ujë: – Ky është tamam frëng, ja për këtë ujë. Frëng nga ata të Frëngjisë. Të shpie në shtatë kronj e s'të jep të pish.

Plaku mbloodhi çipet e jamullëkut, hoqi tymin e fundit të cigares që po shuhej, ndezi një tjetër e tha:

– E që thua ti... Bie në mulli të Mullëmadhit, hyj në radhë e pres që nga zemra gjer pasdreke. Më zë gjumi e fle mbi thasët, si ljepur: një sy hapur, një sy mbyllur, që të mos ma zënë radhën. Në një kohë ndieja që s'di kush më shtyn nga thasët. Hap sytë e shoh përpara llo Mullëmadhin në brekë e në këmishë, i gjatë sa një plep, me kokën gjer në trarët, zbardh i tëri, si i vdekuri me qefin në kokë.

– Mirë e ke, – ia preu Ago Zylali. – Derr me zile ka qenë. Ashtu rrinte ngahera: në brekë e në këmishë, zbathur dimër e verë, me leshrat plot miell. Thoshin se po të shkundej një herë, nxirrte miell sa për të bërë një kulaç, po të shkundej edhe një herë, nxirrte edhe për një kulaç tjetër. Këmbët i kish të dysta, si të ariut, po të mëdha.

Si tha këto fjalë, Ago Zylali shikoi rrotull e priti të qeshnin, po nuk qeshi njeri.

– Po, po, burrë i gjatë, – tha xha Dalipi. – Më shtyn e më thotë: «Dalip, të ardhni radha.» Unjet, merr njërin thes, e ngre lart, e zbraz në kosh të mullirit. Zbraz edhe tjetrin. Heq pengoren, lëshon mullinë. Guri nis të vërtitet e të bluajë. Ilua zgjat dorën poshtë, e mbush me miell, e shikon, e fërkon me gishtërinj, ngre pak gurin, që ta nxjerrë më të ashpër, për të pirë më shumë ujë,

siç i kisha thënë unë, pastaj më thotë: – «Haj, merrja gjumë.» Thotë kështu e bie të flejë në rrogëz me një kërcu nën krye. E zë gjumi e nis të gërhasë si ai i madhi i xhindëve.

– Ashtu bënte, – tha Asllani. – Tamam ashtu. E zinte gjumi sapo vinte kokën në kërcu, me këmbët jashtë rrogëz, në bajgat e kuajve e të gomarëve, e bënte gër-gër; të kallte datën. Të gërhiturit e kish më të fortë se buçima e pendës. Trembeshin edhe minjtë kur e dëgjonin. Kandilin e mbante aty pranë, të ndezur, mbi një gur.

– Ja, e ditka edhe Asllani. Guri i mullirit kish dy trokashka çift, që të vinin në gjumë, sikur të të paskej kënduar mbi kokë Mulla Isufi i Rëmënjit. Mua më pret gjumi, po nuk më mund fare. Rri si i tarkalisur. Kur kështu, hap sytë, e ç'të shoh? Mullëmadhi është ngritur më këmbë, në të bardha. Shikon rrotull, i afrohet podit, merr atë çepurkën e madhe, e mbush tri herë me miell edhe e hedh në hambar. Matem t'i flas e ta pyes ç'bën ashtu, po, besa s'ma mban: hija i vete e i vjen në trarët, si gogozhel, nga ata që trembin fëmijët. Mbaron punë e bie të flejë. Gërhet si buall blate.

– Hë?! – thirri Asllani i çuditur, i trembur. T'i përllau ato tri çepurkat me miell? T'i vodhi?

– M'i përllau që punë e madhe, po unë s'ia lashë. Dëgjoni ç'i punova.

– Gjeti me kë të mbrehë qetë, – tha Rizai. – Xha Dalipi është frëng Frëngjie, s'të lë të bësh çak.

– Kështu bënte Mullëmadhi ngahera? – pyeti Asllani.

– Kështu, po me syleshët.

– Of, i mjeri unë! – rënkoi Asllani. – Prandaj s'më dilte kurrë mielli në kandar. Gjithnjë dy-tri okë më pak. Kur e pyesja, më thosh me të qeshur jo po e ha guri e uji, jo po e ha udha e spria, po jo nëna e mullirit, nusesalës... Unë s'i bija hiles prapa. Gjumin e kam të rëndë.

Po tani që e di, do të vete t'i kërkoj të më ktheje ato që më ka mbajtur.

– Mos u mundo, se nuk do ta gjesh, – tha Saiipi duke lojtur me shatën.

– Ku është?

– Vdiq.

– Si, ore, vdiq?

– Vdiq ashtu siç vdes gjithë bota: u shtri në rrogz, në mulli, e nuk u ngrit më. Shkoi të bluajë në botën tjetër. Ish njeri i punuar, i lodhur. Jo i lodhur, po i robëruar një jetë të tërë.

– Po djem s'ka? Djemtë duhet të paguajnë borxhet e babait.

Kish një djalë të vetëm, të gjatë e balosh, si veten, po fatkeq. Punonte lart në Sharrë, matanë Varrit të Plakës. Priste drurë të mëdhenj për dërrasë. I zbriste poshtë, me të rrëkëlyer. Për bukë goje punonte. Beqar. Tërë dimrit, që Shëmbitrit e gjer Shëngjergjit, rrinte atje në pyll, se mbylleshin udhët me dy pash dëborë. I angullinte ulku në derë. Jo një, po shumë. Jetë qeni. Të zotërit e Sharrës i jepnin një thes miell misri, një torbë kripë një kade me piperka turshi. «Na, këto i ke për tërë dimrin. Paret do të t'i japim buzë vere, kur të hapen udhët.» E nuk ia jepnin kurrë. Batakçinj.

– Mirë, mirë; kjo është pun' e tij. Borxhin duhet ta paguajë. Ku është?

– Më tutje s'di.

– E di unë, – u hodh e tha Dani. – Serafim ia thoshin emrin; i gjatë, i thatë, i verdhë. Vdiq. E ëma e qau sa e qau, pastaj vdiq edhe ajo. Çupat...

Asllani kish marrë zjarr e s'desh t'i ndahej:

– Shtëpi s'ka lënë? Sa për këtë ujë që shkon aty poshtë do vete t'i shkul trarët e shtëpisë, do t'i nxjerr t'i shes në pazar. Më ka mbajtur miellin!

– Shko, shko, se do ta gjesh, – i tha Dani me të

qesëndisur. — Kish një përdheskë sa një qymez pulash, me strehë të varur.

— Ku?

— Pranë mullirit të dytë të beut, matanë urës së jazit, në një kënd midis tri udhëve. Ilua vinte rrallë e tek në shtëpi. Tërë jetën e kish shkuar në mulli, në rrogoz. Edhe kur vinte, unjte kokën që të hynte në derë. Brenda rrinte shtrirë, në rrogoz. Muret gjithnjë të lagura, me nem: prapa kish çezmën e Kolë Panos, përbri kish vijën e Bices, përpara jazin e beut. Po të thashë: Ilua vinte rrallë në shtëpi: rrojti e vdiq në mulli. Një mot, kur teptisi Lumi i Madh, erdhi e nuk e gjeti më: ia kish marrë lumi.

— Çfarë s'gjeti?

— Shtëpinë. Me gjithë plaçka e raçka.

— Haka ime, vëlla, — rënkoi Asllani. — Më gjysmonte drithin. Medet, medet! S'di nga t'ia mbajë njeriu. Këtej të ha dhjetari, andej të ha mullixhiu. Më tutje tregtari, fajdexhiu, kripaxhiu. Më thuaj, vendin e shtëpisë e ka? Do vete t'ia marr.

— Ja morën të tjerët përpara teje, për borxhet, vetë beu!

— Si, ore, për borxhet? Ai mbushte hambarët me miell të vjedhur. Hë?

— I mbushte, po jo për vete.

— Për kë?

— Për të zonë e mullirit, për bejnë e madh.

— Për bejnë? Po beu...

Kuvendi po ndizej mirë e mirë. Ago Zylalit i qeshte buza: ua kish larguar mendjen njerëzve nga uji, nga zënka midis Tares e djemve të Selmanit, nga të dhjetat e dhjetarët — nga të gjitha. Është e vërtetë se xha Dalipi, aë ndofta kish hedhur ndonjë kupë përgjysmë me ujë (tani, në pleqëri, rakia e zinte shpejt), i kish ngulur atë shajkën e trashë, me qoshe, duke përmendur kohën kur

agaj kish qenë zaptije turku, po kjo s'peshon shumë në kandar: ashtu kish qenë koha, ashtu kish bërë. Apo jo? Të shkuara të harruara, aq më fort kur s'na e kënda të na i kujtojnë bota. Sa për atë Kipin e Xhipit, një kaçak kokëndezur nga ata të Vërçës, që kish ngritur krye kundër hyqymetit: s'desh të shkonte as redif as bedel, as me harxhe, s'desh të paguante xhelep, atëherë ishin zbrazur tri dyfeqe dhe s'dihej cili nga këta e kish vrarë. Doemos, më mirë nga të gjithë qëllonte Zylua i Zylfos apo Ago Zylali i sotmë. Ky kish shtënë i pari. Bile, kish sokëllitur me të madhe, se plumbi i tij e kish shtrirë kaçakun? Po ashtu, Zylua kish arritur i pari në vend dhe e kish zhveshur Kipin, i kish marrë martinën, gunën, opingat. Qese s'kish pasur. Dhe Zylos i kish ardhur keq që s'kish gjetur qese. Për këtë «trimëri» vetë yzbashi i kish rrahur supin Zylos të Zylfos e i kish thënë: «Ashkoll-sun, gazi, Aferim!» Hej, po të mos ishin ndryshuar punët e të mos ish prishur Turku, Zylua do të ish ngritur lart e më lart. Edhe sot s'është keq, po sidoqoftë... Në atë kohë Zylon e mori edhe kënga — jo e tija, po ajo e Kipit të Xhipit, që thosh: «Të vrau, Zylo, zaptija, o Kipi, të vrau. Nga nëna e motrat të ndau...» Një të mirë bëri xha Dalipi në këtë mes: nuk zuri në gojë atë punën e kolonjarëve, se kush e vrau e si e vrau, se kush e zhveshi e si e zhveshi. Domosdo, këtë punë e dinë njerëzit, të vjetrit. Po tjetër është të dish e tjetër të thuash.

Mirëpo, papritur, nja dy çunarakë sapodirsur mustaqja u bashkuan kokë më kokë në një cep e ia nisën: njëri thuj, tjetri prit. Me zë të ulët këndonin, po dëgjohej mirë:

*Ke tre vjet në komitet,
Kapedan Gani, medet,
Po bën luftë me një grek...*

Hop u ngrit një tjetër, u shtrua këmbëkryq pranë, u bëri shenjë të pushojnë e ia mori një këngë tjetër. Ai këndonte, ata të dy ia mbanin:

*Malet e Gramozit qajnë
Zi të madhe ata mbajnë,
Për Ganinë që e vranë...
Sali Butkës van' i thanë:
– Ty Ganin ta zun' të gjallë...
– Mos ma thoni këtë fjalë
Se Ganin ma kanë vranë...
Sali Butka shtron rakinë
E me lot e qan Ganinë...*

Dhe tërë Çukën e Vogël e pllakosi pikëllimi. Askush nuk mbante më vesh për të dëgjuar gjinkallën e ferrës dhe sëpatat e dyfeqet e gështenjave. Gani Butkë ky, trim me fletë!

– Më qafsh, xha Dalip, – tha djali i Shaqos pas një copë herë, – po s'na e mbarove atë punën e mullirit. Plaku nuk iu përgjigj. Shikonte. Shkuan aty pranë, me zhurmë, ca mushka të zeza Italie, nga ato të topave, të ngarkuara me thasë të bardhë xhunga-xhunga. Pas mushkave vinin tre ushtarë të dirsur, të shkopsitur e të shkallafitur, si të çalldisur, me kallpakë të lartë mbretërorë në majë të kokës; stema e trunxhtë: një «Z» e madhe, e prerë, pingul me një «I», si hu gardhi, mbi strehën e zezë, të thyer e të varur, shikonte tutje, udhën e Ploçës. Prapa vinin tri mushka të tjera të ngarkuara me lloj-lloj enësh: teneqe të ndryshkura, matare e gaveta të shtypura, stomna e shtamba uji etj. – ca për të pirë e ca për të gatuar. Uji lloçoçitej e spërkatte udhën tërë pluhur. Së fundi, vinte një mushkë vithemadhe e ngarkuar me dy thasë. Ç'kish brenda? Ku ta dish! Ndofta fasule të vjetra, a groshë qorre, ndofta oriz, apo edhe kështu

edhe ashtu. Mushka, siç duket, ishte shumë xanxare, prandaj ushtari ia kish hedhur zinxhirin si hallkë në gojë. Pas mushkave dhe ushtarëve nxitonin ca puftë të zhelosur, të zbathur, dy nga dy, me nga një shilurth nga supi i njërit tek supi i tjetrit. Në çdo shilurth kishin varur nga dy mishra të therura – ftujakë e skopakë – me kokat poshtë, që herë çukiteshin nëpër gurët ose zvarriteshin nëpër pluhur, herë shpëlaheshin në ujin e vijës, duke rrëmbyer që aty ndonjë fill kashte, ndonjë lëvizhde a ndonjë ndyrësi tjetër më të madhe.

– Buka e mishi i ushtisë, – tha Ago Zylali dhe u krekua pak. – Sot e paskan trashë punën: mish me pilaf. Ohoho... Mbretëri kjo, ore!

– E mbushin, po..., – tha Dani me qesëndi.

– Pse, ore, nuk e mbushin, – a? Nuk i pe mishrat.

Apo...

– E mbushin me lëng stërlëngu. Këto mishra, që i ka gjysmuar e stërgjysmuar sipërmarrësi me shokë, do t'i ndajnë këmbë-këmbë oficerët, bekrinjtë, sarhoshët; do t'i futin në torbat, nga torbat në tavat, nga tavat në furrë e haj... brom, rroftë e qoftë! me rakil Për shëndet të naltmadhërisë.

Në këtë mes, në Çukë kishin ardhur edhe katër a pesë burra të tjerë, ca për të pritur radhën e ca për të shkuar kohën. Ish kthyer Grendelli, tërë qejf. Siç e kish këshilluar Ago Zylali, Grendelli kish lajmëruar «të zonë e pazarit» dhe policin e bashkisë, i kishin vajtur bashkë në derë Tili Samarxhiut, ia kishin bërë lëkurën dy pare dhe i kishin zhvatur dhjetë lekë: pesë për tagrën e qomarëve me thekërishte që kishin shkelur gurët e kalldrëmit, dhe pesë për gjobë. Tërë thekërishtet s'bënin as shtatë lekë. Tili ish munduar t'ua mbushte mendjen se nuk e kish bërë për tregti (këtë as që duhej t'ua thosh, se e dinin vetë), po kish vajtur e kish marrë në Peshkëpi, nga një myshteri, të cilit i kish ndrequr një

samar veresie. Fjala e tij s'piu ujë. I zoti i pazarit dhe polici i bashkisë kishin dhënë një vendim të prerë: «Çdo mall që hyn në pazar, duhet të paguajël.» Samarxhiu kish dashur të hiqte dorë nga thekërishta, ia kish falur të tërë kryetarit të bashkisë dhe sipërmarrësit të pazarit, po as njëri as tjetri s'kishin dashur ta merrnin ta hanin, kështu që më në fund kish nxjerrë parat e kish paguar. Thekërishta e marrë për samarin veresie, udha të vajtur e të ardhur, e mira që i kishin bërë të zotërit e gomarëve – të gjitha kishin shkuar kot; së bashku me thekërishten kish humbur edhe tre lekë pare xhepi. Veç kësaj i kishin thënë «hajdut» «batakçi»... «samarxhi» e shumë të tjera të kësaj dore. E shoqja, një gjysmëgrua, thatime, që nuk i vinte as gjer në sup, ish trembur shumë e kish ngrirë me gisht në gojë, fëmijët kishin qarë, sepse polici i bashkisë me ato rrobat zyrtare tërë shirita të kuq, të zinj, tërë çapraze të arta, me kapën të ngjitur përpara e të ngjeshur në gropën e qafës, me një kobure të madhe të varur në të mëngjër, pa këllëf, e kish pamjen shumë të rëndë. Nga të pesë lekët e gjobës, tre i kish marrë polici, dy – Grendelli. Dhe i qe bërë zemra mal: Ago Zylali i kish rrëfyer udhën për të nxjerrë lekun me të ndenjtur dhe ai, Grendelli, i kish sjellë peshqesh, si mirënjohje një defterkë kartëcigare nga ato të Stambullit. Kështu, sapo u kthye në Çukë, ia dha dhuratën agait e ndenji nën këmbët e tij, ashtu siç rri qeni nën këmbët e të zot dhe mbajti vesh të dëgjonte, po shumë hijerëndë, sepse tani edhe ai ish goxha, gjysmë qeverie...

Dani vazhdoi:

– Kur bëja ushtrinë në Tiranë, jashtë, në gazemat e Ali Rizait, ushqimet e ushtrisë i kish marrë përsipër një kompanjë hajdutësh apo, si të themi ne, një zhgan larosh e balosh. Në këtë zhgan kish ministra, ish-ministra, deputetë, tregtarë të mëdhenj. Të gjithë ortakë: kaq do marrësh ti nga fitimet, kaq unë, kaq do t'i japësh Lalës,

se Lalën e kishin krye. Ushtrisë i shkruanin dhjetë, i jepnin një; të tjerat këtu. – Dhe bëri sikur futi diçka në xhep, në të djathtë, ndonëse s'kish fare xhep. – Ushqimet shkonin dorë më dorë, gjersa katandisej kokoshi një thelë. Zgrapnin të gjithë. Efendilerët e bejlerët thoshin si në kohën e Turkut: «Malli i shtetit është mall pa zot; kush s'vjedh është budalla. Kur i marr shtetit një lek, sikur i shkul një qime derrit.» Të gjithë kishin ngritur tri-katër palë shtëpi në Tiranën e Re e në të Vjetrën, dyqane të mëdha në mes të pazarit. Ca nga këto shtëpi e dyqane i kishin lëshuar me qira shtetit. Ama qira të madhe, që të lot tepja e kokës! Shtetit ia vjedhin paret, shtetit ia japin me qira shtëpitë, siç bëri ai miku i këmtushëm me paret e të dhjetave. Ca burra të tjerë, ministra, deputetë e më the të thashë i vjedhin paret në Shqipëri e i hedhin në Itali, blenë atje mall të patundur, që të kenë gjithnjë shpatullat të ngrohta, të rrojnë me të ardhura. Një palë ka zaptuar kripën, një palë duhanin; italianin ka marrë gazin e sa e sa të tjera. Ca burra kanë kaq shumë pare, sa nuk dinë ç'të bëjnë, hanë, pinë e u teprojnë. Lënë gratë e fëmijët në shtëpi e shkojnë shtrojnë aheng në Stamboll-Hotel, në Tabakët, në Bërrakë. U prishën menç pas një çingie që i thonë Marie. Buçet anembanë kënga: «Marie, moj Marie, Moj si mushkë Italie...»

Pastaj Dani zuri të përmendte emra zyrtarësh të mëdhenj: hajdutë e kurvarë. Zuri në gojë edhe Lalën, edhe aspirantët bukuroshë, «çunat» e Lalës e sa e sa të tjerë.

Papritur Ago Zylali u nxeh: ndofta i erdhi keq, se Dani kish gojosur emrat e disa miqve të mëdhenj, që i kishin bërë nder.

– Ndrej gojën, o djalë! Si vjedhkan goxha ministra e deputetë? Fjalë është kjo? Ata janë... janë... E di, apo s'e di? Janë... baballarët e vendit.

– E mora vesh, janë hajdutët e vendit, – ia preu Dani gjakftohtë, përbuzës.

Sado i mbajtur që ishte Ago Zylali, kësaj here nuk e duroi dot. Ndofta brenda tij që zgjuar zaptija e vjetër e Turqisë. E kërcënoi me çibukun e gjatë të stolitur me thith qehlibari e ia këputi:

– Hap sytë, djalë, se të kam sërë miku. Hap sytë, të them, mos shkosh lidhur në Tiranë.

Dani i hodhi një shikim si dackë, pastaj fytyra iu zbut dalngadalë. Buzëqeshi e tha:

– E mora vesh ç'kërkon të bësh, aga; do të vesh të më kallëzosh. Po unë s'jam nga ata të Kakaçit, që ia paskan frikën ariut. Sa për ata miqtë e Tiranës, po të them edhe një herë: vjedhin me të dy duart, zgrapin, zhvatin. Ne hanim koromane të thata të përziëra me misër të mykur, ata pinin verë Italie me çingitë e «Stamboll-Hotelit», me Marien-mushkë-italien. Merrnin përsipër të ndërtonin udhë e ura, u hidhnin të vjetrave një cipë çimentoje, sa për sy e faqe, e paguheshin si për të reja. Ehe, Ago Zylal, ti ke mbetur hala ne ura, siç thonë andej, në Gegëri: je edhe në kohën e Turqisë e të Ethem beut me shokë. Nuk këndon ç'shkruajnë gazetën, megjithëqë shkruajnë shumë pak nga ato që ndodhin. Kudo sipërmarrësit fitojnë pesë, dhjetë për një, majmen si derrat. Le që ti as nuk di të këndosh, ke mbetur dyfek me çark.

– Fitojnë se punojnë; janë të zotët. Kanë para, janë nikoqirë, të mbledhur. Paraja heq paranë, punon. Atë që e do zoti, me të madh të tij, (jarebi shyqyr!) e ngre lart e më lart.

– Ashtu them edhe unë. Fitojnë ata që i do zoti nën-prefekt, ata që i do zoti rrethkomandant, zoti gjykatës, zoti kryetar i bashkisë, zoti prefekt, e kështu me radhë, gjithë zotërinjtë e tjerë gjer lart fare. Po që të të duan, duhet t'i duash. Jo me fjalë, po me punë, me ortakllëk. Për punë të vogla është mjaft një kadushkë gjalpë, një qyp mjaltë, një thes arra, ca koranë e ca ngjala, po për punë të mëdha duan pare të madhe nën dorë. Po të

bësh kështu, mbyllin sytë e të lënë të vjedhësh, të rrëm-besh, të fitosh, siç thua zotrote. Jakma, si në Jamë të Homezhdit.

Xha Dalipit i qeshi fytyra e zhubrosur, po finoke. E shikoi Danin sikur t'i thosh: «Të lumtë, bjeri zaptijes!»

– Unë s'të marr vesh, o djalë, – tha Ago Zylali me njëfarë pikëllimi. – S'të marr vesh se si je bërë kështu, kaq i prapë. Nuk di kush të prishi andej. Ndofta ajo Maria-mushkë-italia... Ti dhjetarët nuk i do; sipërmarrësit nuk i do; fajdexhinjtë nuk i do. As bejlerët, as deputetët, as nënprefektin, as ministrat, as ata të kripës, ata të cigarevë... Po më thuaj, ore ç'do ti?

– Unë? Hëpërhë ca ujë për të vaditur misrin, – ia bëri Dani duke hequr zvarrë zërin, me të tallur. – Sa për Marien... Ptu, ment prisha gojën!

– Në do ujë, prit radhën aty ku je.

– Peqe, aga: e pres këtu ku jam, – ia ktheu gjithë me të tallur.

– Jo, mos prit. Dëgjo, o Saipi!

– Saipi shkoi, se i erdhi radha, – tha Asllani.

– O Rushan, nd'je turk e më din, jepi radhën tënde këtij, të ngopet me ujë, se na bëri helaq, pastaj shohim e bëjmë. Ti merre në mëngjes.

– Dua t'ia jap, po s'ia jap dot, aga. Edhe unë kam shtëpi, fëmijë. Jepi zotrote tënden, atë të arës së Unapit, se misrin e ke të hazdisur, sa humbet brenda kali me gjithë kalorin.

– Unë ndaj e s'mbaj për vete, s'mbjell e s'korr.

– Atë të djemve, të nipërve...

– E si prishkam unë një bukuri selishtë për skërkën e këtij? – dhe tregoi me çibuk Danin.

– Mirë i the, aga, – tha Dani me të qeshur, – tamam skërkë. Po do të vijë, ndofta, një ditë kur skërka do të hajë selishtat, kur... Ja, prit edhe ca..

Ago Zylali e shikoi duke u munduar të merrte vesh se ç'kish dashur të thosh, pastaj kafshoi qimet e varura të mustaqeve, ndolli një tym e nuk e ngau më tej punën, po me mendje tha: – «Medet, ç'u prish bota! Të rinjtë s'ua varin pleqve; harbutët hahen bashambash me parësinë. Shkon një çunak në Tiranë për të bërë ushtrinë e kthehet azgan, si qen me katër sy, mban botën nëpër gojë; jo po ky merr rryshfet, jo po tjetri vjedh... Dale, pa ia fërkoj unë kokën me akull. Vetë në qeveri, e kallëzoj se bën turbullirë. Një hiç bir hiçil!»

Tha me zë të lartë, duke rënkuar:

– Hej, vakt, vakt!

Druri po merrte fill shtrembër, sepse këto të uruara fjalë janë si ato qershitë bishtgjata: bën të heqësh dy e heq tërë togun. Këtë punë e dinte mirë djali i Shaqos, se kish kohë që kur vinte në «mehtep të shelgut» – në Çukën e Vogël – ku mbante vaz Ago Zylali, i cili, veç të tjerave, ishte shpeshherë çerek ose çerek çereku dhjetari nëpër ortakllëket e mëdha e të vogla dhe futte ngahera lugën në majë të gjellës, në lyrë, sapo hiqej kapaku. U mundua të largonte havalen e tha:

– O xha Dalip, na e nise e nuk na e sose atë punën e llo Mullëmadhit. Më qafsh po s'na e rrëfeve të tërë. Si ia punove pastaj?

Xha Dalipi e shikoi, mori vesh se ku shtinte dyfeku e tha:

– Peqe, peqe. Ja tashi...

Mirëpo në këtë kohë u dëgjuan ca çape këpucësh andej nga Arra e Mukes. Ata të Çukës kthyen kokën dhe panë se po vinte një si njeri, që herë humbiste në hije, herë dilte në dritë dhe herë tjetër kredhej midis dritës e hijes, e bëhej larush, tërë vija të bardha e të zeza. Kur u afrua edhe ca, panë se njeriu me këpucë ishte i paktë nga trupi, i zeshkët, as i ri as i vjetër, me një palë rroba allafrennga, bojë hiri, as të çelura as të

nbyllura, me një bastun të trashë varur në krahun e mëngjër, kundruall zemrës, kurse me të djathtën çante erën për të hapur udhë. Të ecurit e kish herë më të shpejtë, herë, më të ngadalshëm, pak si me dredhka. Kur arriti përbri Çukës, që ku ngrihej anembanë tym duhani, shikoi sa shikoi duke zhubrosur ballin dhe, së fundi, sikur u çel, u kthye përgjysmë e kuturisi t'u jepte një tungjatjetë pak si të vëngjërt: ngriti dorën në kapelën gështenjë për të përshëndetur evropiançe, pastaj ktheu mendjen, uli pëllëmbën në zemër, preku dorezën e bastunit, e ngriti dorën shpejt në ballë, allaturka, dhe tha me një zë që herë rritej, ngrihej, trashej, pastaj hollohej, ulëj e këputej, ngrihej përsëri, ndërsa ai vetë qëndronte hijerëndë, i menduar, thumbonjës:

— Tungjatjetani e mirë se ju gjejmë, o zotërinj agallarë e zotërinj dhjetarë, kryepleq e kryekatundarë. — Bëri sikur buzëqeshi, po shumë i përmbajtur. — Si vini, si shkoni, o zotërinj? A jeni shëndoshë e mirë? Si i keni gjënë e gjallë të shtëpisë? Si dolët me të dhjetat? Si i keni të lashtat e arave?

— Të lashtat i korrëm, tashi po vaditim të vonat, misrat, — ia kthyen ca si me gjysmë goje, pa vënë dorën as në zemër, as në ballë e as më lart.

— Misrat-a? O, sa mirë, sa mirë! Të na bëhen të mëdhenj, që t'i këputim zhgrap-zhgrup, t'i pjekim e t'i hamë krap-krup, me zotërinjtë pojakë e me zotërinjtë dhjetarë, kryepleq e kryekatundarë. Se na hahen, ore, na bëjnë mirë në bark! Ama, duam të jenë të njomë, qumështorë. Ashtu na hahen. Apo jo, o zoti Riza i zotit Shaqir? Shikoni? Edhe zotit Riza të zotit Shaqir ashtu i pëlqejnë: zhgrap-zhgrup me dorë e krap-krup me gojë.

Rizai uli kryet, se i dogji miza në shapkë, u mundua të gjente e të këputte ndonjë fije bari të thatë afër shtegut të milingonave.

Ata të Çukës e shikonin njerinë me këpucë e nuk i

përgjigjeshin. Ca thoshin me mendje: – «Hajde-hajde... Ky po flet si xhahil Mokre a Gore. Pale, po qeveria e mban me rrogë, e ka dërguar të mësojë nëpër shkolla», ndërsa të tjerët e shikonin e s'merrnin vesh asgjë. Vetëm Dani e xha Dalipi e kuptuan se tallej me gjithë të mëdhenjtë e fshatit. Kish dashur t'u thosh: «Si i keni ato të shtëpisë, që i mbani mbyllur, si kafshë?» e kish thënë: – «Si e keni gjënë e gjallë?» Rizait të Shaqos, kish dashur t'i thosh «hajdut» e kish thënë «zoti Riza i zotit Shaqir». Po ashtu edhe ajo puna e pojakëve, dhjetarëve e kryekatundarëve.

Pas përshëndoshjes së takimit u bë një çast heshtje. Më tej, pas heshtjes, ardhi përshëndoshja e ndarjes, me të njëjtën të folur gorarçe e mokrarçe, ndërsa sytë i flakëronin nën zhubrat e zeshkëta të ballit të zeshkët, as të gjerë e as të ngushtë. Kësaj here iu drejtua në fillim një konke këmbëhollë, me njolla të bardha e të zeza, me një turi të mprehtë, me ca sy finokë e të ndritur si ruaza.

– Hajde, moj Lule e dashur, t'u themi «mirë mbeçi» e «punë të mbarë» këtyre zotërinjve agallarë e dhjetarë, «kryepleq e kryekatundarë,» që po mbajnë kuvend për të vënë në vijë punët e fshatit. – Bëri sikur qeshi e sikur desh të thosh: – «Shikoni, unë jam budalla, flas me qentë», dhe shtoi me zë të butë, të hollë, pothuaj të përzemërt: – E shikoni, zotërinj. Kjo kone është e mençme, si njeri e të vjen keq t'i thuash qen. Rrini me shëndet e kuvend të mbarë, zotërinj! Rrofshi e qofshi! – Tha kështu, duke përshëndetur madhështor, me dorë në zemër e lart në ballë, bëri të largohej, po u pendua, nxori nga xhepi një kartë të mbështjellë, i hodhi konkës gjësënd për të ngrënë. Kjo i mori erë, nuk e pëlqeu, shkoi në gardhi pas një ere tjetër, ndofta më të këndshme, ngriti njëren këmbë dhe...

I zoti u zemërua e i thirri:

– Hej, ngordhç edhe ti. Të hëngërt ulku pa dhëmbë. Lanet! Ngordhçin gjithë qentë e botës!

Ata të Çukës ca qeshën, ca s'qeshën. Edhe kësaj here Dani e mori vesh se ku shtinte dyfeku, ndërsa ai miku po largohej duke nëmosur: «Lanet! Lanet!»

– Po ky si e ka terezinë? – pyeti dikush.

– Si ta ketë? Llamba-llamba, – tha një tjetër. – Shkollë ka parë, po s'është gjë. I pëlqen të flerë në një qoshe plevice pa derë, andej nga Qaramithana. Del natën e numëron yjet një nga një. Rri shtrirë nën arrë e bën karabaçka. Mirë thonë se shkolla e tepër të prish mendjen.

– Të prish, – tha Ago Zylali. – Shkolla s'është gjë. Që kur doli shkolla, u shkretua bota, humbi trimëria e burrëria. Mua më ka thënë një kadi se...

Nga lart dëgjohej zëri herë me të lutur e herë me të kërcënuar i të zot të konës:

– Na, Lule, na! Na këtu, të çaftë ariu i Kakaçit!

– Lule i thënka? – pyeti dikush me të qeshur.

– Lule, I ka nxjerrë edhe këngë.

– Kones-a?

– Po, kones. Thotë se Lulja e tij është më e mirë se një njeri. «Nuk vjedh, – thotë, nëpër arat e vreshtat, siç vjedh zoti pojak; nuk merr ryshfet si zoti nënprefekt e si zoti gjykatës me shokë!» Ama të gjithë këta thotë se i ka miq...

– Shiko, shiko.. Ç'punë bën ky?

– Ky? – tha Ago Zylali. – Mundohet të marrë diellin në shoshë e ta futë brenda, për dimër. E prishi shkolla. Të kem të marr një kazmë e t'i futem asaj shkollës, ta bëj shesh e lëndinë. S'e kish keq ai miku që thosh: vendi mbahet me spahinj e me zaptije. Shkolla prish. Ama edhe ata të mëdhenjtë ia kanë vënë këtij, si i thonë, festen sipas kokës; i japin një si rrogushkë e nuk e vënë në bukë të madhe: tagrambledhës, nënprefekt,

kryetar bashkie. Atje duhen burra që ta lozin, jo ata që bëjnë karabaçka.

– Jo, s'bën për punë të atilla, s'është i zoti.

– Kish një shok, ore. Më të vogël. Me ca gjyzyllkë. Shkonin poshtë e lart: zbraz e mbush thasë me fjalë.

Rifati qeshi:

– Kish gjetur koka kokën. Matnin ujin e gjolit me filxhan, sa okë ka. I prishi shkolla.

– Ç'u bë ai tjetri?

– Humbi andej nga Vllahia, pas shkollave.

– Ptui! – pështyu Ago Zylali, ërzëliu.

Djali i Shaqos shtoi:

– Ky tjetri, që thua zotrote, mban aty afër Qeramithanës një qen sa një viç, nga ata të Çervenakës. I thotë Buzo. E lëshon natën sallma, ta ruajë.

– Ta ruajë? A mos ka ndonjë hasm?

– Jo, hasm s'ka, po thotë: «Pojaku e xhandarët na ruajnë nga hajdutët, po kush na ruan nga pojaku e nga xhandari? Qenit po t'i japësh të hajë, ngopet e nuk trazon; pojaku e xhandari sado t'u japësh, nuk ngopen.» Buzua të çan, po të bësh një çap brenda në oborr a në kopsht.

Dani i hodhi Rizait një fishek qorr:

– Ruaju, Riza, mos dil pa fener nëpër arat e vresh-tat e botës...

Rizai që po fjalosej kokë më kokë me Grendellin, bëri sikur s'dëgjoi.

– Ai bëka për mua, – tha Meti i Sulit, që kish ca krerë bagëti të vogla në mal. – Më tha djali se atje vjen një ulkonjë me gjithë këlyshë.

– Merrja e ngjite lart. Është skotë e mirë nga ata që e mbajnë edhe ujkun. Ky mjaft e ka Lulen, – tha Rizai.

– Ia marr, po si t'ia marr? Ti the se të çan.

– E ndill me ndonjë mëlçi a me ndonjë buçe, e lidh me zinxhir e hiqe lart, na shpëto nga havaleja.

– Mor, unë i jap edhe një milor, vetëm të di se.

– Milorë na e jep neve, ta therim e ta hamë. Ai mjaft e ka rrogën. Apo e kam keq?

Nuk iu përgjigj njeri. Fluturuan dy dallëndyshe rrafsh me udhën, ment çikën me krahë vijën e teptisur, shkuan si dy shigjeta nën Arrën e Mukes dhe u zhdukën tej shtëpisë së Koçiut, me një ballkon të stolisur me dy copa pasqyre të vendosura si yll e gjysmëhënëzë. Kjo stoli ishte data e ndërtimit të shtëpisë: 1914, kur kish zbritur Myrto beu me këllëçin e zhveshur e me bajrakun e Osmanllisë, vetëm se me kohë e mot ballkoni bashkë me yllin dhe gjysmëhënëzën ishin zgjebosur mjaft dhe kishin humbur bardhësinë dhe shkëlqimin e dikurshëm, sepse tani dukeshin pllackat si ca brinjë gomari.

Në Çukë u duk sikur fjalët kishin shterrur përngahera, kur Asllani pyeti:

– Hajde, o xha Dalip, mos na lër kështu të shurdhër; na thuaj si të vajti pastaj ajo puna e mullirit të Mullëmadhit?

– E ku të ndahet Asllani... – tha dikush. – Ky e ka si ai dibrani, që e ndoqi gallofin tri vjet, më dyfek, mal më mal, se i kish rrëmbyer një kallj misri.

– E zuri? Ia mori?

– Jo, pas tre vjet, pam-pum, kur pa se nuk ia shkulte dot nga sqepi, i tha: – «Hajt, o gallof, ta kam falur. Haje për shpirt të babait.»

Xha Dalipi ndezi një cigare tjetër, shikoi përçark.

– Ku e lashë? – pyeti. – Se ma bëri mendjen dhallë ai miku i Buzos...

– Atje ku të përblau ato çepurkat me miell natën.

– Tamam. Ngrihet llua, mbush çepurkat, i hedh në hambar e bie të flejë me kokën në kërcu, kurrizin në

rogos e këmbët jashtë, në bajga. Me të rënë, e zë gjumi e nis t'i bjerë dudukut, të gërhasë. Bubullon tërë mulliri. S'dëgjohet as penda, as guri, po vetëm të gërhiturat. Mustaqet i fryhen e i shfryhen në dritën e kandilit, lart-poshtë, lart-poshtë. Ngrihem unë ngadalë, marr çepurkën, e mbush gjashtë herë në hambar të tij dhe e hedh miellin në pod të mullirit, e mbledh në qoshe e bie të fle. Një sy e mbaj mbyllur, një sy hapur, të shoh se ç'do të bëjë. Ilua fle e gjëmon si Shëndëlliu me Sulltan Nevruzë bashkë.

– O sa mirë ia paske punuar! – thirri Asllani, i gëzuar. – Të lumtë!

Xha Dalipi psherëtiu.

– Jo, Asllan, nuk bëra mirë, po nejse... Asokohe aq dija, aq bëja. Në mëngjes shkrep dielli e hyn brenda në mulli nëpër baxhë, nëpër të çarat e çatisë, nëpër hatujt. Ilua ngrihet, del, u hedh syve ca grushte ujë poshtë ne penda e kthehet, thotë «mirëmëngjes», rri në një gur e ha bukë me qepë e kripë. Buka është e thatë. Ilua s'ka dhëmbë. Njom bukën në një misur ujë që ka pranë, mundohet ta mbllaçitë. Kur e kur fshin lotët me grusht. Siç duket qepa djeg shumë. Leshrat i ka tërë miell, mustaqet tërë miell. Edhe vetullat.

– Si derr, – tha Asllani, po askush s'ia ushqeu fjalën.

Xha Dalipi e shikoi me të qortuar dhe vazhdoi:

– Ashtu thosha edhe unë më parë. Tashi e kam kthyer mendjen e them: njeri hallexhi, i varfër, i munduar. Mulliri është mbushur plot dritë të kuqe. Pahu i miellit lëvrin në të katër anët. Dal laj sytë e i them: – «Mirëmëngjes, o mullixhi. Si u gdhive? A fjete mirë? A pe ndonjë ëndërr?» – «Mirë, thotë. Fjeta ca. Ëndrra thua? S'di. Ndofta pashë, ndofta s'pashë. Në pashë, i kam harruar. S'i mbaj mend, aga. As të mirat, as të këqijat. Kështu është më mirë. Nuk gëzohem, nuk hidhërohem. Unë kam vetëm një gëzim: kur ha bukë. Po ti, pe ndonjë ëndërr

të mirë?» – tha «Pashë llo, po haj të mbarojmë punë, pastaj ta rrëfej.» Ai lë bukën në mësirin me ujë, lë qepën e kripën mbi gur. «Jo, i them, mos e lërë bukën përgjysmë. Të pres gjer të mbarosh.» «S'ka gjë, më thotë. Le të zbutet ca, se më vret mishrat e gojës. Më dhëmbin, një janë bërë fulltakë. Kam ca të mallkuara rrënjë që më therin. Duhet të vete ndonjë ditë në Nexhip Nallbani a ne Kopi Shurdhua, që të m'i nxjerrin, po s'mund. Punë, punë.» Merr çepurkën e vjen të marrë hakën e të bloturiturit.» – «Më bien, thotë, tri çepurka.» Unë bëj buzën në gaz: – «Merr sa të duash o mullixhi, të drejtën tënde.» Ilua mbush dy çepurka edhe i hedh në hambar; mbush një tjetër edhe e hedh në një thes të vogël që ka pranë podit. Shkon sjell gomarë, shkel nëpër bajga, më ndih ta ngarkoj, më thotë: «E hëngësh gëzuar me gjithë fëmijë, me farefis e miqësi, me dasma e poganikë. Mot të bëftë ara më shumë: një kalli, një killë.» Më përcjell jashtë derës, në ura e jazit që vinte si e thepisur, më thotë «Udhë e mbarë, aga» e matet të hyjë në mulli, që të mbarojë së ngrëni bukën e qepën. Unë kthehem e i them: – «Dale, o llo, të të rrëfej atë ëndërrën që pashë në mulli. M'u duk sikur ti u ngritke natën, mbushke vëp e vëp tri çepurka miell nga imi dhe i hedhke në hambar. Pastaj rënke të flësh e zënke të çash dërrasa.» Ilua u skuq pak, pastaj u zbardh e u bë si miell. Bëri të qeshë e s'qesh dot. – «Si fjetke ti, i them unë u ngritkam unë, marrkam gjashtë çepurka nga hambari e i hedhkam në miellin tim. Kjo është ëndërra që pashë në mulli. Rri me shëndet, o llo», edhe i bë gomarit: «Ush, or ti, se erdhëm plot e u kthjem më plot.» Atëherë Ilua qeshi me të madhe e thirri: «Ah, ç'ma paske punuar, O Dalip. Qenke i zoti. Të lumtë! Hallall e paç.» Nuk dukej i zemëruar, po i gëzuar. Ndofta sepse e priste buka me qepë e kripë. – «Dushk për gogla, llo vëlla. Një herë ustai, një herë agai. Apo jo?» Ai s'di se ç'tha... Qeshi...

M'u duk se thirri: «Nga hambari i haramit! Ohoho!»

Më të shumtët e atyre që ndodheshin në Çukë qeshën, po më fort qeshi Ago Zylali: sytë iu mbushën me lot, nisi ta ngiste kolla e duhanit.

– Mirë ia bëre derrit! Edepsëz mullxhi. Hajdut. Të kisha qenë unë, do t'i kisha vënë grykën e kobures në lule të ballit e do t'ia hiqja këmbëzën, t'ia merrja shpirtin e t'ia hidhja në...

– Për tri okë miell? – pyeti xha Dalipi i çuditur. – Të vrasësh një njeri? Punë që s'bëhet. Ne kemi duruar e po durojmë gjëra shumë më të mëdha, shumë më të rënda. Kemi duruar thika që na kanë hyrë gjer në eshtër.

– Nuk e kam për tri okë miell, po pse të më vjedhë? Apo jo? Plumbin në lule të ballit! Unë, që thua ti, lëroj arën, mbjell, prashit, korr, shij, punoj, mundohem sa më bie bretku... edhe ai... që thua ti, i biri i botës vjen e më kobon... Koburja i ndan të gjitha. E lija thes në mes të bajgave, si derr, e s'më bënte as tër veshi. S'më zinte gjyqi. Vinte llovica ta ngrinte në trirë, ta qante e ta kallte në varr.

Xha Dalipi u err, pastaj u çel përsëri, bëri sikur qeshi me ato faqet gufalle tërë qime kuqaloshe:

– Me sa di unë, ti, Zylo, s'para je munduar me të lëruar e me të mbjella, s'e ke nxjerrë bukën me djersën e ballit. Në të ri ke bërë zaptillëk, më tutje myftarillëk, sot ke nikoqirllëk, bujklëk, e rrugallëk, gjysmë bejllëk, gjithnjë bollëk. Pare plot... Ne të tjerët kemi dirsur. Megjithatë, nuk e kemi nxjerrë aq kollaj koburen. Jo nga frika, po meqë jemi njerëz.

Në motin e Bullgarit, kur ra zia e bukës e njerëzit u shuan bashkë me fëmijët, ti i kishe hambarët plot. Shisje pesë okë misër për një lirë turku; flori, të pafshirë. Lirë doje, jo napolona. Ata që s'kishin lira, hanin koçanë misri të bluar në mulli. Fryheshin e pëlçisnin. Shtatë-tetë

të vdekur në ditë, se kishim edhe muhaxhirë. Ty s'të erdhi njeri të të vërë koburen në lule të ballit për një okë misër. Bile, shisje edhe koçanët me pare. Atë mot u zgjerove shumë, se bleve kaq ara për një copë bukë. Mos fol kështu, Zylu, se s'të ka lezet. Atëherë ma more edhe mua atë... atë... që... Ti e di. Nga halli ta shita. Zylu, nga halli. Mall babe...

Në këtë kohë Dani zuri të këndonte ngadalë, shtruar:

*Të vrau Zylua, o Kipi të vrau,
Nga nëna e motrat të ndau...*

Ago Zylali e shikoi xha Dalipin si nëpër sitë: nuk i qenë tharë edhe lotët e të qeshurit të mëparshëm. Megjithatë, vështrimi i tij, qoftë edhe nëpër sitë, thosh se donte ta përpinte të gjallë, t'i vinte koburen në «lule të ballit». Tundi kokën e s'foli. Ndofta i vinte keq se nëpër ato turbullirat e shumta që ishin derdhur, dikur nëpër vendin tonë, ai e kish pasur në dorë ta qëronte xha Dalipin nga kjo botë e të mos e merrte vesh as dreqi, se këtë punë mund ta kish bërë me dorë të tretë. Dhe si shpërblim, sot, duke qenë plak e s'ngre dot dorën njeri ta trazojë, bën ç'bën e i fut nga një peronë të trashë, nga ato me qoshe, që bëjnë koveçët evgjitë.

Asllani s'qeshi nga pikëllimi për miellin që i kish mbajtur llua. As Dani nuk qeshi, po fërshëlleu më tej këngën e Kipit të Xhipit. Ai kish kohë që ishte ngrysur si Guri i Kamjes kur e rrethojnë retë. Kështu rrinte pothuaj gjithnjë nga dita kur ish kthyer nga kryeqyteti, ku kish nisur të përziante toskërishten me gegërishten. siç bëjnë ca kohë ata që shkojnë andej ushtarë.

— Of, unë i mjeri — rënkoi Asllani. — S'e pata ditur se llua bënte kështu, ja për këtë dhe, që do të na hajë. Bëj hesap: unë bluaja një killë drithë në javë, pesëdhjetë e dy killë në mot. Ai më merrte të paktën pesë a gjashtë

okë më shumë për killë. Sa bëjnë në njëzet vjet? T'i kisha këto të gjitha, sot do ta rrija më lart se shokët.

Dhe zuri të llogaritte me gishtërinj, duke murmuritur, Dani e shikoi si me përbuzje e si me të ardhur keq.

— O Asllan, — tha unë s'të pata ditur kaq varfanjak. Ato që shkuan, shkuan. Po dal ta kapim punën me radhë. Fshati ia ka ditur dhëmbë e dhëmballë Ilo Mullëmadhit. Le që, siç na thotë Xha Dalipi, i gjori s'kish as dhëmbë as dhëmballë; bukën e hante të njomur në ujë. Me qepë e kripë. Kështu rrojti gjithë jetën, me qepë e kripë. S'la asgjë prapa.

— Mor, më ka vjedhur! — thirri Asllani i zemëruar. Merr vesh ti, apo jo? Pesë okë për killë! Pesëdhjetë e dy killë në mot! Njëzet vjet!

— Ku i ka! Kujt ia la? Ç'i bëri?

— S'dua t'ia di; mua m'i mori, m'i vodhi.

— Prit, mos u ngut, — tha Dani dhe aty për aty iu ngrit ai damari me bigël në mes të ballit. Hoqi këmbën nga vija e u shtrua këmbëkryq përballë Asllanit, që rrinte hundë e buzë. — Ilua punoi një jetë të tërë, ditë e natë, për bukë goje. Zbathur e në këmishë rrojti, zbathur e në këmishë vdiq. Në mulli. Në mes të bajgave. Pare nuk mblodhi. Përpara se të vdiste, i zoti i mullirit e nxori në mezat vendin e shtëpisë, për borxhin që i kish mbetur.

— E zuri haka ime, — tha Asllani.

— Prit. Ty nuk të hëngri Ilua, po të hëngri një tjetër me dorën e Ilos.

— Kush?

— I zoti i mullirit, beu.

— Ai merrte miellin e drithit të tij, siç e kishin prerë fjalën, kaq në mot.

— Jo të tijnë, po tëndin, timin, të xha Dalipit.

— Jo, unë s'ia lashë, ia mora prapë, — tha Dalipi me të qeshur, po Dani bëri sikur s'e dëgjo.

— Dëgjo, Asllan: tërë fshati e di se Ilua ka qenë

hyzmeqar e ka bërë siç i kanë thënë. Beu nuk i thosh kurrë me emër; gjithnjë «derr», «domuz», «qafir», «gomar». E rrihte. Edhe qahjai e rrihte. Beu i kërkonte tetëdhjetë killë në mot, veç të blojturit pa hakë për konakët e tij – një javë në muaj – se ishte shtëpi e madhe, hanedane, me sejmenë e më the të thashë, me dasma e gostira. Shemshedin bej, ky...

– Pse e mbante mullinë kur s'kish hesap?

– E mbante, se beu e kish lidhur këmbë e duar: llua ia kish bërë shitkë shtëpinë për një borxh të vjetër, të shpifur, të larë e të shpëlarë që qëkuri. Tapinë ia kish në xhep. «Puno, derr, siç ke punuar. Kullot, derr, siç ke kullotur. Mos ngri krye. Mulliri është si çiflig. Ka edhe për mua, ka edhe për ty, ka edhe për rosat e patat e mia.» Hyzmeqar më të mirë se llua s'gjente dot; ky ia dinte mirë radhën mullirit, se ish mullxhi bir mullxhiu. llua kish pasur dhe një dhembkë tjetër, që s'e kish lënë të iargohej: mulliri kish qenë i tij. Beu ia kish zaptuar. Thosh me mendje: kushedi, ndofta është më mirë të rri këtu ku jam, të duroj, gjersa ishallah e mashallah... Arë s'kish, zanat tjetër, s'dinte. Nuk i ndahej shpirti nga pahu i miellit e nga trokëllima e trokës. Mbeti hyzmeqar. Kur u lodh së prituri e së punuari më kot e desh të ikte, nuk ikte dot, se nuk e linte beu. U bë si ajo përralla: – «Baba, zura një hajdut». – «Sille». – «S'vjen». – «Lëshoje». – «S'më lëshon».

Heshtje në Çukë.

Shkoi përsëri i zoti i Buzos me një djalë të vogël prapa tij. Djali mbante një torbë. Lulja vraponte herë në pararoja herë në praparoja, ngrinte këmbën e prapme nën ndonjë gardh e shkonte më tej.

– Vete t'i shpjerë kocka e mëlçi Buzos, – tha djali i Shaqos. – Hej, ç'gjetëm belanë me Buzon e këtij mikut. Del natën udhëve, si devrie, leh me zë kaba, si më ulk, s'na le të flemë. Punë i thonë kësaj? Pojaku e ka prërë

udhën e s'shkel dot këtej. Duhet folur me kryetarin e bashkisë.

Shkuan udhës udhëtarë nga fshatrat e për në fshatrat, kaluan kalimtarë nga udha e Lagjes së Poshtme, plaka të z bathura e të kërrusura, me peshtemallë lara-lara, – kuq e bardhë – në kokë, si gogole të dala nga botë tjetër, shkuan qen pa zot, djem të vegjël e burra të mëdhenj kaluar në vithe gomarësh që hidhnin shqelma, se i shqetësonte ndonjë mizë kali, një dem vrapëtar që e kish zënë zegri, dy a tri kurbatka me vëthë të florinj të, me fustanë të gjatë kinda-kinda, gjer poshtë në noçkat, me targaçë në njërin krah, me shporta e kanistra ose lyrekë në krahun tjetër, me ndonjë fëmijë të rreckosur prapa. Ata të Çukës as që kthyen kokën t'i shikonin.

– I dije këto, xha Dalip? – pyeti Dani.

– Meqë më pyete, o djalë, po të them atë që di e s'po të them atë që s'di, se jam plak, me qefin nën sqetull, e nuk të gënjej dot. Të katër mullinj të që kish beu këtu brenda, i kish të zaptuar. Në të katër mbante mullxhinj, që për sy e për faqe ishin qiraxhinj, po, e drejta e së drejtës, ishin hyzmeqarë. Ajo puna se u thosh «derra e domuzë», s'është gjë, se ashtu e kish të folurit edhe ashtu ishte koha, po shtrëngesa që u bënte, ishte e madhe: «Ti të më sjellësh kaq. I dua!» Mullxhinjtë rronin për bukë goje, teretiseshin ditë e natë, bashkë me fëmijët. Duhet ta dini se mulliri ka shumë punë: të pastroshe jazin nga gryka e gjer në mëregat, të kalitësh gurët, të ndreqësh çekanët kur u del uji e s'hanë gur, të kesh mendjen në korita, në penda, në felaqia, në guri e shumë të tjera. Njëherë, duke bluar (duhet ta dini se unë s'iu ndava mullirit të llos gjer në fund, megjithë që më kish ndodhur ajo ngatërresa), e pyeta: – «O llo, si e ke ti punën? Ca miell e hedh në thes, ca në hambar. Përse?» Më shikoi si me të dyshuar e s'më foli. – «Pse më shikon? Pse s'flet?», «Flas, po më parë dua të të pyes,

o Dalip: a ke besë?» «Çfarë bese?» «Besë njeriu». «Po, besë njeriu kam. Ke dëgjuar ndonjëherë të kem ngrënë njeri në besë, të kem bërë seitllëk a kallauzllëk?» «Jo, s'kam dëgjuar. Atëherë afrohu e dëgjo.» U afrova e mbajta vesh. «Hambari, tha, është mielli i haramit, i beut; – thesi i vogël është imi. Jo i tëri, as gjysma se, kur e do puna, duhet ta hedh tërë në hambar të haramit, po nga ky thes mbaj sa për bukë e kripë. Bëj si më thonë, o Dalip. Marr e jap.» Atëherë m'u kujtua ç'më kish thënë atë mëngjes ne ura e vogël e thepisur. «Nga hambari i haramit! Ohoho!» Tunda kokën e mbajta vesh, si më parë: «Im gjysh, tha, ka rrojtur e ka vdekur si mullixhi, këtu. Ja, në atë qoshe, pranë vatrës. Edhe babai. Siç duket, këtu do të vdes edhe unë. Agai i madh e beu u ka thënë «derra». Kështu më thotë edhe mua beu. S'ia kam kthyer kurrë fjalën. Po tashi u lodha. S'mund më. Puna jonë është punë robëtie, siç e sheh vetë. S'dimë të çlodhur, s'dimë të kremte. Punë që ditën e hënë e gjer të hënë tjetër, pastaj, që të hënë e gjer të hënë. Tërë jetën. Për një copë bukë e për emrin «derr». Djalin e hoqa. S'dua t'i lë këtë zanat. Gjyshi s'ia pa të mirën. Babaj s'ia pa. As unë. Si do t'ia shohë im bir? Drithë bluajmë, bukë s'gatuajmë. E ha llamja. Ngarkojmë qafën. Vjedhim. More vesh? Mua po më mbyt pahu. Gulç. Thonë se pahu i miellit më është bërë brumë këtu brenda. – Edhe i ra me grusht gjoksit të madh, leshtor. U mundua të kollej e s'u koll dot. Sytë iu mbushën me lot. Ndënji sa ndënji ashtu, i mekur, gojëhapur, gjersa u mbush me firomë. – Hë, tha, ku e lashë? Më mbyti ky viran. Kur më zë, mbetem si peshku në të thatë. Keq, vëlla.. Më thanë që djalin ta bëj furrxhi. E vura në një furrë për të mbushur ujë, për të çarë dru, për të ndezur zjarr, për të zënë brumë. S'i vajti mbarë. Kollë. Ju prenë këmbët. «S'mund ta bëj, baba, këtë punë. Dua, po s'mund. Më dhemb këtu.» Medet, thashë, po i bëhet edhe

djalit brumë në gjoks! Si ktheu pak më mirë, e pajtova lart, në Sharrën matanë Shkumbinit. Të punojë nga shëngjergji gjer shëmbitrit e të ruajë dërrasat, e sharrat nga shëmbitri gjer shëngjergjit, të presë pisha e ahe në kohë të mirë. Thonë se era e malit bëka birë. E tretka brumin e gjoksit, e heqka kollën. More vesh? Shkoi. Po edhe aty robëti. Për bukë goje. E ç'bukë... Thuaj shafran, jo bukë. Ropatu, o plëncbosh; llup, o plëncplot.»

Kështu më tha. Nuk shtova gjë, nuk pakësova gjë. Ju e dini se kush e kish sharrën. Më parë e kish Fiti i Gjorgjit me Rrapush benë. Ortakë. Dërrasat i zbrisnin këtej mushkat e çobenëve, i hiqnin tutje, në Ohri e në Strugë gjemitë. Fiti i hipi qypit, u hap si vaji në lakrat, zaptoi gjysmën e fshatit, u bë Fiti bej. S'ngopej me gjë të gjallë. Parja është punë e djallit. Të zë sytë, bëhet zot e të bën rob. Fiti beu ish çoban, po çobenëve të mushkave nuk u jepte hakën e qirasë. As punëtorëve të sharrës. Ra edhe pas fajdesë, nxori njerëz, në diell, la jetimë udhëve. Pastaj Rrapush beu ia mori të gjitha Fiti beut. Sharën ua dha ca çobenëve të tjerë. Edhe këta ndoqën ca nga ca udhën e Fiti beut. Aty, në Sharrë, vdiq djali i llos, siç tha Dani. Kaq di.

Njerëzit e dëgjuan të heshtur.

Dani tha:

– Ashtu, të lumtë goja, xha Dalip. – Dëgjo tashti ç'më ka thënë njëherë babai. Ērdhi, tha, əjmeni i beut e më thirri: «O Lilo, të kërkon beu.» Babai s'kish punë me bejnë, po me dhenë. U çudit, «Ç'më do?» «Vallahi, nuk e di. Do vish me mua apo vetë?» «Shko se të arrij, i tha babai. Sejmeni e ka hijen të rëndë. Mora, tha babai, dyfekun, e mbusha, shkova. Koburen e kisha në brez. Helbete... Me bejnë s'isha as mirë as keq, po në të këtilla punë është mirë të kesh shok me vete. Shokë më të mirë se dyfeku e koburja s'ka. Atje pashë se puna që më kish thirrur s'ish gjë. Grindeshin dy fshatra për

një copë mal: për dru e kullotë; beu desh të më ngatërronte në një punë të fëlliqur.

— E di, — tha xha Dalipi. — Ne të dy kemi qenë në një mendje e thamë ç'thamë. U mbajtëm. Beu s'ia prishi as njërës palë, as tjetrës. Bëri ç'bëri, edhe u fut si pykë në mes të të dy palëve, që të ndante grindjen. Mori ca korije, ca luadhe, vuri dy bujq e u përplau të ardhurat. Dalgadalë bujqit hapën ara, shtuan gjënë e gjallë. Të gjitha për bejnë. Këtë punë e di edhe Zylua, se atëherë ishte...

Ago Zylali s'foli.

— Ta lëmë këtu, — tha Dani. — Kur po rrinte babai në oborr të beut, këtej, në konak të dytë, të mysafirëve, hop na vjen llua. E sjell sejmeni. Beu kthehet e pyet: «Erdhe, o derr?» «Erdha, bej». «T'u mbush koka?» «Jo, bej. S'e bëj dot, de. Do ta lë. Më mirë varmë.» «Për të varur kollaj e kemi: ja ku është trari, ja ku është litari. Varu vetë.» — «Kam fëmijë, bej.» «Në ke fëmijë, o derr, pse s'punon?» «Punoj, po s'del. Zotrote kërkon shumë. Bota e ka marrë vesh.» «Bëj të dalë.» «Mjaft e kam ngarkuar qafën, bej. Nuk e ngarkoj dot më shumë.» «Të thashë: ti je derr; derri e ka qafën të trashë e mban shumë.» «Nuk mund, bej. Në tapinë e shtëpisë, se do shkoj të punoj në Sharrë. Këtu u sëmura. Më ka zënë gulçi. Thonë se nga pahu i miellit...» «Hajt, lëri nazet, se do të mbetesh në ndonjë përrua, si qen. Unë kam kudo njerëz. Tapinë ta kam në dorë. Do punosh siç ke punuar?» «Të puth këmbë e dorë, bej. Ver dorë në zemër, bej. Mos më vraj: kam fëmijë. Ata që më kanë mbetur. Të tjerët m'i mori zoti.» «Në ke fëmijë, shko puno siç ke punuar, mos ngri krye.» — «Aman, be...» «Atëherë,» këtë ma ka thënë babai, Ilo Mullëmadhi, me ato leshrat e bardha, vetullat të bardha, në brekë e në këmishë, në thonj, zuri të qante me lot. Qante e i fshinte me pëllëmbë. «Nëm tapinë e shtëpisë, bej, të rrofshin djemtë. Borxhin ta

kam larë. Më ler të shkoj. Dua ta shes e të ik matanë» dhe bëri me dorë andej nga gjoli. «Hajt, derr! Shko në mulli, ku e ke vendin.» Ilua mezi u ngrit. Ish bërë pluhur e kashtë. Punoi si qen e vdiq si qen, pa një kasolle. Babai e dinte e i dhimbsej. Vetë më kish dërguar t'i shpija kur një shinik e kur një shoshë drithë. More vesh, o Asllan?

Asllani nuk u përgjigj. Tundi kryet; edhe mernte vesh, edhe s'mernte. Pas pak tha:

– Ta paskështa ditur, vija të bluaja në një mulli tjetër.

– Kudo që të vije...

Dhe përsëri u bë qetësi: një qetësi e rëndë si përpara fërtyme. Xha Dalipi i fryu cigarishtes, hodhi tej bishtin e shuar të cigares e tha:

– Dani është i ri, po ka të drejtë: kështu rroi e vdiq Ilua.

Dhe përsëri:

– A ju kujtohet moti kur kemi dashur të marrim të dhjetat fshatçe, të mos lëmë të na shkelë këmba e dhjetarit në arë, në kopsht a në vresht? Të mos e lëmë të na zhveshë?

– Fshatçe s'merren dot të dhjetat, – ia preu Ago Zylali. – Qeveria të do paret çink-çink, në dorë.

– Çing-çink ia jepnim edhe ne, në dorë. Fshati u var për pesëdhjetë të verdha. Hiç asgjë. Ca do t'i nxirrinim nga duhani, ca nga drithërat. Do të hanim bukën tonë.

– S'bëhet, jo!

– Bëhet, bëhet, po na doli përpara laneti, ai me një këmbë: kumpanjat e dhjetarëve. Njëra kish në krye Te-kiçkën, tjetra kish një djall tjetër. Në të dyja ishin mbledhur të gjithë të hurit e të litarit, ata që donin të nxirrinin pare shumë me të ndenjtur. Të dy palët ishin marrë vesh të mos i binin më qafë shoku-shokut, të mos i linin rjerëzit t'i blinin të dhjetat fshatçe. Na kërkuan njëqind

e pesëdhjetë napolona në dorë, erë, parasi. U dhamë pesëdhjetë. Ata thanë: ja njëqind e pesëdhjetë, ja hiqni dorë, se do ta marrim ne. S'u tundën nga vendi. A të kujtohet, Ago Zylal?

– Më kujtohet... Fajin e keni vetë; unë ju dola nga borxhi, thashë t'u jepnit sa kërkonin, që të ... Puna kishte hesap; pesëdhjetë napolona qeverisë edhe njëqind e pesëdhjetë atyre, bëheshin dyqind. Moti ishte i mbarë.

– E pse njëqind e pesëdhjetë atyre? – ia preu Dani.
– A mos ata ishin qeveri më vete? Jo qeveri, po tri herë qeveri! Një zhan hajdutësh kishin zaptuar një krahinë të tërë, ishin bërë qeveri mbi qeveri. Përse?

– Përse, përse... Se ashtu i do mushka drutë. Ti je i ri e nuk i di këto punë sa të thella janë. Ata nuk do t'i mbanin të gjitha për vete. Do t'i ndanin me të tjerët, me më të mëdhenjtë. Këtu e në Tiranë. Se edhe ata nuk e nisnin më kot me pesëdhjetë kur mund të arrinte dyqind e treqind. Këtë arallëk e linin për të mirën e të dy palëve: mishi të piqet, helli të mos digjet. Fundi i fundit, ata s'merrnin nga ne, po merrnin nga qeveria. Qeveria ka shumë e s'do t'ia dijë për gjëra të vogla. Është si ai thesi me miell: sa herë t'i biesh, do lëshojë nga pak. Ka pasur të drejtë kadiu që më ka thënë se uji i detit e paraja e doletit s'mbarohen kurrë.

Dani xheç tha nëpër dhëmbë.

– Ç'ke? – e pyeti xha Dalipi.

– Grindem me vetveten. S'më pret kosa. Luadhi u bë për të kositur, e unë s'jam i zoti. S'kam kohë.

– Shpjere ta kalitësh e mos u grind më kot; mblidh shokët e kosite – ia ktheu xha Dalipi, që ndofta e kuptoi se për ç'luadh e për ç'kosë e kish fjalën Dani. – E kështu, që thua ti, ne u mbajtëm, ata u mbajtën. Ne pesëdhjetë, ata njëqind e pesëdhjetë. Përse? Për asgjë. Erë parasi. Që të na linin ta merrnim fshaçe. Fshati u var në portë. Thamë se shpëtuam. Të nesërmen doli një e e zbriti nga

porta. Nga pesëdhjetë u ngrit njëqind e shtatëdhjetë, pastaj dyqind. U ndezën gjakrat. Luftë e shkuar lufte. Atë mot kam zënë të pi raki. Më parë s'kam dashur ta shoh me sy, pastaj e bëra mike. Mjaft sa t'i rrëshqasë një herë këmba njeriut, pastaj s'mbahet dot. Nejse. Arriu dyqind e pesëdhjetë. Ca nga tanët u trembën e thanë të heqim dorë. E morën ata që e morën për treqind. Na shtrydhën si limua. Ment ramë në gjak. Qimja e ndau. Duruam si s'ka duruar raja në botë. — «Dërgo njeri, o dhjetar, të numërojmë duajt në arë.» «E duam qesim. Kaq killë.» «Ore, kësaj s'i thonë me dhjetë një, po më kotër një.» «Le t'i thonë si të duan. Kaq dua. Kollaj kur hytë në luftë e na shtuat pagesën? Tashi do t'jua nxjerrim të gjitha nëpër hundë.» Kur erdhi radha e misrit u bë keq e më keq. Po të mos jepnim sa kërkonin, do të kalbej misri në arë. Në flas për kopshtet e për vreshtat: merrnin sa donin vetë, përgjysmë. «Dua kaq! Po të mos paguash, mos e vil vreshtin, lëre të kalbet...» Dhjetarët dolën mirë e bukur; ca pare ia dhanë qeverisë, ca s'ia dhanë. «Kemi humbje, — thanë. Duam zbritje». Miku është der' e xhenetit! Valon hatri. Si tha ai miku: felaqi feluqi, fiton hatëruqi. Dhjetarët ishin nëntë ortakë; ndanë nga njëqind napolona fitim. Veç të tjerave: shtëpitë brusë me të gjitha të mirat, për vete e për hanedan. Ne? Si delja në hell. Ramë borxh. Shkurti na gjeti pa bukë. Zi, Borxhe mbi borxhe. Shitëm nga një copë arë për të blerë misër. Misrin tonë, që e kishin mbyllur dhjetarët në hambar. Matanë, ja aty, në prag të derës, misri ishte katër herë më i lirë, po nuk e linin të hynte; gjoja për të mbrojtur bulkun, drithin e vendit. Thuaj çifligarin, dhjetarin, hambarxhinë, fajdexhinë, jo bulkun.

Xha Dalipi heshti. Asllani tha si nëpër ëndërr:

— Ashtu, ashtu, s'dimë nga t'ia mbajmë. Ne jemi kaq burra në shtëpi e rrimë pa punë. Kërkojmë e s'ka. Arën e kemi vënë në befa. Borxhi shtohet e rritet si troska,

fajde mbi fajde. Mjerë ai që lë t'i lypë troska në arë; lështon rrënjë pas rrënje, ta mbyt grurin e misrin. Na vrau buka, na hëngri kripa, gazi, opinga, e dhjeta, xhelepi. Shtrenjtë. Një okë kripë bën një okë mjaltë. Ku të shkojmë e ku të mbytemi?

— Dëgjo, Asllan, — ia bëri Ago Zylali duke tundur atë çibukun e gjatë, sikur desh edhe ta kërcënonte edhe ta këshillonte, po Asllani as që ktheu kokën ta shikonte.

— Dëgjon apo jo? Asllan!

Asllani sikur u zgjua nga gjumi i brengave të bukës e kripës.

— Dëgjoj, — tha.

— Ashtu, po mbaj vesh mirë. Vjet, që thua ti, kish ardhur këtu për teptil hava një burrë i madh nga Tirana. Jo i madh sido-kudo, po beter i madh: deputet, ministër këtej, ministër andej, dorë e djathtë e mbretit. Shaka s'i thonë! Ca thoshin është bej bir pashai nga Vlora, ca të tjerë bej bir pashai nga Berati. Ca jo, as bej bir pashai nga Vlora, as bej bir pashai Berati, po burrë me divit në brez e kallmër në vesh, bejtexhi i madh. Të gjithë i thoshin «Shkëlqesi». Ama e kish hak këtë emër, shkëlqente i tëri; bojalli me japi, ballaban si top gjalpi Vërçe, i bardhë, i kuq, kokën lart si deve Misiri, me një bastun të trashë në dorë. Ky bastun i bënte më shumë se një shtëpi nga këto tonat: me një kërrabë të madhe argjendi e me një shqiponjë floriri me krahët hapur mbi argjend. (Ago Zylali kish të drejtë: ashtu ish vetëm se duhej të shtonte se mbi shqiponjën me krahët të hapur kish një «Z» të artë, të trashë. Veç kësaj, burri i madh kish një zë të butë, si të lyer me vaj e mjaltë e betohej orë e çast: «Për kokën e mbretit», «Për kokën e lartmadhërisë». Thoshin se i pëlqenin shumë gjërat e ëmbla, ato të mirat: llokumet i sillte drejtpërdrejt nga Stambolli, në kuti nga ato të Haxhi Beqirit; bakllavanë e sillte nga Siria, në kuti të mbyllura se ashtu i pël-

gente). Kur ecte, me kokën lart e me bastunin në dorë, që e hidhte hop-hop, kish lezet ta shikoje. Ja, këtij i thoshin burrë! Nënprefekti e gjithë të tjerët i rrinin prapa, njëri një çap larg, tjetri dy, tre, sipas radhës. E që thua ti, na dëgjon Neziri i Zi, kurrizdali, që po mbledh dita ditës shuk e puk, se ka ardhur filan burrë i madh nga Tirana. Ngrihet nga rrogozi, me stap, e i vete në shtëpi. Jo në shtëpi, po në oborr. Pret të dalë, ta shohë, t'i flasë. Del ai miku në krye të shkallëve. Neziri i Zi, që vdiq njëviti, ngre kokën ta shikojë e mezi e shëmbëllen. E ku je ti: ai tjetri duket si një lis i madh, me fletë, Neziri i Zi duket si rozgë e nxirë, që e ka përzhitur cingërima. «Hë, xhaxho, ç'kërkon?» e pyet ai miku me zë të butë. «Kam ardhur të të shikoj, zoti Shkëlqesi bej». «Më pe?» i thotë ai tjetri duke qeshur si dielli kur shkrep majë malit, po shqipen e flet pak si ndryshe, shtrembër, qi-barçe, përzier me turçe. «Të pashë, zoti shkëlqesi bej. Të lumtë! Qenke tamam si vali Janine.» Atij i pëlqen fjala e i bëhet qejfi, i flet me të qeshur. «Hë, – thotë – hair haber, a ke ndonjë hall për të qarë? Fol.» «Kam, – thotë Neziri, – Kam shumë halle. Arat m'i mori fajdexhiu, se kisha marrë borxh për bukë. Borxhi hipi ditë për ditë, u ngjit lart, si themi ne, si ajo e Zeqos majë thanës. Se kështu u bë puna jonë: kur bëjmë grurë – e shesim lirë, që në lëmë, për borxhet, pastaj në mars, blemë misër, shtrenjtë.» «Keq bëni i thotë ai miku. Pse e shisni? Pse s'e mbani që ta kini për tërë motin?» Neziri i qahet: «Kripa shtrenjtë, zoti shkëlqesi bej. Gazi shtrenjtë. Qefini shtrenjtë. Na mbytën borxhet. Aman, shpëtona nga hallet.» Ai miku qesh: «Hahaha! Dëgjo – thotë, – qeveria nuk përziehet në punë të këtilla. I le njerëzit të lirë. More pare? Paguaj! Me zor t'i dha ai që t'i dha? Jo. Ti vajte ju lute. Pra, jepja». «Ia jap, zoti shkëlqesi bej, po s'kam. Djemtë pa punë. Unë sëmure. Ai miku më ka hedhur në gjyq e kërkon të më nxjerrë nga shtëpia.

Si t'ia bëj?» «Sa djem ke, xhaxho?» «Pesë, zoti shkëlqesi bej.» – «Dëgjo të të them një fjalë për ndjezot, që ta mbash mend: kurbeti-selameti. Dëgjove? Po ta them edhe një herë: kur-be-ti se-la-me-til Haj, xhaxho, shko. Qeveria i lë njerëzit të lirë të bëjnë ç'të duan, të shkojnë ku të duan. Ama borxhi duhet paguar.» Ja kështu i tha: kurbeti selameti. Nga fshati ynë kanë shkuar kaq burra në kurbet, ca në Amerikë të Bardhë e ca në Amerikë të Zezë: ca në Stamboll, ca ku u ka dashur qejfi. Kanë mbledhur para me lopatë. Pasuri të madhe. Tashi rrinë më lart se shokët. Hanë e pinë; shtojnë ato që kanë sjellë, me fajde, se paraja sjell paranë. More vesh, Asllan? Në s'more vesh, po ta them edhe një herë: kurbeti-selameti. Lum kush e di, lum kush e bën.

– More, Ago Zylal, po nuk shkoj dot. Jam plak. Jam i sëmurë.

– Nuk të them të shkosh ti. Dërgo djemtë. Ti ke pesë: nis tre e mbaj dy. Jo tre, po katër. Një mjaft e ke këtu, se ty një copë skerkë të ka mbetur.

– Ku të shkojnë?

– Në Stamboll, ore. Atje lot pare e madhe! Nuk e kanë keq ata që thonë: ja ne mbreti, ja ne deti. Për nja nëntë a dhjetë vjet bëhen nikoqirë të patundur, siç u bë Dulja i Zërvaskës me gjithë djem.

– Ajo e Dules është: shkoi qeni e zuri një ljepur. Po ta lëmë këtë. Ti the t'i dërgoj në Stamboll. Të katër, Peqe. Po e bëj zemrën gur e po i dërgoj, megjithëqë s'më vjen mirë. Njeriu rron me njerinë, në vend të tij. Sikush i do djemtë pranë. Helbete, kemi jetë, po kemi edhe vdekje. Siç do ti që t'i kesh të tre djemtë këtu të shtuar me nipëri e stërnipëri, ashtu dua e unë. Po haj, ta zëmë se do t'i dërgoj atje të shesin paçe e zorrë udhëve, të qelbur, me nga një tabor mizash prapa...

– Si gjithë bota, Asllan, Posi posi. Paraja s'të vjen vetë në derë. Duhet të vesh ta kërkosh atje ku është, ta

nxjerrësh. Domsodo, me punë, me djersë, me të kursyer. Të hash bukë një herë në ditë.

– Peqe. Po me se t'i nis? Dua parc udhe. Më jep ti hua? Me senet. Nuk t'i dua xhaba. Me fajde, si gjithë bota, pesë për qind në muaj. T'i paguaj kur të më dërgojnë nga Stambolli.

– Unë s'kam. Atë që e kisha, ta dhashë: fjalën e mirë. Shit arën. Në mos arën, shit shtëpinë me gjithë kopsht.

Asllani e shikoi me të dyshuar, me zemërim.

– Arën, thua? Shtëpinë e kopshtin? I ble ti?

– Të shohim. Në mos unë, një tjetër, megjithëqë ara s'bën, është gurishtë. Shtëpia është vjetërsirë me plitharë. Nejse, mund të të gjej ndonjë myshteri.

Asllanit i dhambi shumë. Më mirë t'i paskej rënë me sëpatë, sesa t'i kish thënë këtë fjalë. Nuk iu durua e i lëshoi ca fjalë nga ato që nuk i priste jo Ago Zylali, po asnjë nga ata të tjerët.

– E di si i thonë kësaj, o Zylo? I thonë, me nder zotërisë suaj, o burra: rri bythë e ndërto kuvend. Ti e ke kollaj të flasësh si të duash, se s'të vret samari. Kripën e ke të thatë. Më je hapur në mal e në fushë si Ingjilizi nëpër dete. Fiton pare me okë nëpër tërë llonxhat. S'di se ku t'i vësh verdhushkat. Ble mot për mot nga një arë a kopsht. Po bëhesh bej, oxhak. Pale, po u thua të tjerëve «kurbeti-selameti». Po a ke vajtur vetë në kurbet? Të ka ngrënë morri i kurbetit? Të kanë ndjekur grerat duke dalë me paçe e zorrë varrur krahëve, në hu, nëpër udhët e Stambollit. Të ka dirsur balli? Jo. Ti ke rrojtur gjithnjë këtu, me marifete, me llonxha. Atë mot që deshëm të merrnim të dhjetat fshatçe, ti ishe ortak me tarafin e Tekiçkës. Ne të tjerët u bëmë bërlok, ti vu-re dhjamë, pare të thatë. Sa fitove? Njëqind, dyqind? Unë e di, se paraja e gjynahet s'rrëfepen, po të pyeta ashtu, më kot. Mot për mot merr të dhjeta me ortakë.

Tashi vjen e na jep vaz: bëni kështu, mos bëni ashtu. Mirë thonë se barkploti nuk i zë besë barkboshit. Pale, po thua se punoke për rahmet. E ku të lë paraja e gjnahu të fitosh rahmet e xhenet.. :

Ago Zylalit ment i ra pika. Bëri t'i përgjigjej, po iu morr goja. Murmuriti: – «Edepsëz njeri, Mua... ai... Po... dhe u nxi ashtu siç ish nxirë, ndofta, sulltan Abdyl Hamiti kur e kishin zbritur nga froni. Ata të tjerët, bashkë me Grendellin e me djalin e Shaqos, kishin mbetur si pa gojë. Thanë me vete: «Ç'po bëhet këshu? A mos po përmbysen bota? A mos i kanë hipur xhindet Asllanit?» Vërtet ashtu ish: Asllanit i kishin hipur xhindet, se i kish vajtur thika gjer në eshtë, pra e kish bërë fora. Xha Dalipi vështronte i qetë, i qeshur, si një diell në të perënduar, dhe thosh me mendje: «Ama kopaçe po ha sot zaptije agail» Dani shikonte buzëgaz. Çukën e kish mbështjellë qetësia. Ai e kuptonte se kjo nuk ish një qetësi sidokudo, po nga ato që sjell fërtymë. Në këtë fërtymë Dani priste të hidhej i pari ndër të parët.

Shkoi kaluar mbi një mushkë me samar të ri, nxitimthi, Zenun efendiu, ftuesi i gjyqit, ose bumbashiri, siç i kish thënë në kohën e Turkut dhe vazhdonin t'i thoshin edhe sot. Ai shkante nëpër fshatra për të përndarë ftesa gjyqi të paditurve për punë borxhesh, të pandehurve për punë vrasjesh e rrahjesh, dëshmitarëve të ndryshëm e kështu më tej – dhe këtë punë e bënte me qejf të madh, sepse merrte dieta, shpërblime dhe shumë të tjera, që ia bënin rrogën trefish. Tha «mehraba», siç kish thënë gjithnjë, vuri dorën në zemër dhe pastaj e ngriti në ballë, perëndoi sytë si bumbareq, sikur të paskej parë të hapur derën e ndritur të xhenetit, por asnjë nga ata të Çukës nuk iu përgjigj. Rrinin të heshtur si ca lundra të mbytura.

Ndërkaq, nga udha e tregut po afrohej duke u rrë-

këllyer dalngadalë, hop-hop, një lëmsh i madh larush me të gjitha ngjyrat e dheut e të qiellit: të bardhë e të kuq, të kaltër e të verdhë, fletë preshi e bojë jargavani, të hirtë, kafe reng e ku ta di unë çfarë. Këto ngjyra sikur shuheshin, kur lëmshi shkonte hijeve, pastaj ndizeshin përsëri e shkrepnin më fort kur dilte në diell. Qëndroi ca çaste nën gardhin e lartë, të hazdisur si pyll, të oborrit të Sashollarëve e u mat t'ia merрте udhës së shkurtër përbri shtëpisë së Lakes së gjatë e asaj të djemve të Saipit, për të dalë poshtë, buzë liqerit, duke kaluar nën dritaret me kafazë të shtëpisë së Mulla Xhaferit, të birit të Mulla Kamberit, po pastaj e ktheu mendjen e bëri përpara, drejt Çukës së Vogël.

— Shiko, shiko... — ia bëri Rizai i mahnitur, sepse ndodhej edhe nën përshtypjen e fjalëve të papritura që kishin teptisur nga goja e Asllanit, i cili gjer atëherë kish qenë gjithmonë i urtë, i duruar, pothuaj i drojtur. Dhe në qoftë se edhe Asllani kish arritur të thotë fjalë të këtilla, që nuk i ngre dot në të rëndë as kapani i madh i pazarit, — ai që peshon dengjet e kripës së Kavajës — ta dini se ndofta do të përmbysset bota, do të kemi shi yjesh, do të shuhet dielli.

— Ç'ke, o lugat? — e pyeti xha Dalipi. — A mos të venë shtatë nga Buzua i Çervenakës? Mos ki merak. Do t'i them atij mikut që ta lëshojë vetëm natën, si devrie, të na ruajë nga pojaku e nga xhandarët. Ditën do ta mbajë me zinxhir.

Rizai tregoi me dorë lëmshin që po vinte kollotumba.

— Shikoni!

Të gjithë kthyen kryet e shikuan andej. Vetëm Ago Zylali ndenji një hop pa lëvizur, këmbëkryq, siç ish, pastaj e mundi kureshtja, ktheu kokën si me përtesë, shikoi ca çaste, bëri një gjysmë rrotullimi me tërë tru-

pin bashkë me të ndenjurën, çakërriti sytë dhe mbeti në pritje, me kërbishten të përkulur duke këqyrur lëmshin shpëtimtar. Me të vërtetë, ky lëmsh larush do ta shpëtonte aganë nga udha pa krye ku e kishin futur fjalët e papritura të Asllanit e nga çargu i Danit të Lilos. Domosdo, po të kish qenë herë tjetër, nuk do të kish duruar një fyerje të këtillë e do t'i kish rënë kokës Asllanit. Mirëpo Asllani kish pesë djem. Ishte i varfër, po kish rreth mjaft të fortë, kështu që këtë radhë sharra kish zënë shajkën. Prandaj duroi, gëlltiti gjersa t'i vinte rasti që t'ia lëshonte ujët nën rogoz. Si e qysh? Do të shihte...

Lëmshi që po vinte s'ishte lëmsh leshi a pambuku, po lëmsh njerëzish. Përpara çanin udhë pesë a gjashtë biçim grash, prapa vinin tetë a nëntë biçim burrash. Gratë mbanin fustanë të bardhë, të kuq ose me lalë, një çepirok mbi kupën e gjurit, të ngjitur pipthi pas kofshëve, pas të gjitha të teptisurave e të funditurave, e kështu me radhë. Këta fustanë me ngjyra të ndezura, gjysmë të ndezura ose të përziëra, siç thamë më lart, mbulonin, domosdo, siç e desh moda, vetëm disa pjesë të atyre që mbulohen, duke lënë jashtë të tjerat dhe pikërisht: shpatullat gjer në njëfarë vendi, kraharorët prapë gjer në njëfarë vendi, krahët që nga kyçet e supeve bashkë me mugëtirën e errët ose të mavinjtë të nënsqetullave dhe këmbët nga mbikupa e gjurit e tatëpjetë, gjer në gishtërinjtë e qëndisur me të kuq të ndezur. Vetëm kaq. Të tjerat ishin të mbuluara, ose më mirë të mbuluara disi e diku, sepse herë-herë, bashkë me rrezet e diellit, depërtonte edhe vështrimi tejpertej i mëndafshit të hollë si fleta e qepës, dhe atëherë, hej-hej! Sa për trajtat nuk di nga t'ia filloj. Pjesët gollomeshe të shpatullave e të kraharorëve kishin trajtë veze nga ato të Kristofor Kolombit që zbuloi Amerikën, trajtë trekëndëshi pitagorian, katrori, zemre dhe të tjera, që nuk i

ngjanin fare njëra-tjetrës, dhe këto pjesë gollomeshe ishin stolitur me sende të ndritura, nga ato që të verbojnë sytë, si: florinj, xhevahirc të vërtetë dhe të rremë – iskra xhami me ngjyra të shumta xixëllonjëse, që i pëlqejnë kaq shumë grarisë – e kështu me radhë. Krahët kishin trajta të tjera: ca ishin si bërдила, pra të ngjeshura, të tultë, topolakë, të shkurtër, ca të tjerë si bisht lopate ose këmbë këmbaleci apo njëfarë gjëje, as kështu as ashtu, po që të gjitha me thonj të gjatë, të skuqur si petëza trëndafili ose paparune, të ngjitura s’di se si, ngarkuar me xhingra-mingra, që shkrepnin e llamburinin, shuheshin e ndizeshin prapë. Këmbët... Ca ishin të bytynta, të trasha, si mahi ose më mirë si tabanë gështenje, nga ato të Verdo-vës, ca të tjera ishin të holla, kiska, pa pulpe, si fyej Vërçuni, nja dy ishin si shishe birre Pshor-Brau (nga ato që sillen nga jashtë, kontrabandë, pa doganë), po me grykat poshtë e fundet lart dhe ca të pakta, ishin shumë nazike, pothuaj fluturake. Kaq. Po këpucët? Ah, këpucët, ose më saktë këpuckat, skërpinkat, ishin vepra të vërteta arti. S’ka rëndësi se ç’ngjyrë kishin këto vepra – të bardha, të argjendta, të florinjta, të gjelbër, larushka e kështu më tej – po më fort ka rëndësi maja ose majucka, dhe fronka ose taka, sepse maja dhe taka i japin tërë bukurinë këmbës, atë që e ka dhe atë që s’e ka. Dhe veç kësaj, mos harroni, ato mbajnë alamet peshe. E pra: majat ishin pothuaj si shtiza për të shpuar zemrat e lolove, kurse fronkat ose takat ishin shumë të holla e të larta, prandaj pronarët e tyre zonjat e zonjushat gjysmë të veshura e gjysmë të zhveshura, përkundeshin si ato gjemitë e liqerit tonë kur i rrahin valët e shkumbëzuara. Mirëpo ç’është e vërteta, fajin e parë për këto përkundje nuk e kishin aq shumë këmbët, këpuckat, fronkat, po udha e fshatit. Harrova të them që në krye, se kjo udhë ishte e kish mbetur siç

e kish bërë natyra, dua të them këmbët e njerëzve dhe të bagëtive, pra plot gropa, plot pluhur, plot gurë dhe, me nder zotrisë suaj, si udhë fshati, kish tek-tuk, dua të them në çdo hap, mjaft bajga nga të gjitha llojet: kuajsh pelash, mushkash, gomarësh, por sidomos bajga lopësh të kullotura në bar të njomë, kështu që shumë shpesh krenaret skërpinjka, të cilat ne i quajmë vepra të vërteta arti, zhyteshin brenda me gjithë fronka, pra edhe me thonjtë e lëmuar e të përskuqur.

Duhet ta dini, se bashkia e vendit mbahej krenare se nuk prekte fare bukurinë e natyrës dhe e kish lënë udhën ashtu siç kish qenë përpara vërshimit të ushtrisë së Xhavit pashës. Fshesa ishte ndaluar me rreptësi! Buxheti i bashkisë parashikonte në kaptinën e lëndës vetëm dy nene: shumë raki rrushi të fortë dhe pak vajguri për fenerët. Po shpesh, dua të them dendur, neni i vajgurit derdhej i tëri në ninin e rakisë: brom! rroftë!

Po le të kthehemi tek lëmshi ynë larush.

Një pjesë e madhe e udhës, të themi si një të tretën, e zinte një grua e plotë dhe stërplotë si deng me dhjamë, më e ngjeshur nga shoqet. Nuk ishte e shkurtër, po prapë vinte më e gjerë sesa e gjatë, pa qafë, me tre a katër rrathë mishi e dhjami varur në gushë, me ca krahë dërdëngë, të solisur me tre a katër byzylykë shumë të ndritur. Këta krahë, meqë nuk i mbante dot pëngul, i kishte, siç thuhet në gjeometri, si dy tangente. Njëra dorë nuk e çikte dot tjetrën, kështu që të dyja ishin të dënuara të jetonin të vetmuara, sikush për llogari të vet. Kjo lëkundej më fort se të tjerat në fronkat tepër të larta, të cilat i zhyste orë e çast, pa dashje, nëpër garniturat e lëngëta që kishin braktisur udhës lopët e kullotura luan dheve ose fëmijët gjysmëlakuriq... Dhe, sa herë që i kredhte në këto prodhime të natyrshme, lëshonte një klithmë të hollë, si cihatje rike të pushtë: «Nikollaqkël». Njeriu çuditej kur dëgjonte një cicërimë kaq të hollë të dalë

nga një deng kaq i ngjeshur, që mbahej në dy shtylla të shëndosha dorike, pothuaj të ngjitura, po s'kishte ç'bente: kjo ishte gjendja. Dhe ajo që është, siç thotë Ago Zylali, është e nuk ndryshohet kurrë. Kështu «Nikollaqkë!», këtu, «Nikollaqkë!» më tej, lëmshi larush po i afrohej Çukës së Vogël ku mbahej kuvendi i ujit. Mirëpo ne folëm për disa gjëra – për shpatulla e kraharorë, për krahë gjer në majë të gishtërinjve e për këmbë gjer në majë të fronkave ose në majë të thonjve të paparuntë: me pedikyr, dhe nuk përmendëm fare fytyrat. Kërkojmë ndjesë dhe sjellim arsyet: fytyrat me gjithë koka ishin të mbuluar me kapele kashte pak si të përthyera anëve e të stolisura me lule nga të gjitha llojet, por jo të vërteta: lule cohe mëndafshi. Disa kishin edhe ndonjë zarzavat: ndonjë karrotë, ndonjë fletë hudhre a qepe; të tjerat kishin kordela e fjongo të bardha e të kaltra, të qiellta. Këto e shumë të tjera të bënin të thoshe se kapelat nuk ishin kapela të vërteta, por luadhe lëvizëse, ose kopshte e bostane, kështu që kish pasur të drejtë, ajo lopa baliskë e Meskes të Saipit që, sapo i pa, pëlliti me të madhe: mu! mu! dhe u sul për të kullotur, por atë çast u dëgjua cihatja e njohur «Nikollaqkë!» – më e fortë nga të parat – kështu që baliska u step, aq më shumë se ia prenë hovin tre a katër bastunë të ngritur me disa thirrma në dy gjuhë. Por ne duhet të nxitojmë ta mbyllim këtë pjesë, se po të vazhdojmë me gra që kanë kapela si luadhe lëvizëse dhe me lopë hamëse, s'di se ku mund të degdisim.

Pra, fytyrat nuk i përshkruam pikërisht për shkak të këtyre të nëmosurave kapela-luadhe ose kapela-bostane, që ua fshihnin dhe ua bënin të mistershme. Vetëm njëra s'kish kapelë. Kjo ishte një zeshkane me trupin tri herë thyer, domethënë të gozhduar në prangat e forta të korsesë prej balene për të ngurosur ato që ishin tepër të flashkëta. Kish leshra të prera shkurt «alla bebe» ose më saktë «alla bebekë» apo «allabebeçkë», me fustan të

bardhë, plise, të shkurtër, po pa kollan mbi prapanicë, dhe i ngjante shumë një oçi Zagorçani, në dëborë ose një mize të rënë në qumësht. Fytyrat e tjera «të mister-shme» s'mundëm t'i shihnim, por pamë vetëm gjërat që ishin të përbashkëta dhe që binin në sy: njëra i kish buzët të zografisura me të kuq të çelur «alla Greta Garbo», pra në trajtë katërkëndshi, kështu që goja të dukej më e madhe, tjetra i kish qëndisur me çiklamën «alla Estrelita Kastro». Pastaj kish «alla Marlen Ditrih», «alla Mirna Lloj» etj., sipas shijes vetjake – kush ngjyërë flakadani, kush ngjyërë speci e kështu me radhë. Po ashtu, sipas shijes vetjake, kishin kallkanosur edhe mollëzat e nënmollëzat. Hundën jo. Kjo nuk kishte veçse pudër fino erëmirë «Sën flër – Forvil» të sjellë në Selanik drejtpërdrejt nga Parisi dhe në Korçë drejtpërdrejt nga Selaniku.

Por, medet! Përmes të kuqit të të gjitha llojeve dhe përmes pudrës pariziane kish shkuar brana e rrëkeve të djersës dhe kish lënë prapa plot zgharavina.

Ndërsa lëmshi po i afrohej Çukës, Grendelli bubulloi:

– Frengë! Allah-bir, janë frëngë e frëngore! Ma pri-sni kokën nga rrëza, po s'qenë frëngë e frëngore. – Dhe vuri pëllëmbën si thikë në fyt.

– Jo, – ia preu Rizai, – janë teferiç nga Elbasani, se ata kanë pare me okë, të mykura, në qypa.

– Po të qenë teferiç nga Elbasani, – tha një i tretë nga një cep, do të ishin verdhacukë, me ethe. Këta... këta... Shiko! Llokume me arra!

Me të vërtetë, të shumtët ishin të shëndoshë, qafë-dema, po kish edhe disa të hollë.

– Unë e di, – tha një i katërti nga cepi tjetër. – Janë korçarë nga Selaniku e korçarë nga Korça.

Ndërkaq lëmshi kish sosur e kish qëndruar rrëzë Çukës. Që aty s'po bënte një çap më tej, sepse vija e ujit

që çante udhën tërthor ish hapur tejmatanë dhe nuk e hidhnin dot jo vetëm gratë me fustane të ngushta e me kollanë të lëshuar mbi prapanicë, po as burrat me pantallona si çakshirë e këpucë lustrini ekstrafino.

Prapa lëmshit qëndroi, ca çape më tej, një zhgan fëmijësh që i ndiqnin për sehir, siç ndjekin, ta zëmë, ndonjë ari që sjellin kurbatët (s'kishin parë kurrë kaq mish e dhjamë rrathë-rrathë, të nxjerrë sheshit, siç i nxjerr Halit Kasapi shterpat e therura e të varura në çengel).

Po burrat si ishin?

Burrat si burrat, njerëz si gjithë bota: me dy duar e dy këmbë. Ca të gjatë, ca të shkurtër; ca të hollë, ca të trashë; ca veshvegjël të mbërthyer pas kafkës, ca veshllapushë, të varur, si të atij mikut të katoit. Domosdo, të rruar e të kruar.

Si gjithë bota e jo si gjithë bota, sepse ishin qytetarë. Dhe jo qytetarë dosido, po pasanikë, me tagji të mirë, të ngopur e stërngopur, tamam si ai «zoti shkëlqesi beu», që kish zënë në gojë aty më parë Ago Zylali ynë. Prandaj disa, ishin, siç thonë ata të Shqipërisë së Mesme, bullafiqë e barkulë, si ca gra shtatzëna në muajin e tyre, gati-gati... Këta s'kishin qafa, po i kishin kokat të lidhura drejtpërsëdrejti me trungun. Disa nuk ishin bullafiqë, po vetëm dërdëngë, të ngjeshur. Por midis tyre kish edhe nga ata që u ngjanin atyre gurneckave të thata të Gllom-boçit, si dhe nga ata që u ngjasin zgalemëve e karabatakëve të Poradecit ose bakalaros të Tarabolluzit, që hanë korçarët kreshmëve. Njëri, bile, ishte fare qose me ca faqe të fishkura si mafishe nga ato të Sotir Çupkës apo atë të Menellas të Korçës.

Domosdo, ishin veshur qytetarçe, pastër, qibarçe: disa me rroba bojë hiri prej stofe, «angliko», disa me «fresko» bojë qiçre ose bojë thierze, të tjerë me «lino» të bardhë si dëbora e kështu me radhë, të qepura në Selanik, me pantallona pothuaj se çakshirë Stambolli, domethënë

shumë të gjera lart e shumë të ngushta poshtë, të shkurttra mbi kërcinj, sipas modës shumë burrnore të kohës. Kish edhe ashtu-kështu: me pantallona të bardha e xhaketa bojë thierze ose anasjelltas, siç kish edhe nga ata që i mbanin xhaketat në krahun e mëngjër, për shkak të vapës, me springa larushe mbi këmishët e mëndafshhta, me kravata bajadera. Disa mbanin këpucë të bardha, të tjerët këpucë lustrini ose gjysmë ashtu e gjysmë kështu, po të gjitha plot garnitura nga ato sendet e mirënjohura që kish lënë prapa, si petulla, ajo baliska e Mekes të Saipit. Më të shumtit kishin bastunka të hollë dhe kapela kashte, apo «kashtorka», që të mos u përvëllonte dielli kokën.

Midis kësaj lyshtre shquhej një burrë mesatar nga trupi, as i trashë as i hollë, bardhosh por i përcëlluar, që nuk u ngjiste të tjerëve. Kish më fort pamje ushtaraku sesa tregtari dhe qëndronte si një «stratigos» grek, pikërisht si gjeneral Gonatas i kur thyente grevat e punëtorëve të duhanit, në Selanik, që kishin dalë me flamur të kuq dhe kërkonin «bukë». Ky, burri mesatar, me rroba ngjyrë thierze, nuk jepte urdhër të pritët me shpatë ndonjë kokë gruaje që mbante në duart e saj të shëndosha flamurin e kuq dhe thërriste «psomi»¹⁾ (atëherë koka e përgjakur ish rrëkëllyer në kalldrëm, flamuri ish përkulur e kish rënë mbi kryet e grevistëve, ndërsa kufoma e gruas, së cilës i gurgullonte gjaku, ish mbështetur në rreshtin e ballit të grevistëve të paepur), po vetëm shikonte, këqyrte, gati me urrejtje njerëzit e zyrtë të Çukës, malet e veshura me qiqërimë, kodrat e zhveshura, gjithë vendin rrotull. Kur e kur diç pyeste një tregtar bulla-fiq e kuqalosh (të kushërinë), të ardhur nga Korça dhe të ngulur në një dyqan të madh, në mes të pazarit, për tregti me shumicë e pakicë. Bisedimi bëhej herë gre-

1) (gr.) – bukë

qisht, kështu që nuk ndiheshin veçse vargje tingujsh të hollë me shumë «i» dhe «s»; «is-os» «kis-kos», «us-tus-tos» dhe herë shqip, farësisht korçare, po ca si të vjetër e të lamandryqur me greqishte dhe frëngjishte.

Dhe tek rrinin kështu përbri Çukës e përballë vijës së vërshuar, doli nga udha e poshtme ai burri mustaqeverdhë kaluar mbi atë pelën e vogël barsë e leshtore. Prapa tij vinte tup-tup, si e verbër, ajo gruaja me lyrek në krahë, me xhybe të gjatë e me kokën të lidhur me dylben të bardhë, ato dy çupërlinat e z bathura, leshverdha, me dumane të gjata nëpër këmbë dhe tri gra të tjera: njëra me mollokof gjer në thembrat e këmbëve, me kokën të lidhur me dylben dhe dy me peshtamallë të hedhur sipër, gogolçe. Pela barsë me kalorin çau udhë nëpër ujë e ia mori për në pazar, siç e drejtonte i zoti, që as kësaj here nuk u tha tungjatjeta atyre të Çukës. Pas tij shkuan nëpër ujë, duke u lagur, gratë dhe çupërlinat. Gratë qytetare me erashka bajadera në dorë i shikuan me llaftari dhe përbuzje. Ato të tjerat, kokëlidhurat e kokëmbuluarat, nuk di se si i shikuan motrat e tyre gjysmëgollomeshe, sepse nuk u dukeshin sytë. Dy botë kaq të largëta nga njëra-tjetra, ndonëse bënin pjesë në të njëjtin trung...

– Të kthehemi, – tha bullafiqi. – Këtej s'paska udhë, po ujë!

Atëherë nga mesi i qytetarëve doli njëri, që s'dukej as tamam burrë, as tamam djalë, po «burrkë», siç i thonë në Korçë: i thatë e i rreshkur, si i ushqyer një jetë të tërë vetëm me koromane e uthull, veshur me xhaketë «fresko» dhe pantallona «lino». Ky i dha dikujt bastunin dhe kashtoren, u praps disa hapa, mori hov dhe këceu. Në atë çast u dëgjua ai zëri shumë i hollë e shumë i trembur i dengut dhjamë: «Nikollaqkë», po ndërkaq Nikollaqka kish sosur shëndoshë e mirë matanë vijës së vërshuar, pa lagur fare lustrinat e pluhurosura. Që andej shikonte fitimtar shokët dhe i grishte të këcenin, po as-

kujt s'ia mbante, bile as atij «stratigoit», që rrinte si hu dhe sodiste vendin dhe njerëzit.

– Athletis, atletis!¹ – brohoritën, ndërsa ajo që kish klithur «Nikollaqkë» kish mbetur gojëhapur, me erashkën japoneze në dorë.

Kur pa se askush s'po i ndiqte shembullin, Nikollaqka u praps, mori hov e kërceu përsëri këtej, nga të thatë në të thatë, iu afrua bashkëshortes, dengut me dhjamë, i mori dorën dhe ia puthi, (për hatrin e madh të prikës!). Ajo s'di se ç'cicëriu shqip apo greqisht, iu njomën sytë dhe e hoqi pranë e pranë. Dhe kështu siç rrinin, të ngjeshur njëri pas tjetrit (ajo – një kuintal e gjysmë, ai tahmaqari, më pak se gjysmë kuintali), dukeshin një çift nga më të goditurit: një baldosë e martuar me një ketërush...

U matën të ktheheshin.

Ata të Çukës vështronin pa zë, në pritmëri diplomatike.

Befas, njëri nga trumba, një tregtar i madh vendas, që ish ngritur e kish marrë të përpjetën brenda pak vjetëve, duke bërë batall gjysmën e tregtarëve të vegjël të pazarit, tha:

– Tungjatjeta, Ago Zylal. Si më je, si më shkon? Si m'i ke djemtë? Si m'i ke nipërit e stërnipërit. A mbahesh ca?

Ago Zylali, ndonëse plak thinjak, këceu drejt e më këmbë (kish qenë shastisur fare dhe s'e kish vënë re njerinë me të cilin kish allishverish të madh) dhe, si njeri terbietli, ia ktheu tungjatjetën me dorë në zemër, me trupin pak si të përthyer e të përkulur përpara, me sytë të perënduar si të Zenun efendiut, që shihte hapur dyert e xhenetit.

– Tungjatjeta, o zoti Coli. Medet, s'të njoha. Pleqëri,

1) (gr) – atlet

ore. Ii më je zotrote? Ç'i kemi këta afendikonj? Nga na kanë urdhëruar?

— Iregtare të rëndë, Ago Zylal. Jo të rëndë, po shumë të rëndë. Ca janë korçarë nga Korça, ca janë korçarë nga Selaniku, që heqin e sjellin mallra, fitojnë alltën me okë. Njëri është lëkuraxhi, tjetri hambarxhi, i treti manifaturaxhi, toptanxhi me magazëra të mëdha. Njerëz që rrojnë me të ardhura e i shtojnë dita ditës. S'peshojnë vetë sa bankat e Evropës. Ne s'jemi gjë përpara tyre, ramona fare (dhe bëri sikur i ra tamburasë). Paraja është gjë e madhe, Ago Zylal. Është mbreti i botës.

— Bre, bre, bre..

Për hir të parave që kishin, megjithëqë nuk i pëlqente se i nxirrnin gratë kështu, teferiç, gjysmëlakuriq, me tulet jashtë, Ago Zylalit i shkrepën sytë xixa-xixa e u bëri të gjithëve, me radhë, nga një temena të madhe, duke qëndruar me këmbë «hazëroll», siç kish qëndruar dikur përpara mylazimit. Ata të tjerët ia kthyen «avropjançe», duke hequr e tundur kashtoret dhe u larguan duke folur herë shqip e herë greqisht, më fort në këtë të fundit, se u vinte më e ndorshme, më e ëmbël..

Vetëm ai burri i përcëlluar u vonua edhe pak, duke soditur vendin, për të tiposur diçka në tru, pastaj u largua ngadalë, po me çap ushtaraku.

Grumbulli — gratë përpara, si ca pata, burrat prapa, si ca patokë, dhe fëmijët sehirxhinj pas tyre — ktheu në të djathtë, në cep të kopshtit të Lakes e ia mori tatëpjetë. Ago Zylali e përcolli sa e përcolli me sy, më këmbë, po me dorë në zemër, pastaj, u ul e ndënji këmbëkryq, siç kish qenë në krye, ndezi një cigare të dredhur e ia bëri:

— Dëgjuat ç'tha Coli? Paraja është mbret i botës. Sa më shumë të kesh, aq më mirë është.

— Nuk iu përgjigj njeri.

Ago Zylali rënkoj thellë • shtoi:

– Eh, vakt, o vakt!

Dhe përsëri: dy a tri herë, me dhimbje:

– Eh, vakt, o vakt! Vakt, o vakt!

Të gjithë rrinin të heshtur. Ca e shikonin, ca nuk e shikonin.

– Ç'ke, aga? – e pyeti Grendelli.

– I qahem vaktit, o Grendell.

– Përse, aga?

– Desha të kish qenë vakti që dua unë, i miri, kur isha i ri.

– Ç'do bëje, aga?

– S'dëgjove ç'tha ai miku? «S'peshojnë vetë sa peshojnë paret që kanë.» I zija, i lidhja e u thosha: dua kaq mijë lira për kokë. Ja paret, ja kokat. Domosdo, do sillnin paret.

Grendelli e shikoi me ca sy të habitur, të zgurdulluar. Në krye s'mori vesh gjë, pastaj nisi të kuptonte si nëpër tym dhe, fundja, hungëroi si derr i egër i plagosur: «Uf...»

– Mënë, ore! – tha Dani, vërdovarçe, po me zë të ulët, duke zgjatur e theksuar të zëshmet. – Zaaptiie ka qenë, zaaptiie ka mbetur. Zorraxhi ka qenë, zorraxhi ka mbetur! Mënëëë! S'ngopet me asgjë.

– Ti nuk e di, – ia ktheu Asllani me zë të butë. – Pasanikët janë si rëra. Rëra, o djalë, s'ngopet me ujë, pasanikët s'ngopen me pasuri. Jepu sa të mundësh: do të të thëthijnë e përpijnë. Kanë sprijën në bark! Ptu! – dhe pështyu.

– Si ajo këpusha! – ia bëri Cutja, që sapo ish zgjuar nga gjumi i egjrit. – Pi, pi e nuk pëlçet.

Xha Dalipi tha:

– Dëgjoni një përrallë të vogël. Na ish një mbret e na del për gjah. Hop këtu, hop aty, na gjen një kafkë të vdekuri. E merr e fut në hejbet, e shpie në sarajet, e mban atje. Një ditë thotë: «Pa të shohim sa peshon kjo

kafkë?» Merr terezinë, vë kafkën në një tas, vë gurët në tasin tjetër. S'e ngrënë dot. Vë një okë flori, dy, tri, dhjetë, njeqind. Tasi me kokën e të vdekurit s'lot nga vendi. Thërret të mëdhenjtë, i pyet: «Ç'është kjo punë?» «Nga kjo punë, i thonë ata, mund të fitosh shumë flori. Thirri njerëzit të sjellin kaq flori gjersa të ngrihet lart koka e të vdekurit.» Mbret, ai! Bën urdhër: kështu e kështu. Vijnë njerëzit, sjellin qindra okë flori. Koka s'lot. Mbreti kanoset se do t'ua marrë tërë pasurinë, do t'i vrasë. Sjellin ata çdo gjë të shtrenjtë që kanë: unaza, vëthë, bylykë. Koka s'tundet. Ç'të bëjnë? Shkojnë e gjejnë një plak të urtë e i qahen. Plaku mendohet e thotë: «Kjo duhet të jetë kafka e filan pasaniku, që s'ngopej me asgjë. Më shpini në mbreti.» E shpian ata. Sheh ai në njërin tas kafkën, në tasin tjetër togje me florinj. Heq florinj të e hedh një dorë dhe. Tasi i kafkës ngrihet menjëherë. Mbreti çuditet. «Ç'është kjo punë?» – «Ky njeri, o mbret, i thotë plaku, s'ngopej në të gjallë me flori. As i vdekur nuk ngopet. Vetëm dheu mund ta ngopë.» Morët vesh? Pasaniku s'ngopet veçse me dhe, në gropë. Dëgjove, o Zylo? Kështu po bëhet edhe kjo puna jote...

Ago Zylali u mat xheç të thosh, po e ktheu. Të gjithë e shikonin në gojë. Uli kryet e s'foli.

Dani shikoi hijen e plepit përtej udhës, e mati mirë me sy dhe u ngrit më këmbë, i gjatë, i rreshkur, në brekë e në këmbishë. Hodhi shatën krahut e tha:

– Tashi po shkoj, se më erdhi radha. Ja, hija iu afrua Varrit të Mukes e të djemve. Do të shkoj të kthej vijën në skërkën tonë. – Nuk e pyeti e nuk e përfilli fare Ago Zylalin, po u kthye e i tha Asllanit: – Mbahu burrë, yha Asllan. Mos i dërgo djemtë të humbasin në Stamboll. Atje shumë shkojnë, pak kthehen. Kurbetin e kemi këtu, se vendi ka bukë për të gjithë. Sa për atë shkëlqesi benë si top gjalpi Vërçe, me bastun argjendi e floriri e me

kokë si deve Misiri e për këta miqtë që ishin këtu e që peshojnë më pak se sa paratë që kanë e sa për të gjithë ata agallarët e bejlerët që janë turrur si Ingjilizi nëpër dete për të zaptuar me borxhe e stërborxhe arat e botës, mos u bëj merak. Do t'u vijë dita. Thirre të të dëgjojë. Së shpejti do të bëhet dasmë e madhe. Me mish. Se dasmë pa mish s'bëhet. Dëgjomë mua.

Tha kështu, zbriti Çukën e hyri në vijë. Atëherë u dëgjua një zë i hollë djali të vogël, zëri i të vëllait:

– Daaani! O Daaani! Haaajde, ore, se duan të na e marrin rradhën e ujit.

Dani ia ktheu me bubullimë:

– Ja, po vij, ja, po vij!

Në këtë mes Ago Zylali nxori sahatin e madh, e hapi, e shikoi i vrenjtur, numëroi me gishtërinj shenjat si gozhda, tundi kokën, psherëtiu e s'tha asnjë fjalë, po i ra lehtë me bërryl Rizait. Ky bëri sikur s'mori vesh e nuk u tund nga vendi. Siç duket, xheç kish nisur të kup-tonte.

Dani u kthye e tha:

– Tungjatjeta, xha Dalip! Kosën do ta mpreh mirë që të ruskosë. Do mblidhemi të gjithë, se luadhi është i madh e ka shumë ferra. Tungjatjetani, o miq! – dhe u largua me çap të shpejtë duke lënë gjurmë të lagura këmbësh të zbathura në pluhurin e udhës.

Edhe gjinkalla vazhdonte këngën e saj nëpër drizat. Anëmbanë afsh i valë. Në Çukë zotëronte qetësi, siç ndodh përpara fërtyme.

Tiranë, 1943

Ripunuar më 1965

Si u takua Ndoni me zallorët

A doni t'ju them si u takua Ndoni me Zallorët? Po druaj, se ju s'dini cili ishte Ndoni e cilët ishin Zallorët. Ashtu? Atëherë bëni durim t'i marrim të gjitha me radhë.

Ndoni ishte një fshatari im: as i mirë as i keq, as i pashëm as i papashëm, pra as kështu as ashtu – dua të them njeri si gjithë bota, baltë perëndie apo burrë me kapë, si thoshin qëmoti. Vinte mesatar nga trupi, i thatë nga farka, po i gjallë engjërvë, njeri që nuk i zinte vendi vend. Dikur, në vogëli, ndofta kish qenë bardhosh e bukurosh, se shenjat s'i kish të këqija: vetulla të shpeshta, qepalla të gjata, sy të zinj si ata të çobanëve që vijnë e shkojnë me karvanët e mushkave. Po kush është ai që mbetet gjithnjë ashtu si pat qenë? Andej nga mënga jonë, sapo përkëmbet pak djali që të ndjellë kërrutat me një krodhe buke a me nja dy thërrime kripë, apo të heqë gomarë për kapistalli, të ngjitet lart në mal, të bëjë dru e t'i ngarkojë vetë, me vastangarkë, nis ta rrahë shiu e breshri, dielli e dëbora, që e rreshkin, e zeshkin, e argasin. Më tej, kur i del pushi i mustaqeve, fillojnë halle edhe më të mëdha: punë poshtë e lart, për bukë misri e kripë Kavaje. Pa më tutje, kur pushi nis të nxihet e të bëhet mustaqe e mjekër të kërleshura bashkë, që rrallë e tek i shpyllëzon brisku i berberit, fytyra i

merr ngjyrën e egjrit a të thekrës, ose, të paktën, atë të grurit që e ka rrahur vrugu, kështu që nuk i ngjan më atij bardhoshit e bukuroshit të dikurshëm? Po kush ka nge t'i vërë re këto të gjitha, kur ka andralla të tjera mbi krye?

Pra, nuk i vinte re as vetë Ndoni.

Të them se ish trim që trimëronte – nuk e them dot. Nuk e them, sepse Ndoni s'mbante dyfek krahut e pisqollë brezit, s'kish vrarë njeri, s'kish plagosur. Dhe s'kish cilin të vriste a të plagoste, sepse nuk kish hasmëri. Ama as frikaman nuk ishte. Sepse si mund t'i thuash frikaman një njeriu që i binte kryq e tërthor Mokrës e Gorës plot me kapedanë të mëdhenj e të vegjël, me hajdutë e kaçakë, me zyba e stërzyba, që mbanin kapën mbi sy e u dhimbsej më shumë plumbi sesa jeta e njeriut? Jo, besa, Ndoni nuk ish frikaman. As i drejtë shumë, as i shtrembër shumë. Luftonte ditë e natë për bukën e gojës e kur ia donte puna, i binte pak (lehtë, shumë lehtë) bishtit të kandarit me gishtin e vogël që të kërcente a të unej poshtë, sipas rastit. Domosdo, në këtë të uruar botë s'rrohet dot po s'bëre nganjëherë edhe pak hile... Mirëpo Ndoni e bënte hilen me vend: e mernte okën më të madhe sesa oka e vërtetë atje ku kishte shumë, ku vrahu ishte i madh, dhe më të vogël atje ku shihte se kishte zi e zibiti.

Kështu siç ish, ujem mulliri: as i mirë as i keq, as i bukur as i shëmtuar, as trim as frikaman, ajo që ish e tija ish e tija, dhe kjo ishte kënga. Zërin e kish të plotë, të rrumbullt e të ngjeshur, e s'përtonte t'ia thosh në dasma e në poganikë, në të lusura, në udhë e sipër, në punë e sipër e kështu me radhë. Kur ish i gëzuar, këndonte për të shtuar gazin; kur ish i helmuar, këndonte për të pakësuar helmin. Të tijën e të të tjerëve.

Kështu e ngrysi ai këtë jetë të ëmbël e të hidhur: me punë e më këngë. Prandaj njerëzit, të shumtët, e donin.

Sepse kënga e afron njerinë me njerinë, e zbut, e bën më të mirë, më të dashur. Po kjo s'do të thotë se s'kish edhe nga ata që nuk ia varnin fare e që rrinin hundë e buzë kur këndonte. Mirëpo këta ishin të paktë, nga ata që ne u themi andej shpirtkazmë, pa shpirt. Këta dinin e donin vetëm një gjë: qesen me pare.

Për fat të keq, që kur i kish buzët me qumësht, i ranë shumë brenga: i vdiq i ati edhe e la jetim, me motra që duheshin pajosur e martuar. Mall e gjë nuk i la. Ndoni nuk e humbi torruan, nuk u qa. Punoj si kalë barre, xhaftoi poshtë e lartë dhe i nxori një nga një, i martoi. Si u lehtësua kështu, veshi xhoken e dhëndërisë, bëri dasmë, u martua edhe vetë. Gaz i madh, si zogu në mars, ku rin bari, ndonëse marsi s'ka besë. U gëzuan të afërmit e të largmit, dhe më fort u gëzuan të motrat. Vëlla, ky! Derë babe! Shkëndijë që ndez vatrën! Mirëpo gëzimi nuk zgjati shumë: një mot, dy, tre. Në krye të tre vjetëve, nusja i vdiq nga të lindurat. Ajo vdiq, fëmija i rroi. Çupë. Edhe me dy të mëdhatë u bënë tri. Çupë-çupë, s'ka gjë, sepse sikush vjen në botë me fatin e vet, me lugën në brez. Fundi i fundit, çupat kanë ca si halle më shumë, po nuk është parë e dëgjuar që shtëpia të priset nga çupat. Halli i gruas që mbyll sytë e la tri jetime. Ndoni e qau, e kalli në varr, e mbajti dyzet ditë pa shkuar brisk faqeve, pa këngë. Zor, po i duroi të gjitha. Po ç'e zë njerinë e nuk e heq?

Atë ditë që i ndau të dyzetat, mori naxhaken, vuri të dy gomarët përpara e shkoi në mal, për dru. Larg, gjer ne Hija e Zezë. Dru kish edhe më afër, po ai desh larg. Preu e bëri dy barrë të mira, pastaj ndenji të pijë një cigare duhan.

Mali shushurinte. Kronjtë ua mbanin zërin. Ata s'duan t'ia dinë, se as u qan as u këndon. Dimrit vishen me sinjak e me dëborë, tuliten, durojnë, presin; pranverës e verës përtërihen, stolisen me të blerta, zbukuro-

hen; vjeshtës përskuqen, shkunden. Pastaj vjen sërish dimri me dëborë, zbardhen, spastrohen. As mplaken, as kërrusen. Prandaj Ndoni u kish zili maleve. Edhe kronjve. Dëgjoi sa dëgjoi fletët që murmurisnin kur i krihte era, dëgjoi ujërat që zbrisnin pllajave, shoi cigaren, e shkeli me majë të opingës, që të mos mernte zjarr ndonjë dëllinjë a ndonjë përnar i thatë, shërëmtiu sa buçiti tërë valthi e s'iu durua dot, ia mori këngës – në krye shtruar, pastaj lart e më lart. Ama një këngë me të qarë e për të qarë, se i qe mbledhur vveri lëmsh në zemër.

O shok, s'ma dini hallë,
O shokë!
Më ka vdekur nus' e parë,
O shokë!
Do vete t'i zbuloj varrë,
O shokë!
Të shëkoj se ç'nur ka marrë,
O shokë!
Nur të kuq a nur të bardhë,
O shokë...

Shokë s'kish që ta dëgjonin – veç pyllit e kronjve që shushurin e gurgullonin, veç shqiponjave që silleshin rrotull lart në qiellin e kthjellët e veç zogjve të vegjël këngëtarë, që cicërinin nëpër fletët – po ai vazhdonte t'ia thosh këngës e t'u truhej shokëve. Dhe ndërkaq lotët i rridhnin faqeve, i pikonin përdhe. Shërëmtiu edhe një herë, sa t'i dhimbsej edhe gurit e drurit, dhe vazhdoi:

Do vete t'i zbuloj gjinë,
O shokë!
Më ka lën' një rreth fëmijë,
O shokë!

S'kanë' të hanë e s'kan' të pinë,

○ shokë!

Thërresin më perëndinë,

○ shokë...

Këndoi e qau, qau e këndoi, pastaj ngarkoi e zbriti në fshat, i lehtësuar, me zemrën të larë e të shpëlarë si ato guriçkat e anës së liqerit pas dallgës, në mëngjes.

Zia zi, po edhe jeta jetë. Fundi, s'e ka keq ajo fjala e pleqve që thotë: «I gjalli me të gjallët, i vdekuri, me të vdekurit. Pra, Ndoni kuturisi dhe u martua së dyti. Edhe kjo i bëri dy fëmijë: të dyja çupa. Pastaj ra e vdiq. Prapë zi e vaj, prapë dyzet ditë kreshmë kënge.

Po sikur të mos paskeshin qenë mjaft e para dhe e dyta, ra i vdiq edhe e treta. Kjo e preu mes për mes, sepse ndodhi ta donte më shumë sesa të dy të parat bashkë.

Dhe të tria i lanë fëmijë. Të shtata çupa.

Mirë ka thënë kush ka thënë se kur bie shi, i pasuri mbyllet brenda në shtëpi e numëron paret. I varfri, që s'ka ç'të numërojë, rri me gruan e shton fëmijët. Pa kur është fare i këputur, si Ndoni, shton cucat. Dhe, siç duket, mot për mot, kur qe martuar Ndoni, kishte rënë shi me stomna. Se ndryshe, si mund të mbijnë, si kërpudhat, shtatë cuca nga tri nuse, në një derë? Jo, domosdo duhet të ketë rënë shi me stomna. Shokët kishin ca vetëm djem e ca të nakatosur: djem e çupa, kurse Ndoni vetëm çupa.

Mirë, mirë, t'i lëmë të tjerat, po shtatë fëmijë janë shtatë gojë. Edhe goja do bukë. Edhe siç e dini, buka nxirret me vuajtje, me djersë e gjak. Aq më shumë kur s'ke veçse dy duar e dy gomarë – as arë, as vresht, as pëlleja që të bëjnë bulmet. Kështu ishte Ndoni e në s'më zini besë, dilni e pyesni vetë në fshat, sepse aty, midis murishtave e gërmadhve që la topi i Grekut e

zjarri i Italianit e Gjermanit, ka mbetur tek-tuk ndonjë plak nga të parët, të cilin e ka harruar vdekja. Pyeteni këtë, e do t'ju thotë se kështu pat qenë. Me gjithë këto halle – «halle me shallvare», siç u thonë andej nga ne, kur janë shumë të mëdha – Ndoni nuk e preu këngën. Domsdo, tani nuk këndonte aq shpesh si në të ri, se xheku edhe grindet, siç grindet njeriu kur i hip skamja e madhe, po për të harruar nuk e harroi. Sepse me këngë e nxirrte dufin e zemrës. Shpesh e shpesh këndonte edhe këngë vaji, nga ato që të ronitin zemrën.

Punonte ditë e natë për bukë goje. Ngrihej sapo regëtinte drita, vinte përpara të dy gomarët, priste dru, i ngarkonte e i sillte në të gdhirë. Sapo shkarkonte drutë, shkante të punonte argat nëpër arat e vreshtat e botës. Herë-herë merrte me qira ndonjë copë tokë nga selishta e beut – jo shumë; një shoshë farë – dhe e punonte me gruan e katërt e me fëmijët, teretisej, fingjillosej. Veç në vlak s'kish punuar, se nuk e donte punën në ujë me gurneckat e gurneckatarët. Më tej e ktheu fletën: ngarkonte dy barrë poçe, stomna, misurë balte e të tjera të kësaj dore, që i merrte veresie nga Pandel Poçari dhe haj, përpjetë, me ush e ngorç, ngëcë-ngëcë, siç e ka gomari, nëpër Mokër e Gorë. Aty i bënte tramba me drithë peshin a me drithë veresie, gjer në lëmë, me lëkurë qengji a keci, me bulmet, me arra, rrallë me pare në dorë, se Mokra e Gora s'kishin gjëra të tilla, e pastaj zbriste prapë në fshat. Ama poçet, misurët e stomnat e Ndonit shpinin gëzim nëpër fshatrat, më fort grarisë që, sapo e shihnin, i bënin zë shoqja shoqes.

– Dil, moj Sinanore, se ka ardhur ai xhaxhua me poçe e misurë!

Sinanorja, e hollë e gjatë, dëgjonte e i thërriste Shabanores së trashë e të shkurtër:

– Dil, moj Shabanore, se ka ardhur Ndoni me poçe e qypa!

Pastaj Shabanorja i jepte lajmin Halitores, Halitorja Xhemalores e kështu me radhë, zinxhir, gjersa merрте vesh tërë fshati, nga Kroi i Poshtëm ne Kroi i Sipërm.

Dilte tërë kjo grari në lëmë, zgjidhte e merрте poçe për të zier fasule a groshë qorre, stomna për ujë, misurë për dhallë, qypa për salcë, pekmez e narden, sikush sipas punës. Burrat nuk përziheshin në këtë punë. Kush kish drithë, i jepte drithë, kush kish urov, i jepte urov, kush s'kish as kështu as ashtu, i jepte fjalën për në lëmë a tutje lëmit. Ndoni s'mbante as defter as çetele, po i gëdhendte të gjitha në mendje. Veç kësaj, e dinte se asnjë nuk do t'ia hante të drejtën e t'ia bënte hasha paret. Kur qëllonte të harronte, ia sillte vetë borxhlesha – sepse si do të ziente fasulet në një poçe të papaguar, si do të pinte ujë nga stomna e si do të hante dhallë në misur? Nuk e linte zemra!

Në verë linte poçet, qypat e stomnat dhe mbushte koshat me piperka, me bostanë, me qepë, sipas kohës e kërkesës. Nganjëherë vinte në xhep të fermelesë ndonjë varg rruazash, ndonjë kartë me zhizha, pak shikla, këna e mazi për të nxirë leshrat e vetullat, se graria është kudo grari, bile edhe në Mokër e Gorë, dhe do që t'i pëlqejë vetes e më fort burrit...

Zallorët i poqi për herë të parë tutje, matanë Bregut. Ish muaji gusht, ziente gjinkalla. Ndoni kish ngarkuar kësaj here dy barrë bostan: pjëpra e karpuzë.

– Po ç'ishin Zallorët? – ke për të pyetur zotrote.

– E ç'të ishin, or mik? Ja, burra nga Zalli i Torrës, hajdutë mali, kaçakë me dyfek në dorë e kokë në torbë. Shkonin mal më mal e stan më stan, hanin këtu një mish të pjekur në hell a në gropë, me lëkurë, përtej një oshmar të mbytur në gjalpë, apo mish dhe oshmar bashkë. Bënin jetë ku rënça mos u vrafsha! Helbete, kur ua donte puna, dilnin edhe andej nga Xhyra, zīnin pusi në ndonjë ngushticë shkrep-shkrep e ia prisnin udhën karvanit.

Ama nuk e zhvishnin të tërë. Merrnin pak nga të gjitha, ato që u duheshin: ca kripë, ca pëlhurë, ca më the të thashë, ndonjë lirë të verdhë a ndonjë mexhite të bardhë, pastaj i thoshin «udhembarë». Gjak nuk derdhnin, veçse...

— Po hyqymeti ç'bënte? — do të pyesësh zotrote. — Nuk e dinte, nuk e shihte këtë punë?

— Jo, e dinte, e shihte, po s'kish lojtur menç ta mbrehte me Zallorët, të bënte dyfek. Një herë e kish mbrehur, po kish dalë si pulë e rrjepur, pastaj kish hequr dorë.

Dëgjoni.

Në krye të herës Zallorët s'kishin qenë as kaçakë, as hajdutë që t'i prisnin udhën karvanit, po barinj me dhen. Nuk i binin më qafë njeriu. Bënin djathë e gjalpë, travok e manure, zbrisin poshtë me calikët plot e i shisnin me pare apo i bënin tramba me kripë, sheqer, piper e gjëra të tjera që u duheshin: pe e gjilpërë, pëlhurë për këmishë e qefin (njerëz jemi...), plumb e barut për të vrarë ndonjë egërsirë a për të bërë zap ndonjë hasm. Mirëpo barinjve u ra më qafë kajmekami i turkut. U dërgoi fjalë me një bumbashir: «Dëgjoni, ore: unë dua xhelep!» «Xhelep? Ç'është ky xhelep?» «Xhelepi është pagesë për gjënë e gjallë: Dua dy groshë të bardhë për kokë pëlleje a shterpe, shelege e milor. Për të gjitha nga dy groshë!» Zallorët kishin kopera të mëdha, se me to rronin. Që të paguanin këtë xhelep, duhej të shisnin më shumë se gjysmën e gjësë së gjallë e të mbeteshin me gisht në gojë. I bënë fjalë kajmekamit: «Pse, or ti? Ortak të kemi ne ty?» «Ortak, se unë jam mbretëri.» «Në je mbretëri, bëja çaren vetes. Puno, rrit gjë të gjallë, bëj stan e gjalpë e djathë, si gjithë bota.» «Jo, kjo s'është punë për mua. Dua groshë të bardhë!» «Po kur na bie neve sëmundja e na ngordh gjëja e gjallë, a vjen ti të na japësh ndonjë milor a ndonjë sheleg?» «Unë marr e s'jap.

Jam mbretëri! Sillni paret!» «Haj t'i marrësh!»

Atëherë u ngritën edhe barinj të tjerë e thanë: «As ne s'japim xhelep!» E nuk dhanë.

Pastaj puna u mbyll vetvetiu: kajmekami s'kërkoi më xhelep; Zallorët nuk zbritën poshtë për të shitur shterpa e pëlleja, gjalpë e djathë, lesh e lëkurë, po i dërguan me dorë të dytë.

Mirëpo uji fle, i ligu s'fle. Në këtë mes kajmekami e vuri punën në kallauz se ku e kullosnin Zallorët gjënë e gjallë, se ku veronin e ku dimëronin — të gjitha. Si e vuri në kallauz nisi e dërgoi yzbashin me një tabor të tërë, që e bënë natën ditë e u gdhinë në mëngjes në Zall të Torrës, e rrethuan vendin si në çark, zunë tragat e shtigjet. Alurinë qentë. Ç'po bëhet kështu? A mos ka rënë ulku? Vërtet, ulk kish rënë, po nga ata me dy këmbë. «Lidhuni, o barinj! Kemi ardhur të marrim xhelepin!» Po lidhet burri, kur ka dyfekun në dorë? Krisi nga të dy anët. Zallorët luftojnë me kapaklli, nizamët me dogra. Mirëpo Zallorët janë trima, e njohin vendin me pëllëmbë. Vrasin ca nizamë turku, çajnë udhë e dalin me gjithë tufë e fëmijë, heqin tutje, në Sopot; të tjerët u mbajnë krahun, e mbërthejnë në vend yzbashin, s'e lënë të bëjë gëk. Nga Zallorët nuk u vra asnjë; nga nizamët u vranë pesë veta. Mirëpo Zallorëve u mbarohet plumbi, u mbarohet baruti. Bëjnë të hiqen, po nizamët u marrin krahun, zënë tre burra të gjallë. Yzbashi kall në dhe të vrarët, kurse ata të tre i lidh e i zbret poshtë. Turp i madh! Qesh tërë Mokra. Burra si lisa të lidhur me litar... E kush i ka lidhur? Një yzbash si mingo. Zallorët durojnë, me sytë përdhe. I futin haps. Kajmekami do që t'i varë në hallkë, t'u japë shëmbëlltyrë të tjerëve, atyre që s'duan të paguajnë xhelep e që ngrihen me dyfek në dorë kundër mbretit të turkut. Pret kartë nga Manastiri. Po gjer të vijë karta, Zallorët thyjnë prangat e këmbëve e të duarve, thyjnë hapsanën, u marrin armët zaptijeve.

i lidhin këskëvrëk e haj, përpjetë malit. Kur dëgjon kajmekami se Zallorët kanë dalë me armë, mbyllet brenda me gratë, s'guxon të dalë. Në këtë kohë Zallorët arrijnë lart, në Breg, e që aty lëshojnë tri batare: «Ja ku jemi!»

Pastaj ia fillojnë punës siç dinë vetë: ia gjejnë gjurmën kallauzit që u kish hapur udhë nizamëve – ky qenkej njeriu i afërt i beut të Velçanit – dhe e dërgojnë atje ku duhet. Më tutje vrasin aganë që i kish dhënë bukë yzbashit, ndezin dyfek me Kaproshët, vrasin Lamçe Kaprin e kështu me radhë, e pastrojnë malin. Më tej: pam-pum, zien tërë Mokra. Yzbashit s'ia mban të ngjitet maleve as me tre taborë. Kur del udhës, brenda në qytet, ditë më drekë, dërgon devrie të ruajnë qoshet dhe mban një tufë zaptijesh prapa nones. Ua ka frikën Zallorëve. Po këta nuk zbresin poshtë, mbajnë kapën mbi sy e luftojnë në tre krahë: me zaptijet e turkut, me bejnë dinak të Velçanit e me Kaproshët. Kanë vetëm një krah ndihmë: ata të Krekës.

Ja këta burra i poqi Ndoni matanë Bregut, në gusht, kur sapo kish dalë bostani. Ai po ngjitej Mokrës me dy barrë shalqinj.

– A, mre! – i thirrën Zallorët njëri-tjetrit. – Shalqin, mre! Oburra të hamë, se na e ka çuar peshqesh kajmekami.

Edhe «mre!» këtu, «mre!» aty, nxjerrin thikat e gjata, marrin shalqinj të nga koshat e Ndonit, i presin, i hanë... Pa pazar, pa kandar: merr të marrim, rrëmbe të rrëmbejmë! Hanë e s'ngopen, sikur t'u paskej hyrë qoftëlargu brenda në bark.

Ç'bëri Ndoni?

Ç'të bënte, i gjori? Po pa më thuaj: ç'do të bëje zotrote, sikur të ishe atje lart, në mal, ballë për ballë me Zallorët? Me këta dyfeqe të gjatë, me këto pisqolla të argjendta futur në silahe, me këto pallaska si brëshka,

me këta sy të ndezur, me këta kraharorë leshtorë si zabelë, me nga një trastë mustaqesh nën hundë? Doemos, kishin edhe morra, shumë morra, se njerëz të gjallë ishin, dushkun e larushkun kishin shtëpi, gurin shtresë dhe qiellin mbulesë, gjithnjë nëpër luftëra e limerë.

Ndoni thirri e u lut me gjak të zemrës:

– Amani, o burra! Amani, o trima! Amani, o kapedanë! Amani! Amani!

Dhe përsëri:

– Mos më merrni më qafë! Shalqinj të s'i kam të kajmekamit. As të mitë. M'i ka dhënë veresie Lidini i Agushit e kërkon ja pare, ja drithë. Lidini s'është si Pandel Poçari, që thotë: «Baltë e pjekur është kjo e uruar. Kur të kesh – më jep, kur të mos kesh – mos më jep.» Obobo, unë i mjeri! Si do t'ia laj borxhin Lidinit? Do t'i qahet kadiut e do të më marrë të dy gomarët, me gjithë litarë e samarë.

Po Zallorët – dymbëdhjetë shpirt ishin kësaj radhe, të gjithë me thikë në dorë – s'ia varin torbën: merr e pri, pri e ha. Iku një kosh, po ikte edhe i dyti, megjithëqë Ndoni u lutej e u përlutej:

– Kam shtatë cuca, i ziu unë. Pa bukë. Vini dorën në zemër, o kapedanë. Ku të shkoj e ku të mbytem...

Kur dëgjoi se s'dinte se ku të mbytej, u hodh një shakatar, burrë i imët e leshkuq, me një fytyrë tërë preka, si kokë mërene, e i tha me gojën plot:

– Në Shkumbi, xhaxho, në Shkumbi! Andej, poshtë Golikut, ku uji vjen i rrëmbyer. Aty ka edhe vende me gropa dy bojë njeriu.

Një tjetër ia preu:

– Jo, mos shko në Shkumbi. Më mirë ngjitu në ata shtatë liqeret e Bishnicës, nën Gjemth. Aty ka ujë akulli, të kulluar. Po të duash, të çoj unë e të lidh një gur në qafë.

Edhe gjithë të tjerët: «Ha-ha-ha-l!» – me gojën plot.

Njëri, më i mirë nga të tjerët, kur e pa shumë të pikëlluar, i rrahu supin e i tha:

– Numëro bishtrinjtë, se ne do të t'i paguajmë. Në mos sot, mot; në mos mot, pas tri vjet; në mos pas tri vjet, në ahiret. Kur të kemi pare me thasë, do të t'i japim me torba; kur të kemi me torba, do të t'i japim me qese; kur të kemi me qese...

Po ku kishin pare Zallorët?... Ata e kishin qesen byk, se kishin kohë që s'kishin dalë për të zhveshur ndonjë karvan. Siç thashë, morra mund t'i jepnin sa të donte, po Ndoni nuk donte, se kish të vetët. Ai donte groshë të bardhë, çereke e mexhite ose drithë, që t'ia lante borxhin e ri Lidinit e t'i mbetej gjësend për bukën e shtëpisë.

Atëherë u hodh ai shakatar i parë, leshkuqi e prekamani:

– Shalqinjte do të t'i paguajmë në lëmën e shëndreut, kur fryn e bie. Eja me thasë, që të t'i mbushim plot me dëborë në vend të miellit.

Tallej burri i botës...

Pastaj Zallorëve u hipi ngopësira dhe e kthyen ndryshe: pri e lër, bjeri me këmbë e rrokullise tutje: «Ky s'qonka i mirë. Ky s'qonka i kuq. Ky qonka farëbardhë!» Hanin vetëm zemrën. Kështu, u zbrazën të katër koshat, u mbush tërë lëndina me kore e fara, me shalqinë të prerë e të hedhur. Rreth e rrotull zhurzhurin mizat e gjelbra e grerat e verdha, që kullosnin ëmbëlsirë. Jo vetëm mizat e grerat, po edhe të dy gomarët e Ndonit: zgrup, e zgrup, pa pikë mëshire, si në gjë të hasmit. Lëmë shalqini, ky!

Si u dendën së ngreni, burrat e dheut çliruan brezat e rripat e ndenjën në hije të kapitur, me plëncet të fryrë. Ca nxorën e ndezën nga një cigare, ca u shtrinë të mekur e s'loznin dot nga vendi.

Kur e pa tërë këtë dërmajë e shëmbëtyrë, xha Ndoni

– se xhaxho duhet t'i themi edhe ne, të paktën për atë bijë mjekër që ma kish më të gjatë se sa të priftit të Llëngës, atij të vjetrit, papa Kostandinit, që shkonte në kishë e hynte në meshë me martinë krahut e tapanxhë brezit (zoti të ruajttë të bie në dyfek të tij, se të grintel) – nxori kapën nga koka, e plasi përdhe, u shtrua këmbëkryq përpara Zallorëve, u përkul pakëz përpara e ia mori një kënge ashtu siç dinte vetë:

*Zbrisnje që nga Mal i Thatë,
Pinje ujë në një sterrë –
Merrja, bilbil, me ngadalë,
Për atë çapkën e mjerë.
... O bilbil, ku ke folenë,
O pranë lisit të prerë,
Merrja, merrja, me ngadalë,
Për atë çapkën' e mjerë.*

Zërin herë e ngrinte lart, gjer në majë të Gjemthit, herë i ziente dhe dërrmonte si ato ujërat e shkumbëzuara të Kalivaçit, pastaj e platiste qetë-qetë si ata shtatë liqeret e Bishnicës. Mbaroi një këngë e nisi një tjetër: atë të Xhafer Këmbpulës: «*Fry mos fryfsh, moj erë e shkretë,/ Jalla ku bien këta dyfekë./ Lëfton Xhaferi vet i tretë,/ Vetë i tretë me treqind vetë*»; atë të File Zikës të Vërçës: «*Ditënë e shtunë, ditën e pazarit,/ Na vrau File Zikën Mehmet i Dusharit,/ Na vrau File Zikën në mes të pazarit,/ Se ç'i la opingat ne dyqan i Vanit*».

Zallorët po e shikonin të mahnitur: «Si u bë kjo punë? Ky paska qenë bilbil këngëtar, na i ditka këngët tona...» Ata u pikëlluan për vrasjen e Xhafer trimit, që e tradhtuan rajcarët, po u gëzuan për vrasjen e File Zikës, që kish qenë qehaja i kajmekemit. Gomarët, të lehtësuar nga barra, lanë kullotën dhe krekuar veshët: edhe ata

çuditeshin, ndonëse e kishin dëgjuar ngaherë kur këndonte.

Ndoni ia mori pas një çasti këngës të Isuf Qoses, që kish ndezur zjarre mal më mal e kish thyer vet' i shtatë një tabor të tërë: «Isuf Qosja, një burr' i thatë,/ Ktheu askerin vet' i shtatë./ Nuk lëftohet me kësmetin,/ Gjithsekush e ka të vetin». Tërë Mokra e kish dashur dhe e kish pritur me bukë trim Isuf Qosen – atë burrin me dy emra: edhe Isuf, edhe Josif, që kish thyer kaq herë asqerin e madh të Turkut.

Një burrë i gjatë me mustaqe të shkuara tri herë rrotull veshit, thirri:

– A mre! Ky qonka zog mali! E paska zanin si kulaç të grynj nga ata të Potkozhanit!

Të tjerët i bënë me dorë: «Lëre të këndoje». Ndoni e ngriti lart e më lart e ia mori këngës së Maliq Torrës:

*Tundet Mokra, tundet Gora,
Bën dyfeg ky Maliq Torra,
Maliq Torra, që e bën fora,
Plumbin se ç'ia treti dora.
Që ne guri gjer ne frashri,
Se ç'u vra ky Lamçe Kapri...
O Maliq, o dorergjëndë,
Lamçen se ç'e le pa dhëmbë.*

– Ohol – thirri ai shakatar i që kish dashur ta mbytte në liqerët e Bishnicës. – Të lumtë goja, o xhaxho!
Ndoni uli kryet poshtë dhe shtoi:

*Që ne shpella ne kasolla,
Thonë u vrake Maliq Torra...*

Atëherë ai burri i gjatë me mustaqet shkuar tri herë rrotuil voshit ngriti pëllemben dhe fshiu një lot: ë kish pasur xhaxha Maliq Torrën.

Luftëtarë ishin Zallorët, kaçakë mali, njerëz të vrazhdësuar, si gjithë ata që rrojnë me kokë në torbë, po edhe ata kishin zemër, dhe kjo zemër u qe zbutur siç zbutet dylli kur i bie afshi i zjarrit. Ky afsh ishte kënga e Ndonit. Po edhe Ndoni kish zemër. Ai ua dinte hallin Zallorëve, që duhej të flinin dushqeve e gërxeve, me njërin sy mbyllur e tjetrin hapur. E dinte se ata kishin marrë nga e keqja udhën e kusërisë. Kur i pa shumë të pikëlluar, e ktheu fletën e ia mori një kënge tjetër, më të butë:

*Ke dalë më rrinje
Në sofat të portës,
Na prishe nga mendtë
Çup' e Lamje Hoxhës...*

Pastaj:

*Fryri er' e detit,
Na mbuloi kumi,
Hamide të thirra
Të zgjova nga gjumi:*

*Tunde djalit, tunde,
Gjer ta zërë gjumi.
Një dorë nga unë,
Një dorë nga çuni,
Hamide të thirra,
Të zgjova nga gjumi.*



Ai kish pandehur se me këto këngë të fundit do t'ua çelte ballin Zallorëve, po kish ndodhur e kundërta: i kish pikëlluar edhe më shumë. Domosdo, edhe ata kishin në shtëpi ndonjë Hamide e ndonjë çun në djep, që vinin t'i shihnin rrallë e tek. Ndoni, padashur, ua zgjonte dëshirat e përgjumura me fjalët e buta të këngës: «Gush' e zotris sate/ Si shkumbë sapuni;/ Hamide të thirra,/ Të zgjova nga gjumi,/ Bel, i zotris sate./ Përdridhej si plumbi;/ Hamide të thirra! Të zgjova nga gjumi.»

Edhe këngë pas kënge, i mbytur që i mbytur ish, ua filloi atyre të valleve. Jo vetëm ua filloi, po edhe ua drodhi me shami në dorë, sikur të paskej fituar e jo humbur dy barrë shalqinj. U ngritën edhe Zallorët – me këta fustane kinda-kinda, të nxirë sterrë, me këto shtate të drejta si boriga – e ia morën valles herë shtruar, si në bunacë, herë rrëmbyer si në fërtymë. Hajde gaz, hajde!... Në valle e sipër, i pari i të gjithëve, një burrë nofullmadh me ca vetulla si degë bredhi, të varura, thirri:

– A, mre! Ta mbajmë për darkë këtë xhaxho, se na gëzoi. Ejani këtu, o çuna!

– Urdhër, kapedan!

Burri nofullmadh u tha ç'u tha e ata morën dyfeqet e shkuan. Pas një copë here u kthyen me tri shqerra e dy mushka të ngarkuara me drithë. Mbi thasët e mushkave kishin hedhur nja tre a katër kulaçë të grynj. Shqerrrat i therën e i poqën në hell; drithin ia falën xhaxhos që këndonte bukur. I morën ku i morën, pun' e tyre po atij ia dhanë.

– Merri, xhaxho, se paske cuca e ditke t'ia thuash mirë.

Kur u pa me kaq drithë, sa t'ia lante borxhin Lidinit e t'i mbetej edhe për vete, Ndoni kapiti kapën mbi sy e zuri të kërcente kur si kaposh mali e kur si kapruall, sikur të paskej mbledhur në vetvete gjithë gazet e gjyshstër-

gjyshërve dhe i derdhte tani përpara Zallorëve të mah-nitur.

Pastaj shtruan darkën.

Pasdarke, ai burri i imët, lëshkuqi, nxori fyellin nga si-iahu e ia tha bukur, ëmbël. Pas tij këndoi përsëri Ndoni.

Dy ditë e mbajtën Zallorët atje lart në mal, me mish të pjekur, me djathë të butë e mjaltë të patretur. Dhe s'donin ta lëshonin të zbriste poshtë (se qysh u lëshuaka zogu nga dora?), po e dinin se e prisnin cucat në shtëpi. Kaçakë mali ishin Zallorët, po çuna e cuca kishin edhe ata vetë, pra dinin ç'është dhimbja e prindit. Pa kur erdhi puna të ndaheshin, zhdrodhën qeset që mbanin varur në qafë e i dhanë Ndonit ato pak pare që kishin mbledhur poshtë e lart. Pastaj e përcollën me bujë gjer në Breg, që të mos e ngiste njeri.

Ndoni mori tatëpjetën, me këngë në gojë, kurse lart Zallorët shkrenin dyfeqet, që t'i thoshin: «Këtu na ke, xhaxho! Mos u druaj!»

Edhe sa rrojtën e luftuan Zallorët, Ndoni e kish synë pishë kur bridhte nëpër Mokër e Gorë, sepse për xhaxhon këngëtar Zallorët e shpinin gjakun gjer mbi gju.

Kështu u mbajtën Zallorët shumë vjet, mal më mal e limer më limer, me luftë në të tre krahët: me turkun, me derën e beut të Velçanit e me atë të Kaproshëve. Pastaj erdhi një mot i prishur: Zallorët ranë në pusi të keqe (my-nafiku shpirt mos pastël). Ca çanë udhë me jatagan në dorë, ca u vranë. Këtyre ua sollën kokat poshtë, në hy-qymet, që t'i shohë gjithë bota e të bëhet tembi.

Edhe kur i pa, Ndoni i njohu menjëherë e i qau me lot, si miq e vëllezër.

1944

Ripunuar më 1965

Hanet e karvanet

S'di sa hane do kish pasur më parë fshati im – se, helbete, vend i vjetër e pranë rruge është – po di se në kohën e vogëlisë sime katër i kish: i Petres një, i Pacit dy, i Silkës tre dhe ai i beut, që i thoshin edhe hani i Mokrës, katër.

E s'ishin hane të kotë si mund të ta presë mendja zotrisë sate, hane Xhyre, po hane me xhoke, sikush me nga dy palë trarë. E të mëdhenj sa të lodhesh kur të ecësh brenda. Pa më t'më kishin këto porta të mëdha sa hynte qerja me gjysmë mullari bar; pa këta zinxhirë të trashë që viheshin ditën e pazarit, pa këto plevica të mëdha për bar, e sa e sa të tjera, si për kuaj e për njerëz.

Kish fshati im edhe ca si hane të dorës së dytë, si hani i galave, ku mbatheshin kuajt e mblidheshin kurbatët e xhambazët e ca të tjerë, po këta s'i merr kalem, se më fort na e turpëronin fshanë sesa e nderonin.

Pa ai i Petres na kish edhe oda me mindere ndër-tuar rishmë, sot e gjashtëmbëdhjetë e kusur vjet, ku ka ardhur edhe llandoni i Manastirit me gjithë ato zile që na prishnin mendjen neve vegjëlisë. Ky kish në ballë, mbi ballkon, dy luanë me kokat prapa e ca pasqyra, sa kush shkonte e vështronte, mbetej me gojë hapur.

Për kuaj hanet kishin bar të hollë, nga ai i fushës, – i zgjedhur nga i zoti – pa një koçkor e pa një fije myk, për njerëz: bute me verë e voza me raki rrushi, sepse çdo han kish vreshtat e tij që i plehroste sa duhej. E sepse raki e rrushit s'ka se qysh pihet pa një gjë të kripur të përzier me një gjë majoshe, aty pranë na ishin kadet me turshi e arme edhe ata bukuri kollozhegë prej balte të pjekur, ku kish sende me uthull. E jo vetëm kaq, sepse ata t's karvanit nuk vinin duarthatë e vetëm me rrogoza me duhan, thasë me kripë a kacekë me vaj – po sillnin edhe ullinj, të ndërtuar a të pandërtuar, si të ta kërkonte e bardha zemër.

Në s'ishin mjaft këto të gjitha – edhe unë vetë e di se nuk ishin mjaft, se në udhë e sipër njeriu ha shumë! – po të zgjatje dorën aty lart, merrje vetë pastërma ftuje a kolloface me piper të zi ose, në je barkmadh, që të dyja bashkë. Edhe Brahimnë e ke aty afër zjarrit të ta pjekë si e do vetë. Veç kësaj, Brahimi që i punonte mendja si flaka, dinte edhe tjetër gjë: dinte ta bënte tavën me kohë sa pa hyrë karvani në fshat e ta çojë në furrë, dinte të mbledhë me kohë vargje me cironj – pllashnica a bargjera a si t'i duash – e jo fort rrallë, kur e sillte moti, edhe ndonjë ngjalë të kripur e të tharë, sa të mos të të sosë një vozë verë.

Edhe hanin e pinin këta lalët me jakuce – si shisnin mallë e si mbushnin qeset me mexhitë e me lira – hanin e pinin, pinin e këndonin, sa ment mbeteshin me gojë hapur.

Sa nuk i desh ky fshati im, atëherë si sot, gegët e egër të Dibrës që vinin e bënin plaçkë, si ujku në dimër – aq fort i desh gegët e butë të Elbasanit: me këto bukuri jakuce me tufëza mbi supe, e me thekëza papa. Sepse gega i butë i Elbasanit sillte vetëm të mirat. Deshe vaj, – e kishe. Deshe ullinj, – t'i sillte. Deshe kripë Kavaje, duhan e portokall me erë, – vinte e t'i jepte në

dorë. Pun' e tij se bënte kaq ditë udhë nëpër shi e nëpër dëborë, e nëpër prita hajdutësh që zhvishnin fort dendur – gega i butë i Elbasanit vinte e t'i sillte të gjitha të mirat ne dera e shtëpisë. Kur t'i s'kishe ç'të bësh me kaq arra e gështenja, me mollë e me grufë, me qepë e me lëkurë, gega i butë t'i blinte me grosh të madh, kur kthehej nga udha e Manastirit a e Janinës. Ti veç hap gojën e kërko e mbaj dorën të t'i numërojë mexhitet e bardha, se edhe ai pa barrë s'ka për t'u kthyer në shtëpi, se e qeshin shokët.

Fitim kish, vërtet, po ndahej më dysh, vllazërisht, që të rrosh e ti e unë e puna të soset.

– Ç'hynim ne vegjelia në këtë mes? – pate pyetur zotrote.

Hynim edhe ne me punët tona, sepse kush thua ti se e ngjeshte barin e plevicave në verë? Kush vinte pas leq kali për ato krazat e mëllinjave? Kush vinte e i thosh gegës se filani ka arra e gështenja për të shitur? Kush vinte e mbante rrush me gomar për të mbushur butet? Kush u fëshëllonte kuajve kur vinin për ujë?

E jo më kot, se karvani sillte edhe fiq të thatë për zogat¹⁾ tona edhe portokaj me erë e sa e sa të mira.

Prandaj edhe ne sa dëgjonim zilet e këmborët që afroheshin ne Shkalla e Madhe – kur frynte e binte, a ne Guri i Mullozhit – kur s'kish erë, dilnim dhe e prisnim me gaz dhe i numëronim kuajt. E si i numëronim, ia vinim synë atij që kish ndonjë bisht të gjatë edhe i binim këmba-këmbës prapa. Dhe e dinim sipas të trokiturit, që së largu, në është karvani i Oç Këllëzit, i Llazit të vogël a i Nas Çobanit, të birt të Samarxhiut. E s'ishin karvane të vogla këta, po tetëdhjetë e njëqind kuaj e lart, ca

1) vajzat

binekë për udhëtarë e të shumët barrë, sikush në vendin
e tij, me kallauz në krye.

Kallauzi kish zile edhe qahej me zë të hollë, si grua
– Tink-tink-tink... (Kam borxh, kam borxh, kam borxh.)

I dyti kish këmborë edhe i përgjigjej me zë të trashë,
si zë burri:

– Tynk-tynk-tynk! (Ta laj, ta laj, ta laj!).

Dhe të tjerët i mbanin zënë të dytit; i lanin borxhin
të zot të karvanit dhe ia mbushnin qesen si kokë maçoku
me lira e me mexhite të zjarrit.

Të gjithë kuajt i desh gega i butë, si barrë e binak,
se për të punonin, po më fort e desh binekun e harxheve
ku ish varur kotrulli i ujit edhe hejbet me takëmet e kafes
e të sheqerit. Ku gjente bar për të kullotur kuajt, qën-
dronte pakëz sa për një kafe e për një cigare duhan në
çibuk të gjatë edhe pastaj haj! përsëri për rrugë.

Kaq gaze sillte, o zot! asohere karvani brenda në
fshat e brenda në han! Vetë i zoti i hanit me yzmeqarët
u dilte përpara, i zinte kuajt për kapistalli e i çonte
drejt në grazhd... Edhe derdhej lirësia si s'kish vend në
botë.

Tani më s'ka karvan. S'ka kush kalon, si dikur, me zile
e këmborë, Urën e Haxhi Beqarit, Qafën e Polisit, që të
dalë në Babje, të bjerë në Qukës, ku ta zërë nata e gjumi
e t'ia marrë pastaj, qëmenatë, Lëngajtës përpjetë e që
aty të bjerë në Kotodesh, në Piskupat edhe pastaj në
fshatin tim.

Tani në rrugën e vjetër të karvanit është rritur bari,
kurse në rrugën e re, ku punon rrota, shkon ditë e natë
vdekja me qefin në kokë.

Tani në fshatin tim nuk shkon as bari, as gozhda, as
gështenja. E se nuk shkojnë këto të gjitha, nuk rrjedh as
argjendi e floriri si më parë. Tani as plehu bëhet e as
vreshta rritet edhe paraja mbeti kallpe.

Haneve u ra zjarri i latinët edhe vreshtave sëmundja.
Pa njerëzve tanë – pleq e të mitur – u ra vdekja.

Sepse që kur u hap rruga me rrota edhe që kur
zbriti latini këmishëzi e shpirtdreq, me qerre me hekura,
u mbush vendi me kuje e vaj...

1944

Lumi i madh

Njerëzit – të mirë a të ligj, të bukur a të shëmtuar, të pasur a të varfër – vijnë e shkojnë, po Lumi ynë i Madh lumë ishte, lumë është. Kur me ujë shumë e kur me ujë pak, vërtet, po atë ma ke aty për jetë e mot, kurse unë e ti, or tunjatjeta, sot jemi, nesër s'jemi.

Ama duhet ta dish se ky që sheh zotrote sot – i drejtë, i urtë, i platitur – ndryshon shumë nga lumi i vogëlisë sime, sepse ka hapur udhë të re, siç desh vetë, mes për mes fshatit. Dhe këtë udhë e ka hapur me shpatë në dorë!

Atëherë, dua të them në kohën e vogëlisë, pasi mernte fill nga kronjtë e largët të Hijes së Zezë, i kulluar si jar e i lehtë sa ta pije me grushte e të mos ndieje kurrë të ngopur, çante grykën e Krushës duke u hedhur zdrang-zdrung, prag më prag, nëpër shkëmbinj me myshk e pa myshk, shtohet me ujëra të tjera, që i vinin nga e djathta e nga e mëngjra: me ato të kronjve që dalin nën Gurin e Kolë Branës, ato të Kabashit me shokë, të Stregës, të Fitit, nën pllajën e gështenjave të Katjelit e soste poshtë, nën Gurin e Etheve, aty ku ndahet jazi i mullinjve. Jazi ia pakësonte ujin, po Lumi i Madh ish bujar e nuk mbante mëri: Le të marrin, thosh, njerëzia, të bluajnë, të bëjnë bukë e kulaç», pastaj rusej nën mullinë e Veselit, nën

atë të Emin Blacërit (E mbani mend Ëmrin Blacërin apo Emin Jargon, siç i thosh gjithë fshati? Në s'e mbani mend, ua them unë: një burrë i trashë, gushëmadh e zëngjirur, që vrau të nipin, të vetmin, nga inati, me një gur kokës; më tej Eminin e vrau me sëpatë, në gjumë, për të marrë hakun, Aliu, i biri i vetëm dhe kështu dera u mbyll vetvetiu), çante udhë nën Najazmë, përmes arave më dhe të butë e shëlgjishta, gurgullonte midis drizash e kulprash ku që në muajin prill këndonin ferrakët dhe dilte me bujë, duke kërcyer rrasë më rrasë, nën shtëpitë e djemve të Velës, shkante nën vigun e udhës së Mokrës – të ngushtë sa mezi mund të vinte dhia këmbën – futej prapë në një amëzë të butë gjer aty nën Gurët e Meros, mernte nën urën e Nackës dhe bënte t'i turrej gjolit, sepse, siç e dini, uji i shumtë ndjell të paktin.

Mirëpo aty njerëzit ishin ngjeshur bri për bri në ca rripa toke, që holloheshin shumë e më shumë kur ndaheshin vëllazëria. E, meqë këta s'kishin se ku të shtriheshin e të zgjeroheshin, ia nxirrnin inatin lumit. Pa kish edhe nga ata me kopshte pak më të mëdhenj, po që nuk ngopeshin me kaq e donin më shumë. Zotërit e njëjës anë thoshin: «O lumë, largohu nga sinori im e hidhu matanë, në sinor të fqinjit: gënjeje, batisë, batërdisë!» Ata të anës tjetër ia prisnin: «Jo, lumë, mos ceno këtej, po kafsho sa të mundësh andej: prish, shkreto, shkatërrro!»

Këto nuk ishin vetëm me të thënë, po edhe me të bërë: e ngushtonin lumin, ndërtonin ledhe të forta me hunj e purteka gështenje. Këto ledhe i forconin poshtë, brenda në lumë, me grazhde, me mure me gurë kraste e me gëlqere, që t'ia prisnin hovin lumit e ta shtynin matanë. Ashtu bënin edhe ata të anës tjetër, se shtrati i lumit qenka mall pa zot: shtyje ta shtyjme, ngushtoje ta ngushtojmë! Asnjë s'çante kokën, se lumi është lumë e rrjedh nga lart poshtë, pra do udhë të gjerë, gjithnjë të hapur.

Lumi i Madh s'tha fjalë goje: rrodhi nëpër ngushtica sa një vrage dhie, gjarpëroi nën dredha, shkoi nëpër ura e vigje.

Njëherë dikush e teproi: si i zhvati lumit nja tri a katër pëllëmbë dhe e forcoi vendin e tij sa munda, zgjati ca trarë sipër, pothuaj gjer në gjysmë të lumit, i mbështeti këta trarë në tabanë gështenje të shëndoshë, vuri sipër një trirë, e çarkoi me gardh dhe bëri kështu një kotec. Brenda në këtë kotec futi një alamet derr, që ta majmte për Ignasht. I thanë: «Ore, s'e ke mirë! E ngushtove shumë lumin.» Ai qeshi: «Le të shkojë t'i qahet gjykatores!» Lumi nuk iu qa gjykatores, se e dinte që hante rryshfet, po i duroi të gjitha. Kështu, rrinte derri majë kotecit, si në tatrivan, mbi lumë, edhe gau-giu tërë ditën, të thoshe se s'ishte derr me kreshtë, po zog me pendë, i vënë në kafaz për të kënduar.

Ashtu bëri edhe Agënushka e Mokrarit, që kish kazan rakie: hodhi trarë mbi lumë e ndërtoi një kotec e s'di ç'gjë tjetër. Pak më poshtë, lumit i doli përpara Kozman beu — dajo Mani s'ish bej i vërtetë, po teneqexhi, që punonte tërë ditën me çekan në dorë e me pagurin e rakisë pranë, po i kish shkrepur qejfi t'i thosh vetes «bej», se kish një palë mustaqe të mbushura, të gjata, që ia kishin zili bejlerët e vërtetë, ata mingot-pipingot gjysmë qose e gjysmë njerëz, po që kishin rrëmbyer shumë mall e u shkante vula. Them, i doli përpara, ashtu siç ish, vetullvarur, edhe i shfryu:

— Ore ti! Unë të kam vënë sinor gardhin, që t'i vish rrotull ngadalë. Hap sytë e mos ma gërryey kopshtin, se të ha xhuxhullima. More vesh?

Thua se kur i tha këto fjalë Kozman beu, duhej të kish qenë i dehur? Jo: ish si ngahera — dua të them gjysmë kështu e gjysmë ashtu, me pagurin në brez — po ashtu e kish të folurit, se ish burrë me çallëm. Dhe i

pashëm: i gjatë faqekuq – gjer thellë në pleqëri. Kish shumë çupa dhe të gjitha t'u rrëmbeje kokën. Dera e tij ish dera e bukurisë në fshatin tonë, si në vajza ashtu edhe në djem.

Pas dajo Manit, siç i thoshim ne, a Kozman beut, siç i thosh vetes, tërë lagjja i dha urdhër lumit që të shkonte nën një urë të unjtër ku mezi hiqej zvarrë dhe gjarpri, të bënte një bërryl përpara portës së Çaçes, të merrte për nga Çomollarët, pastaj një të kthyer për nga Kolça e të thyente qafën tatëpjetë, ku të donte.

Të gjitha këtyre nyjeve iu shtrua Lumi i Madh. Jo nga frika e jo për gjë tjetër, po se ishte shpirtmirë e i duruar si s'ka lumë tjetër të madh në botë.

Mirëpo, me të shpëtuar nga kaq tevatyra, kur të thotë «lavdi, o zot», i doli nga njëra anë xha Petreja e nga ana tjetër Risto Lushi me shtatë a tetë të tjerë. Sikush e ngushtoi mot për mot një pëllëmbë a dy, me gjerdhe, ferra, kulpra, mure – ashtu siç i thosh engjëlli që kish në bark.

– Dua të mbjell një qershi belicë, ja mu këtu, në rrëzë, – tha xha Petreja i shkurtër, i shoqi i Çaçe ballabanës.

– Mbille, – ia ktheu lumi.

– Dua ta bëj ledhin si kala, me ferra e kukurak, sa të mos hyje as breshka, as gjarpri.

– Peqe.

– Dua të bëj një urë...

– Bëje.

Matanë u hodh e tha Risto Lushi, që kish një rrip kopshti:

– Më ka shkrepur të mbjell një shtog këtu, rrëzë gar-dhit, që të ma forcojë mezhdën.

– Mbille.

– Dua të mbjell e ca shelgje, sa e kanë rrënjën të fortë e t'i anoj mbi ty. Aty të mblidhet shpesëria e të

më këndojnë kur të numëroj trespiket e të ngrë pa gurin e rakisë më çëke.

– Mirë.

Aty më poshtë u hodhën e thanë të dy ata të derës së Panos:

– Duam të bëjmë nga një palë përdheska me themelet në shtratin tënd.

– Bëni.

Ashtu thanë edhe djemtë e Bices.

Edhe sikush punoi siç desh vetë: mbollën shelgje, shtogje, kulpra, bënë ura me këmbë e pa këmbë, e ngushtuan môt për mot lumin.

Kur me të dalë nga kaq shtrëngesa – njëri shty këtej, tjetri shty andej – si bëri një të kthyer në Grop' e Silkës, i doli përpara Piti Ruvina edhe e shtyu tutje nja dy pëllëmbë. Pastaj, kapak mbi të gjitha ia preu udhën beu i madh, me dy a tre sejmenë prapa, e i tha:

– Dëgjo, or ti, përrua mali!

– S'jam përrua bej, por tamam lumë. E në do ta dish mirë e paq, më thonë Lumë i Madh.

– Tyt, bre! Harbut! Përrua thashë, përrua jel!

– ...

– Dëgjo, o përrua mali! Ata njëzet e kusur dyqane e shtëpi e ata katër mullinj, nuk i kam mjaft. Dua të zgjerohem, po s'kam ku. Çdo «mall pa zot», mall rajaje, e përlava. Tashi kam fqinjë bejlerë të tjerë e s'dua ta prish punën me ta. E, meqë s'kam ku të zgjerohem, dua të bëj këtu, mbi ty, njady dyqanë, se i thonë vrom pazari dhe lot qira e madhe. Ti të shkosh poshtë, urtë e butë edhe hap sytë se, po solle gurë e drurë që t'u biesh mureve, të ha gjarpri i zi.

Të thënë, të bërë: urdhër të gjorit Petro të Ninës, që ish burrë i urtë e s'trazonte as mizën, të marrë qysqinë, barenë e çekanët e të nxjerrë gurë në Krastë,

urdhër gjemisë së Dios e asaj të Kaçamakut që t'ia sjellin gurët gjer buzë gjolit, urdhër Qafkos, Dangos e Ndrios, që t'ia mbajnë gurët me qerre nga buza e gjolit e gjer në vend, urdhër tushemishtarëve t'i djegin e t'i sjellin gëlqere, urdhër një mjeshtri Vllahie që t'ia shuajë gëlqeren, urdhër s'di se kujt të presë e të sjellë qereste të shëndoshë gështenje.» «Me pagesë?» – më pyete zotrote? «Jo, ore, ç'është ajo pagesë? Bukën sikush në torbë nga shtëpia e një kopaçe kurrizit. Se kështu ish atëherë: puna-punë, pa pagesë, e kopaça kopaçe. Pastaj dërgoi e thirri mjeshtrit e Pvelanit të Mokrës, të vijnë me çekanë e mistri. «Erdhët, ore?» «Erdhëm, bej». «Hajt ndërtoni mbi lumë dy magaze të mëdha me qemer. Muret i dua qereç e rosan të fortë, që të mos i prishë lumi.» Edhe gazet u ndërtuan.

Ç'të bënte lumi i gjorë? Bej, ky! Pa ç'pa, e hyri nën kubënë me qemer si në furriq, edhe i mbajti vite me radhë gazet përsipër, se këto i sillnin qira beut.

Kur të del që aty, nga furriqi, e t'i turret gjolit, i lodhur pas kaq kthesash e ngushticash: i doli përpara, nën jaz, kopshti e shtëpia e Azis efendiut të tapive dhe, më tej, luadhi i madh i beut të madh, e bënë të dredhonte përsëri udhën midis shëlgjesh e plepash. Më së fundi, shkoi edhe nën një urë tjetër me qemer, si samar gomari, pranë mullirit të fundit të beut, u zvarrit rrëzë avllisë, afër perdheseve të evgjitëve, teva-binjve të beut, edhe hyri në gjol, i kapitur, i turpëruar e i përunjur, si s'ka lumë tjetër të madh në botë.

Aty, në gjol, ish mirë, se uji përzihet me ujin e s'të pyet cili je ti e cili ka qenë yt atë a yt gjysh. Barazi kjo, or tungjatjeta: ujë ti, ujë unë e së bashku gjol i madh!

Kur e kur, më fort në dimër, kur frynte veriu, dallga e gjolit i sulej lumit përpjetë, kështu që ky mbushej me ujë, zgjerohej, gëzohej. Gëzohej, sepse peshku ngji-

tejt përpyetë e dilnin njerëzit ta gjuanin natën me hostë e fener. Beu varte vetullat, po ç'ti bënte veriut e dallgës?

Në mot të ngritë, në cikmën e shënëndreut, peshku i mirë – belbica e lekna pikalore – ngjiteshin gjer lart fare. Si e qysh i kapërcente pragjet e shkëmbinjve, nuk e di, po di se ai që ishte i zoti kthehej në shtëpi me shportat e torbat plot me peshq pa hala nga ata që i do lala... Dhe tërë bota e lëvdonte Lumin e Madh.

Kësaj s'ke ç'i thua, se dallga e gjolit s'pyet për bej e për aga: ajo turret kur e ngre veriu edhe e mbush grykën e lumit. Bashkë me dallgën hyn edhe peshku. Po e kaqja ishte se njerëzit e kishin bërë lumin kutullaç si litarin në thes e si të drejtën nëpër nenet e ligjeve.

Vite me radhë, që kur zuri të ngushtohet vendi e të shtohet lakmia, Lumi i Madh i duroi të gjitha. Jo vetëm ato që thashë, po edhe tërë plehërat dhe fëlliqësitë e botës – që nga macet e qentë e ngordhur e gjer ne kominat e kazaneve të rakisë e sa të tjera (se kjo botë paska shumë palavi e të gjitha i hedh në lumë).

Zemërmadh, siç ish, lumi zbriste kur e kur me vërtik dhe i lante e spastronte. Atëherë bota dilte ne pragu i derës dhe shikonte se si u vinte fshesën palavive. Si mbaronte punë, lumi tarakste, shteronte e i dukej tërë shtrati i pastër si pasqyrë. Atëherë shihej edhe ç'kish sjellë nga lart e ç'e kish lënë në shtrat. E ç'mund të sillte veçse gurë, e kërçeje? Tamam këta i duheshin botës: kërçelet që t'i digjte në zjarr e gurët që të bëjë mure të reja.

Njëherë, kur e pa veten shumë të ngushtë, lumi i tha fshatit:

– Ore, mua po më shtrëngon puna të vij me rrëmbim, se m'u pre mali e m'u shtuan rrëketë: ca nga Guri i Frëngut, ca nga Guri i Lakuriqkave, nga Gjinavdolli

e Liskoveci, nga Shën në Diela e s'di që ku. Kur bien shira të rrëmbyera, s'kam ç'bëj, e doemos do mbushen majë më majë, do bëj kërdinë. Vëri gishtin kokës. Pleq ke për të pleqëruar, të rinj ke për të punuar. Hap-më udhë, se po s'më hape ti, do ta hap vetë. Mos harro se as ti s'më pyete kur i preve e i dogje korijet e gështenjat që të bësh vreshta e skërka.

Si tha këto fjalë, Lumi i Madh priti sa priti që t'i vinte mendja fshatit, pastaj, një ditë, kur u nxi qielli andej mbi Krushë, u lëshua me bujë të madhe. Më parë i erdhi buçima se sa vetë uji. U tund e u tremb tërë fshati. Kësaj here solli nga lart jo vetëm gurë e drurë, si ngahera, po edhe bagëti të mbytura dhe gjarpërinj të mbledhur kutullaç.

Dhe, që ta shohë gjithë bota se ç'ishte i zoti të bënte, shembi shumë mure e ledhe, ia mori atij mikut derrin me gjithë kotec edhe ua shpuri peshqve, në gjol. Se, si tha një i vjetër, mjaft hëngri njeriu nga uji, le të hajë edhe uji nga njeriu. Pastaj gërreu mezhda e gjerdhe, përkuli plepat e sheligjet që rrinin si devrie anës. Disa i shembi fare. Si bëri këtë punë, çau përrenj nëpër kopshte, teptisi udhëve, hyri oborreve, shtëpive, qilarëve, rrëmbeu ç'mundi: aty një pash me dru, më tej një govatë, një kade me arme e piperka turshi, një voze me verë a raki (se si u ngrënga ai goxha derr pa një gjë majhoshe, pa verë e raki?) dhe i hoqi të gjitha poshtë.

Ç'bënë njerëzia?

Ç'të bënin? Ata gjithë me avazin e Mukes...

Kur binte shiu e gjëmonte lumi, vajtën në kishë e xhami, për duva, se, helbete, për këtë punë kishin bërë kishë e xhami! Ranë kambanat e mëdhja dhe e vogla, këndoi prifti. Doli hoxha ne pragu i xhamisë, (se në minare nuk ngjitej dot) e thirri të tijat.

Disa i lanë ata me mjekër të bënin të tyret dhe

vetë bënë sipas kanunit shumë-shumë të vjetër: nxorën ne pragu i derës sëpatat e latat, thikat e hanxharët, pallat e moçme – të gjitha armët që presin – e i vunë me heun lart, që pika e shiut të pritet përgjysmë, të vritej, të vdesë... Ca, edhe më trima, i ranë qiellit me stringa e pisqolla, që ta hapnin, t'i bënë copë retë... Pellazgë këta, ore!

S'di cila nga këto lidhi e u dëgjua atje lart ku ngjizet shiu (ca thoshin fjala e priftit, ca – ajo e hoxhës, e ca të tjerë tehu i thikës, i shpatës e i sëpatës), po e di se pas pak u kthjellua moti, taraksi shiu, lumi e preu hovin, u kthye në shtratin e tij, u platit, shteri.

Atëherë doli tërë fshati me kuç e maç për të mbledhur drurë e kërçe. Si mbaruan këtë punë, zunë të mblidhnin gurët e grindat për të bërë mure të reja. Ai i derrit, ata të kadeve e të vozeve hipën lundrat e shkuan në gjol të gjenin ato që u kish marrë lumi. Gjoli ish mbushur me piperka turshi, që notonin mbi valë, nëpër resa, me dru e shumë të tjera. Po derri e vozet s'dukeshin gjëkund...

Nga inati, njerëzia mbyllën përrenjtë që kish hapur lumi nëpër kopshtet, forcuan më shumë anët: kush kish pasur ledh e grazhd bëri mur, kush kish pasur mur me gurë të vegjël bëri mur me gurë të mëdhenj me qereç e rosan, që të mos e prishë jo lumi, po as topi i Moskovit!

Pastaj bota e lanë më të harruar e ra sikush pas fitimit: njëri me dyqan – me të blere e të shitur, tjetri me vresht e gështenja. Krisën dasma e gëzime, të lusura e për lusura. Lumin e harruan fare. Ky qeshi nën mustaqe e tha: «Mirë, mirë, po do të vijë një ditë...» Herë-herë turrej pak më i rrëmbyer, po nuk e tepronte shumë.

Pastaj, një vjeshtë (të keqen e asaj vjeshte!) e bëri fora, me pallë në dorë.

Në fillim vetëtiu e gjëmoi, po hehé, sa larg! S'ia vari njeri. «Ehu, thanë, sa e sa herë vetëtin e gjëmon maleve, që mbarsen-mbarsen e pastaj pjellin një mi...» Pastaj vetëtiu afër e më afër. «Pun' e madhe, thanë. Vetëtin e gjëmon më të thatë. S'ka punë tjetër...» Ama tërë këtë kohë Lumi i Madh kish vetëm një vijë uji, që e kapërcente edhe këndesi pa lagur pendët. Në këtë vijë mezi laheshin rosat. Mirëpo këto, rosat, dolën më të zgjuara se sa njeriu: e ndjenë shinë e gagaritën me të madhe. Ashtu edhe galat. Zunë të vijnë vërdallë mbi fshat, të qëndronin xhumbla majë plepave e shelgjeve, të ndillin shi. Fëmijët thoshin se galat bënëin dasmë, se shkonin të merrnin nusen, e prandaj thërrisnin: «Gala, gala, nusja prapa!»

Dhe namëta një buçimë nga ato që s'ishin dëgjuar nga koha e Nuhut: Uturoi e vrungulloi tërë gryka e lumit, nga Krusha poshtë. Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, çatisi lumi: i egër, i turbull, të thoshe se s'ishte lumë, po det me valë. Përlau si për shaka rosat e këndesat (këndesat i mbyti, rosat i shpuri të gjalla në gjol, se ato ujë donin), shembi e vuri përpara vigun e udhës së Mokrës, pastaj urën e Nackës, atë të Çaçes. «Hajt, u tha, me mua, në gjol, se mjaft më shtypët e munduat...» Mirëpo ia preu udhën ajo kubja me rosan që mbante përsipër gazet e beut. Të forta ishin muret që kishin ndërtuar mjeshtërit e Pvelanit, po edhe lumi s'binde më poshtë. Dhe nuk vinte vetë, po me shokë! Shokë kish lisat e grendat. Këta u ranë mu-reve siç i bie dashi me brirë ulkut. U vulos gryka me gurë e drurë. E gjer të çajë udhë e të shembë qemeret, lumi teptisi tejmatanë, u bashkua me ujin e jazit. Dhe sa vinte shtohej, se shiu binte me stomna, rrëketë valonin në të katër anët. Çau udhën drejtpërdrejt nëpër kopshtin e Kozman beut, shembi një shtëpi me tri kate e u turr përmes kopshtit të xha Petres. Ku gjeti

mur – e prishi, ku gjeti pemë – e shkuli, e vuri përpara. Vërshoi udhëve, nëpër pazar, u bashkua me rrëketë që vinin nga lart. Atje ku gjeti kripë e sheqer të kyçura tyxharçe (që të shiten me të shtrenjtë kur mbyllen udhët), i treti në vend se nuk e mbante barra airanë t'i shpinte më tutje; ku gjeti defterë me senete për borxhe, tapi e më the të thashë – i resiti të gjitha. Lumë ky, ore, e Lumë i Madh! Bën si do vetë. Solli edhe shumë gjarpërinj, ulq e dhelpra të mbytura, që i kish gjetur strukur nëpër strofka e një gomar të zi që e kish gjetur tek kulloste me nge. I gjori gomar, s'kish bërë ndonjë faj – ai s'kish as dyqane, as ara e vreshta, as deftere e senete – po kish ndodhur pak si teknefes e nuk i qe larguar lumit kur e kish parë që po vinte i turbullturbulluar. Lumi e mbyti dhe e solli poshtë. E gjer të shembte qemeret me rosan, e shtyu nëpër ulicën e Ndrios, nëpër hajatin e Nasi Ruvinës, hapi vetë derën dhe e nxori në mes të pazarit, me të katër këmbët përpjetë që ta shihte gjithë bota. E shëtiti sa e shëtiti kështu, të fryrë me ujë të turbullt, pastaj e shpuri në gjol e nuk u pa as u dëgjua më.

E bija e dajo Mani u gjend kaluar mbi një but dhe buti në mes të lumit. Thirri, po kush ta dëgjonte? Edhe sikur ta dëgjonte, kush guxonte të hidhej në lumë? Ky e tundi dhe e shkundi, pastaj e fali dhe e hodhi në anë, me gjithë but: gjysmë të gjallë e gjysmë të vdekur. Dajo Mani mbeti rob lufte në qilar, kaluar në një but tjetër, që s'gjente dot udhë të dilte. Ndonji ashtu gjersa pushoi lumi e shpëtoi kokën. Rrojti e ca vjet, po me hidhërim të madh, se i shkoi shtëpia e kopshti me pemë. Për inat, që atëherë e gjer ditën e vdekjes, s'vuri ujë në gojë po vetëm raki.

Atë mot u shemb ajo kulla e lartë e Hysen beut e shumë shtëpi të tjera. Muret që nuk i shembi dot, lumi i vulosi me vulë – pesë pëllëmbë mbi dhe që ta

dijë bota: ja, gjer këtu shkela kësaj radhel! Herë tjetër, po të ma zini udhën, keni për të parë se do t'ju fshi fare nga faqja e dheut!

E nëse herë tjetër ndofta, mund të thoni ju, nuk i kish pasur hije emri «i madh» – që vjen, siç dihet, nga Leka e Pirrua me shokë – asaj dite i ka ndenjtur bukur, siç i rri trimit kapa mbi sy.

Por, medet, asaj dite lumi e teproi në ca gjëra. Jo për ulqit, gjarpërinjtë e dhelprat, as për gomarë e zi, as për magazin e beut, po mori më qafë edhe shpirtra foshnjash e grash pa faj. Këto ishin nga dera e Ndrios, një plak i gjatë, eshtërmadh, flokëbardhë, që s'i bënte keq njeriu. Dikur kish qenë bujk, po që kur ia kish marrë arat beu, qe bërë qerrexhi: shkonte e mbante bar nga luadhet e Sovjanit e të Velitërnës (të beut edhe këto) edhe ua sillte hanave. Kur mbarohej bari, mbante me qerre gurë kraste nga buza e gjolit. Shtëpinë e kish pranë lumit, po jo në buzë, se i kish lënë nja njëzet e ca pash vend, që të hapej, kur t'ia donte puna. Mirëpo aty afër ishin ato dyqanet e mallkuara me rosan, që i kishin zënë udhën lumit. Prandaj, gjer t'i shembë këta, lumi vërshoi anëve, hyri në shtëpi të Ndrios, ia mbylli të renë me gjithë dy foshnja – një në djep e një sapo të përkëmbur... U mbytën të mjerat foshnja në ujë të turbull e shkuan bashkë me nënën në atë botë ku s'ka lumenj të turbull, as dhembje, as lot. Murgu Ndrio shpëtoi gjallë, se ndodhi shumë i gjatë, me kokën gjer lart në tavan, dhe uji nuk e arriti dot atje... Po nuk duroi dot dhembjen dhe pas pak kohe shkoi me të shumtit.

Më në fund, lumi shembi koben e magazin e beut, çau udhën e hoqi përpara.

Që atë ditë mënxyre, fshati nuk i vuri më pengesa, nuk e bëri kutullaç, po ia la udhën të drejtë e të gjatë, ashtu siç e kish hapur vetë. Tani, kur zbret nga malet,

s'gjen përpara as qoshe, as mure, as ledhe, as magaze me qemur dhe shkon drejt në punë të tij e nuk i bën ndokujt: nuk gërryen, nuk shemb, nuk mbyl, se s'ka përse të gërryëjë, të shembë e të mbylë – udhën e ka të hapur. Se si tha ai i miri: vetëm e drejta s'prish punë, po e shtrembra të merr më qafë.

Po ca kohë buza e lumit mbeti kërr, e zhvoshur. Aty s'kish bimësi, që të bënin zogjtë folenë e të këndonin. Pastaj u rritën shelgje, plepa e drurë të tjerë, ana u mbush me blerim e blerimet me zogj, që ia thanë këngës. Vetëm stërgjet u rralluan shumë. Nuk vijnë më në pranverë tufë-tufë për të ngritur çerdhet majë plepave. Po për këta fajin s'e ka lumi. Andej poshtë shteroi blata, u tha kënetat, kështu që s'ka zhaba e gjarpërinj uji për të ushqyer zogjtë e shtërgjet. Në vend të blatës e kënetës të dikurshme ka sot mollë që çelin buzë vere, sa mbushet tërë vendi me erë të mirë. Pastaj, në vjeshtë, ju e dini: koshat plot! Po në doni të dini më shumë, molla u ngjit edhe lart, në ato faqet e zhveshura të dikurshme të Përroit të Gjinos, që s'bënin dikur as thekër e ku shtoheshin e shumëheshin vetëm breshkat. Kur hidhni sytë andej buzë vere, mos pandehni se ka rënë dëborë. Jo, jo! Zbardhin lulet e mollëve. Afër menç, kur vishet mali me pemë, shiu nuk sjell rrëke poshtë në lumë, se ujin e pi dheu. Nesër a pasnesër do të vishet me drurë edhe ajo faqja e këtejshme – Guri i Frëngut e shumë rripa të tjera, që vijnë mbi shtratin e Lumit të Madh. Atëherë të urdhëroni të ngjitemi bashkë përpjetë për të parë tërë atë vend të bleruar e të lulëzuar e të dëgjojmë këngën e ferrakëve...

1944

Ripunuar më 1965

FJALORTH

Beta – Peng.

Binek,-u – Kalë shale, at.

Bumbeskë – Syth i fryrë bime që sapo çel; burbuqe, gonxhe.

Cifun,-i – Vrimë e ngushtë e koritës së mullirit, që ku del me fuqi uji që godet dhe vërtit pendën; cifund.

Cinxull, i (cinxuj) – Zokth me pupla të verdha e të gjelbra, që u afrohet në dimër vendeve të banuara. Në dimër fëmijët i ngrenë leqe dhe këndojnë: «Cinxulli, Minxulli! Nëm një cinxull/ Ta cimboj/ Pa pastaj, Ta dërgoj»; Cinxërr.

Çallëm,i – Rreptësi, Burrë me çallëm, burrë i rreptë, hijerëndë.

Çepurkë,a – Enë e drunjte, e luguar me dorezë, Përdoret në mulli për të hedhur në thes miellin e bluar.

Dajandë-a – Durim; direk, trung ose hu që vihet për të mbajtur një mur ose një ngrehinë tjetër (p.sh. një koritë mulliri) në rrezik të shembet. «Ky mur ka lëshuar bark; do nja dy dajanda të mira».

Dallëndyshkë – Kryqi që lidh sipër pendën e mullirit.

Damf,i – Kundërmim i fortë si fjala vjen, ai i rakisë, i ahurit etj.

Divit,i – Takëm shkrimi që zakonisht mbahej në brez; shishe boje.

1) Fjalët orientale me prejardhje turke, arabe ose persiane janë dhënë në kuptimin që kanë marrë në gjuhën shqipe. (Shënim i M. Kutelit).

2) Për shpjegimin e fjalëve të cilat nuk përfshiheshin në «fjalorthet» e autorit falënderojmë Mësuesin e Popullit, Kol Koci, Prof. Selami Pulahën, doc. Qevqep Kambon e Kozma Bashon.

- Dymeni* – Timon, lopatë që vendoset në pjesën e prapme të varkës dhe bën punën e timonit.
- Dhëmb-parasi* – Taksë e shpikur nga bejlerët për dhëmbët që u harxhoheshin nga të ngrënat nëpër fshatrat e tyre.
- Fatakeq-i* – Shëndetlig, shëndetkeq, thuhet edhe «i fatakequr».
- Fetaqi,a* – Pjesa e poshtme që vë në lëvizje gurin e mullirit: cifun bosht, pendë. Në felaqi hyhet duke ngritur qepenin që gjendet pothuaj përbri koshit.
- Fiknaxhi* – Njeri i cili u fut spica shokëve apo miqve për t'i armiqësuar.
- Fragjeps* – Thaj, përthaj, plasarit.
- Fushqi,a* – Fushki, pleh dhish.
- Gushëkuq-i* – Kështu u thoshin xhandarëve në kohën e Zogut, sepse kishin nga një copë cohe të kuqe të qepur në jakën e xhaketës së mbyllur.
- Harbi,a* – Shufër e hekurt për të mbushur pushkën e për të fshirë grykën e saj.
- Haznë* – Thesar, visar, hazine.
- Hazëroll* – Gatitu!
- Ilderem, marsh!* – Marsho si rrufel!
- Idaré* – Sigurimi minimal i një ushqimi, p.sh. bëra trahan sa për idare; ekonomi, kursim.
- Indisap (tq. ihtisab)* – Taksë në monedhë që i paguhej administratës së qytetit.
- Lekuqe* – Veshje e sipërme burrash që arrin deri në bel, punuar me lesh deleje ose me lesh deleje e dhie së bashku, mëngët i ka të shkurtra dhe jakën me thekë.
- Jar (si)* – Shumë i pastër e i kulluar, si ar.
- Kapan,i* – Peshore me pjatë që mbahet në dorë.
- Karabatak,u* – Një nga zogjtë e liqenit të Pogradecit që vjen në vjeshhtë e ushqehet me peshq. Shumë herë rri bashkë me nositin, të cilit i jep peshk.
- Kolloface* – Zorrë e mbushur me mish koke, me presh dhe erëza.
- Krazë, a* – Karton: lak prej fijesh bishti kali për të zënë zogj.
- Kullme (i, e)* – Në ngjyrë mjalti, të verdhë në të kuq (për kuaj).
- Lusura (të)* – Kremtime të festave të ndryshme fetare.
- Mandall-i* – Një copë dërrasë që vihet sipër ose anës derës dhe shërben për ta mbyllur këtë nga brenda.

Marauzhgë-a – Milingonë.

Mërcgat (shum.) – Njëfarë trire prej copë dërrasash ose hunjsh të vegjël, që vendoset në krye të koritës së mullirit për të mbajtur sendet që mund të pengojnë punën e rregullt të pendës.

Meqezme – Lule, zbukurim vertikal që bëhet në çorape në zonën e Mokrës.

Narden – Brumi që mbetet nga zierja e kumbullave të tharta. Ky brumë përdoret për të ndërtuar gjellët, në vend të salcës së domateve; p.sh. u bë narden – u thartua, u zemërua sa s'plasi.

Ogradisur (i) – I rënë mësysh, i sëmurë nga që e kanë marrë më sysh.

Otra, ja – Hu i gjatë, i fortë që futet nga lart në dhëmbët e pendës së mullirit, që të ndalet.

Peshin – Aty për aty; p.sh. e këmbëu me drithë peshin – këmbëu me drithë aty për aty e jo që do t'i jepet më vonë, veresie, në bazë të një fjale.

Pillashtë, a – Anie, dërrasë e pagdhendur që nxirret nga pjesa e jashtme e trupit të drurit. Pillashtat janë si të thuash, dërrasa me vlerë të vogël dhe përdoren për çati, çatma ose për të rrethuar kopshtet si gardh.

Pod, i – Arkë ose e ndarë drejtkëndëshe, ku bie mielli i bluar, përballë gurit.

Psomi (gr.) – Bukë.

Purë – Hi i nxehtë, shpuzë, prush.

Rosan,i – Suva e fortë për të mbrojtur muret nga lagështia.

Zhavar – Bimë që rritet në anë të kënetës e liqenit, me kërcell të hollë, kashtë kënete, shavar.

Zhavuloj ose: zhavloj – Ik me të shpejtë, me nxitim.

Salavate – Nderime të mëdha

Sinjak – Brymë e hollë që bie e mbulon drurët në dimër (i thonë edhe «okitës»)

Shtëng – Shumë i ngjeshur.

Syngjitak – Luftë me thikë, me bajonetë.

Shukretë – Shpullë e fortë, dackë.

Shusha – Xhade –

- Tatrivan* – Mjet transporti i mbyllur, që mbahej nga dy njerëz;
 «si në tatrivan,» – si në erë, si në hava.
- Tebabi* – Shtresa më e ulët e njerëzve që jetonin nën mbrojtjen
 e njërit be nga bejlerët e tjerë.
- Tembi* – Bind me forcë, përmbledh. (bëj tembi)
- Titis* – Dorështrënguar.
- Torozhan* – Zog me madhësinë e mëllenjës, ngjyrë afërsisht kafe
 që del dimrit.
- Trambë (bëj)* – Shkëmbim
- Tropo-ja* – Mënyrë, intrigë, vrasje. «Ia gjeti tropon», ia punuan e
 vranë.
- Urgjisur (i)* – I mallkuar.
- Ushë-ushëzë* – Kasolle e vogël e ndërtuar me degë e me fletë,
 ku rri fshehur gjahtari për të pritur gjahun.
- Xhaftoj* – Përpiqem shumë për të nxjerrë jetesën. Punoj e xhaftoj
 për të mbajtur shtëpinë.
- Zek, u* – Dëshirë, dëfrim; më desh zekun – më desh qejfi.

SHËNIM

Gjuha e veprës letrare të Mitrush Kutelit i përket dialektit jugor, me nuancat lokale të trevës së Pogradecit. Ajo tregon se autori është njohës i thellë dhe shumë i saktë i gjuhës së gjallë të popullit, e cila në veprën e Kutelit shpaloset me gjithë begatinë e vet.

Synimi i redaksisë ka qenë që në përgjithësi ta ruajë gjuhën me të cilën ka shkruar autori me veçoritë e saj individuale, por edhe të kohës kur u shkrua vepra dhe të trevës ku ajo u ngjiz.

Kemi ndjekur këto kritere në trajtimin e gjuhës së veprës:

Në asnjë rast nuk kemi prekur ndërtimin sintaksor dhe leksikon e veprës. Për fjalët e fondit të lashtë leksikor të popullit, që mund të jenë të panjohura për lexuesin, kemi dhënë shpjegime në fund të secilit vëllim të serisë.

Për sa i përket drejtshkrimit jemi përpjekur që vepra e autorit të mos pësojë gjymtim në stilin e vet, por edhe të mos tingëllojë tepër anakronike edhe lokale, për më tepër se vetë autori gjatë punës së tij krijuese ka ardhur duke e afruar drejtshkrimin e veprës së tij me atë të sotmin. Këtë evoluim të autorit në njëfarë mase jemi munduar ta ruajmë edhe në vepër.

— Kemi lënë të paprekura fjalë që ndryshojnë nga trajta që ato përdoren sot, sepse ato janë kthyer dhe në veçori stilistikore të gjuhës së autorit, p.sh. *kronjtë, kreishta, deshinj, liqer, skllavesha, pagëtyrë, grynjat, i zbardhylët, i rëposhtëm, pëllorë, i zgjebur, manxer, trunç* etj.

— Kemi lënë të pandryshuara dhe emërtimin e ditëve të shenjta, apo përshëndetjet, që autori i jep në trajtën e përdorur nga populli, p.sh. *shëmbitër, miserdhe* etj.

- I kemi lënë të pandryshuara parafjalën *ne* për *te*, *tek*, *si* dhe disa shprehje ndajfoljore që s'përdoren sot.

- Është ruajtur drejtshkrimi i disa emrave të përveçëm si *Amua*, *Genthi* etj.

- Është ruajtur e kryera e thjeshtë me - në në disa folje si: *vanë*, *arrinë* etj.

- Është ruajtur forma mbiemrore: *turbullonjës*, *shpjegonjës* etj.

- Është ruajtur trajta foljore *shkoi* të marrë për *shkoi* të *merre* që përdoret sot.

- Është ruajtur kallëzorja me - në vetëm në emrat e gjinisë mashkullore që mbarojnë me e të theksuar, si *Shkënderbenë*, *Ishanë*, *dhenë*; në raste të tjera e kemi ndryshuar sipas rregullave të sotme gramatikore e drejtshkrimore.

Janë bërë ndërhyrje në përgjithësi në ato raste kur drejtshkrimi ka të bëjë me çështje të karakterit grafik e që nuk sjellin ndryshime në shqiptimin e fjalës.

- Apostrofin, vizat ndarëse të fjalëve, fjalët bashkë apo ndarës i kemi vendosur sipas rregullave të sotme drejtshkrimore.

- Bashktingëlloret e shurdhëta në mes dhe në fund të fjalës i kemi kthyer në të zëshme, si p.sh. *i math* - *i madh*, *trahhtar* - *tradhtar*, *ndes* - *ndez*.

- Bashktingëlloren *j* në disa raste e kemi kthyer në *i*, si *djell* - *diell*, ose e kemi evituar si *Shqipërija* - *Shqipëria* etj.

- *Y* e kemi kthyer në *i* të rastet: *ay* - *ai*, *krypë* - *kripë*.

- *f* në *th* - *fellë* - *thellë*;

- *ll* në *l* - *llatin* - *latin*

- *th* në *t* - *theatër* - *teatër*

- Grupin bashktingëllor *mb* e kemi eliminuar në rastet *embër* etj.

- Parafjalët, *mi* në *i* kemi bërë *mbi*, *ndër*.

- *Rr* e kemi vendosur sipas rregullave të sotme drejtshkrimore.

- Grupin *lë*, *rë* e kemi bërë *el*, *er* në rastet: *veglë* - *vegël*, *motrë* - *motër*.

- *Q* në disa fjalë e kemi kthyer në *k*: *shqelm* - *shkelm*.

- Kemi ndryshuar disa zanore në shumësin e emrave ose në fjalë si p.sh.: *degat* - *degët*, *qërtoj* - *qortoj*, *nëmëroj* - *numëroj* *ta varën* - *ta varrin*.

– Nj në vetën e parë të kohës së tashme të foljeve e kemi bërë
j: *punonj – punoj*.

Janë bërë ndërhyrje në rastet e disa formave gramatikore të
përdorura jo drejt, si *neve* për *ne* në rasën kallëzore tënde për
sate në rasën gjinore etj.

Për përgatitjen e këtij botimi jemi konsultuar me të gjithë bo-
timet e këtij autori. Në disa raste, si në tregimet e përfshira te
vëllimi «Tregime të zgjedhura», jemi mbështetur në botimin e fundit,
ndërsa në rastin e novelave të përfshira te «Në një cep të Ilirisë
së Poshtme» jemi bazuar në botimet me të hershme.